- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit si dhe
- Arkivit të Komunës.

Hani i Elezit
Data: 21. 08. 2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



6.1 Korniza strategjike

Për përgatitjen e Kornizës strategjike është marrë për bazë Planin Hapësinor i Kosovës, i cili jep orientimet dhe përcakton shtrirjen hapësinore të zhvillimeve në të ardhmen (deri në vitin 2020+) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. PHK shërben edhe si udhëzues në hartimin e planeve zhvillimore komunale.

6.1.4 Strategjitë sektoriale në nivel lokal dhe qendror

Planin Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+ - sipas PHK –së Hani i Elezit është përfshirë në Hapësirën e Verdhë të quajtur "Urat e Kosovës" e cila zë pjesën jugperëndimore të Kosovës¹. Urat e Kosovës (Hapësirat e verdha) – duke përfshirë hapësirat shërbyese tregtare, agro-industriale e turistike - paraqesin ndër të tjera pjesën juglindore të Kosovës, të përbërë nga komunat: Ferizaj, Gjilan, Kaçanik, Shtërpce, Kamenicë, Novobërdë, Viti dhe Hani i Elezit, në qendra qytetesh e Ferizajt dhe Gjilanit;

Vizioni i Hapësirës së Verdhë e parasheh atë si *Urë të zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, me rrjet funksional të qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm, atraktive për investime dhe ndërmarrësi në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm shërues e rekreativ me plotësimin e kriterëve për mbrojtje të mjedisit*. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, parashihet të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agro- industriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.

Qëllimet e Përgjithshme të Zonës së Verdhë të cilat janë më rëndësi për Hanin e Elezit janë përcaktuar si në vijim:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje e Zhvillimit Ekonomik Lokal ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda urbane, ndërrubane me hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja e zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

Hani i Elezit si qendër e vogël do të ketë një rol aktiv në planifikimin e ardhshëm hapësinor në aspekt të përmirësimit të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe forcimit të lidhjeve me fshatrat përreth, në përpjekje që e tërë zona të funksionojë mbi bazën e programeve të paracaktuara për zhvillim. Në këtë aspekt është e rëndësishme pozita e Hanit të Elezit në raport me autoudhën R6 dhe rrugën nacionale N2.

Komuna e Hanit të Elezit hyn në kuadër të komunave me ekonomi më pak të zhvilluar dhe depopullim të vendbanimeve ku strategjia e Planit Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020+ për këtë qëllim ka përcaktuar veprime si:

- përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve të reja të infrastrukturës teknike si rrjetit të shpërndarjes së rrymës elektrike, vendosjen e trafostacioneve të reja për përmirësimin e

¹ Për arsye se PHK është përgatitur më herët dhe miratimit i tij ka pasur shumë vonesa, Komuna e Hanit të Elezit nuk është përmendur direkt edhe pse është promovuar si Komunë me të drejta të plota më 2008


tensionit të rrymës elektrike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, sistemeve të ujitjes, rrjetit të telefonisë fikse dhe internetit;

- përmirësimi dhe ngritja e infrastrukturës së re sociale si ndërtimi i shkollave dhe punkteve shëndetësore të reja, shpërndarja e tyre në mënyrë adekuate, përmirësimi i atyre ekzistuese si dhe përmirësimi i shërbimeve;
- zhvillimi i infrastrukturës së transportit si asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i rrugëve të reja në mënyrë që të sigurohet lidhja më mirë ndërmjet vendbanimeve brenda komunës dhe me komunat fqinje;
- stimulimi i bujqësisë dhe blegtorisë në mënyrë që të ulet edhe shkalla e migrimit prej fshatrave në qytete;
- krijimi i mundësive për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në mjetet teknike, duke ndikuar në hapjen e vendeve të reja të punës, sidomos në bujqësi. (shih. PHK 2010-2020+ fq. 161, 162, 168)

Veprimtaritë ekonomike në komunë duhet të planifikohen në bazë të kushteve të dhëna në Strategjinë e Zhvillimit Hapësinor në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ (shih fq. 184).

Bujqësia dhe resurset mjedisore paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e Hanit të Elezit andaj është e nevojshme të shmangen konfliktet e mundshme gjatë zhvillimeve të ardhshme, sidomos shtrirja e vendbanimeve në tokën bujqësore dhe degradimi i lumenjve dhe pyjeve. Andaj, mbrojtja e mjedisit, resurseve natyrore dhe kulturore do të realizohet përmes masave dhe veprimeve e përcaktuara me Planin Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020+ për objektivin Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe degradimi. (shih fq. 170).

Si sinergji e mundshme gjatë zhvillimeve të ardhshme është identifikuar zhvillimi i fshatrave për turizëm kulturor, rekreativ dhe tradicional me zhvillimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.



Harta 1. Strategjia e Zhvillimit Hapësinor (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+)

Përpos PHK 2010 – 2020+ janë konsultuar edhe strategjitë sektoriale të nivelit qendror dhe komunal, ku vetëm disa nga ato përmenden më poshtë.

- *Strategjia Kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH), Prishtinë 2016;*
- *Strategjia e sigurimit të cilësisë për Arsimin parauniversitar në Kosovë 2016-2020, Prishtinë, 2013;*
- *Strategjia e sigurimit të cilësisë për Arsimin parauniversitar në Kosovë, Prishtinë 2016;*
- *Strategjia për konsolidimin e Tokës 2010 – 2020, Prishtinë 2010;*
- *Strategjia për zhvillimin e pylltarisë 2010 – 2020, Prishtinë 2009;*
- *Strategjia për zhvillimin e pylltarisë 2022 – 2030, Prishtinë 2021;*
- *Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017 – 2016, Prishtinë 2017*
- *Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2022 – 2031, Prishtinë 2023;*
- *Strategjia e ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011 – 2018, Prishtinë 2011;*
- *Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publike Private për Republikën e Kosovës, Prishtinë 2014;*
- *Strategjia sektoriale dhe transportit multimodal 2015-2025 dhe Plan i Veprimit 5 vjeçar, Prishtinë 2015;*
- *Strategjia kombëtare për trashëgiminë Kulturore 2017-2027, Prishtinë 2016;*
- *Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësim, Prishtinë 2014;*
- *Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2016 – 2020, Prishtinë;*
- *Strategjia sektoriale e shëndetësisë, Prishtinë 2016.*

Plani Zhvillimor komunal i komunës së Hanit të Elezit 2010 – 2025+ - me PZHK-në në fuqi janë përcaktuar prioritetet strategjike si në vijim:

- *Përmirësimi i infrastrukturës shoqërore, sistemit të arsimit dhe shërbimeve shëndetësore (rritja e kapaciteteve fizike dhe burimeve njerëzore);*
- *Rritja e kapaciteteve industriale (tërheqja/sjellja e bizneseve të reja);*
- *Konservimi, mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror dhe biodiversitetit;*
- *Kontrolli i Zhvillimit (hartimi i planeve rregulluese);*
- *Zhvillimi rural (bagëtitë, pemishtet, bletëve e mjalit);*
- *Përmirësimi i infrastrukturës fizike;*
- *Lidhja e rrugës Hani i Elezit-Gllloboçicë (lidhja e dy pikave kufitare);*
- *Mbrojtja dhe konservimi i trashëgimisë kulturore (zhvillimi i turizmit rural dhe kulturor);*
- *Përmirësimi i cilësisë së banimit;*
- *Bashkëpunimi ndër-komunal dhe ndërkufitar.*

Plani zhvillimor urban 2010 – 2025+ (PZHU), koncepti zhvillimor i qytezës së Hanit të Elezit është bazuar në skenarin C që parashihet zhvillimin e qytezës së Hanit të Elezit në formë kompakte dhe të balancuar. Për arritjen e këtij zhvillimi plani ka përcaktuar strategjitë dhe veprimet e masat, për secilën fushë tematike. Strategjitë e parapara janë si në vijim:

- *Strategjia 1. Sigurimi, rregullimi dhe mbrojtja e tokës së destinuar për shfrytëzim publik;*
- *Strategjia 2. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore;*
- *Strategjia 3. Rritja e cilësisë në sektorin e arsimit;*
- *Strategjia 4. Krijimi i kushteve për aktivitete shoqërore, kulturore dhe sportive;*
- *Strategjia 5. Krijimi i kushteve për zhvillim të ri industrial dhe mbështetje të industrive aktuale;*
- *Strategjia 6. Promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve tregtare, transportuese të mallrave dhe shërbyese – hoteliere;*
- *Strategjia 7. Promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë urbane;*
- *Strategjia 8. Krijimi i infrastrukturës për zhvillimin e turizmit;*
- *Strategjia 9. Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike;*
- *Strategjia 10. Përmirësimi i infrastrukturës së energjisë elektrike dhe telekomunikacionit;*
- *Strategjia 11. Krijimi i një sistemi për menaxhimin e mbeturinave;*
- *Strategjia 12. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën urbane;*
- *Strategjia 13. Hapja dhe rregullimi i shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë;*
- *Strategjia 14. Themelimi i sistemit të transportit publik;*
- *Strategjia 15. Mbrojtja e mjedisit;*
- *Strategjia 16. Dekontaminimi në zonat e kontaminuara;*
- *Strategjia 17. Përmirësimi, krijimi dhe mbrojtja e hapësirave të gjelbra (biodiversitetit) dhe peisazhit urban;*
- *Strategjia 18. Reduktimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu;*
- *Strategjia 19. Rritja e dendësisë së banimit;*
- *Strategjia 20. Promovimi i partneritetit publiko privat;*
- *Strategjia 21. Rritja e mundësive për strehim të përballeshëm dhe banim social; dhe trajtimi i ndërtimeve ilegale.*

Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023 – 2027, dokument i cili synon të sigurojë një kornizë strategjike për menaxhimin e qendrueshëm të mbeturinave për periudhën pesëvjeçare për tërë territorin e komunës në pajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe kornizën planifikuese strategjike. Objektivat e planit janë si në vijim:

- *Objektivi 1. Parandalimi dhe reduktimi i krijimit të mbeturinave;*
- *Objektivi 2. Ripërdorimi dhe riciklimi i mbeturinave;*
- *Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave;*
- *Objektivi 4. Trajtimi dhe deponimi i sigurt i mbeturinave si mjeti i fundit;*
- *Objektivi 5. Zhvillimi i kuadrit dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave.*

Plani komunal për efikasitet të energjisë 2017 - 2022– PKEE, dokument i cili adreson konsumin e energjisë në stokun e ndërtesave dhe ndriçimin publik në pronësinë dhe nën menaxhimin e Komunës së Hanit të Elezit dhe ofron veprimet dhe masat për të përmirësuar efikasitetin në këto objekte që do të ndikojnë në zvogëlimin e shpenzimeve operacionale, optimizimin e shërbimeve, zvogëlim të emetimit të gazrave të dëmshme dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës. **Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë për territorin e komunës së Hanit të Elezit**, udhëzues për identifikimin e shkallës së rrezikshmërisë nga faktorët potencial, planifikimin e masave parandaluese për pengimin dhe zvogëlimin e dëmeve në raste të fatkeqësive natyrore eventuale, përfshirjen dhe trajnimin e të gjitha strukturave dhe shërbimeve gjegjëse komunale të koordinimit të aktiviteteve në raste të fatkeqësive – katastrofave si dhe për angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim me qëllim të ndihmës, vetëndihmës, shpëtimit, evakuimit dhe strehimit të të rrezikuarve dhe zvogëlimin e dëmeve materialo-teknike, sigurimin e kushteve për institucionet Komunale dhe atyre të cilat veprojnë në territorin e Komunës për veprimtari ekonomike, për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente.

Plani lokal i veprimit në mjedis 2021 – 2026, dokument planifikues-strategjik i cili adreson zgjedhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal. Plani ka identifikuar problemet mjedisore dhe bazuar në këtë ka përcaktuar objektivat, prioritetet dhe veprimet që duhet ndërmarrë për të tejkaluar apo zbutur këto probleme.

Strategjia për zhvillim ekonomik 2024 – 2028, dokument që përcakton sfidat, synimet, qëllimet strategjike, objektivat dhe buxhetin për zhvillimin e qëndrueshëm socio – ekonomik të komunës. Objektivat strategjike të strategjisë janë:

- *Promovimi i komunës së Hanit të Elezit në rajon;*
- *Zhvillimi i pikave me potencial turistik;*
- *Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;*
- *Rritja e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme;*
- *Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar;*
- *Promovimi i kulturës dhe sportit në Han të Elezit;*
- *Revitalizimi i objekteve me trashëgimi;*
- *Hartimi i planit për rini;*
- *Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore;*
- *Shërbime të përmirësuara në shërbimet sociale;*
- *Mbrojtja e mjedisit nga ndotja;*
- *Vetëdijësimi i lartë rreth fermave;*
- *Zhvillimi i fermave;*
- *Mirëmbajtja e hapësirave publike;*
- *Ofrimi cilësor i shërbimeve publike.*

6.1.5 Strategjitë rajonale

Strategjia për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030, është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të politikës së qeverisë për arritjen e një zhvillimi të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të rajoneve të vendit dhe për tejkalimin e dallimeve / pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të politikës evropiane të kohezionit dhe arritjes së rritjes të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Kjo strategji realizon politikat dhe programet duke marrë parasysh ndarjen rajonale në pesë (5) rajone zhvillimore: Rajoni Zhvillimor Qendër, Lindje, Perëndim, Jug dhe Veri, ku komuna e Hanit të Elezit bën pjesë në Rajonin Zhvillimor Lindje.

Objektivat strategjike të kësaj strategjie në të cilat është bazuar edhe PZHK e komunës së Hanit të Elezit janë:

Objektiv strategjik 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal;

Objektivi strategjik 2. Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;

Objektivi strategjik 3. Shfrytëzimi i resursëve natyrore, kulturore dhe humane në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

Plani rajonal i trashëgimisë Lindje 2015 – 2018 - të cilit rajon i përket edhe komuna e Hanit të Elezit synon të siguroj përfitime për komuniteti lokal përmes ngritjes së nivelit të vetëdijes , vlerësimit, shijimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm ekonomik apo për qëllime tjera të trashëgimisë së pasur kulturore dhe natyrore.

Sa i përket rajonit të komunës së Hanit të Elezit Plani rekomandon veprime dhe masa të cilat do të kontrobuonin në arritjen e synimeve të planit dhe programit rajonal:

- Ngritja e vetëdijes dhe promovimi i vlerësimit të trashëgimisë në Kosovën Lindore
- Marrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë në Kosovën Lindore
- Zhvillimi dhe inkurajimi i vlerësimit të plotë, hartimit dhe planifikimit të projektit të integruar për menaxhimin e trashëgimisë në rajon
- Zhvillimi dhe koordinimi i praktikave të duhura të menaxhimit për kujdesin ndaj trashëgimisë në Kosovën Lindore
- Zhvillimi në nivel lokal i nismave të përshtatshme dhe të qëndrueshme të turizmit të trashëgimisë në Kosovën Lindore

Kompleksi i ndërtesave në lagjen e Bravës, afër fshatit Puset e Nikës, është njohur si potencial për zhvillimin e turizmit rural duke pasur parasysh objektet e ndërtuara tradicionale të cilat janë të ndërlidhura me stilet tradicionale të jetës së pronarëve. E shtrirë në një zonë të izoluar malore, gjendja aktuale e këtij kompleksi do të mund të revitalizohet dhe të ofrohet si një aset për këtë rajon me mjedisin e vet të bukur natyrorë. Gradualisht, vendi mund të ofrojë programe të ndryshme në ilaçet shëruese bimore.

6.1.6 Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat nga Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+

Hartimi i PZHK është bazuar në zhvillimet e planifikuara për zonën jugperëndimore "Urat e Kosovës", mirëpo me ndryshime në disa aspekte për t'u përshtatur me kërkesat e banorëve dhe trendin e zhvillimeve në komunë.

6.2 Informata për procesin e planifikimit

6.2.4 Prezantimet dhe diskutimet publike

Duke u nisur nga qëllimet e PZHK-së dhe fushat që trajtohen në procesin e hartimit të këtij dokumenti, qasja ka qenë gjithëpërfshirëse përgjatë tërë procesit, me qëllim të ofrimit të një kornize të plotë dhe të qëndrueshme të zhvillimit, e cila do ta orientojë zhvillimin dhe do ti paraprijë planifikimit në nivel me specifik. Hapi i parë i procesit pjesëmarrës ka filluar me identifikimin dhe listimin e palëve të interesuara në proces, fillimisht ata që janë të ndikuar drejtpërdrejt nga çështja, ata të cilët kanë interes dhe ata që mund të ndikojnë në projekt dhe/ose të kenë qasje/kontroll mbi burimet (financiare, teknike, intelektuale). Faktori njeri është një nga komponentët kryesorë dhe ndikues në qëndrueshmërinë e projektit. Prandaj, dhënia e "pronësisë" së Planit Zhvillimor Komunal

autoriteteve që janë përgjegjëse për zbatim ishte thelbësore, gjithnjë duke inkurajuar edhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Duhet thesuar se është dizajnuar dhe ofruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent, sepse kjo mënyrë mundëson arritjen e një rezultati të pranueshëm, që është i kënaqshëm për të gjitha palët e interesit.

Grupi punues komunal i formuar me qëllim të zhvillimit të procesit dhe hartimit të dokumentit ka qenë grup multi-profesional i përbërë nga stafi i disa drejtorive komunale, të cilët kanë analizuar zhvillimet dhe propozimet në fushat e zhvillimit hapësinor, ekonomik, social, infrastrukturor dhe mjedisor, të përkrahur nga konsulentë të jashtëm të angazhuar nga Komuna. PZHK në çdo fazë është prezantuar para Grupit Drejtues dhe në raste të caktuara para Bordit të Drejtorëve (Grupi Ndihmës Drejtues) për të marrë rekomandimet/ udhëzimet e nevojshme dhe dritën e gjelbër për të vazhduar më tutje.

Duhet theksuar se në proces të përfshirjes së pjesëmarrësve/grupeve punuese janë përdorur nivele vijuese: **Informimi:** komunikim i njëanshëm, ku pjesëmarrësit janë informuar për PZHK-në, procesin e hartimit si dhe çështjet që ndërlidhen me komunën e Hanit të Elezit. **Konsultimi:** komunikim i dyanshëm, ka përfshirë një numër më të madh të pjesëmarrësve (prezantime dhe punëtori) ku atyre u është ofruar mundësia që të shprehin sugjerimet dhe shqetësimet e tyre. Është aplikuar në të gjitha fazat e hartimit të PZHK-së duke filluar nga profili i gjendjes ekzistuese, definimi i Vizionit, përcaktimi i skenareve të zhvillimit, plani i veprim etj. **Ndërtimi i konsensusit:** është zbatuar për të kuptuar njëri-tjetrin dhe për të arritur në përfundime të negociuara që janë të pranueshme për të gjithë. dhe është aplikuar gjatë përcaktimit të Vizionit, skenareve të zhvillimit, planit të veprimit etj për komunën e Hanit të Elezit.

I gjithë procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore: profili, vlerësimi i gjendjes, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha fazat janë përcjellë me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant dhe punëtori respektive. Punëtoritë janë organizuar për çdo fazë në bashkëpunim me EKP-në dhe kanë shërbyer si mjet për të diskutuar përmbajtjet e çdo kapitull të PZHK-së. Këto aktivitete janë organizuar si në vijim:

- Takimi publik për diskutimin e Profilit të Komunës është mbajtur në qershor të vitit 2019. Duke u nisur nga të arriturat e mëhershme, në këtë punëtori janë shqyrtuar dhe analizuar edhe potencialet e mundshëm të zhvillimit hapësinor dhe ndikimit reciproke sektoriale. Debati dhe komentet, në këtë punëtori, u përqendruan në informacionin, në lidhje me zhvillimet private në Zonën urbane dhe tek fshatrat e mëdha.
- Punëtorja e Vizionit dhe Skenarëve të zhvillimit është mbajtur në janar 2021. Në këtë punëtori është diskutuar dhe analizuar situata aktuale e Hanit të Elezit, është bërë rishikimi i gjendjes dhe sfidave aktuale në fusha të caktuara tematike, janë parashikuar tendencat të ardhshme. Të gjitha janë përmbledhur në një deklaratë të përbashkët të Vizionit për komunën e Hanit të Elezit. Puna e grupeve punuese ka qenë e përqendruar në krijimi i skenarëve të mundshëm për të ardhmen e komunës së Hanit të Elezit.
- Punëtoritë (4 sosh) për Planin e Veprimit dhe përcaktimit të Prioriteteve Strategjike janë mbajtur në mars/ prill/ maj 2021. Gjatë këtyre punëtorive janë shqyrtuar dhe përcaktuar Prioritetet Strategjike dhe veprimet/ aktivitetet/ projektet për secilën fushë tematike, si elemente që përbëjnë bazën e nevojshme për hartimin e Hartës Zonale. Po ashtu, në këtë punëtori janë prezantuar dhe shqyrtuar objektivat e reviduar dhe indikatorët e VSM-së, si dhe vlerësimi i kompatibilitetit të vizionit.
- Në shkurt 2022 është organizuar një takim në mes të grupit drejtues, grupit punues, shoqërisë civile dhe pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme, ku është diskutuar për destinimin e sipërfaqeve dhe ndonjë aktivitet shtesë në plan të veprimit. Janë detajizuar hapësirat ku mund të zhvillohet turizmi, sikurse janë lokacionet në Pusteni, Gorancë dhe Neçavc, po edhe në pjesët tjera të komunës. Po ashtu është biseduar edhe për kahet e zhvillimit përgjatë Rrugëve nacionale dhe lokale. Ky debat ishte shumë i rëndësishëm për përfundimin e hartimit të PZHK-se për Han të Elezit.
- Në shtator 2022 është mbajtur punëtorja rreth shfrytëzimit të planifikuar të tokës me

anëtarët e grupit punues dhe palët tjera interesi si shoqëria civile, kompanitë publike rajonale, njësitë në Han të Elezit dhe shoqatën e bizneseve;

- Në shkurt 2022 është mbajtur takimi dhe prezantimi i projekt-PZHK-së me Bordin e Drejtorëve,
- Dhe së fundit, në fillim të muajit maj 2024 është mbajtur diskutimi publik lidhur me prioritetet e zhvillimit strategjik ku në mënyrë të veçantë janë diskutuar përmbajtjet nga plani i veprimit.



miratuar në parim draftin e PZHK-së.



- Me dt. 03.05.2024, bordi i drejtorëve ka

Foto 1. Takimet me palët e interesit

6.2.5 Raporti i shqyrtimit publik



RAPORTI NGA SHQYRTIMI PUBLIK I PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS HANI I ELEZIT 2025-2033

1. HYRJE

Shqyrtimi publik i Planit Zhvillimor të Komunës është një hap kyç për përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesit në procesin e planifikimit hapësinor të komunës. Ky raport i hartuar në pajtim me kërkesat e Udhëzimit Administrativ të MMPH nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinor si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për administratë të hapur në Komunë, përmbledhë rrjedhën e diskutimeve, komenteve, vërejtjeve si dhe propozimeve që dalin nga ky proces i rëndësishëm së veçantë për përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME DEBATIN PUBLIK

Para nisjes së debatit publik të draftit të Planit Zhvillimor të Komunës 2025-2033, nga Drejtoria e Urbanizmit si bartëse e procesit janë realizuar këto veprime:

- Është siguruar pëlqimi nga MMPH për hapjen e debatit publik të draft PZHK-s. Vendimi me nr.571-2 i dt. 27.02.2025, i publikuar në ëeb faqen e komunës-linku: <https://hanieliezit.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/05/Vendim-per-pelqim-per-hapjen-e-shqyrtimit-publik-te-Projekt-PZHK-se-2025.pdf>
- Vendimi i Kuvendit të Komunës për hapjen e debatit publik, me nr.01/1615/2025, i publikuar në ëeb faqen-linku: <https://hanieliezit.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/05/VENDIMET-E-MBLEDHJES-SE-3-TE-KUVENDIT-TE-KOMUNES-2025.pdf>
- Është bërë njoftimi publik për hapjen e debatit publik. Vendimi i kryetarit të komunës me nr. 06/2157 i dt. 02.04.2025, i publikuar në ëeb faqen e komunës-linku: <https://hanieliezit.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/04/DOK.pdf>
- Është publikuar Draft Planit Zhvillimor i Komunës 2025-2033 në ëeb faqen e komunës - linku: https://hanieliezit.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/04/1.-Draft-PZHK-Hani-i-Elezit-2025_2033_110225.pdf
- Është publikuar lista e parceleve të cilave me Planin e ri Zhvillimor të Komunës do tju ndryshohet destinimi. Linku: <https://hanieliezit.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/04/Lista-e-parcelave-te-cilave-ju-ndryshon-destinimi-me-PZHK-n-e-re-2025-2033.pdf>
- Nga kryetari i komunës është themeluar grupi punues për shqyrtimin e kërkesave, propozimeve dhe ankesave nga debati publik si dhe hartimin e raportit nga shqyrtimi publik i PZHK-s. Vendimi me nr.02/Nr.2025 i publikuar në ëeb faqen e komunës-linku: <https://hanieliezit.rks-gov.net/ep-content/uploads/2025/05/2518.-Vendim-i-grupit-punues-per-shqyrtim-nga-debati-publik-per-PZHK.pdf>



Po ashtu, me qëllim të pjesmarrjes sa më të madhe të qytetarëve në debat, njoftimi mbi mbajtjen e debatit publik përveç se në ëeb faqen dhe fejsbukun e komunës, konform UVA është publikuar edhe në tabelen e shpalljeve të komunës, mëpastaj në pikat më të frekuentura të vendbanimeve të komunës si dhe në Tv Festina. Ndërkaq me ftesa të veqanta janë ftuar përfaqësues të enteve dhe Institucioneve të

nivelit lokal dhe nacional, kompanitë publike regjionale dhe lokale, kompanitë private të cilat operojnë në territorin e komunës, të gjitha OJQ-t, shoqatat sportive etj.

3. DEBATI PUBLIK I PZHK-S KOMUNA HANI I ELEZIT

Në pajtim me U/A në fuqi, është organizuar debati publik i Draft Planit Zhvillimor të Komunës 2025-2033. Debati është mbajtur nga dt.15.04.2025-15.05.2025 (njoftimi publik mbi mbajtjen e debatit është publikuar me dt.28.03.2025viti). Ndërkaq shqyrtimi kryesor publik i PZHK-s është mbajtur me dt.15.04.2025 në sallën e Qendrës Kulturore të Rinisë "Imri Curri" në Han të Elezit me fillim nga ora 10.15 me pjesëmarrjen e 50 individëve: 36 burra dhe 14 gra.

Rjedhja e shqyrtimit kryesor publik është përshkruar në procesverbal.





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



06/Nr/2025 8548
Data: 15.04.2025

**PROCESVERBAL NGA SHQYRTIMI PUBLIK I DRAFT
PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS HANI I ELEZIT 2025 – 2033**

Procesverbali nga shqyrtimi publik për Draft Planin Zhvillimor Komunal 2025 - 2033, mbajtur me datë 15.04.2025 me fillim pune në ora 10:15 në Sallën e Koncerteve të Shtëpia e Kulturës "Imri Curri". Të pranishëm ishin gjithsej 50 pjesëmarrës, prej tyre 14 gra dhe 36 burra.

Takimin e kryesoi drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit – Nexhmedin Daci, i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje. Më pas propozoi Liridona Ballazhi (shefe në Kabinet të Kryetarit) për procesmbajtës, si dhe Vjosa Rogaçi (Zyrtare në DKA), Amir Berisha (Zyrtar në DSHPE) dhe Adnan Lusnjani (zyrtar në DUKMM), si vërtetues të procesverbalit. Propozimet u miratuan njëzëri. Për fjalë përshëndetës, merr fjalën Kryetarin.

Mehmet Ballazhi: Përshëndetje për të gjithë që jeni prezent këtu, falënderim opër ekipin punues për hartimin e draft planit zhvillimor komunal, që është një dokument shumë i rëndësishëm për vënien e kahjes së zhvillimit të Hanit të Elezit në të gjitha fushat, e ku secili prej nesh duhet parasysh parasysh që të japë kontributin e tyre, duke dhënë propozimet e këshillat e tyre, e nëse duhet edhe ndonjë rekomandim, që parashihet deri në vitin 2033, që do të jetë si një dokument shumë i rëndësishëm për zhvillimin e komunës së Hanit të Elezit. Kërkoj nga ju që të mos hezitoni asnjë për të dhënë komentet e propozimet e tyre.

Nexhmedin Daci: Ky debat është i paraparë të zhvillohet në dy pjesë, pjesa e parë do të jetë për prezantimin e draft planit zhvillimor komunal të cilin do ta bëjë Durim Dernjani – zyrtar i drejtorisë së urbanizmit, kurse pjesa e dytë e këtij shqyrtimi do të jetë për diskutimin e hapur publik. Përndryshe, PZHK-ja është dokument obligues për të gjitha komunat, në bazë të Ligjit të Planifikimit Hapësinor, dhe komuna jonë e ka hartu këtë dokument, e kemi dorëzuar në MMPHI, dhe jemi pajisë me vendim për pëlqim të hapjes së debatit publik, ashtu siç e parashikojnë procedurat ligjore. Ky plan është plan bazik i komunave, që dëmto se të gjitha planet tjera komunale, nga cilido sektor tjetër, si infrastruktura, shëndetësia, arsimit, mjedisi, trashigimia kulturore emergjencat, zhvillimi ekonomik, etj, duhen të jenë në harmoni me PZHK-në, ashtu siç PZHK duhet të jetë në harmoni me Planin Hapësinor të Kosovës. PZHK është plan strategjik, i cili e mbulon të gjithë territorin e komunës, pra përfshin të gjitha zonat: urbane dhe rurale. Sipas ligjit, cilësohet si plan shumë sektorial, i cili përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor të komunave. Ky shqyrtim publik do të jetë i hapur 30 ditë, janë të publikuara në çebfaqen e komunës tre email adresa, email im, i Durim Dernjanit dhe Adnan Lusnjani, ju mundeni me dhanë vërejtje, propozime, edhe në formë të shkruara, përmes emailit, kërkesave zyrtare në QSHS dhe te Drejtoria e Urbanizmit, edhe në zyre të urbanizmit të zyrtarët, pra edhe te zyra ime. Prej nesër, PZHK do të jetë i ekspozuar te salla e kuvendit, aty do të jetë edhe një fletore, mundeni me shkru edhe aty propozime, pra mos ngurroni çdo formë të komunikimit mundeni me e apliku. Tani, fjalën ia jap Durimit, që ta fillojë prezantimin e PZHK-s pjesëve kryesore të sajë, disa pika ma kyçe të draftit, se drafti është me vullm diku 250 faqe.

RENDI I PUNËS

1. Prezantimi i Draft Planit zhvillimor Komunal 2025-2033

2. Diskutimi Publik

Rendi i ditës u miratua unanimishtë nga të pranishmit

1. Prezantimi i Draft Planit zhvillimor Komunal 2025-2033

Durim Dernjani: bën prezantimin e kapitujve kryesor të Draft Planit Zhvillimor të Komunës, siq janë:

- Korniza Strategjike e PZHK-s, Profili i Komunës, Vlerësimi i Gjendjes, Korniza e Zhvillimit Hapësinor, Prioritetet e Zhvillimit dhe Plani i Veprimit si dhe Zbatimi dhe Monitorimi i PZHK-s.

Po ashtu, ai dha edhe sqarime të shumta të hartave sipas sektorëve të ndryshëm.

1. Diskutimi Publik

Nexhmedin Daci: Pas prezantimit të Draft Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033, e hap diskutimin publik.

Mehmet Ballazhi: Ashtu siç e tha edhe drejtori edhe Durimi, ky është dokument shumë i rëndësishëm, dhe nuk duhet me hezitu askush me dhanë propozime, komente e rekomandime. Ky material është mjaft i gjërë, voluminoz e nashta jo të gjitha pjesët iu përshtaten interesit tuaj, por do të ishte mirë që aty ku keni interes për kahjen e zhvillimit të qytetit, të jepni çdo kontribut për qat pjesë, por edhe për ato pika ku doni sqarim, është mirë që edhe në mënyrë individuale të vizitoni zyret përkatës, të informoheni. Ky nuk është dokument politik, por është dokument zhvillimor, andaj kisha kërkua që secili nga ju të jepni kontributin në këtë dokument.

Amir Bushi (udhëheqës i QPS-Hani i Elezit): Unë fillimisht kisha dashtë një sqarim, sepse ndoshta si komunë dalmi keq me e bo popullatën sipas regjistrimit të vitit 2024, kurse papunësinë me e bo të bazume në regjistrimin e vitit 2011. Se nëse e paraqesim 67% si të papunë në krahasim me nr. e banorëve, i bjen diku mbi 5000 - 6000 banorë janë të papunë. E dyta, besoj se disa përmirësime teknike do të ishte mirë me i bo, shembull tek emërtimi MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ekziston mo, tash është në kuadër të Ministrisë së Financave, Punëve dhe Transfereve – MFPT. Dhe e treta, te pika 4.4. e planit të veprimit dhe treguesit e monitorimit, ku është potencu “Përkrahja financiare për kategoritë në nevojë: bursa për studentë dhe ndihmë sociale”, ku komuna jonë e ka një rregullore për mbrojtjen e fëmijëve, e ka një rregullore për mekanizmin kundër dhunës në familje, poashtu mekanizmin për mbrojtje nga radikalizmi, dhe është mirë me u fut mbështetja profesionale edhe për këto kategori, duke futur në kllapa fëmijët si pikë kryesore., si dhe edhe diçka tjetër te kjo pikë do të ishte mirë që termin “ndihmë sociale” me e zëvendësu me “familje në nevojë”, sepse termi ndihmë sociale është pak e vrazhdë.

Nexhmedin Daci: Sa i përket papunësisë, Agjencioni i Statistikave të Kosovës nuk i ka publiku rezultatet finale të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 gjatë kësaj kohe sa ne e kemi hartu draft planin zhvillimor komunal 2025-2033, ata disa të dhana i kanë publiku, e qato i kemi përfshi, ndërsa tjerat i kemi marrë nga regjistrimi i vitit 2011, dhe unë besoj se afërsisht qatj dikun është papunësia, mirëpo dokumenti nuk është final, është draft, dhe të dhanat ka mundësi me u korrigju, ne propozimet e debatit i marrim parasysh, edhe grupin punues e kemi themelua që ka me i shqyrtu dhe trajtu të gjitha propozimet, vërejtjet e komentet.

Burhan Berisha (qytetar i Hanit të Elezit): Unë i kam dy pyetje:

1. A i keni paraparë në PZHK ndërtimet (ndërtesat) e vjetra , a ka probleme ligjore, sepse ndërtimet e vjetra kanë fillu me u bo rrezik për qytetarët?
2. A keni paraparë diku zonë ekonomike, se kërkesa për hapësira për shfrytëzim të zonës ekonomike kemi gjithmonë në Komunën tonë?

Nexhmedin Daci: Sa i përket ndërtimeve të vjetra, ne kemi tentu bashkë me Kryetarin me bisedu me Ministrinë, mirëpo aty është një problem shumë absurd, dmth këto banesa janë private, mirëpo toka në kadastër figuron si pronë shtetërore, në fakt si pronë e Kuvendit të Komunës. Ne kemi kërku prej Kuvendit para 2-3 muaj dhe Kuvendi ka marrë vendim që me iu mundësu këtyre banorëve , ose vet ose përmes investitorëve, me bo ndërtime të reja, mirëpo Ministria nuk na ka dhanë pëlqim. Tash janë dy ligje në Kuvend të Kosovës: Ligji i Tokës Ndërtimore dhe është një ligj i ri, Ligji i Banimit Kolektiv i cili ka kalu në vlerësim të parë, kështu që në bazë të këtyre ligjeve, pronarët e këtyre banesave, kanë me u bo bashkëpronar të parceleve, me qrast do të krijohen kushte për ndërtime të reja. Është problem shqetësues gjendja e këtyre banesave, janë dy tre pronar të këtyre banesave të vjetra të cilët kanë angazhu kompani të licencuara me e konstatu vjetërsinë dhe paqëndrueshmërinë e këtyre banesave. Po shpresojmë që shumë shpejt kanë me u miratu këto ligje dhe ka me u rregullu situata sa i përket ndërtimeve. Kurse te zona ekonomike, ju e dini Sharrcepi është në venbanim, kjo pjesa te rrethrotullimi, prej te Viva e deri në kufi është paraparë pak a shumë si zonë ekonomike, për këto bizneset afariste komerciale, edhe e kemi zonën ndihmëse ekonomike në Gorancë, në Zheden atje ku edhe është fabrika për përpunimin dhe pasurimin e kromit. Një pjesë aty është paraparë edhe për energji të ripërtëritshme, por edhe biznese tjera. Komuna ka pak tokë në pronësi, por edhe mungojnë sipërfaqe në krahasin me komunitat e tjera, është goxha problem, por e kemi lanë Zhedenin, aty ka një hapësirë të mjaftueshme, tash varet prej investitorëve.

Burhan Berisha: Kam edhe një shtesë te kjo puna e ndërtimeve, që është deri në pesë kate, pse s'po ndiqet kjo praktikë si në komunitat tjera, sepse nëse një ndërtues ka mundësi me nxjerrë më shumë hapësira, atëherë çmimi për qytetarin mundet me qenë më i arsyeshëm.

Nexhmedin Daci: Më lejo tju them se me Planin Zhvillimor komunal nuk përcaktohen kushtet ndërtimore. Kjo qëshjte rregullohet respektivisht do të trajtohet me Hartën Zonale të Komunës të cilën jemi duke e përgaditur. Me këtë plan përcaktohen vetëm hapësirat ku lejohet ndërtimi i mesëm, për mos me thanë i lartë, e te ne është te këto banesat e vjetra ku janë në qytet dhe rreth magjistrales. Ne veçse kemi fillu me hartimin e hartës zonale , ajo është një lloj plani urbanistik, dhe me këtë plan përcaktohet etazhiteti. Me normat teknike të planifikimit p.sh çdo ndërtesë duhet me i pas minimumi 20 metra katror hapësirë të lirë, e tash llogarite parcelat sa janë të vogla, e ai që i plotëson kushtet që mundet me i siguru për një banesë me 20 metra katror hapësirë, duhet poashtu për qdo njësi banesoret edhe një garazhë, atëherë i lejohet edhe ndërtim ma i lartë, mirëpo në bazë të gjendjes në terren është problem kjo, sepse bëhet shkelje ligjore nëse jepet leje. Poashtu, ka edhe kriteret tjera, kapacitete e rrugëve, ujit, e rrymës. Por pavarësisht këtyre, kjo qëshjte ka me u rregullu me Hartën Zonale të Komunës dhe shpresojmë që sivjet edhe atë plan kemi me e përfundu.

Shefket Lusnjani (administrator i fshatit Gorancë): Kam vetëm një kërkesë, e shoh tek drafti për deponitë që është paraparë tek në vitin 2027. Unë kërkoj që kjo me u bo sa ma shpejt, sepse ne si fshat e kemi leju me u bo kjo qysh para dy viteve në fshatin Gorancë, tash me prit me u bo deri në vitin 2027 është pak problem, se ne spo mundemi me u bo policë e inspektorë që me i ndalu personat e papërgjegjshëm se ku po i hedhin mbeturinat.

Nexhmedin Daci: Siç e the, ju si fshat e keni dhanë lejen me u ndërtu deponia, edhe Kryetari e ka dërgu kërkesën në Ministri, ne nuk kemi pranë përgjigje, sepse ajo pronë nuk është pronë e Kuvendit Komunal, është pronë publike. Ne e kemi hartu edhe projektin për deponinë diku arrin vlerën 300 mijë €. Ajo që shkruhet te draft PZHK-ja që në 2027 me u bo deponia, kjo nuk është problem, sepse kjo mundet me u realizu edhe ma herët, mjafton që të na jepet leja nga Ministria dhe t'i kemi siguru mjetet e nevojshme për ndërtimin e saj.

Nerxhivane Berisha (qytetare e Hanit të Elezit): Unë jetoj në rrugën "Adem Jashari" dhe fatkeqësisht aty ka qenë një parking që e ka pas fabrika e çimentos, tash është private, ne çdo natë e ditë kemi zhurma, e poashtu edhe kamionat aty tentojnë edhe ecje mbrapa, biles ka aty që edhe janë prish ato hekurat, e ne përveç që nuk kemi qetësi, aty edhe muri tek parkingu që është veçse nuk është shembë, e kjo është rrezik të madh, sepse fëmijët tanë janë të kufizum në lojëra vetëm brenda oborrit, shkak se ka rrezik me u shemb ai mur që është afër shtëpive tona. A mundet dikush me u merr me këtë problem, ose me rindërtim, ose me u largu ai parking, ose me u bo një lloj orari se kur me u leju puna aty, sepse ka ndodh në orën 3 të natës kur vijnë kamiona, dridhet

krejt shtëpia, dhe e kemi të pamundur me pas qetësi në shtëpitë tona. Unë kam bo edhe ma herët ankesa, por edhe 2-3 familje tjera të lagjes, edhe kur e ka pas Sharrcemit, mirëpo fatkeqësisht kurrë nuk janë marrë për bazë. Aty janë ehd estacioni i policisë tash, edhe ata mund të jenë dëshmitarë të këtij problemi.

Nexhmedin Daci: Me PZHK që është në fuqi i miratuar në vitin 2011, aty nuk di se qysh është lanë ajo parcelë si parking, sepse ai nuk i plotëson kushtet për parking. Pronari i parkingut veçse ka bo kërkesë për ridestitim, mirëpo ai duhet me prit deri sa të miratohet ky plan i ri, kurse për problemet tjera, ju keni të drejtë për mendimin tim, madje kish qenë mirë me e parashtrë ju edhe një herë ankesën tek DSHPE-ja dhe do ta shqyrtojmë me Kryetarin.

Burim Suma (qytetar i Hanit të Elezit): Kisha një sugjerim, njëkohësisht edhe pyetje në lidhje me reduktuesit e zhurmës, nuk di a e keni paraparë që të montohen edhe përgjatë fabrikës së çimentos, rreth e përçark kufirit edhe lagjeve mbrapa Sharrcemit, meqë kjo do të ndikojë dukshëm në reduktimin e ndotjes dhe zhurmës. Tek aktiviteti 8.1. , pika 5, nuk e kam shumë të qartë, se a është e paraparë apo nuk është në kompetencën tuaj. Kurse pika e 2 është në lidhje me zgjerimin e trotuarit në drejtim të kufirit, pasi që e kemi shumë problem me i lanë fëmijët vet për të shku në shkollë, është shumë e ngushtë dhe shumë i rrezikshëm, sepse edhe aty lëvizin shumë shpejt automjetet, a është paraparë vija të bardha të instalohen në dy-tre vende afër banimit, s'paku me qenë në dy anët të rrugës.


Nexhmedin Daci: Sa i përket zhurmës, ne e kemi paraparë në plan të veprimit, edhe pse investimi në magjistrale dhe autoudhë nuk është kompetencë e jona, ne kemi kërku edhe prej Ministrisë që edhe te autostrada edhe te kufini mundet me u amortizu zhurma. Edhe për trotuaret, ne i kemi paraparë në plan të veprimit, dmth për këto 8 vjet sa do të jetë në fuqi PZHK, plani është diku 7-8 km me u shtrë rrugë të asfaltume në territor të komunës, e janë rreth 2 km rrugë vetëm në pjesën urbane të qytetit, dhe është një projekt standart që është çdo vjet, është projekt në vazhdimësi, e do të ishte mirë që ju me e bo një kërkesë te urbanizmi, pastaj ne at kërkesë e paraqesim në Kuvend dhe nëse miratohet, ne mundemi me e realizu.

Florim Shkreta (kryesues i Kuvendit Komuna): Unë falënderoj drejtorin e DUKMM-së dhe ekipin e tij për këtë punë shumë të qëlluar për Komunën e Hanit të Elezit, edhe pse kjo punë ka fillu vite më parë, por megjithatë angazhimi juaj si drejtori dhe ekip edhe gjatë këtij rrugëtimi, do ia dalë me sukses.

Nexhmedin Daci: Për fund do të falënderoj bashkëpunëtorët e jashtëm të cilët kanë bashkëpunu në hartimin e PZHK-së, z.Sami Stagova – planifikues hapësinor urban, z.Premtim Asllani – gjeograf dhe ekspert i GIS-it, Artnet Haskuka – planifikues hapësinor dhe Dafina Karahoda – planifikues hapësinor. A keni ndonjë propozim apo diskutim tjetër për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e konsideroj të mbyllur takimin. Në fund, drejtori Nexhmedin Daci falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në shqyrtimin publik për Draft Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Vërtetuesit e procesverbalit:

1. Vjosa Rogaçi:

2. Amir Berisha:

3. Adnan Lusnjani:



LISTA E PJESËMARRJES NË DEBATIN KRYESOR PER SHQYRTIMIN E DRAFT PZHK-së			
Datë: 15.04.2025			
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
1	Bekim Sema	IT	
2	Adrian Jusqani	DUEMI	
3	Skënder Jusqani	Prof. Gjerman	
4	Katerina Dergjan	AS-mentale	
5	Alfred Vila		
6	Armen Ruzi		
7	Armen BENISHA		
8	Vlora Bogdan	Zyrtar e DAKT	
9	Vesim Cuvri	Zyrtar DERS	
10	D A S I M		
11	FATBARDHA PASHI	INSPEKTOR	
12	SEVIME PADRAMI	ZYRTARE	
13	ADIL AHMETI	Z. Policia Hani Hot	
14	SEVIME LAGI	Zyrtar	
15	PRAMAN ZEMRI	ZYRTAR	
16	ALI AXHAMI	ADMINISTRATOR	
17	RASHID LUSHDANI	ADMINISTRATOR	
18	HAKUSHE LOKU	Administratë	
19	ISLAN CYRRI		
20	Armen Krasni	Deputat shkoll	
21	HASDIP VILA	ARTETAR	
22	Veronica Benisha		
23	Rabije Bogdan	PERDITJES	
24	HER AZEM		
25	SALEMAN SULA		
26	LETNIR SHKRETA	STOMATOLOG	
27	Teodor Shkret	infirmier	
28	DRITON LURI		
29	ARBUJTA BAKAMALI	DERS	
30	KADINDA KALOSH	DZNET	
31	Lindita Pallari	DBF	
32	DIRIDONA BALAZOT	ZYRTAR KRYETARIT	
33	Veronica Juriu		
34	Armen Krasni		
35	Veronica Benisha	DEPUTAT SHKOLL, V. Bogdan	
36	Armen Benisha		
37	HAKUSHE LOKU		

38	Florin Shkreta	K.K	Shkreta
39	Bujar BUCHI	KHEK	BSU
40	Vait Daci	Zyrtar i Kadastro	Daci
41	BESNIK BEGI	Z. FINANCARE	BEGI
42	MUHAREM ROGOCI	DKP S- Zyrtar	Rogoci
43	Romir B. B. B.		B. B. B.
44	Mehmet Ballasli	Kryetar	Ballasli
45	Kerem Mehmet	OSCE	
46	OSAN SHKRETI	SHKRETI	
47	AMIR QAZANI	R.H.G	QAZANI
48	Nexhmedin Daci	DIKUM	Daci
49	Pamir Anllari	Konsullat G/S	Anllari
50	Abdullah B. B.	H. E. 10774	B. B.
51			
52			
53			
54			
55			
56			
57			
58			
59			
60			
61			
62			
63			
64			
65			
66			
67			
68			
69			
70			
71			
72			
73			
74			
75			
76			
77			
78			

4. SHQYRTIMI I KËRKESAVE, ANKESAVE DHE PROPOZIMEVE NGA GRUPI PUNUES PËR PZHK

Grupi punues për shqyrtimin e kërkesave, vërejtjeve, propozimeve si dhe hartimin e raportit nga shqyrtimi publik i PZHK-s në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarëve në takimet e mbajtura ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, propozimet, ankesat, vërejtjet dhe ka vendosur si më poshtë vijon:

a. Lëndët e pranuar përmes zyrës së shërbimit civil dhe të protokoluara:

Nr.	Emri mbiemri	vendbanimi	Nr.protokolit dhe data	lënda	Vendimi I grupit punues
1.	Jahi Vila	Hani i Elezit	06\2648 18.04.2025	Kërkesë që dy parcelet e tija nr.19-0 dhe 18-1 në Han të Elezit me PZHK-n e vjetër pa dijenin tonë janë regjistruar si parking dhe kërkojmë që ato të destinohen për banim	Kërkesa miratohet bazuar në faktin se parcelat e lartpërmendura janë në zonë urbane (brenda vendbanimit) dhe nuk janë të përshtatshme për parking.
2.	Afrim vila	Hani i Elezit	06\2781 24.04.2025	Kërkesë: dy parcelet në pronësi timen me nr.315-2 dhe 315-3 z.k. Neqavc të destinohen për banim.	Kërkesa miratohet bazuar në faktin se parcelat janë brenda kufijve të vendbanimit me draft PZHK-n
3.	"Guri i Bekuar"	Hani i Elezit	06\3135 07.05.2025	Kërkesë për zgjerim të hapësirave për shfrytëzim industrial në zonën kadastrale Seqishtë ku edhe me PZHK-n e re është e destinuar për industri (skica dhe parcelat të bashkangjitura në kërkesën e protokoluar).	Kërkesa miratohet bazuar në faktin se në zonën e destinuar për industri ka hapësirë të mjaftueshme dhe se është e përshtatshme për zhvillime të industrisë.
4.	Shemsedin Ramuka	Hani i Elezit	06\3182 08.05.2025	Kërkesë që parcelat e tija në z.k Neqavc në sip.00 16 83ha dhe 09 88 65 të destinohen për prodhim të energjisë së ripërtëritshme (pale solar). Nr. e parceleve janë në kërkesën e protokoluar.	Kërkesa miratohet pasi që lokacioni është i përshtatshëm për zhvillim të energjisë së ripërtëritshme dhe se parcelat janë të klasit mbi IV dhe i plotsojnë kushtet për këtë destinim.
5.	Vaid Daci	Hani i Elezit	06\3443 15.05.2025	Kërkon që parcela kad. me nr. 1204-32 dhe nr.1204-8 me PZHK-n e vjetër figuron si zonë për Industri të hiqen si industri dhe parcela 1204-32 të planifikohet për banim ndërsa parcela tjetër hapësirë e gjelbëruar.	Kërkesa pjesërisht miratohet. Parcela kad.1204-32 për banim refuzohet, ndërsa parcela kadastrale 1204-8 miratohet si hapësirë gjelbëruese.

Nr.	Emri mbiemri	vendbanimi	Nr. protokollit dhe data	lënda	Vendimi i grupit punues
6.	Kimete Kuka Hasallari	Hani i Elezit	06\3411 15.05.2025	Kërkesë: të planifikohet me PZHK një lokacion për ndërtimin e një QKMF të re me hapësira të mjaftueshme dhe sipas standardeve.	Pala është njoftuar se me PZHK-n 2025-2033 është i planifikuar lokacioni në sip 66 ari aty ku sot është policia kufitare.
7.	Fatih Bushi	Hani i Elezit	06\3179 08.05.2025	Kërkesë për korrigjim të pjesës tekstuale të draftit lidhur me hidrocentralet. Është e parashprehme dhe subjektive formulimi në draft PZHK sipas së cilës ndalohej ndërtimi i hidrocentraleve. Injeiti propozon që në vend të këtij formulimi të shkruhet: Shfrytëzimi i potencialeve hidrike për prodhimin e energjisë do të trajtohet në pajtim me Ligjin për Ujrat e Kosovës, Strategjinë kombëtare për Menaxhimin e Burimeve Ujore dhe Planin e Menaxhimit të Pellgut të Lumit Lepenc.	Vëretjet e tija miratohen. Teksti do të korrigjohet sipas rekomandimeve të parashtruara në kërkesë. Edhe grupi punues konsideron se në draftin e PZHK-s nuk duhet të ketë njanshmëri dhe subjektivitet.
8.	Jumri Lusnjani	Gorancë	06\3475 13.05.2025	Kërkesë për ndryshim të destinimit të parces në pronësi të tijë me nr.983-2 dhe 982-0 z.k Gorancë, ti ndryshohet destinimi dhe të planifikohet për ndërtim- banim me funksione të tjera në pajtueshmëri.	Kërkesa miratohet bazuar në faktin se parcelet janë brenda kufijve të vendbanimit dhe të përshtatshme për banim me funksione të tjera në pajtueshmëri.
9.	Shëfqet Lusnjani	Gorancë	06\3479 13.05.2025	Kërkesë: propozon ndërtimin e rrugës nga f. Hunel deri te varrezat e fshatit.	Pala është njoftuar se me planin e veprimt të PZHK-s janë të parapara ndërtime të rrugëve (8km) për tetë vite.
10.	Ramadan Topojani	Hani i Elezit	06-2697 14.05.2025	Kërkesë për ndërtim destinimi të katër parceleve në pronësi private me nr.254-0 255-0 256-0 dhe 257-0 z.k Negavc të destinohen për prodhim të energjisë së ripërtërishtë.	Kërkesa miratohet bazuar në faktin se parcelet e propozuara janë të kl. mbi IV dhe se lokacioni është i përshtatshëm për destinimin e propozuar.

b. Kërkesat dhe propozimet e qytetarëve të pranuarra përmes e-maileve zyrtare të publikuara në njoftimin për shqyrtimin publik të PZHK

Nr.	Emri mbiemri	Vendbanimi	Data e-mail	lënda	Vendimi i grupit punues
1.	Amir Qajani	Hani i Elezit	05.05.2025	Propozon rregullimin e shtratit të lumit Lepenc	Ky projekt madhor është i përfshirë në planin e veprimit të PZHK-s 2025-2033
2.	Sami Vlashi	Hani i Elezit	15.05.2025	Propozon rritjen e etazhitetit të ndërtimeve në zonën urbane sepse me planet ekzistuese etazhiteti është deri 6 kate	Kushtet ndërtimore si dhe etazhiteti i ndërtimeve nuk janë objekt i PZHK-s. Kto dëshitojnë do të rregullohen me Hartën Zonale të Komunës e cila është në përgatitje e sipër.
3.	Islam Curri	Hani i Elezit	15.05.2025	Kërkesë që dy parcele e tija me nr.0149-0 dhe 0139-0 në pjesën qendrore të Hani të Elezit të destinohen për ndërtime të larta	Me PZHK-n 2025-2033 parçelet e lartpërmendura vetëm janë të destinuara për banim me funksione të tjera në pajtueshmëri ndërsa etazhiteti dhe kushtet tjera do të rregullohen me Hartën Zonale të Komunës

c. Kërkesat dhe propozimet e qytetarëve nga shqyrtimi kryesor publik i PZHK-s i mbajtur me dt.15.05.2025

Nr.	Emri mbiemri	Vendbanimi	data	Propozimi/Kërkesa	Vendimi i grupit punues
1.	Amir Bushi	Hani i Elezit	15.05.2025	Të bëhen korigjime në tekstin e PZHK aty ku shkruan Ministria e Punës dhe Mirëqenjes nuk ekziston më dhe tash është Ministria e Financave, Punës dhe Transferit. Po ashtu propozon masa shtesë nga fusha e sigurimit social.	Propozimi mirarohet. Do të bëhen ndryshimet teknike në tekstin e draft PZHK-s.
2.	Burhan Berisha	Hani i Elezit	15.05.2025	Ka shprehë shqetësim lidhur me banesat e vjetra në Hani të Elezit në aspektin e sigurisë e po ashtu propozon që me PZHK të parashihen ndërtime me etazhitet më të lartë. Po ashtu pyet për zonat ekonomike a janë paraparë me PZHK.	Sa i përket etazhitetit të ndërtimeve këto qështje do të rregullohen me HZK. Me PZHK-n e re përveq zonës ekonomike në Hani të Elezit është e paraparë edhe zona ndihmëse ekonomike në Gorançë (Zheden). Lokacioni i kësaj zone është i përcaktuar(ne afërsi të implantit për pasurimin e kromit)

3.	Shefket Lusnjani	Gorancë	15.05.2025	Kërkesë: Deponia për mbetje të ngurta mundësisht të ndërtohet më shpejt e jo siq është e paraparë me planin e veprimit ndërtimi të ndodhë në vitin 2027	Palës i janë dhënë sqarime se ndërtimi mund të ndodhë më herët por që kjo do të mvaret nga buxheti apo mundësia për të thithë donacione nga qeveria apo organizata tjera. Lokacioni është i përcaktuar me PZHK 2025-2033.
4.	Nergjivane Berisha	Hani i Elezit	15.05.2025	Ka kërkuar që të ndërmerren masa ndaj pronarit të një parkingu të mauneve në afërsi të shkollës dhe shtëpive sepse përbën rrezik për sigurinë publike të banorve të asaj zone.	Palës i janë dhënë sqarime se në at zonë nuk do të ketë më parking dhe se pronari i asaj parcele ka kërkuar që ti ndryshohet destinimi dhe të dedikohet për banim me funksione tjera në pajtueshmëri.
5.	Burim Suma	Hani i Elezit	15.05.2025	Ka shprehë shqetësim për ndotjen nga zhurma në afërsi të SharrCem, magjistrales dhe autoudhës dhe propozon që kjo çështje të trajtohet edhe në PZHK	Ndotja nga zhurma është trajtuar me PZHK-n e re po ashtu edhe me planin e veprimit janë të përshkuara veprimet konkrete.

5. Grupi punues për shqyrtimin e propozimeve, vërejtjeve, ankesave etj. nga debati publik i Planit Zhvillimor të Komunës 2025-2033 me kujdes të veçantë ka trajtuar gjitha kërkesat dhe ka vendosë si më lartë. Po ashtu të gjitha propozimet, kërkesat, ankesat etj. të miratuara nga grupi punues do të inkorporohen në draftin final (pjesa tekstuale dhe grafike) të Plani Zhvillimor të Komunës 2025-2033.

Grupi Punues:

1. Nexhmedin Daci, kryesues
2. Majlinda Kaloshi, anëtare
3. Durim Dernjani, anëtar
4. Fatbardha Bushi, anëtare
5. Adnan Lusnjani, anëtar
6. Bujar Bushi, anëtar
7. Vai d Daci, anëtar



 Drejtori i DUKMM
 Nexhmedin Daci

HANI I ELEZIT, 26 MAJ 2025

6.2.6 Përmbledhja jo teknike e PZHK-së së Hanit të Elezit 2025 – 2033

PZHK është plan strategjik i cili mbulon tërë territorin e komunës, duke përfshirë zonat urbane dhe fshatrat brenda komunës. PZHK është plan shumë-sektorial që përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor.

PZHK e Hanit të Elezit, si një plan strategjik shumë-sektorial, paraqet qëllimet zhvillimore ekonomike, sociale, hapësinore dhe qëllimet hapësinore afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata për komunën, të paktën për një periudhë 8 (tetë) vjeçare.

PZHK mbulon fusha të shumta të një politike të tillë sikur: zhvillimin ekonomik, social, banimin, infrastrukturën teknike, infrastrukturën rrugore dhe transportit, infrastrukturën sociale, hapësirat publike, trashëgiminë kulturore, mjedisin dhe zvogëlimin apo nga fatkeqësitë, bujqësinë dhe pylltarinë, zhvillimin rural.

PZHK është hartuar duke respektuar Planin Hapësinor të Kosovës dhe strategjitë dhe ligjet vendore, si dhe është i strukturuar në bazë të udhëzimit administrativ 11/2015 dhe përmban kapitujt në vijim:

Hyrja

Vendimet dhe pëlqimet nga Komuna dhe MMPHI, fjala e Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, përmbajta dhe listat e hartave, tabelave, fotografive dhe diagrameve, shkurtesat dhe anekset. Korniza strategjike ku përshihen strategjitë e dhëna në Plan Hapësinor të Kosovës për zonën në të cilën gjendet Hanit të Elezit, strategjitë kombëtare, rajonale dhe komunale të cilat janë konsultuar gjatë procesit dhe përshkrimi i procesit të diskutimeve dhe shqyrtimit publik si dhe përmbledhja jo teknike e PZHK-së 2025 – 2033.

Profili i komunës - Hani i Elezit me rrethinë e ka pasur statusin e komunës që nga viti 1913, mirëpo një ndarje administrative e pushtetit monist centralist e miratuar në vitin 1961, mundësoi formimin e komunave më të mëdha duke bërë që të shkrihet territori i Hanit të Elezit në Komunën e Kaçanikut.

Mirëpo, në shtator të vitit 2005, u themelua pilot njësia komunale Hani i Elezit dhe në vitin 2008 Komuna e Hanit të Elezit certifikohet nga MAPL në të njëjtin nivel të kompetencave dhe përgjegjësi si edhe komunat tjera në Republikën e Kosovës. Komuna ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës afër kufirit me Maqedoninë dhe shtrihet përgjatë luginës së Lumit Lepenc, në mes të Bjeshkëve të Sharrit në perëndim dhe Bjeshkëve të Karadakut në Lindje. Komuna karakterizohet me terren kryesisht kodrinor – malor, si dhe me pjesë fushore përgjatë rrjedhave ujore. Komuna e Hanit të Elezit përbëhet nga 10 vendbanime të cilat janë të shpërndara në të dy anët e qytezës.

Demografia - sipas regjistrimit të vitit 2024 komuna e Hanit të Elezit ka 8,533 banorë rezident dhe 1,742 ekonomi familjare, ndërsa vlerësohet² të ketë rreth 1,256 banorë të migruar respektivisht rreth 250 ekonomi familjare me 5 anëtarë. Sa i përket lëvizjeve natyrore në periudhën 1948 – 2022 përgjatë viteve popullsia e komunës ka rritje. Ndërsa sa i përket emigrimit ai morri hov prej vitit 1990 dhe vazhdoi me një nivel pothuajse të njëjtë dhe me një rritje të theksuar prej vitit 2005. Arsyet e emigrimit janë punësimi dhe arsyet familjare.

Sipas projeksionit të popullsisë për vitin 2033 komuna do të ketë rreth 8,260 banorë dhe 2,359 ekonomi familjare (mesatare 3.5 anëtarë), si dhe 1,859 banorë të migruar në vendet brenda dhe jashtë Kosovës.

Sipas vlerësimeve nga sondazhi në terren dhe të dhënave nga ndërmarrjet, përqindja e papunësisë është rreth 67%. Në komunë një përqindje e ulët e popullsisë aktive për punë është e punësuar në sektorin jo formal ekonomik, megjithatë nuk ka të dhëna të sakta pasi që të punësuarit në bizneset jo formale nuk janë të regjistruar. Dhe kjo paraqet një sfidë për komunën e Hanit të Elezit, duke u

² Burimi: ASK, Vlerësimet e popullsisë për vitet 2012 deri 2022, numri i vlerësuar i banorëve të migruar është llogaritur bazuar në bilancin e migrimit/emigrimit për periudhën 2012 – 2022.

nisur nga fakti që rreth 65% e popullsisë i përket moshës aktive për punë.

Përqindja e arsimit mbi 10 vjet është me ndryshime të vogla në krahasim me normën mesatare të nivelit të Kosovës, ndërsa ajo e arsimimit mbi klasën e 12 është më lartë se ajo e Kosovës dhe përqindja për nivelet universitet e kolegji është më ulët se mesatarja e Kosovës.

Burimet kryesore të të hyrave vijnë nga personat tjerë dhe nga remitancat, ndërsa në përqindje të vogël nga punësimi, pensionet dhe skemat sociale. Sipas regjistrimit të vitit 2011 vetëm 14.5% e banorëve sgruajnë të hyrat nga punësimi, 11.1% nga pensionet dhe skemat sociale dhe 64.7% nga të tjerët, 3.2% nga remitancat dhe 6.8% nga burime tjera, kjo tregon nivelin e lartë të papunësisë në komunë.

Sfidat kryesore me të cilat do të ballafaqohet komuna me qëllim të përmirësimit të situatës janë: rritja e nivelit të punësimit, ulja e varfërisë, përfshirja e të rinjve në sferën socio-kulturore, përfshirja më e lartë e publikut dhe palëve të interesit në vendimmarrje, ndalimi i migrimit, etj.

Megjithatë, komuna ka **potenciale** të cilat do të mund të shfrytëzohen për arritjen e qëllimeve dhe objektivave, si: popullsia e re dhe mirë e arsimuar, shërbime cilësore arsimore, shëndetësore, kulturore dhe sportit, mbështetja e NVM-ve nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet qendrore e lokale, remitancat, bashkëpunimi me organizatat dhe OJQ për studime/plane të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat e tij me synim të përmirësimit të gjendjes socio ekonomike në komunë dhe ndalimit të migrimit, si në vijim:

Qëllimi: Qytetarët e informuar/ me njohuri të nevojshme dhe të përfshirë në vendim-marrje

Objektivat:

- a) *Rritja e nivelit të gjithë përfshirjes në vendim-marrje lokale, deri në vitin 2027;*
- b) *Rritja e njohurisë së të rinjve/ popullsisë ekonomishtë aktive dhe joshja e tyre për të mos migruar, në vazhdimësi.*

Ekonomia – në përgjithësi komuna karakterizohet me zhvillim të ulët ekonomik, si aktivitet kryesor ekonomik është industria e materialeve ndërtimore si prodhimi i qimentos, rërës/zhavorit, stiroporit dhe në masë të vogël pasurimi i kromit. Zhvillimi i industrisë së çimentos ka zhvilluar mjaft edhe transportin e materialeve të ndërtimtarisë. Sektor tjetër që zhvillohet janë bizneset shërbyese hotelierie dhe tregtare që shtrihen kryesisht përgjatë magjistrates, autoudhës dhe në qytezë. Përkundër potencialeve për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor është pak i zhvilluar. Vitet e fundit vërehet zhvillimi i degës së re si turizmi malor.

Sfidat kryesore me të cilat do të ballafaqohet komuna me qëllim të përmirësimit të gjendjes ekonomike janë: rritja e shërbimeve në terminalin doganor (duke përfshirë edhe depot doganore), stimulimi i prodhimit bujqësor dhe blegtorisë, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillimi dhe promovimi i potencialeve turistike, promovimi dhe krijimi i kushteve për industri ndërtimore dhe për shfrytëzimin e resursve minerale, etj.

Megjithatë, komuna ka **potenciale** të cilat do të mund të shfrytëzohen për zhvillimin e bizneseve, turizmit, bujqësisë, industrisë, e që janë: komuna e pasur me resurse natyrore dhe asete të trashëgimisë kulturore si bazë për zhvillimin e turizmit, tokë bujqësore, zonë kufitare, grantet dhe subvencionet nga qeveria dhe donatorët për stimulimin e bizneseve si start – up, bujqësore, turistike, zejtare, trajnime profesionale nga qeveria dhe organizatat ndërkombëtare, bashkëfinancime për të punësuarit, partneritetet publiko-private, bashkë-financim i projekteve për zhvillim të turizmit, remitancat, përcaktimi i zonës ekonomike/industriale, zonat turistike në Pustenik, Gorancë, Neçavc dhe Dërmjak, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat e tij me synim të rritjes ekonomike të komunës, si në vijim:

Qëllimi: Nxitja e zhvillimit ekonomik bazuar në potenciale lokale

Objektivat:

- a) *Stimulimi i industrisë së materialeve ndërtimore dhe ndërmarrësisë në lidhje me të, deri në vitin 2033;*
- b) *Prezantimi i paketës së përgaditur turistike për banorët dhe vizitorët, deri në vitin 2027;*
- c) *Përmirësimi i infrastrukturës dhe shtimi i kapaciteteve bujqësore (lavërtari, blegtori, kultura ekstenzive, pemëtari dhe tjera), deri në vitin 2033;*
- d) *Promovimi i prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëreshme, në vazhdimësi;*
- e) *Promovimi i pylltarisë industriale, deri në vitin 2033;*
- f) *Stimulimi i ndërmarrësisë dhe aktiviteteve ekonomike sipas potencialeve lokale, në vazhdimësi.*

Infrastruktura teknike – pjesa e vendbanimeve të komunës që kanë qasje në sistem publik të ujësjellësit ballafaqohen me reduktime të ujit për shkak të mungesës së rreshjeve, humbjeve të ujit dhe keqpërdorimeve. Vendbanimet Paldenicë, Seçishtë, Krivenik, Pustenic dhe Dimcë nuk kanë qasje në sistem publik të ujësjellësit, ndërsa në Dremjak, Vërtomicë dhe Neçavc nuk ka sisteme dhe nuk planifikohen sepse janë të zbrazëta. Sistemi publik i ujësjellësit në qytet menaxhohet nga KRU Bifurkacioni ndërsa sistemet e vendbanimeve tjera menaxhohen nga kompania e kontraktuar nga drejtoria komunale për shërbime publike ndërsa sistemi i vendbanimit Gorancë menaxhohet nga vet banorët. Sa i përket kanalizimit gjendja është e mirë pasi që pjesa më e madhe e vendbanimeve, përpos vendbanimeve të zbrazura kanë qasje në kanalizim dhe ka kolektorë të cilët zbrasin në pjesën jugore të komunës në lokacionin e planifikuar të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza ngjitur me rrjedhën e Lumit Lepenc. Gjithashtu, fabrika Sharrcem ka impiantin për trajtimin e ujërave të zeza të kompleksit të vet dhe të disa ekonomive familjare në afërsi. Sistemi kanalizimit të mbyllur të ujërave atmosferik ka në qendrën e qytetit dhe në qendrën e fshatit Gorancë. Kanale të hapura atmosferike ka përgjatë gjitha rrugëve lokale. Sistemi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike menaxhohen nga një kompani e kontraktuar nga drejtoria e shërbimeve publike.

Energjia elektrike ofrohet në tërë komunën e Hanit të Elezit dhe është stabil dhe pa reduktime, mirëpo është e nevojshme që rrjeti i vjetëruar të zëvendësohet.

Rrjeti i telekomunikacionit mbulon qytetin dhe vendbanimet përreth tij, përpos vendbanimeve Pustenic dhe Laç.

Në komunë nuk ka sistem qendror të ngrohjes, dhe produkti kryesor për ngrohje është druri pastaj energjia elektrike dhe në përqindje të vogël biomasa (pelet/briket).

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në gjithë territorin e komunës përpos në dy vendbanimet e zbrazura dhe mbeturinat deponohen në deponinë rajonale në Velekincë të Gjiçanit.

Sfidat kryesore me të cilat do të ballafaqohet komuna me qëllim të sigurimit të infrastrukturës dhe shërbimeve cilësore janë: shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në tërë komunën, trajtimi i ujërave të eza, përmirësimi i infrastrukturës së energjisë elektrike, ndarja dhe reciklimi i mbeturinave, ofrimi i alternativave tjera për ngrohje, etj.

Komuna ka **potenciale** të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për përmirësimin e shërbimeve në të ardhmen, si: burime ujore, konfiguracion i përshtatshëm i terrenit për liqen akumulues për nevoja të ujësjellësit/ujitjes Dimcë-Skallavac), konfiguracion i përshtatshëm i terrenit për kompletimin e sistemit të kanalizimit përmes kolektorëve, bashkëpunimi me KRU dhe grantet nga qeveria për ujësjellës, kanalizim dhe trajtim të ujërave të zeza, grumbullim të mbeturinave, mbështetjet nga qeveria dhe donatorë për ndarjen e mbeturinave, investimet nga KESCO për përmirësim të rrjetit të energjisë elektrike, grante dhe subvencione nga qeveria dhe donatorë për investime në efikasitet të energjisë dhe prodhim të energjisë nga burimet e ripërtëreshme, bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për planifikimet bazë për ngrohje qendrore të përbashkët, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat e tij me synim të sigurimit të qasjes në infrastrukturë dhe shërbime cilësore dhe të shëndosha për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë, si në vijim:

Qëllimi: ofrimi i infrastrukturë/shërbimeve teknike baras për të gjithë qytetarët

Objektivat:

- a) *Sigurimi i qasjes së integruar në sistem të përbashkët të furnizimit me ujë dhe menaxhim nga KRU, deri në vitin 2027;*
- b) *Kompletimi i rrjetit të kanalizimit dhe trajtimi i ujërave të zeza, deri në vitin 2033;*
- c) *Ofrimi i shërbimit kualitativ të mbledhjes së mbeturinave, deri në vitin 2027;*
- d) *Zgjerimi i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore në konsolidim (përgjatë lumit Lepenc), deri në vitin 2033;*
- e) *Promovimi i ndarjes së mbeturinave dhe kompostimit, deri në vitin 2033;*
- f) *Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike në vendbanimet e komunës dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të telekomunikacionit, deri në vitin 2033;*
- g) *Promovimi i energjisë së ripërtëritshme dhe i efikasitetit të energjisë, deri në vitin 2033;*
- h) *Prezantimi i ngrohjes qendrore për objektet publike, deri në vitin 2033.*

Infrastruktura e transportit dhe transportit – në territorin e komunës së Hanit të Elezit shtrihen Autoudha R6 Prishtinë – Hani i Elezit që mundëson lidhje të shpejtë me korridorin VIII me portin e Durrësit dhe me korridorin X në veri, dhe rruga nacionale Prishtinë-Shkup N2 përmes së cilës mundësohet lidhja me Kaçanikun, Ferizajn dhe më tej në veri dhe Shkupin në jug.

Rrugët e nivelit lokal janë në gjendje relativisht të mirë dhe janë të ndriçuara dhe të sigurta, përpos në disa zona që ka nevojë për përmirësim dhe zgjerim të rrugëve dhe ndriçim si dhe sigurimi i qasjes së sigurtë për banorët e zonës urbane dhe vendbanimeve në perëndim të hekurudhës të cilët e kanë të kufizuar vetëm përmes rrugës nacionale N2 dhe daljes ngjitur me kufirin.

Sa i përket shtigjeve për transportin jo-motorrik është në gjendje mesatare, i cili sigurohet në disa segmente të rrugëve lokale, në tërë zonën urbane, ndërsa në rrugën nacionale N2 dhe hekurudhën Fushë Kosovë – Hani i Elezit kalimet nëpër to janë jo të sigurta. Megjithatë janë identifikuar si nevojë, nuk ka shtigje malore të rregulluara dhe shenjuara për biçikleta apo për ecje.

Në komunë shërbimi i transportit ndër-komunal dhe lokal sigurohet nga sektori privat përmes autobusëve dhe minibusëve si dhe taksive. Komuna nuk ka stacion të autobusëve.

Sa i përket vend parkingjeve, në qytezë ka mjaftueshëm si për vetura poashtu edhe për kamionët transportues.

Në komunë ka shtrirje të rrjetit hekurudhor dhe ka lidhje të përshtatshme rrugore me nyjet kryesore hekurudhore Fushë Kosovë dhe Shkup. Momentalisht hekurudha nuk është funksionale sepse Hekurudhat e Kosovës janë duke e rindërtuar rrjetin.

Sfidat kryesore të komunës për përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe lëvizshmërisë janë: përmirësimi i sigurisë në trafik, kushteve për qarkullim jo motorrik, rrjetit të transportit publik dhe krijimi i lëvizjeve të sigurta për këmbësorë në qytet dhe fshatrat e mëdha.

Mundësitë për zhvillim: bashkëpunimi me qeverinë qendrore për ti bërë më të sigurta disa kyçe në rrugë nacionale, grante qeveritare dhe donacione për përmirësimin e infrastrukturës dhe transportit hekurudhor dhe kompletimin e rrjetit rrugor lokal, bashkëpunime me OJQ dhe organizata tjera për ndërtimin e shtigjeve për hiking.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat e tij me synim të sigurimit të qasjes në infrastrukturë të transportit dhe lehtësim të lëvizshmërisë, si në vijim:

Qëllimi: Ofrimi i lëvizshmërisë optimale dhe të sigurtë për qytetarët dhe vizitorët

Objektivat:

- a) *Përmirësimi i rrjetit hekurudhor, deri në vitin 2030;*
- b) *Përmirësimi i rrjetit rrugor në territorin komunal, në vazhdimësi;*
- c) *Ofrimi i shërbimeve të sigurta të transportit sipas karakterit të vendbanimeve, deri në vitin 2033;*
- d) *Shtimi i linjave të lëvizshmërisë jo-motorike (këmbësorë dhe çiklistë), deri në vitin 2033.*

Infrastruktura publike dhe sociale – shërbimet publike shëndetësore në komunë kryhen në nivelin parësor, i cili përfshinë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në qytezë e cila i ofron shërbime të gjitha vendbanimeve dhe Ambulancën e Mjekësisë Familjare (AMF) në Gorancë e cila i ofron shërbime qytetarëve të Gorancës dhe Rezhancës. Në komunë ofrohen edhe shërbime private nga 4 klinka dentare dhe 3 barnatore.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore sfidë është mungesa e mjekëve familjarë dhe teknikëve, pediatri dhe stomatologut si për nga kualifikimi edhe për nga numri, gjithashtu ka mungesë edhe të stafit të përgjithshëm dhe barnave. Sfidë tjetër është rrezja e mbulueshmërisë e cila për disa vendbanime si Goranca dhe Kriveniku, të cilët për të marrë shërbim në QKMF banorët duhet të udhëtojnë 7 km, ndërsa vendbanimet tjera kanë 1km ose më pak. Ndërsa, në rastin e AMF-së në Gorancë, banorët e vendbanimit Rezhancë duhet të udhëtojnë deri në 2km.

Procesi arsimor në komunën e Hanit të Elezit është i organizuar në katër nivele: niveli para fillor, fillor, mesëm i ulët dhe mesëm i lartë.

Infrastruktura në përgjithësi është në gjendje relativisht të mirë, mirëpo është e nevojshme që të sigurohet një shkollë fillore (klasa 1 – 5) për zonën e Lagjes së Re duke pas parasysh mbipopullimin e SHFMU në Han të Elezit, distancës prej 1.5km dhe rrezikut të kalimit të hekurudhës. Shërbimet arsimore kanë nevojë për përmirësime të vazhdueshme si në aspektin e trajnimeve të mësimitdhënësve, infrastrukturë dhe inventar.

Në vitin 2022 në qytezë është ndërtuar qendra e kulturës e cila i plotëson nevojat për të mbuluar nevojat e qytetarëve e komunës.

Sa i përket infrastrukturës së sportit dhe rekreacioni, ekzistojnë fushat e terrenet e diciplinave të ndryshme mirëpo nuk i plotësojnë nevojat e qytetarëve prandaj ka nevojë të shtohet numri i tyre. Gjithashtu, duhet të zhvillohen kapacitetet profesionale për të zhvilluar më tutje jetën kulturore dhe sportive.

Shërbimet e mirëqenies sociale ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale që funksionon në qytezë dhe ofron mbështetje për të gjithë komunën.

Institucionet fetare dhe administrative e të sigurisë ofrojnë infrastrukturë në gjendje të mirë dhe shërbimet që i plotësojnë nevojat e gjithë komunës.

Për shkak të karakterit rural komuna ka mungesë të hapësirave të hapura në formë shesheve, andaj për të ardhmen është e nevojshme që të identifikohen hapësirat potenciale dhe të përmirësohet qasja në to.

Komuna viteve të fundit ka investuar në rregullimin dhe shtimin e parqeve dhe korridoreve të gjelbra e cila për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve të saj do të vazhdojë edhe në të ardhmen të punoj në këtë drejtim.

Në përgjithësi secili vendbanim i komunës ka sipërfaqe të mjaftueshme për varreza, të cilat kanë nevojë të mirëmbahen.

Sfidat kryesore të komunës për sigurimin e infrastrukturës publike e sociale dhe shërbimeve cilësore janë: ngritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale, zgjerimi i aktiviteteve kutlruore, zgjerimi i infrastrukturës së sportit dhe rekreacionit, hapësirave publike dhe mirëmbajtja e tyre, etj.

Për tejkalimin apo zbutjen e këtyre sfidave do të mund të zhfrytëzohen mundësitë si: grantet qeveritare dhe donacionet për përmirësimin/ndërtimin e infrastrukturës publike e sociale, avancimi profesional i stafit arsimor, shëndetësor, kulturë dhe përmirësimi i hapësirave publike me mbështetjen e qeverisë dhe organizatave, stimulimi shtesë i stafit profesional shëndetësor, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat e tij me synim të sigurimit të qasjes në infrastrukturë dhe shërbime për të gjithë qytetarët në mënyrë barabartë, si në vijim:

Qëllimi: Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve sociale e publike baras për të gjithë qytetarët

Objektivat:

- a) *Mirëmbajtja dhe freskimi i vazhdueshëm i infrastrukturës parashkollore dhe parafillore sipas nevojave të identifikuara, në vazhdimësi;*
- b) *Organizimi i mësimi tërë-ditor në të gjithë Komunën, vazhdimësi;*
- c) *Ngritja e cilësisë së arsimit (mësimor dhe përcjellës) në tërë Komunën, në vazhdimësi;*
- d) *Përkrahje financiare dhe sociale për kategoritë në nevojë, në vazhdimësi;*
- e) *Rregullimi i infrastrukturës për shërbime sociale, deri në vitin 2033;*
- f) *Rregullimi i infrastrukturës fizike dhe shtimi i shërbimeve shëndetësore, deri në vitin 2033;*
- g) *Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të administratës publike lokale, deri në vitin 2033;*
- h) *Funksionalizimi i infrastrukturës dhe organizimi i eventeve kulturore/ sportive, deri në vitin 2030;*
- i) *Rritja e sipërfaqeve të hapësirave publike të rregulluara, në vazhdimësi;*
- j) *Rregullimi/ mirëmbajtja e rrjetit të varrezave për të gjitha vendbanimet, në vazhdimësi.*

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri – përkundër përpjekjeve në përmirësimin e situatës si nga ana e fabrikave ashtu edhe komunës, komuna e Hanit të Elezit karakterizohet me ndotje të lartë të ujit, tokës dhe ajrit si rezultat i zhvillimit të industrisë përkundër, derdhjes së ujërave të zeza dhe depolive ilegale të mbeturinave.

Fatekqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga faktori njeri janë prezente edhe në komunën e Hanit të Elezit sidomos për shkak të ndryshimeve klimatike. Vendbanimet përgjatë Lumit Lepenc me përrenjtë e Rezhancës, Seçishtës, Dimcës dhe Laçit ballafaqohen shpesh nga vërshimet, me ç'rast dëmtohen infrastruktura, objektet e banimit, bizneset, qytetarët dhe toka bujqësore.

Për shkak të terrenit kodrinor – malor komuna rrezikohet edhe nga zjarret, erozioni sidomos në male dhe rrëshqitja e dheut tek formacionet shëmbore përgjatë rrugës nacionale N2 dhe rrugës lokale Hani i Elezit – Gllloboçicë (Kaçanik). Rrëshqitja e dheut shkaktohet nga intensiteti i lartë i të rreshurave dhe faktori njeri.

Territori i komunës së Haniti të Elezit i takon Zonës së V-të të presionit respektivisht 7 – 8 gradë në bazë „MSC”.

Sfidat kryesore të komunës në reduktimin e ndotjes së mjedisit përmes trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimit cilësor të mbeturinave, përmirësimit të kanalizimit, ndotjes nga industria, automjetet, dhe zvogëlimin dhe zbutjen e rrezikut nga fatkeqësitë.

Mundësitë që do të mund të shfrytëzoheshin me qëllim të përmirësimit të gjendjes janë: grantet dhe donacionet për investime në reduktim të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, rregullimin e shtretërve të lumenjve, pyllëzim, rehabilitim të mihjeve sipërfaqësore, në ngritje të kapaciteteve për zjarrfikje, masat e Qeverisë për reduktimin e makinave të vjetra, investimet në teknologji inovative që ndihmojnë në reduktimin e ndotjes, ndërtimi i impiantit rajonal për trajtimin e ujërave të zeza dhe trajtimi i përkohshëm në pikat e fundit të ujit të përdorur, përfshirja e biznesit privat në hapësirat pyjore, të gjelbra dhe rekreative, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat me synim të sigurimit të një mjedisi të shëndoshë dhe të sigurtë, si në vijim:

Qëllimi: Krijimi i një mjedisi të sigurtë përmes përmirësimeve organizative, mjedisore dhe adresimit të ndryshimeve klimatike

Objektivat:

- a) *Reduktimi i efekteve të ndotjes dhe parandalimi i ndotjes së mëtutjeshme, në vazhdimësi;*
- b) *Adresimi i ndryshimeve klimatike përmes masave të reduktimit dhe adaptimit, në vazhdimësi;*
- c) *Reduktimi ndikimeve të fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njeriu, në vazhdimësi.*

Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike - komuna është e pasur me trashëgimi natyrore pasi që rrethohet nga Malet e Sharrit dhe Karadakut, të cilat janë me biodiversitet të pasur dhe rrjedha ujore, këto së bashku ofrojnë një peisazh të jashtëzakonshëm i cili është potencial për zhvillim të turizmit malor.

Komuna gjithashtu ka një numër të konsiderueshëm të trashëgimisë arkitekturale, arkeologjike dhe shpirtërore, të cilat mund të adaptohen dhe të shfrytëzohen në funksion të zhvillimit të turizmit.

Sfidat kryesore të komunës janë reduktimi i ndotjes së natyrës, mbrojtja e ujërave dhe pyjeve, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore si dhe mbrojtja e tyre nga fatkeqësitë.

Mundësitë të cilat mund të shfrytëzohen për mbrojtje të vazhdueshme të aseteve janë: bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për aktivitete të promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, mbështetje nga MKRS për intervenime në asetet e trashëgimisë kulturore, grante dhe donacione për planifikim dhe përmirësime mjedisore, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat me synim të mbrojtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si në vijim:

Qëllimi: Mbrojtja e trashëgimisë natyrore/ biodiversitetit dhe kulturore**Objektivat:**

- a) *Marrja e masave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, deri në vitin 2030;*
- b) *Marrja e masave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, deri në vitin 2031.*

Vendbanimet - komuna përbëhet nga zona urbane qyteza e Hanit të Elezit dhe dhjetë vendbanimet rurale. Sa i përket kontekstit hapësinor qyteza është e organizuar duke u bazuar në vijën hekurudhore dhe Lumin Lepenc si dhe rrugën nacionale N2. Brenda këtyre elementeve është zhvilluar bërthama urbane ndër vite. Si rezultat, zona urbane ka lidhje të mira fizike me rrugën nacionale, hekurudhën e së fundi edhe me autoudhën R6 si dhe me fshatrat përreth. Zona urbane është e ndarë në 5 njësi, e që përfshinë zonën urbane me sipërfaqe 159.88 ha me 2,300 banorë dhe lagjet e ngjitura të cilat janë pjesë të zonës kadastrale të Hanit të Elezit dhe zonave kadastrale të Seçishtes, Rezhancës, Pustenikut, Dimcës dhe Paldenicës. Në qytezë janë përqëndruar përmbajtjet dhe funksionet kryesore publike në nivel komunal, dhe komerciale. Në qytezë dominojnë kryesisht ndërtesat individuale dhe në bashkëpronësi me etazhitet P+2 dhe P+3, ku në përdhësë kryesisht zhvillohen aktivitetet komerciale ndërsa në kate banimi. Në komunë ekzistojnë vetëm 4 ndërtesa në bashkëpronësi me etazhitet P+4 deri në P+8.

Në vendbanimet rurale dominon banimi rural, të cilat janë zhvilluar në mënyrë spontane me ndërtesa me etazhitet mesatar P+1 dhe në raste të rralla P+3. Të gjitha vendbanimet janë të tipit malor me përjashtim të Seçishtes e cila është më ngjitur luginës së Lepencit.

Sfidat kryesore të komunës janë: ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore, ofrimi i kushteve më të mira të planifikuara brenda zonave të ndërtuara, zhvillimi i vendbanimeve me dendësi adekuate, gjetja e fondeve për zhvillim social dhe punësim dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.

Mundësitë për zhvillim: zgjerimi i zonës urbane në pronat komunale, bashkëpunime me organizata dhe OJQ për planifikimin dhe rregullimin e vendbanimit joformale, mbështetja e NVM-ve, remitancat,

etj, grantet dhe donacionet për sigurimin e banimit social dhe të përballueshëm, densifikimi në banim dhe rigjenerimi i disa pjesëve të zonës urbane, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivi me synim të sigurimit të zhvillimit kompakt të vendbanimeve, si në vijim:

Qëllimi: Zhvillimi hapësinor i vendbanimeve sipas modelit kompakt

Objektivat:

a) *Rritja e densitetit zhvillimor dhe konsolidimi i vendbanimeve, në vazhdimësi;*

Banimi – komuna karakterizohet me banim me veçori rurale dhe me dendësi të ulët, ku shumica e njësive të banimit janë të ndërtuara pas luftës, si rezultat i shkatërrimeve dhe kanë etazhitet P+0 deri në P+3, ndërsa në qyteze kemi deri në P+7. Në nivel komunal banimi përfshinë 207 ha që është rreth 2.5% e sipërfaqes së përgjithshme të komunës. Numri i përgjithshëm i njësive të banimit është 1,914 nga të cilat rreth 14.6% janë të zbrazëta.

Per të plotësuar nevojat e popullsisë së projektuar është llogaritur që sipërfaqja e nevojshme për banim është rreth 50 ha respektivisht 7 ha për zonën urbane dhe 43ha për atë rurale, ku brenda kësaj sipërfaqeje do të plotësohen edhe nevojat për banim për banorët jo rezident.

Sipas të dhënave të vitit 2015 – 2016 , në komunë janë mbi 2.000 ndërtime pa leje të cilat janë duke u trajtuar përmes procesit të legalizimit. Vlen të theksohet që mbi 99% e objekteve në zonat rurale janë pa leje.

Sfidat kryesore të komunës janë: sigurimi i banimit të përballueshëm, ndalimi i zhvillimeve /paligjshme të banimit, përmirësimi i kushteve të banimit dhe ofrimi i shërbimeve adekuate, etj.

Mundësitë për zhvillim: bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për studime sektoriale të banimit në qëllim të ngritjes së standardit dhe ofrimit të banimit të përballueshëm, grante dhe donacione për banim të përballueshëm, densifikimi në banim, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivat me synim të ofrimit të banimit për të gjithë, si në vijim:

Qëllimi: Përmirësimi i kushteve të banimit

Objektivi:

a) Rritja e efijencës së energjisë në 50% të ndërtesave të banimit në komunë, deri në vitin 2033;

Qëllimi: Sigurimi i banimit të përballueshëm

Objektivi:

a) Ndërtimi i njësive të banimit të përballueshëm (për rreth 10% të familjeve me të ardhura të ulëta);

Vendbanime joformale – në komunë ekziston Lagja Brava e cila është e zhvilluar në pronë publike mirëpo është e kyçur në infrastrukturë dhe shërbime. Në këtë lagje janë 34 objekte individuale të banimit dhe një objekt publik për nevoja të lagjes. Sfidë për komunën është rregullimi i çështjes pronësore në mënyrë që të kthehet lagja në vendbanim formal.

Sfidat kryesore të identikuara janë: ofrimi i kushteve më të mira, ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara, rregullimi i çështjes pronësore, etj.

Mundësitë për zhvillim: bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për planifikimin dhe rregullimin e vendbanimit joformal, investimet e vazhdueshme në përmirësimin e shërbimeve teknike dhe sociale për të gjitha zonat dhe vendbanimet e komunës, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivi me synim të trajtimit të vendbanimit joformal, si në vijim:

Qëllimi: Rregullimi i vendbanimit joformal

Objektivi:

- a) Rregullimi i çështjeve pronësore në vendbanimin joformal, deri në 2033;
- b) Përmirësimi i gasjes në infrastrukturën teknike, publike dhe sociale, deri në vitin 2030.

Shfrytëzimi i tokës – sipërfaqja dërmuese e territorit të komunës përfshihet nga tokat pyjore, pasuar nga toka bujqësore dhe pastaj shfrytëzimet tjera me përqindje shumë të vogël. Mungesa e bazës së të dhënave të PZHK-së në fuqi, e pamundëson vlerësimin se deri në çfarë mase janë realizuar zhvillimet e planifikuara dhe qëllimet e objektivat e tij.

Sfidat kryesore të komunës janë: kontrolli i zhvillimeve, mbrojtja e tokës bujqësore dhe mjedisit, mbrojtja e aseteve të trashëgimisë kulturore, mbrojtja nga rreziqet, krijimi i mundësive për punësim, etj.

Mundësitë për zhvillim: planifikimi i zhvillimit përmes plotësimit/dendësimit, zgjerimi relativisht i vogël i kufirit të tokës ndërtimore, përcaktimi i zonës ekonomike, mbështetja nga qeveria dhe donatorë për aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, mbështetja nga qeveria dhe donatorë për sektorin e bujqësisë dhe NVM-të, mbështetja nga qeveria dhe donatorë për investime në sektorin e shërbimeve sociale e teknike, etj.

Me PZHK janë përcaktuar qëllimi dhe objektivi me synim të shfrytëzimit racional të tokës, si në vijim:

Qëllimi: Shfrytëzimi racional i tokës me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm

Objektivat:

Objektivi 1. Kontrollimi i zhvillimeve përmes hartimit të politikave të planifikimit hapësinor, deri në vitin 2027.

Kapacitetet njerëzore dhe financiare – në dhjetor të vitit 2022 totali i të punësuarve në administratën komunale ishte 66, që konsiderohet i mjaftueshëm për realizimin e punëve ditore të tyre, mirëpo është i nevojshëm zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve në mënyrë që të përmirësohen shërbimet për qytetarët.

Investimet publike kryesisht realizohen përmes buxhetit komunal, granteve nga buxheti i Kosovës dhe donacionet. Buxheti komunal çdo vit ka shënuar rritje, nga i cili rreth 64% i tij shpenzohet për paga dhe mëditje, duke u pasuar nga investimet kapitale me 15% ndërsa shpenzimet tjera mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, transfere dhesubvencione.

Të hyrat vetanake të komunës gjithashtu kanë shënuar rritje çdo vit. Megjithë rritjes së buxhetit komunal nuk është i mjaftueshëm për realizimin e nevojave zhvillimore të përcaktuar me këtë PZHK.

Korniza e zhvillimit hapësinor - që përmban vizionin, qëllimet dhe objektivat e parapara për zhvillimin e ardhshëm të Hanit të Elezit, të cilat janë prezantuar më lartë në secilën fushë tematike. Gjithashtu janë zhvilluar dy skenarë ai i zhvillimit qendror dhe ai i decentralizuar dhe për të arritur te një koncept më të mirë për zhvillimin e ardhshëm këta skenarë janë shkruar në një skenar të vetëm bazuar në të cilin është formuar koncepti zhvillimor. Më tutje është zhvilluar Koncepti zhvillimor që përmban planet zhvillimore sektoriale të paraqitura me harta dhe të përshkruara në formë narrative.

Prioritetet e zhvillimit strategjik dhe plani i veprimit - përmban prioritetet zhvillimore strategjike dhe planin e veprimit. Prioritetet strategjike janë të detajuara më tej në plan veprimi që jep projektet dhe jep indikatorët që janë edhe bazë për monitorimin dhe zbatimin të planit.

Zbatimi dhe monitorimi - përcakton dispozitat për zbatimin e planit të cilat udhëheqin realizimin e qëllimeve dhe objektivave dhe monitorimin e realizimit të PZHK-së; përshkrimi i dispozitave kalimtare që japin të dhëna për kohën e hyrjes në fuqi të këtij plani afatin e vlefshmërinë e këtij plani.

Autoritetet për zbatim dhe monitorim - PZHK e përcakton përgjegjësinë për monitorimin e zbatimit të planit Kryetarin e Komunës, Bordin e drejtorëve dhe Kuvendi i Komunës të cilët e vlerësojnë dhe aprovojnë raportin e monitorimit të cilin e përgatit DUKMM. Ndërsa në nivelin operacional monitorimi është detyrë e Komisioneve për zbatim, monitorim dhe raportim dhe DUKMM.

Pjesë përbërëse të këtij dokumenti janë edhe anekset (hartat dhe tabelat)

7 PROFILI KOMUNAL

7.1 Historiku i shkurtër i Hanit të Elezit³

Zbulimet arkeologjike tregojnë se një vendbanim ilir ka qenë ndërtuar në fushat e tanishme të Hanit të Elezit, në vendet pranë rrugëve të lashta që kanë lidhur rajonin me Shkupin e sotëm. Kjo është zbuluar pasi që janë gjetur materiale arkeologjike të pjesëve të Kalasë. Artefakte antike janë gjetur në pothuajse të gjitha fshatrat e Hanit të Elezit. Rrënoja të kishës dhe manastirit janë gjetur në Gorancë. Në Paldenicë janë gjetur mbeturinat e një nekropoli, qeramika të vjetra, materiale bronz, një stelë nga një varrezë e shekullit të tretë pas Krishtit dhe dy monedha. Njëra nga monedhat është rreth 2300 vjet e vjetër dhe i përkiste Mbretit Ilir Monun. Në Dimcë janë gjetur dy pllaka me mbishkrim dhe gjurmë arkeologjike të kishës, që tregojnë se ky vendbanim është mjaft i vjetër. Emri Afërditë në Dardani në formën teoforike është gjetur në koloninë 'Scupi' në Dimcë, në veri të Shkupit. Një statujë romake është gjetur në kishën e vjetër në Dremjak. Ekzistojnë edhe një numër i madh i materialeve tjera të rëndësishme të lashta që janë gjetur në Secishtë, Neqafç, Krivenik dhe Pustënik.

Nuk ka fakte të njohura për atë se si është quajtur Hani i Elezit gjatë lashtësisë. Emërtimi i parë i këtij vendbanimi SHAR (SAR) daton nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë (dhe vazhdon në vitet 1564, 1589, 1689, 1690, 1730, 1775, 1788, 1812, 1822, etj.). Vendbanimi mori emrin Hani i Elezit në shekullin e nëntëmbëdhjetë, sipas Elez Dimcës, i cili kishte ndërtuar një Han. Ky emër është përdorur deri në vitin 1912, kur regjimi serb e quajti atë Gjeneral Jankovic, emërtim ky i cili kurrë nuk u pranua nga ana e popullatës vendase. Vendbanimi dhe Komuna më vonë kanë vazhduar të quhen gjithnjë Hani i Elezit në shqip, përderisa edhe zyrtarisht atij iu ndërrua emri në Elez Han edhe në gjuhët serbe dhe angleze me ligj⁴. Fshatrat janë përmendur edhe në arkivat osmane më 1452, 1455, 1468, 1544, 1568, 1893, 1896 dhe 1900. Ekziston edhe një hartë austriake nga viti 1689 që i referohet Hanit të Elezit dhe fshatrave të tij. Në vitin 1920, Hani i Elezit kishte një stacion treni (1873), një Han, dy kafene, një bakallhane. Rreth kësaj kohe familjet shqiptare nga fshatrat përreth kanë filluar të vendosen në Han të Elezit. Numri i të ardhurve në këtë zonë është rritur, kur në vitin 1936 u ndërtua fabrika e çimentos. Pas Luftës së Dytë Botërore (dhe pas rindërtimit dhe zgjerimit të fabrikës së çimentos), Hani i Elezit ka evoluar në një vendbanim, ku shumica e punonjësve të fabrikës së çimentos kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në mënyrë që të jenë më afër punës.

Hani i Elezit me rrethinë ka pasur statusin e komunës që nga viti 1913, mirëpo një ndarje administrative e pushtetit monist centralist e miratuar në vitin 1961, mundësoi formimin e komunave më të mëdha duke bërë që të shkrihet territori i Hanit të Elezit në Komunën e Kaçanikut. Që nga atëherë Hani i Elezit ka qenë i përfaqësuar në nivel të Zyres së Vendi e cila ishte e kufizuar në ofrimin e shërbimeve të Zyres së Shërbimit Civil.

Në shtator të vitit 2005, në bazë të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr.2005/11 për krijimin e Pilot Njësie Komunale, e cila u nënshkrua me 22 korrik 2005 si pjesë e procesit të decentralizimit, u themelua Pilot Njësia Komunale e Hanit të Elezit (PNJK e HiE). Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) më herët kishte rekomanduar përcaktimin e strukturës territoriale për Pilot Njësitë Komunale në bazë të vendimeve ekzekutive të UNMIK-ut (2005/17 dhe 2005/21) për përcaktimin e territorit të secilës PNJK, të nënshkruara me 12 gusht 2005. Seanca inauguruese për konstituimin e Asamblesë së Përkohshme të Kuvendit të PNJK të Hanit të Elezit u mbajt me 22 shtator, 2005. Seanca vijuese e Asamblesë u mbajt me 11 tetor 2005, në të cilën u emëruan Kryetari dhe Zëvendëskryetari i PNJK-së së Hanit të Elezit.

³Të dhënat historike janë marrë nga libri "Hani i Elezit me rrethinë" i Emrush Dërnjanit

⁴Ligji Nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Neni 16.4

Burimi: PZHK Han të Elezit (2010-2025)

2.2.1 Pozita gjeografike



Vendbanimi i Hanit të Elezit është në një vend i përshtatshëm gjeografik pasi që prek autoudhën R6 “Arbën Xhaferi” (Prishtinë-Hani i Elezit), rrugën nacionale Prishtinë-Shkup N2 dhe vijën kryesore hekurudhore të Kosovës Fushë Kosovë-Shkup. Përtej kësaj, rruga që lidh dy pikat kufitare (Hani i Elezit dhe Gllaboçicë) gjithashtu kalon përmes territorit. Rruga është 13km e gjatë dhe mund të përdoret në situata emergjente duke qenë më e përshtatshme sesa rruga që kalon nëpër malet e Sharrit nga veriu, e cila është 52km më e gjatë. Është gjithashtu vend kufitar pasi që në pjesën jugore

gjendet pika kufitare që lidh territorin e Kosovës me Maqedoninë. Kjo është një pikë kyçe për rajonin dhe Kosovën dhe shumica e mallrave eksportohen/importohen nëpër aty. Industria e materialeve ndërtimore (çimentos) është shumë e zhvilluar dhe e njohur jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj.

Qyteti ka lidhje të mira rrugore me fshatrat Pustenik, Seçishtë, Krivenik, Gorancë dhe Rezhancë që shtrihen brenda Maleve të Sharrit në perëndim; dhe me fshatrat Paldenicë, Dimcë, Dërmjak dhe Neqafç që i përkasin Maleve të Karadakut në lindje. Përjashtim në këtë rast bën vetëm fshati Vërtomicë i cili nuk ka lidhje të mirë rrugore me Qytetin. Ky fshat së bashku me Neqafcin janë shpopulluar tashmë, kurse Dërmjaku dhe Pusteniku kanë numër shumë të vogël të banorëve. Komuna është një territor i organizuar në mënyrë qendrore me një total prej njëmbëdhjetë vendbanimeve që janë të organizuara në mënyrë strukturore në njëmbëdhjetë zonat kadastrale.



Foto 2. Qyteza e Hanit të Elezit me industri


2.2.2 Topografia

Relievi është njëri prej komponentëve më të rëndësishëm fiziko-gjeografik të çdo hapësire. Ndikimi i tij kushtëzon edhe faktorët tjerë natyror siç janë: klima, ujërat, tokat, vegjetacioni etj. Nga i cili varet sa do të jetë një hapësirë e caktuar tërheqëse, komunikative si dhe funksionale.

Relievi i territorit të Hanit të Elezit është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre të jashtme të cilat kanë modeluar atë. Pikënisjen e bazamentit strukturor të territorit të Hanit të Elezit lidhet me ngritjet periferike të shprehura të maleve të Sharrit dhe Jezercit në perëndim dhe jugperëndim dhe të maleve të Karadakut në anën lindore dhe verilindore. Kjo tektonikë është shoqëruar edhe me shkëputje të rëndësishme gjatësore (shkëputja e Lepencit) e tërthore mjaft aktive gjatë këtij evolucionit.

Shpatiet e maleve të Sharrit të cilat shtrihen në territorin e Hanit të Elezit karakterizohen me pjerrtësi relativisht të madhe dhe me vlera të copëtimit vertikal dhe horizontal mesatar të relievit. Këto vlera mesatare të thellësisë së copëtimit, lidhen me rrjedhjet ujore (përroi i Seçishtes, Rezhancës, Laçit/ Kotlinës, etj.), duke i shfrytëzuar kryesisht edhe shkëputjet tërthore.

Në pjesën lindore të territorit të Hanit të Elezit shtrihet mali i Karadakut. Kryesisht karakterizohet si tërësi morfologjike kodrinoro-malore dhe malore me lartësi më të madhe brenda territorit të Hanit të Elezit. Relievi karakterizohet me vlera deri mesatare të copëtimit vertikal dhe horizontal të cilat i janë kushtëzuar nga rrjedhat lumore (përroi Dimca, përroi i Konopit, etj.).



Harta 3 Hipsometria

Mund të theksojmë se këto shpatie paraqiten mjaft të modeluara nga veprimtaria e forcave ekzogjene të cilat kanë lenë gjurmë të shumta në to, por edhe nga veprimtaria e faktorit antropogjen. Nëpër këto shpate vihen re lugje të thelluara të ndryshme gjatësore të krijuara si rezultat i rrjedhjeve ujore si dhe veprimet të denudacionit dhe shpëlarjes.


Territori i komunës së Hanit të Elezit karakterizohet kryesisht me terren kodrinor-malor, si dhe me pjesë fushore përgjatë rrjedhave ujore. Përshkruhet nga pellgu i lumit Lepenc i cili përfshin edhe përrën.

2.2.3 Klima

Klima është e ndryshueshme mesdhetare, me dimër të ashpër dhe temperatura minimale nga -10°C deri 5°C , dhe verë të nxehtë me temperatura maksimale që arrijnë 40°C . Ka një ndikim të fuqishëm nga lugina e Vardarit (klima e butë me ndikim të fortë gjatë dimrit që pasohet nga sasi të vogla të reshurave të borës) dhe Gryka e Kaçanikut (klimë tipike kontinentale me ndikim të fuqishëm gjatë verës). Zona është e karakterizuar nga reshje të dobëta. Ata janë matur me rreth 500ml/m^2 . Lagështia mesatare është rreth 65% (minimumi 51% dhe maksimumi 87%). Drejtimi kryesor i erës është veri - jug.

2.2.4 Hidrografia

Të dhënat e sakta hidro-gjeologjike për territorin e Hanit të Elezit janë shumë të kufizuara për shkak të mungesës së studimeve. Territori i komunës së Hanit të Elezit ka rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit Egje.



Harta 4. Harta hidrologjike

Nëpër këtë komunë kalon lumi i rëndësishëm jo vetëm për Komunën e Hanit të Elezit por për tërë Kosovën, Lepenci. Buron në shpatiet veriore të malit Sharr te Oshlaku me lartësi mbidetare 2212m. Lepenci ka luginë interesante kompozite e ndërtuar nga pjesët e gjëra dhe ngushticat. Me rëndësi është se lumi i Lepencit për shkak të burimit në lartësitë e mëdha mbidetare që mbulohen me borë i sigurojnë ushqim stabil me ujë. Bora qëndron deri në fillim të qershorit. Ushqimi i tij është nivalo-pluvial (bora dhe shiu). Sipërfaqja e pellgut është e mbuluar me pyje ndërsa në viset e larta me kullota malore. Ky lum është i tipit të hapur me një rrjedhje në drejtim të jug-lindjes, dhe formon pellgun e saj ujqor në rajon, që përfshin Hanin e Elezit, Kaçanikun, Shtërpçën dhe një pjesë të Ferizajit. Ajo mbulon zonën prej 800 km² dhe ka prurje mesatare prej 8 m³/sek. Pellgu ujqor i Lepencit është pellgu i trete me radhë ujqor për nga madhësia në krahasim me të tjerat në Kosovë, dhe mbulon 7.2% të sipërfaqes totale.

Territori komunal është gjithashtu plot me përrrenj që kalojnë në dy anë të perëndimore dhe lindore të luginës së lumit Lepenci. Tre përrrenjtë kryesore janë ai i Laçit/ Kotlines, Rezhances dhe Dimcës. Të tre përrrenjtë derdhen në lumin Lepenci. Ka edhe përrrenj të vegjël në gjithë territorin. Përroi i Konopit shtrihet në kufi, përroi i kishës, përroi i mullirit dhe përroi i kallugjerës në Gorance, përroi i Krivenikut, etj. Ka një burim të ujit i thartë në vendin e ashtuquajtur Uji i Thartë, afër rrugës nacionale N2. Sipas raporteve nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, burimet e këtij uji mineral kanë cilësi fiziko-kimike të ujit mineral që përdoret për pije. Ekzistojnë burime të ujit natyral në pothuajse të gjitha fshatrat e Hanit të Elezit.

Ujërat nëntokësorë kanë përhapje të kufizuar. Nga analiza e hartës hidrogeologjike shihet se ka ujëra nëntokësorë rreth aluvioneve lumore si është Lepenci. Burimet natyrore ujore janë të vogla por ka mjaft për shkak sasisë së reshjeve dhe terrenit malorë.

2.3 Demografia

Zhvillimi demografik është një fushë mjaft komplekse dhe me rëndësi të veçantë për planifikim dhe zhvillimin e përgjithshëm të një vendi. Në përgjithësi i tërë planifikimi për një zhvillim të qëndrueshëm bëhet për njerëzit dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës së tyre në vendin ku ata jetojnë. Analiza e faktorëve bazë të zhvillimit demografik është një kusht i domosdoshëm në procesin e planifikimit. Bazuar në rrjedhën e zhvillimit të komponentëve të zhvillimit demografik më realisht mund të planifikohen kërkesat dhe nevojat e shoqërisë për të tashmen dhe të ardhmen. Të dhënat për numrin e popullsisë kryesisht i japin regjistrimet e popullsisë. Për periudhën kohore 1948 – 1981 janë të dhënat për numrin e popullsisë së komunës së Hanit të Elezit sipas regjistrimeve të popullsisë. Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit 1991 që është vlerësim për faktin se në atë kohë nuk kishte pasur regjistrim të popullsisë, por megjithatë konsiderohen si relativisht të sakta.

2.3.1 Numri i popullsisë

Në Komunën e Hanit të Elezit jetonin 9,403 banorë sipas regjistrimit 2011⁵. Që nga viti 1948 e deri më 2011, Komuna e Hanit të Elezit ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Në vitin 1948 Hani i Elezit kishte 3,321 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore 63 vjeçare, numri i popullsisë ishte rritur pothuajse trefish. Ky trend i rritjes ka vazhduar edhe deri në vitin 2022

Vendbanimi	Popullsia e Komunës së Hanit të Elezit në vite										
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2001	2011	2023 ⁶	2024 ⁷	2024 ⁸
Numri i popullsisë gjatë viteve	3,321	3,722	4,001	4,693	6,044	7,029	7,029	9,403	8,655	8,533	8,555

Tabela 1. Numri i popullsisë gjatë viteve

Për shkak se PZHK HiE 2010-2025 nuk ishte miratuar ende në atë kohë, ASK e konsideroi popullsinë e Komunës së Hanit të Elezit si rurale. Dendësia e popullsisë ishte 121 banorë/ km².

Sipas Regjistrimit të popullsisë 2011, komuna e Hanit të Elezit numëronte 9,403 banorë, gjegjësisht rreth 0.54% të popullsisë së Kosovës. Sipas regjistrimit të njëjtë zona urbane kishte 3,787 banorë ose 37.5% të popullsisë komunale që është përafërsisht sa mesatarja e Kosovës prej 38%. Me këtë rast duhet pasur parasysh se ky numër i banorëve të zonës urbane përfshin zonën kadastrale të Hanit të Elezit dhe pjesë të zonave kadastrale të Seçishtes, Dimcës, Paldenicës, Rezhancës e Pustenikut (shih Aneksin 2). Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se ishin 791 persona nga Hani i Elezit të cilët jetonin jashtë Kosovës⁹. Ndërsa, sipas Regjistrimit të popullsisë 2024, komuna numëron 8,533 banorë rezident që në krahasim me numrin nga ai i vitit 2011 ka zvogëlim për rreth 9.25 %, që është më i lartë në krahasim me atë të nivelit të vendit prej 8.87%. Zvogëlimi i numrit të banorëve paraqet një tregues që banorët e komunës së Hanit të Elezit ashtu si në të gjitha komunat tjera të Kosovës po migrojnë si brenda vendit ashtu edhe jashtë për një jetë më të mirë sociale e ekonomike.

Dendësia e popullsisë është 103 b/km², që është më e ulët se ajo e nivelit të Kosovës - 146.9 b/km².

Vendbanimi	Popullsia 2011	Popullsia 2022 Vlerësim	Popullsia ¹⁰ 2024
Han i Elezit	2,533	2,736	2,555

⁵Burimi: Atlasi i regjistrimit të popullsisë 2011 <http://ask.rks-gov.net/media/2005/atlasi-i-regjistrimit-te-popullise-2011.pdf>

⁶Burimi: ASK, Vlerësimi i Popullsisë 2024

⁷Burimi: ASK, REKOS 2024

⁸Burimi: ASK, Vlerësimi i Popullsisë 2024

⁹Burimi: ASK, <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

¹⁰Burimi: ASK, Regjistrimi i Popullsisë 2024

Dimcë	249	269	147
Dromjak	121	132	108
Gorancë	1,028	1,110	767
Krivenik	283	305	204
Neçavc	110	120	102
Paldenicë	1,723	1,860	1,629
Pustenik	629	679	403
Rezhancë	475	513	487
Seçishtë	2,252	2,432	2,123
Vërtomicë	0	0	8
Gjithsej	9,403	10,155	8,533


Tabela 2. Popullsia sipas vendbanimeve

Prezantimi i të dhënave statistikore për vitet e mëparshme është bërë në bazë të regjistrimeve të vitit 1948/'81, ndërsa për vitin 1991 të dhënat janë mbledhur nga statistikat të atëhershme të vlerësimit. Regjistrimet dhe vlerësimet e mëparshme të kryera nga autoritetet e Kosovës përfshijnë numrin e përgjithshëm të popullsisë, ndërsa të dhënat e regjistrimit të vitit 2011, vlerësimet për vitin 2022 dhe 2024 përfshijnë vetëm popullsinë rezidente. Ndërsa, sa i përket numrit të popullsisë jo rezidente, në vitin 2011 ishte 791, numër i cili ka pësuar rritje gjatë viteve në vijim, ku në vitin 2024 ka arritur në 1413 banorë (bazuar në Vlerësimet e ASK-së për migrim ndërkombëtar dhe kombëtar duke filluar nga viti 2012 përfshirë edhe vitin 2024).

2.3.2 Moshë dhe gjinia


Të dhënat nga regjistrimin 2024¹¹, tregojnë që popullsia e komunës është kryesisht e re. Vërehet një dominim i grupmoshave nën 30 vjet me 48%, numër i cili ka pasur trend të uljes për 8% nëse e krahasojmë me regjistrimin e 2011. Ndërsa, popullsia aktive 15-64 vjet përfshinë rreth 67% të banorëve të komunës, e cila ka rritje prej 2% nëse krahasohet me numrin e vitit 2011.

Sa i përket raportit gjinor në përbërjen e popullsisë, në komunën e Hanit të Elezit vërehet një dominim i vogël i meshkujve prej rreth 4% përqindje e ngjashme me atë të Rekos 2011.



Grafiku 1. Popullsia sipas grupmoshave dhe gjinisë (Rekos 2024)

¹¹ Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë 2024



Grafiku 2. Popullsia aktive sipas gjinisë

2.3.3 Përkatësia etnike

Bazuar në regjistrimin e 2024¹² nga 8,533 banorë 8,517 janë shqiptarë (99.8%), 3 serb, 9 boshnjak, 3 të tjerë si dhe 1 ka preferuar të mos përgjigjet.

2.3.4 Përkatësia fetare

Sa i përket përkatësisë fetare në komunë sipas regjistrimin e 2024¹³ 99.98% e popullsisë i përket fesë islame.

2.3.5 Ekonomitë familjare

Në komunën e Hanit të Elezit janë gjithsej 1742 ekonomi familjare¹⁴, që në krahasim me atë të regjistrimin e 2011 është më i lartë.

NUMRI I ANËTARVE TË EKONOMISË FAMILJARE											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10+	Gjithsej
2011	14	50	72	195	325	239	146	126	91	194	1,452
2024	54	170	196	331	401	261	171	61	40	57	1,742


Tabela 3. Ekonomitë familjare sipas numrit të anëtarëve, viti 2011 dhe 2024

Në përgjithësi dominojnë familjet me nga 5 dhe 4 anëtarë me 23% gjegjësisht 19% pasuar nga 6, 3, 7 dhe 2 anëtarë. Analiza e të dhënave tregon që në krahasim me vitin 2011 numri i familjeve me 8 e më shumë anëtarë ka pësuar ulje ndërsa ato me numër 5 e më pak kanë pësuar rritje.

¹² Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë 2024

¹³ Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë 2024

¹⁴ Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë 2024



Grafiku 3. Ekonomitë familjare sipas numrit të anëtarëve, sipas Rekos 2011 dhe 2024

2.3.6 Lëvizjet natyrore

Sipas të dhënave të vitit 2022¹⁵, shkalla e lindjes është 144 fëmijë në vit, me normën e vdekshmërisë prej 48 persona në një vit. Shtimi natyror për këtë vit është 96 apo rreth 10 persona në 1000 banorë. Nëse e analizojmë rritjen e numrit të banorëve për periudhën 1948 – 2024, vërehet një rritje prej 157%. Përderisa numri i lindjeve ka pasur rritje në periudhën 2012 – 2015, pas vitit 2015 ka pas një ulje të lehtë, ndërsa numri i vdekjeve çdo vit ka shënuar rritje.

2.3.7 Lëvizjet mekanike

Kosova është karakterizuar me emigrime të popullsisë në periudha të ndryshme për shkak të rrethanave politike dhe ekonomike. Këto zhvillime e kanë karakterizuar edhe Komunën e Hanit të Elezit. Emigrimi në komunës mori hov prej vitit 1990, si edhe në tërë Kosovën, deri sa pas vitit 2000 emigrimi në nivel të Kosovës pësoi rënie, në Komunën e Hanit të Elezit ky trend vazhdoi me një nivel pothuaj se të njëjtë dhe me një rritje të theksuar prej vitit 2005. Arsyt kryesore të cekura për emigrim janë punësimi dhe arsyet familjare.

Sipas të dhënave nga ASK më 2011, nga 791 persona nga Komuna e Hanit të Elezit që janë të emigruar në shtetet e jashtme, pjesa dërmuese janë në shtetet e Evropës Perëndimore (sidomos në Itali, Gjermani dhe Zvicër). Duhet theksuar se migrimi ka marrë hov në 5-6 vitet e fundit duke përfshirë edhe Hanin e Elezit, ndërsa ASK parashikon ulje të këtij trendi pas 3-4 viteve¹⁶. Vlerësohet që numri i banorëve të migruar nga vitet 2012 deri në vitin 2023 i banorëve të migruar në vitin 2023 është rreth 1,256.

2.3.8 Niveli i arsimimit

Sipas Rekos 2024 për nivelin e arsimit brenda popullsisë 10 vjet e mbi, përqindja e popullsisë pa arsim formal dhe nivel të përfunduar të shkollimit është e njëjtë me atë në nivel vendi, përqindja me nivel të përfunduar fillor dhe të mesëm të ulët është më e lartë se në nivel vendi, ndërsa ajo me baçelor, master apo doktoraturë është me e ulët.

Nëse krahasohet me nivelin e arsimit sipas Rekos 2011, përqindja e popullsisë që nuk ka arsim formal dhe ajo me nivel të përfunduar fillor dhe të mesëm është më e ulët, ndërsa ajo me arsim të lartë ka pësuar rritje.

¹⁵Burimi: ASK, Vlerësimi i popullsisë 2022, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/09246935-0817-4685-8174-c080ed3b7a6c.pdf>

¹⁶Burimi: ASK, <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

Niveli i arsimimit													
	Nuk ka arsim formal		Fillor		E mesme e ulët		E mesme e lartë						
	Dinë shkrim dhe lexim	Nuk dinë shkrim dhe lexim	4 klasa, sistemi fillor	Sistemi i ri 5 klasor	8 klasa, sistemi i vjetër	9 klasa, sistem i ri	12 klasa sistemi i vjetër	12 klasa, sistem i ri					
Hani Elezit	402	299	762	750	2,076	773	1,537	662	78	205	13	1	7,558
%	5.3	4.0	10.1	9,9	27.47	10.2	20.3	8.8	1.0	2.7	0.2	0	10
Kosovë	43,702	43,827	71,623	70,948	210,138	77,631	98,748	54,395	10,640	29,424	2,811	228	1,429,175
%	6.1	6.1	10	9.9	29.5	10.9	13.8	7.6	1.5	4.1	0.47	0.03	100

Tabela 4. Niveli i arsimit në Han të Elezit dhe Kosovë

Burimi: REKOS, regjistrimi, 2011

Niveli i arsimit (popullsia 10 vjec e mbi)														
	Nuk ka arsim formal		Fillor		E mesme e ulët		E mesme e lartë							
	Nuk ka arsim formal	Nuk ka asnjë nivel të përfunduar shkollimi	4 klasë, sistemi i vjetër	5 klasë, sistemi i ri	8 klasa, sistemi i vjetër	9 klasa, sistem i ri	12 klasa sistemi i vjetër	13 klasa, sistem i ri						
Hani Elezit	148	165	468	667	1,728	671	673	1,894	45	570	93	6	40	7,168
%	2.1	2.3	6.5	9.3	24.0	9.4	9.4	26.4	0.6	8.0	1.3	0.08	0.6	100
Kosovë	41,449	28,886	79,725	106,295	270,015	119,015	205,988	269,821	16,950	169,863	42,602	4,144	5,831	1,360,584
%	3.0	2.2	5.9	7.8	19.8	8.8	15.1	19.9	1.2	12.5	3.1	0.3	0.4	100

Tabela 5. Niveli i arsimit në Han të Elezit dhe Kosovë, RekOS 2024

2.3.9 Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia

Shkalla e lartë e papunësisë është një nga çështjet më sfiduese në Kosovë, duke qenë një nga sfidat kryesore edhe për Komunën e hanit të Elezit. Për ta treguar nivelin e punësimit, në Kosovë merret në shqyrtim popullsia e aftë për punë, përkatësisht grup mosha 15-64 vjeç. Fillimisht bëhet ndarja e popullsisë aktive në dy kategori: popullsia aktive dhe joaktive. Popullsia aktive (fuqia punëtore) përfshinë personat që punojnë dhe ata që në mënyrë aktive kërkojnë punë. Popullsia joaktive përfshinë personat që nuk punojnë dhe që nuk janë duke kërkuar punë (studentët, amviset, pensionistët dhe ata që nuk janë në gjendje për të punuar).

Sipas vlerësimeve aktuale nga sondazhi në terren dhe të dhënave nga ndërmarrjet në HiE¹⁷, përqindja e papunësisë është 67%. Ka një numër të vogël të punësuarve në sektorin jo formal ekonomik. Megjithatë, nuk ka të dhëna të sakta pasi që të punësuarit në bizneset jo formale nuk

¹⁷Burimi: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, 2022

janë të regjistruar. Sipas statistikave, popullsia e moshës aktive për punë përbënë rreth 67% të numrit total të popullsisë, të dhëna këto që vërtetojnë për një potencial për zhvillim duke u bazuar në fuqinë punëtore që ka Hani i Elezit.

Më poshtë me anë të tabelës kemi paraqitur të dhënat për punësim si llojit të vendit të punës dhe në tabelën tjetër kemi paraqitur popullsinë e moshës 15 vjeç e mbi sipas statusit të aktivitetit aktual në komunën e Hanit të Elezit:

Gjinia	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Vendi fiks i punës	970	130	1100
Punon kryesisht në/nga shtëpia	9	1	10
Nuk ka vend fiks të punës	54	1	55
Nuk janë në dispozicion	4	0	4
Gjithsej	1037	132	1169

Tabela 6. Punësimi

Gjinia	Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Të papunësuar, ka punuar më pare	Të papunësuar, nuk kanë punuar kurrë më pare	Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të cilën janë pranuar	Ekonomikisht jo aktiv
Meshkuj	2142	1037	443	654	8	1238
Femra	353	132	19	198	4	2892
Gjithsej	2,495	1169	462	852	12	4,130

Tabela 7. Numri i të punësuarve dhe të papunëve nga popullsia e aftë për punë

2.3.10 Burimet kryesore të jetesës

Duke u bazuar në burimet e të hyrave në komunën e Hanit të Elezit, shihet se përqindja e të hyrave nga punësimi është shumë e ulët. Po ashtu, niveli i mbështetjes përmes pensioneve dhe skemave sociale është shumë i ulët. Banorët e komunës janë kryesisht të varur nga të hyrat që vijnë nga persona të tjerë dhe nga remitancat.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2011, vetëm 14.5% e banorëve mbështeten në të hyrat nga punësimi. Të ardhurat nga skema e pensioneve, ndihmës sociale dhe nga fondet e tjera ndihmëse (papunësia) janë 11.1%/. Mbështetja kryesore financiare vjen nga personat e tjerë nga të cilat varen 64.7% e banorëve, 3.2% nga remitancat dhe 6.8% nga burime të tjera. Shikuar përgjithësisht, niveli i varfërisë në komunë mbetet i lartë.

		Puna (përfshirë punën në pronë, biznesit privat ose të biznesit familjar)	Pasuritë e patundshme, investimet, (qira, interesi)	Pensione	Ndihma sociale	Transferet tjera (përfshirë nga papunësia, sëmundjet, pushimi i lehonisë, burime tjera)	Remitancat (Të ardhurat nga të afërmit nga jashtë vendit)	Mbështetje nga njerëzit e tjerë	Burimet e tjera	Total
Hani i Elezit	Nr.	1365	36	560	484	27	303	5087	541	9403
	%	14.5	0.4	5.0	5.8	0.3	3.2	54.7	5.8	100
Kosova	Nr.	390281	5330	112020	34683	7102	92317	922464	124628	1739825
	%	22.4	0.4	5.4	5.2	0.4	5.3	53	7.2	100

Tabela 8. Burimet kryesore të jetesës

Burimi: REKOS, regjistrimi i vitit 2011

2.4 Ekonomia

Peizazhi dhe organizimi hapësinor i Qytezës së Hanit të Elezit lë të nënkuptojë se industria e materialeve ndërtimore ende mbetet aktiviteti kryesor ekonomik në vend. Në këtë industri dominon prodhimi i çimentos si veprimtari e vetme në Kosovë e ndjekur nga prodhimi i rërës/ zhavorrit (3 prodhues) mëpastaj stiroporit dhe në masë më të vogël pasurimi i kromit. Industria e çimentos ka tërhequr me vete edhe transportin e materialeve ndërtimore si një veprimtari mjaft e zhvilluar me mbi dyqindë qind kamionë në pronësi të kompanive të ndryshme lokale.

Duke marrë parasysh lidhjen e lehtë dhe shumë të mirë me arteriet kyçe nacionale rrugore, bizneset shërbyese hoteliere kanë një zhvillim solid posaçërisht përgjatë magjistrals dhe autoudhës duke sjellë të hyra shtesë nga jashtë Komuna.

Edhe pse me tokë bujqësore kualitative të kufizuar, një numër i madh i banorëve të komunës janë marrë tradicionalisht me bujqësi. Si kultura më të mëdha kemi kryesisht: misrin që kultivohet në luginën e Lepencit, grurin në rrafshnaltën e Krivenikut dhe livadhet si aktivitet përcjellës i zhvillimit blegtoral në Bjeshkët e Sharrit dhe Karadakut. Përtej kësaj banorët vazhdojnë edhe më tej të kultivojnë fruta/ perime në kopshtet e tyre (në raste edhe me serra) si dhe fruta mali në sasi të kufizuara kur ato janë subvencionuar.

Turizmi malor paraqet degën e re ekonomike që sapo ka filluar të zhvillohet në pjesën e Pustenikut, Neçavcit dhe ndonjë hapësirë tjetër.

Edhe përkundër asaj që u përmend më lart, Komuna e Hanit të Elezit vlerësohet të ketë zhvillim të ulët ekonomik. Në përgjithësi, mjedisi për zhvillimin e ndërmarrjeve ende mbetet i pafavorshëm dhe me mbështetje të pamjaftueshme. Potenciali për procesim të materialeve ndërtimore si zhavorr dhe çimento në elemente ndërtimore montazhe apo gjysmë montazhe mbetet për tu analizuar. Potenciali turistik (natyra/ kultura në bashkëpunim me shërbimet hotelierike) mund të zhvillohet edhe më tej ku si ndihmesë mund të jetë edhe prodhimi i përmirësuar bujqësor lokal.

Vlen të theksohet që komuna ka potencial edhe për zhvillimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, të cilat mund të shfrytëzohen nga ndërmarrjet për prodhimin e energjisë të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

2.4.1 Industria

Si një zhvillim që i ka dhënë karakterin qytezës dhe në të njëjtën kohë ishte edhe shkaktar i evoluimit dhe zhvillimit të saj, industria është dega më e zhvilluar ekonomike në Han të Elezit. Bazuar në burimin natyror nëntokësor mergele si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, i cili më vonë (gjatë viteve 70 dhe 80) u hulumtua në sasinë e 13.438.260 ton në Han të Elezit (e verifikuar) dhe 25.985.030 ton në Paldenicë (e pa verifikuar); kapacitetet prodhuese fillestare të çimentos (sot quhet fabrika për prodhimin e çimentos “Sharrcem”) u ndërtuan që në vitin 1936 duke u shtuar më vonë në vazhdimësi në vitet e 70-ta dhe 80-ta. Nga viti 2000 deri 2010 fabrika ishte e komercializuar nga firma zvicerane Holcim, kurse nga 2010 ajo është privatizuar nga firma greke Titan Group. Gjatë këtyre viteve janë bërë edhe hapa substancial në përmirësimin dhe digjitalizimin e linjave prodhuese, përmirësime në rritjen e efijencës, automatizim të punëve, menaxhim më të mirë të shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, reduktimet e ndotjes, etj.

Prodhimi i çimentos ka variuar nëpër vite. Gjatë sistemit të mëparshëm kishte arritur kulmin e prodhimtarisë më 1982 me 550.000 ton në vit. Pas montimit të teknologjisë më të avancuar, më 2009 u arrit sasia e rreth 600.000 tonëve në vit. Që nga atëherë e deri më 2014, prodhimtaria ka arritur çdo herë mbi 500.000 tonë në vit. Në vitin 2015 prodhimtaria vjetore arriti në 630.000 ton¹⁸. Me këtë sasi të prodhuar, nevojat e Kosovës mbulohen në sasinë nën 50%. Përqindja tjetër importohet kryesisht nga Maqedonia por edhe Shqipëria dhe Serbia.

¹⁸“Burimi: CSR and Sustainability Report 2015”, Sharrcemit, faqe 8-9

Që nga viti 2002 e në disa raste edhe më parë, Sharrcem ka shfrytëzuar rreth 500.000 ton mergele në vit në mihjen sipërfaqësore në Han të Elezit duke arritur totalin e mbi 10.000.000 tonëve deri në fund të 2021. Kjo sasi duhet analizuar në kontekstin e sasisë totale të mergeles së verifikuar në zonat e lartpërmendura. Bazuar në këtë si dhe vrojttimeve në terren, mund të thuhet se rezervat e mergeles në Dimcë janë shpenzuar në sasi relativisht të mirë që qon në përfundim se duhet shtuar masat në shfrytëzim sa më racional të kësaj lënde të parë.

Përveç qëllimit kryesor të prodhimitarisë, Sharrcem ka ndërmarrë edhe hapa për rrjetëzimin e tij si dhe për mbështetje të komunitetit në Han të Elezit. Në vitin 2011, Sharrcem ishte iniciues në themelimin e Rrjetit për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave (CSR). Gjithashtu është themeluar dhe financuesi kryesor i Laboratorit për Aktivitete të Biznesit (LAB), i themeluar më 2014 me qëllim që të kontribuojë në edukimin dhe mbështetjen financiare të iniciativave që do të mundësonin alternativa të vetë-punësimit dhe gjenerimit të të hyrave për qytetarët e Hanit të Elezit. Në kuadër të Lab-it dhe nismave tjera për komunitetin si dhe për përfitime sociale, Sharrcemi ka investuar në vlerë mbi 450.000 euro deri në vitin 2021.

Guri gëlqeror, si burim tjetër industrial, shfrytëzohet relativisht mirë në Han të Elezit. Janë gjithsej 2 gurëthyes që operojnë në komunë. Po ashtu, pritet shumë shpejtë hapja e nje impianti për prodhimin e gëlqeres e cila do të ndikoj shumë në rritjen ekonomike të Hanit të Elezit.

Fabrika “Kosovaplast” për prodhimin e stiroporit gjithashtu është privatizuar dhe shndërruar në biznes të ngushtë familjar me numër minimal të punëtorëve dhe me aktivitet të limituar. Gjithashtu ekziston një fabrikë e betonit dhe disa biznese prodhuese tjeratë vogla.

Po ashtu vitin 2020 ka filluar punën impianti për pasurimin e mineralit të kromit në fshatin Gorancë (Zheden). Është ky një investim Zviceran dhe parashihet punësimi i 50 punëtorëve të profileve të ndryshme. I tërë prodhimi është i paraparë për eksport. Resurse tjera natyrore të pashfrytëzuara në Han të Elezit janë edhe argjila e vërtetuar me mbi 26 milion ton, guri dekorativ, guri vullkanik, kromi, hekuri dhe uji mineral¹⁹.

2.4.2 Ndërmarrjet

Në komunë janë të regjistruara gjithsej 201 biznese. 90 nga ky numër nuk janë funksionale. Sektorët ekonomik dominues janë kryesisht tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet shërbyese dhe ato transportuese. Tregtia përfshinë 20% të ndërmarrjeve, aktivitetet shërbyese 16%, transporti 18%, ndërtimtaria 6%, ndërsa sektorët tjerë përfshinë pjesën tjetër prej 40%. Përkundër potencialeve në vend për zhvillimin e bujqësisë, ky sektor mbetet fare pak i përfaqësuar me një përqindje tepër të ulët. 93% e bizneseve janë të përqendruara në Qytezë dhe përgjatë rrugës nacionale N2.

Sikur në tërë Kosovën, informaliteti ekonomik është shumë i lartë. Ai është shumë i theksuar në formën e bizneseve të paregjistruara ndërtimore, shërbime profesionale të ofruara nëpër amvisëri, prodhimtari bujqësore, etj. Informaliteti gjithashtu shprehet edhe te bizneset e regjistruara kur një pjesë e aktivitetit të tyre nuk regjistrohet fare.

Të gjitha ndërmarrjet janë private me përjashtim të Kompanisë për Menaxhim të Mbeturinave “Pastrimi” dhe Kompanisë Regjionale për Ujësjellës/ Kanalizim “Bifurkacioni” – Njësia në Han të Elezit, të cilat janë publike. Dominimi i sektorit privat është një tregues se ka nevojë për përkrahje të mëtejme të tyre, duke i pasur parasysh edhe potencialet lokale.

Sa i përket tregut, përveç drithërave dhe frutit të dredhëzës që për momentin e kanë atë më të organizuar, prodhimet tjera vendase kanë vështirësi që të plasohen në treg dhe të shiten. Tregu i këtyre prodhimeve në Kosovë nuk është i rregulluar. Në Han të Elezit ekziston tregu i qytetit i cili organizohet një herë në javë si dhe një vend ku mund të ekspozohen prodhimet (i ndërtuar nga LAB). Por fuqia blerëse e Komunës me numër të vogël të banorëve nuk mund të konsumojë prodhimet që shumica e tyre kanë një periudhë të shkurtër konsumimi. Prodhimet e mjedres janë ulur ndjeshëm

¹⁹Sipas Planit Zhvillimor Komunal të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2011, faqe 39

për shkak të tregut jo të organizuar dhe çmimit të ulët, përderisa pemët dhe perimet e ndryshme plasohen në tregun më të gjerë kosovar me shumë vështirësi.

Gjithsesi janë bërë hapat e parë për standardizimin e produkteve bujqësore si dhe trajnime dhe mbështetje permanente të bujqve për kultivim sa më mirë dhe efikas të kulturave të lartpërmendura. Trajnime dhe mbështetje ka pasur edhe për aktivitete biznesore të natyrave tjera. Këto aktivitete pritet të intensifikohen në vitet në vijim.

Burimi: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa 2022

2.4.3 Punësimi

Sipas regjistrimit të vitit 2011 numri i popullsisë së aftë për punë (15-65 vjeç) në Komunën e Hanit të Elezit ishte 6101. Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, numri i të punësuarve në ndërmarrjet (publike/ private) dhe administratën lokale/ qendrore brenda Komunës së Hanit të Elezit është 1024, që përfshinë vetëm rreth 17% të popullsisë së aftë për punë (15-64 vjeç). Nga ky numër, 272 janë të punësuar në administratë dhe ndërmarrje publike, ndërsa tjerët në sektorin privat (752). Nëse krahasohet numri i të punësuarve me numrin e ndërmarrjeve private, madhësia mesatare e ndërmarrjes del të jetë 3.13 punëtorë, që është vlerë e ulët.

Megjithatë, për shkak të jo-formalitetit është e vështirë të përcaktohet qartë numri total i të punësuarve dhe rrjedhimisht përqindja e papunësisë. Agjencia e Statistikave e Kosovës në vlerësimet e tyre 3 mujore vlerëson se gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, në nivel të Kosovës, shkalla e papunësisë është 25.8%. Papunësia më e theksuar është te femrat me 29.7%, krahasuar me meshkujt, 24.2%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grup moshat 15-24 vjeçare me 48.6%.

Burimi: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa 2022

2.4.4 Turizmi

Natyra e Hanit të Elezit është shumë unike me dy masivet malore të Sharrit dhe Karadakut të cilat mbyllin çdo horizont. Në këto hapësira vlerësohen veçmas pishat e Gorancës dhe Neçavcit e Vërtomicës si dhe Pustniku, Kriveniku dhe Dremjaku me asetin shtesë të trashëgimisë kulturore-historike. Kur kësaj i shtojmë edhe Luginat e Lumit Dimca dhe Laç të cilat janë gjithashtu atraksione të veçanta turistike, atëherë paketa turistike bëhet edhe më e larmishme. Pas 2008 është investuar edhe në infrastrukturë rrugore duke e lehtësuar qasjen drejt këtyre lokacioneve. Mirëpo duhet investuar edhe më tej në përmirësimin e qasjes në këto vendbanime, infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe grumbullimit të mbeturinave si dhe në sferën e shërbimeve hoteliere-shërbyese dhe sportive-rekreative. Kombinimi i shtëpive tradicionale për qëndrim të shkurtë, ushqimit tradicional, hiking-ut nëpër shtigje malore, afërsisë së Shkupit, Bregut të Diellit/ Tetovë, Shtrazës (Kaçanik) si dhe promovimit të gjithë këtij sistemi do ta bënte më atraktive dhe më të dëshiruar shijimin e këtyre mrekullive nga qytetarët kosovar dhe nga jashtë. Ushqimet tradicionale mund të bëhen nga produktet bujqësore të treguara më lart.

Vlerat kulturore të vjetra dhe të reja (më shumë detale jepen te zhvillimi social – pjesa e trashëgimisë kulturore) gërshetohet në mënyrë unike me natyrën e Sharrit duke ia shtuar mundësitë për zhvillimin e turizmit.

Në qytezë ekzistojnë objekte banimi dhe objekte industriale të vlerësuara si trashëgimi industriale²⁰ sepse i përkasin periudhës kur industria ishte në filllet e veta. Një pjesë e fabrikës Sharrcem e vlerësuar si e tillë është rrënuar para disa viteve, por kanë mbetur silosët e vjetër të cilët duhet ruajtur dhe përmirësuar në kuadër të zhvillimeve të gjithmbarshme. Rindërtimi i Hanit të vjetër ishte vlerësuar gjithashtu potencial për zhvillim të turizmit²¹. Trashëgimia kulturore me zona

²⁰ Sipas Planit Rregullues Urban të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2014, faqe 45 dhe 54

²¹ Sipas Planit Rregullues Urban të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2014, faqe 45 dhe 54

arkeologjike, objekte arkitektonike, objekte të veçanta të trashëgimisë²² si dhe artefakte të ndryshme do ta plotësonin mozaikun e vlerave për një turizëm serioz në Komunë.

2.4.5 Bujqësia


Bujqësia me rol mesatar në zhvillimin e gjithmbarshëm të Hanit të Elezit sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2011) kishte vetëm 26 të punësuar që përbën vetëm rreth 2.5% të totalit të punësuarve. Numri i **ndërmarrjeve bujqësore** është tejet i ulët. Siç u përmend më lartë, numri total i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore përbën vetëm 4% të ndërmarrjeve në komunë, që tregon përgjithësisht për kapacitete të vogla të ndërmarrjeve dhe strukturim kryesisht familjar.

Toka bujqësore e kategorizuar sipas kualitetit i takon ekskluzivisht kategorive 5-8, përveç ndonjë sipërfaqe rreth lumit Lepenc e cila tashmë është ndërtuar veçanërisht në Lagjen e Re.

Aktiviteti kryesisht zhvillohet në formë të bujqësisë familjare për krijimin e të ardhurave shtesë në familje, me parcela të vogla private bujqësore dhe me mekanizëm bujqësor të munguar apo vjetruar (amortizuar) me përjashtim të rasteve të pakta kur mekanizmi është subvencionuar. Sipërfaqet e tokës bujqësore përgjatë Lumit Lepenc (kulturat bujqësore- lavërtare të mbjella kryesisht me misër) ujiten përmes kanaleve të hapura të ujitjes të ndërtuara si kanale klasike dheu. Serrat e perimeve, frutat e pyllit si dhe disa pemishte, të subvencionuara këto nga entitete të ndryshme, kanë sistemet enkas të ndërtuara për ujitje pikë-pikë. Perimet në hapësirat e jashtme dhe shumica e pemishteve ujiten duke shfrytëzuar burimet private, lumenjtë/përrojet si dhe ujin nga ujësjellësi. Nuk ka ndonjë sistem të mirëfilltë të ujitjes sepse shumica e këtyre sipërfaqeve bujqësore janë të shpërndara nëpër të gjithë territorin e komunës.

Viteve të fundit ka filluar përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit nga qeveria qendrore/ lokale, LAB-i (i treguar më lart), IKC-ja, Caritas Luxembourg, Caritas Kosova, Islamik Reliev, Fondacioni Kosovë-Luxembourg gjithnjë në bashkëpunim me komunitetin. Në të shumtën e rasteve, subvencionimi ka përfshirë 90% të lëndës (serra së bashku me sistemin e ujitjes, farërat dhe plehrat/ushqimin e duhur apo shtalla së bashku numrin e kafshëve shtëpiake). Në disa raste janë subvencionuar edhe mekanizmat bujqësore si motokultivatorët dhe mekanizmat bujqësor përcjellës. Megjithatë nevojat për përkrahje janë ende më të mëdha se mundësitë buxhetore.

²² Sipas Planit Zhvillimor Komunal të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2011, faqe 35-36



Harta 5. Përshtatshmëria e tokës

Toka bujqësore – Sipas të dhënave nga Sektori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, bazuar sipas regjistrit të vitit 1958, sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është si në vijim:

Sipërfaqja e tokës bujqësore (ha)		
Tokë pjellore	Tokë lavërtarë	1.177,30
	Livadhe	230,16
	Kullosa	1.693,26
	Gjithsej	3.100,72
Tokë jo pjellore		519,40
Gjithsej		3,620.12

Tabela 9. Sipërfaqja e tokës bujqësore

Nga zhvillimet në terren dhe të dhënat komunale është më se e qartë se toka lavërtare është duke u shfrytëzuar kualitativisht vetëm rreth 13%. Pjesa tjetër e sipërfaqes është duke u shndërruar ditë-ditës në tokë ndërtimore (posaçërisht Lagja e Re), lënë djerrë apo duke iu ndërruar destinimi në favor të livadheve/ kullosave.

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore – sipas të dhënave komunale, ndërrimi formal i destinimit të tokës bujqësore është tepër i ulët (më pak se pesë ari në vit). Kjo është shifra e bazuar në kërkesat e aprovuara për ndërrim destinimi që janë bërë për ndërtimet në zonën urbane dhe në vendet ku kanë marrë grante prej MBPZHR-së. Ndërtimet tjera që janë bërë në vendbanim e në toka bujqësore janë pa leje dhe si të tilla nuk kanë as dokumente për ndërrim destinimi.

Burimi: Komuna Han të Elezit- DBZHRP-së 2022

Prodhimtaria bujqësore – sa i përket tokës lavërtare, tradicionalisht në territorin e Hanit të Elezit (në të shumtën në Rrafshnaltën e Krivenikut) është mbjellë gruri. Kulturat tjera që mbillet tradicionalisht janë misri, elbi, tërshëra dhe patatja të cilat janë në sasi më të vogla. Mesatarja e prodhimit të drithërave sillet nga 3.5 t/ha deri në 4.5 t/ha të gruri dhe nga 5t/ha deri në 6.5 t/ha të misri. Edhe

kultivimi i perimeve ka marrë hov viteve të fundit. Janë ndërtuar serra për kultivim ekstenziv të domates, specit, trangullit, pjeprit por edhe perimeve barishtore. Këto kultura mbillen edhe në hapësira të jashtme.

Në vazhden e këtij hovi përfshihet edhe kultivimi i frutave të pyllit si dredhëza dhe mjedra. Në kuadër të pëmtarisë është prezantuar edhe rrushi i tryezës. Vazhdojnë të kultivohen edhe arrat, mollat, kumbullat, dardhat dhe frutat tjera. Kultivimi i foragjereve përfshinë barin klasik (sanë) dhe jonxhën. Këto të fundit po kultivohen nëpër toka të destinuara si livadhe

Sipërfaqet e mbjella me këto kultura janë dhënë në vijim:

Sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme (ha)		
Drithërat dhe të ngjashme	Gruri	15,00
	Misri	00,00
	Elbi	13,50
	Tërshëra	2,50
	Patatja	5,00
	Gjithsej	36,10
Perime të ndryshme (domate, specia, tranguj, pjeper, perime barishtore, etj.)	Në serra	2,50
	Në hapësirë të jashtme	1,50
	Gjithsej	4,00
Fruta pylli	Mjedra	1,50
	Dredhëza	2,50
	Gjithsej	4,00
Pemishte	Arra	7,70
	Pemishte tjera (molla, dardha, ftoj, kumbulla, etj.)	5,00
	Gjithsej	12,70
Vreshta		1,50
Gjithsej sipërfaqe e kultivuar bujqësore		58,30

Tabela 10. Sipërfaqja e kultivuar bujqësore

Prodhimtaria blegtorale – blegtoria është zhvilluar gjithashtu në kohët e fundit duke bërë që të shtohet veçanërisht numri i lopëve qumështore, por edhe të deleve dhe dhive. Edhe numri i pulave dhe kolonive të bletëve është shtuar me të madhe. Numri i tyre është dhënë në tabelën në vijim:

Numri i krerëve të kafshëve shtëpiake/ shpezëve/ kolonive të bletëve		
Gjedhi	Lopë qumështore	450
	Pjesa tjetër e gjedhit	135
	Gjithsej	585
Delet		1639
Dhitë		52
Pulat		200
Kolonitë e bletëve		2060

Tabela 11. Numri i krerëve të kafshëve blegtorale

Prodhimtaria e qumështit vlerësohet në 87,67 litra/ ditë, e mishit në 3500 kg/ vit, e vezëve 180 copë/ ditë dhe e mjaltit në 4000 kg/ vit.

Burimi: Komuna e Hanit të Elezit 2022

2.4.6 Pyjet

Po sipas të dhënave nga Sektori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, tokat pyjore përfshijnë 5,202 ha. E tërë sipërfaqja pyjore kategorizohet si e mbrojtur, pa destinim për ndonjë qëllim komercial.

Sipërfaqja reale e pyjeve nuk përkon me atë destinuar si më lart. Duke filluar nga vitet e 90-ta, pyjet janë dëmtuar (zjarre) dhe prerë në vazhdimësi në mënyrë jo-formale për tu shfrytëzuar si lëndë

djegëse (burim kryesor për ekonominë familjare). Në të vërtetë pyje të larta kanë mbetur në sipërfaqe relativisht të vogël. Një gjë pozitive është se aty ku pyjet janë prerë kanë filluar të rriten pyje të reja të cilat duhet ruajtur dhe zhvilluar. Shumica e sipërfaqes është potencial për pyje të larta përveç anës jug-perëndimore e cila mbulohet nga shkurret. Më së shumti është i përhapur ahu por ka edhe sipërfaqe me bung, shkozë, pishë, frashër, etj.

Në dhjetë vitet e fundit ka pasur aktivitete të pyllëzimit si mbjellja e 17 hektarëve me pisha në Gorancë nga qeveria lokale dhe qendrore, etj. Këto aktivitete planifikohen të vazhdojnë edhe në të ardhmen së bashku me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të pyjeve. Rrallimet komerciale dhe para-komerciale janë të përvitshme dhe ndikojnë pozitivisht në mirëmbajtjen e pyjeve dhe në shërbim më të mirë të ngrohjes.

2.4.7 Burimet e ripërtërishme të energjisë

Viteve të fundit në Kosovë për shkak të kursimit të energjisë elektrike është duke u promovuar nga Qeveria dhe donatorët efienca e energjisë dhe prodhimi i energjisë nga burimet e ripërtërishme si me zhvillim të kapaciteteve ashtu dhe me mbështetje financiare. Si rezultat, në shumë ndërtesa të institucioneve publike janë instaluar panelet solare për prodhim të energjisë për nevoja të tyre. Poashtu, shumë amvisëri dhe biznese kanë perfituar në rehabilitimin e ndërtesave por edhe në instalimin e teknologjisë për prodhim të energjisë nga dielli dhe në masë më të vogël edhe nga era, si masa me qëllim të kursimit të energjisë. Kjo ka ndikuar në ngritjen e nivelt të interesimit të investitorëve për investime në këtë sektor, përfshirë dhe komunën e Hanit të Elezit. Si rezultat, komuna tashmë i ka të identifikuar lokacionet me potencial për zhvillim të energjisë nga burimet e diellit dhe erës, të cilat përbëhen nga tokat e klasës mbi IV.

2.5 Infrastruktura teknike


2.5.1 Ujësjellësi

Burimet dhe infrastruktura – zona urbane e Hanit të Elezit me Lagjet përreth (pjesa e poshtme e Seçishtes deri te burimi, lagja Maliqi, lagja Brava dhe lagjet përgjatë rrugës nacionale N2, etj.; me 5487 banorë) ka një sistem të përbashkët të ujësjellësit. Për shkak të disa problematikave që do të përshkruhen më poshtë ai është i ndarë në dy pjesë. Pjesa në perëndim të hekurudhës furnizohen nga burimet e Gllloboçicës (Kaçanik) si në vijim:

- Burimi 1 (te lajthia) në koordinatat: $x=4670199$; $y=7515681$ dhe nivel $z=773m'$
- Burimi 2 dhe 3 (kepi i shqipes) në koordinatat: $x=4670509$; $y=7515981$ dhe nivel $z=756m'$
- Burimi 3 (i cili karakterizohet me sasi të vogël uji dhe gjendet ngjitur përroit Kotlinë)

Sipas matjeve²³, këto burime në periudhën e thatë kanë kapacitet prej 11-12 l/sec ndërsa në periudhën e shirave arrin deri në 18-20 l/sec. Uji nga këto burime vjen me rënie të lirë deri në rezervuarin betonarme mbi lagjen Brava në lartësi mbidetare $h=494 m'$. Rezervuari ka 2 dhoma me diametër 11.8m' dhe lartësi 4m' të cilat mund të mbajë rezerva uji deri në $V=860 m^3$. Në kuadër të këtij sistemi ekziston edhe një rezervuar aty afër me kapacitet $V=1200 m^3$ i ndërtuar në lartësi mbidetare $h=521m'$ për të furnizuar në mënyrë të rregullt pjesën e epërme të fshatit Seçishtë, Lagjet Maliqi dhe Brava dhe ndoshta edhe fshatin Paldenicë. Megjithatë, për shkaqe teknike ai nuk është futur në përdorim. Në të njëjtën kohë edhe pjesa e epërme e fshatit Seçishtë ka rrjet të ndërtuar të ujësjellësi i cili nuk është në përdorim.

²³Matjet janë bërë nga Drejtoria Komunale e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me UN Habitat-in në disa raste, më të fundit gjatë vitit 2015.



Harta 6. Shtrirja e rrjetit të ujësjiellësit

Pjesa e Qytezës në lindje të hekurudhës furnizohet me ujë nga Impianti për pastrimin e ujit që merr ujin e Përroit Dimca. Ky impiant ka kapacitet prej 20 l/sec. Për ndryshim nga rasti i mëparshëm, në impiant uji futet në filtra me pompim. Sistemi ka gjithashtu edhe rezervuarin betonarme me kapacitet $V=250 \text{ m}^3$. Për shkak të problemeve menaxhuese, dhe problematikave teknike vitin 2022 dhe 2023 janë bërë investime shtesë në impiant me çrast dukshëm është përmirësuar performansa teknike e impiantit përfshirë këtu edhe përmirësimin e cilësisë së ujit të përpunuar. Ky sistem është i ndarë nga pjesa perëndimore e qytezës. Pavarisht investimeve edhe në këtë pjesë ka mungesë të ujit për arsye të humbjeve në rrjet (rrjeti i vjetër) si dhe keqpërdorimeve.

Edhe fshati Gorancë ka sistem të përbashkët ujësjellësi dhe ballafaqohet me problematika të njëjta të mungesës së ujit dhe të menaxhimit të sistemit. Ky sistem menaxhohet nga vetë banorët. Burimet kanë kapacitet total prej 5 l/ sec dhe rezervuar me kapacitet 400 m³. Fshatrat/vendbanimet tjera furnizohen me ujë nga burime private apo bunarë/puse jo të mirëmbajtura mirë.

Rrjeti i prurës nga burimet në rezervuare është i gjatë L=12,084 m' nga materiali PVC, ndërsa rrjeti furnizues/ shpërndarës është me material HDPE L=827 m' dhe çelik L=251 m'. Gjatësia totale e sistemit të gypave është L=13,162 m'.

Shërbimi dhe menaxhimi – duke filluar nga 2019, sistemi i ujësjellësit në Qytezën e Hanit të Elezit menaxhohet nga Kompania Regjionale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit KRUK “Bifurkacioni” sh.a, Njësia në Han të Elezit. Më herët ai ishte menaxhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike duke realizuar të gjitha projektet dhe intervenimet e nevojshme përfshirë projektet e reja, mirëmbajtjen, dhe eliminimin e defekteve.

Shërbimi për konsumatorët është i pjesshëm si për nga sasia ashtu edhe cilësia. Pjesa perëndimore e Qytezës furnizohet me ujë kualitativ sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe rregulloreve/ normave të IKSHP (uji i burimit nëntokësor klorinohet vazhdimisht) por ka

mungesa gjatë sezonës së thatë dhe shpeshherë praktikohen reduktimet e ujit sipas nevojës. Pjesa e Qytezës në lindje tani furnizohet me ujë të trajtuar mirëpo ende ka mungesa përkatësisht humbje të ujit si pasojë e rrjetit të vjetër, keqpërdorimeve etj. Kohëve të fundit janë realizuar projekte në pjesën e para-filtrimit të ujit gjatë marrjes së tij nga lumi është vendosur edhe një rezervoar i filtrimit, janë pastruar rezervoarët e brendshëm, është vendosur trafo e re e rrymës si dhe janë vendosur ujëmatës nëpër ekonomitë familiare afërsisht 600 ujëmatës. Impianti i rifunksionalizuar në parim do të mundëson pastrimin e ujit me para-filtrim përmes shtresave të zhavorrit të granulateve të ndryshme, filtrimin kryesor përmes dhomëzave me rërë përmes të cilave uji kalon me shtypje, rrezatimin me rreze ultravjollcë dhe klorinimin.

Sa i përket sasisë minimale të ujit nga burimet me kapacitet total 30-32 l/sec, ajo duket të jetë më se e mjaftueshme nëse krahasohet me numrin e lartpërmendur të banorëve dhe shpenzimet mesatare deri 200 l/ ditë për kokë banori. Megjithatë mungesat e ujit janë evidente. Bazuar në matjet e mësipërme, një arsye duket të jetë humbja e ujit nga burimet e Gllloboçicës deri në rezervuar. Përtej humbjeve në rrjetin prurës dhe shpërndarës, gjendjen edhe më shumë e rëndojnë lidhjet ilegale dhe keqpërdorimi i ujit për ujitje dhe pastrim të rrugëve/ oborreve. Pothuajse e njejta situatë është edhe me burimin e ujit nga përroi i Dimcës.

Sistemi i ujësjellësit në fshatin Gorancë menaxhohet nga vetë banorët. Në lidhje me këtë, Komuna ka bërë investimet e nevojshme për rehabilitimin e sistemit bazuar në rekomandimet e KRU-së në mënyrë që menaxhimi t'u kalojë atyre në një të ardhme të afërt. Aktualisht ujësjellësi në fshatin Gorancë përballet me të njëjtat problematika që u përmendën më lart për Qytezën. Kualiteti nuk sigurohet në vazhdimësi për shkak të klorinimit jo të vazhdueshëm si dhe ka mungesa të ujit. Gjatë sezonit veror, mirëmbajtësi i rrjetit aktivizon edhe pompat e ujit për të arritur sasinë e nevojshme për furnizim me ujë. Të gjitha këto problematika që u cekën më lart vlerësohet se vijnë si pasojë e mos menaxhimit të sistemit nga KRU dhe aplikimit të tarifës fikse për pagesë dhe jo sipas shpenzimeve.

Kontrollet e cilësisë së ujit në ujësjellësin e Qytezës, të Gorancës dhe në burimet publike në vendbanimet rurale janë të vazhdueshme nga IKSHP.

Numri i qytetarëve dhe klientëve të shërbyer me ujë përmes sistemeve të përbashkëta është si në vijim:

	Vendbanimet	Sasia e ujit	Nr i Banorëve	Kyçe amvisërie	Kyçe tjera
1	Qyteza - perëndim	5-6 l/s	2252	513	6
2	Qyteza - lindje	18-20 l/s	5,487	600	55
3	Goranca	5 l/s	1,028	196	5
	TOTALI :		8767	1309	66

Tabela 12. Sasia e ujit dhe numri i klientëve të shërbyer

Fshatrat në të cilat nuk ofrohet shërbim përmes sistemit të përbashkët të ujësjellësit janë Paldenica, Seçishta, Kriveniku, Pusteniku dhe Dimca, si dhe fshatrat e zbaruza Dremjak, Vërtomicë dhe Neçavc.

2.5.2 Kanalizimi

Infrastruktura – ngjashëm si në rastin e sistemit të ujësjellësit, sistemi i përbashkët i kanalizimit të ujërave të zeza përfshin zonën urbane të Hanit të Elezit me lagjet e lartpërmendura përreth duke përfshirë edhe lagjen Curri dhe fshatrat Paldenicë dhe Seçishte. I tërë rrjeti është funksional duke përfshirë edhe kolektorët e nevojshëm dhe ka pikën e zbrazjes në pjesën më jugore të Komunës, në lokacionin e planifikuar të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza ngjitur rrjedhës së Lumit Lepenc. Gjithashtu edhe fshatrat e tjera të banuara kanë sistemet e tyre (Goranca, Rezhanca, Kriveniku dhe Pusteniku duke përfshirë edhe Laçin). Për arsye të trajtimit të ujërave planifikohen të lidhen me sistemin e Qytetit. Në raport me numrin e banorëve, shërbimi me kanalizime ofrohet 100%.

			Gjithsej;	10,155	Rreth 1186	Rreth 29,204
--	--	--	-----------	--------	------------	--------------

Tabela 13. Sistemi dhe klientët shërbyer


Sistem të kanalizimit të mbyllur të ujërave atmosferik ka në qendrën e qytetit ($L=3516\text{m}'$) dhe në qendrën e fshatit Gorancë ($L=710\text{ m}'$). Kanale të hapura atmosferike ka përgjatë të gjitha rrugëve lokale ($L=3,710\text{ m}'$). Në përgjithësi ato janë funksionale por mirëmbajtja e tyre paraqitet problematike.

Menaxhimi – mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike menaxhohet nga Kompania e kontraktuar për Mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik e menaxhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike duke realizuar të gjitha projektet dhe intervenimet e nevojshme përfshirë projektet e reja, mirëmbajtjen dhe eliminimin e defekteve. E njëjta Drejtori ende vazhdon t'i bëjë investimet në rregullimin e pjesëve të reja të rrjetit pasi që akoma ujësjellësi dhe kanalizimi publik nuk menaxhohen nga KRU.

2.5.3 Energjia elektrike

Furnizimi me energji elektrike sigurohet nëpërmjet një sistemi të veçantë komunal dhe të përbashkët me Kaçanikun. Njësia punuese KEDS në Han të Elezit mbulon 10 vendbanime, ndërsa 1 vendbanim (Pustenik) mbulohet nga njësia punuese të komunave fqinje (shih Aneksin 8).

Infrastruktura – energjia elektrike ofrohet në tërë Komunën e Hanit të Elezit. Ky shërbim ofrohet përmes 2 lidhjeve alternative nga Bibaj, Ferizaj si primare respektivisht nga Gjilani si sekondare. Të 2 lidhjet janë të fuqisë 35kv, secila me qëllimin primar furnizimin e prodhuesit të çimentos Sharrcem. Nga aty, përmes transformatorit 35/6kv, rrjeti i fuqisë 6kv furnizon Qytezën dhe të gjitha vendbanimet tjera përmes 14 transformatorëve me fuqi të ndryshme. Përrjashtim bën Pusteniku dhe Laçi të cilët për shkak të lokacionit furnizohen nga rrjeti i fshatrave fqinje të Komunës së Kaçanikut.



Harta 8. Stacionet bazë të energjisë elektrike

Ne Komunën e Hanit te Elezit ekzistojnë dy stacione të energjisë elektrike si më poshtë:

- Hani i Elezit: gjatësia gjeografike-21.29703056, gjerësia gjeografike-42.15026945,dhe
- Pusteniku: gjatësia gjeografike-21.27370283, gjerësia gjeografike-42.15249998.

Në hartën më lart është i hijezuar territori i komunës ku përfshihen vetëm dy stacione bazë. Numri i konsumatorëve mesatar të lidhur në këto stacione është 3400 përdorues. Duke marrë parasysh që në këtë komunë mbulojnë nga pak edhe dy stacione bazë të komunës së Kaçanikut që janë në kufi me komunën e Hanit te Elezit, pra, stacionet bazë në Gllloboqice dhe Gajre (Ivajë) atëherë numri mesatar i përgjithshëm është i përafërt me 5500 përdorues. Në këtë numër të përdoruesve përfshihen edhe ata të përkohshëm (kalimtar) për shkak të qarkullimit për dhe nga Maqedonia e Veriut si dhe nga qytetet tjera të Kosovës.

Shërbimi dhe menaxhimi – furnizimi dhe mirëmbajtja menaxhohet nga KEDS ndërsa faturimi/inkasimi nga KESCO, të dyja këto kompani private turke. Shërbimi është në përgjithësi stabil dhe pa reduktime. Përtej kësaj, edhe përkundër përmirësimeve të vazhdueshme, rrjeti ende mbetet në përgjithësi i vjetër dhe me defekte të herëpashershme. Si problematikë paraqitet edhe mungesa e ndërprerësve në pika të caktuara që do ta mundësonin furnizimin e vazhdueshëm me rryme të pjesëve të caktuara në rast të defekteve.

Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të rrjetit elektro-energjetik në komunë është 3400 përdorues.

Burimi: KEDS 2022

Prodhimi i energjisë – momentalisht nuk ka prodhues të energjisë elektrike në Han të Elezit por më parë ishin të planifikuara së paku 2 hidrocentrale të vogla në vitet e ardhshme. Për të dy hidrocentralet në vijim Komuna ka lëshuar lejet e ndërtimit, MMPHI pëlqimet e nevojshme mjedisore/ ujore dhe ZRRE autorizimet finale:

- Hidrocentrali “Lepenci 1” me kapacitet 9.9 MW dhe pronar Hidroenergji shpk nga Ferizaj. Uji do të devijohet në gypa në lokacionin “Guri i Shpuar” (Kaçanik) ndërsa impianti prodhues planifikohet në vendin “Uji i Thartë” ngjitur rrugës nacionale N2;
- Hidrocentrali “Kotlina” me kapacitet 4.4 MW dhe pronar Muja shpk nga Prishtina. Uji i lumit Kotlina/Laç do të devijohet në gypa në fshatin Kotlinë (Kaçanik) ndërsa impianti prodhues planifikohet në Laç.

Për shkak se këto hidrocentrale nuk kanë filluar të ndërtohen sipas kohës së paraparë, të gjitha pëlqimet mjedisore/ ujore, lejet ndërtimore dhe autorizimet nga ZRRE kanë skaduar.

Burimi: OJQ Gjethi 2022

2.5.4 Telekomunikacioni

Infrastruktura dhe shërbimi – rrjeti i telefonisë mobile ofrohet në tërë territorin përmes operatorëve Vala (BTS) dhe IPKO.Në një distancë prej 10 km nga kufiri ofrohet shërbim edhe nga operatorët e Maqedonisë Veriore.

Është një central i telefonisë fikse (Telekomi i Kosovës) ku ofron telefoni fikse, TV kabllor dhe internet për 130 klientë në Qytezë, lagjet përreth dhe Seçishtë dhe Paldenicë.

Ofrues interneti me më së shumti klientë është Elektra/ Telkos. Shërbimi i internetit/ kabllor televiziv ofrohet në Qytet me vendbanimet përreth, Paldenicë, Dimcë, Seçishtë, Krivenik, Gorancë dhe Rezhançë (gjithsej 1900 klientë). Vetëm Pusteniku dhe Laçi mbesin vendbanime me banorë permanent pa këtë lloj shërbimi. Shërbime televizive pa pagesë nuk ofrohen në Han të Elezit.

2.5.5 Energjia për Ngrohje

Si rrjedhojë, druri mbetet produkti kryesor që përdoret për ngrohje në Han të Elezit. Në këtë mes përdoruesish hyjnë të gjitha objektet publike. Për nevoja të ngrohjes së objekteve të banimit, biznesit dhe atyre publike që menaxhohen nga qeveria lokale/ qendrore, vlerësohet se në Han të Elezit digjen së paku 12.000 m³ dru në vit²⁴. Shumica nga to priten ilegalisht nëpër pyjet e Hanit të Elezit. Shembull pozitiv në këtë rast mund të përmendet sistemi i ngrohjes në SHFMU të Gorancës i cili përdor për ngrohje ashklat e drurit si biomasë nga pastrimi i përvitshëm i pyjeve. Nga çka u tha më lart rezulton se prezantimi i ndonjë burimi/prodakti apo ndonjë sistemi alternativ për ngrohje do të ndikonte dukshëm në menaxhimin dhe ruajtjen e pyjeve në territorin e Hanit të Elezit. Në komunë nuk ka sistem të ngrohjes qendrore.

Shërbimi dhe menaxhimi – shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në tërë territorin e Komunës së Hanit të Elezit (100%) Në. qytezë²⁵ ofrohet dy herë në javë, kurse në vendbanimet tjera një herë në javë. Mbeturinat deponohen në deponinë e përkohshme në Ferizaj apo në deponinë e përhershme regionale në Velekinçë, Gjilan. Shërbimi ofrohet nga qeveria lokale përmes Ndërmarrjes Publike Lokale – NPL “Pastrimi” që nga 1 janari 2017. Çmimet fikse mujore janë 5 euro për ekonomi familjare, 8 euro për biznese dhe 13 euro për çdo zbrazje të kontejnerit 1100 litërsh (secila me kontrata të veçanta). Duke përfshirë aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve, NPL ka një staf prej 21 veta, ndërsa ka në pronësi 3 kamionë, 2 traktor, 1 veturë dhe disa mekanizma shtesë për mbeturina.

Harta 9. Grumbullimi i mbeturingave

²⁵Në këtë rast nënkuptohet hapësira nga hekurudha deri te rruga nacionale N1

Shtrirja e shërbimit është si në vijim:

Nr	Vendbanimet	Shërbimi	Nr. i klientëve amvisëri	Nr. i klientëve të tjerë		Gjatësia e rutës së shërbimit (m')
1	Qytezë (nga hekurudha në rrugën nacionale N2)	2'/javë	430	Biznese 82	Institucione 8	5-km
2	Qytezë me vendbanimet përreth	1'/javë				
3	Paldenicë	1'/javë	265	2	1	4- km
4	Gorancë	1'/javë	136	3	1	7-km
5	Rezhancë	1'/javë	79			
6	Seçishtë	1'/javë	340	2		5-km
7	Krivenik	1'/javë	43			7-km
8	Dimcë	1'/javë	37			2-km
9	Pustenik	1'/javë	88	2		5-km
10	Laç	1'/javë				7-km
11	Dremjak	1'/javë	18			3-km
12	Vërtomicë (i zbrazur)	JO	0			0
13	Neçavc (i zbrazur)	JO				0
		Gjithsej:	1436	91	10	38

Tabela 14. Numri i klientëve të shërbyer dhe gjatësia e rutës së shërbimit për vendbanime

Deponitë jo-formale – si rezultat i gjendjes së krijuar për disa vite pa ofrues formal të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave (para 2017), në territorin e komunës ka ende 2 deponi ilegale të mbeturinave edhe pse një numër i madh janë eliminuar. Kësaj i duhet shtuar edhe deponitë e mbeturinave ndërtimore edhe pse Komuna e HiE ka përcaktuar një lokacion për mbeturina të tilla në lokacionin e mihjes sipërfaqësore të mergeles. Kjo gjendje e krijuar në terren paraqet një nga sfidat më të mëdha të Komunës së HiE respektivisht NPL Pastrimi.

Mbeturina tjera – mbeturinat e azbestit të gjeneruara nga fabrika e produkteve të azbest-çimentos para vitit 1999, në vitet 2017-18 janë pastruar nga shtrati i lumit Lepenc dhe nga vet uzinat e fabrikës dhe janë deponuar në pjesën e minierave të vjetra të kromit në Gorancë ngjitur kufirit me Maqedoninë. Në këtë mes vlerësohet se duhet bërë hulumtime shtesë në terren për të ditur nëse janë pastruar në tërësi këto mbetje të rrezikshme.

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike 2022

2.6 Infrastruktura e transportit dhe transporti

Lokacioni unik i Qytezës së Hanit të Elezit si vend kufitar dhe në raport me shtrirjen e rrjetit rrugor/hekurudhor nacional dhe zhvillimi në mënyrë të favorshme i rrugëve lokale në territorin e komunës mundësojnë lidhje shumë të mira të vendit me pjesët tjera të Kosovës, Maqedoninë Veriore dhe përtej. Në kontekst rajonal, Intervenimet e viteve të fundit kanë bërë që cilësia e rrugëve ndër-komunale dhe atyre lokale të jetë shumë e mirë, përderisa ka ende nevojë për intervenime në krijimin e kushteve më të mira të sigurisë dhe për lëvizjen e këmbësorëve(shih Aneksin 7, si dhe Hartën Infrastruktura e transportit).


Intervenimet e viteve të fundit kanë bërë që cilësia e rrugëve lokale që lidhin komunën dhe vendbanimet të jetë shumë e mirë, ndërsa ende ka nevojë për intervenime në krijimin e kushteve më të mira të sigurisë dhe për lëvizjen e këmbësorëve.

2.6.1 Rrugët e nivelit qendror

Autoudha (R6) Prishtinë – Hani i Elezit – e përshkon territorin e Komunës në drejtimin veri jug me gjatësi $L = 6\text{ km}'$. Kalon përmes konfiguracionit të luginës së Lepencit (nga Lagja Kashan deri në Qytezë me $L = 2\text{ km}'$) duke vazhduar përmes ultësirës deri te kufiri ($L = 4\text{ km}'$). Përmes kësaj rruge Hani i Elezit bëhet pjesë e korridoreve me rëndësi ndërshtetërore regjionale. Hyrje/ dalja në autoudhë është brenda zonës urbane. Në nivel ndërkombëtar kjo autostradë mundëson lidhje të shpejtë me korridorin VIII me portin e Durrësit, korridorin X në veri.

Rruga nacionale Prishtinë - Shkup (N2) – kalon nëpër territorin e Komunës ngjitur, paralelisht dhe në gjatësi të njëjtë me autoudhën. Gjatësia e segmentit të Hanit të Elezit është 6 km. Përmes kësaj rruge mundësohet lidhja me Kaçanikun, Ferizajn e më tej në veri dhe Shkupin në jug. Profili përbëhet prej dy shiritave me nga 3.5 metra, ndërsa trotuari ekziston për 2.8 km në pjesën jugore të segmentit. Pas ndërtimit të autoudhës, rruga N2 nuk është e ngarkuar me trafik si më parë dhe gjendja fizike e rrugës vlerësohet mesatare. Problematike mbetet çështja e sigurisë nga shembjet dhe rëniet e gurëve si dhe segmenti i cili për të njëjtat shkaqe mbetet edhe më tej me një kahje. Zhvillimi i vendbanimeve përgjatë trasesë rrugore gjithashtu përbën një çështje sa i përket sigurisë në trafik përdërisa kalimet nga një anë në tjetrën mbesin ende jo të sigurta.

Rruga që lidh dy pikat kufitare Hani i Elezit dhe Gllaboçicë/ Kaçanik dhe kalon përmes Maleve të Sharrit dhe fshatit Gorance duhet të promovohet si rrugë rajonale. Kjo rrugë ka gjatësi 13 km (9.79 km brenda territorit komunal) dhe është në gjendje relativisht të mirë duke përjashtuar një segment ku është duke u intervenuar për rrëshqitje dheu dhe bajpasin në fshatin Gorancë i cili nuk është i ndërtuar.



Harta 10. Infrastruktura rrugore/ hekurudhore dhe transporti

2.6.2 Rrugët e nivelit lokal

Rrugët lokale – posaçërisht në 15 vitet e fundit një pjesë relativisht e madhe e investimeve kapitale

të buxhetit komunal dhe qendror si dhe donacioneve të huaja janë shpenzuar për të përmirësuar infrastrukturën e përgjithshme në Han të Elezit. Nga ky shpenzim pjesën më të madhe e mori përmirësimi i infrastrukturës rrugore ku me atë rast u shtruan (asfalt apo pllaka betoni) shumica e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet, rrugët urbane dhe rrugë të vendbanimeve rurale. Si rezultat, të gjitha vendbanimet janë të lidhura mirë me njëri-tjetrin.

Nga tabela e mëposhtme kuptohet se janë të shtruara gjithsej 27,13 km rrugë lokale që lidhin vendbanimet duke përfshirë të gjitha rrugët që lidhin fshatrat e banuara me qytezën e Hanit të Elezit. Kanë mbetur të pashtuara vetëm rrugët lokale drejt fshatrave të shpopuluara si dhe rrugët lidhëse për ndonjë vend të caktuar (pikë turistike, etj.; ku disa nga to nuk janë të listuara këtu).

Listën e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet e gjeni në tabelën në vijim:

Rrugët lokale në Han të Elezit			
Nr	Emërtimi i rrugës	Statusi	Gjatësia (km)
1	Hani i Elezit – Paldenicë	e shtruar ²⁶	4,36
2	Ura e Seçishtës – Seçishtë – Krivenik	e shtruar	6,40
3	Lagja Maliq – Pustenik	e shtruar	5,13
4	Rruga Nacionale N2 (Hani i Elezit) – Dimcë	e shtruar	1,30
5	Rruga Nacionale N2 (Kashan) – Laç	e shtruar	2,87
6	Rruga Nacionale N2 (Dheu i Bardhë) – Paldenicë	e shtruar	0,93
7	Hani i Elezit– Dërmjak–Neçavc – Gjurgjedell (Kaçanik)	e shtruar	8,80
8	Hani i Elezit – Lagja Curri	e shtruar	0,54
9	Rruga Nacionale N2 (Uji i Thartë) – Bush (Pustenik)	e shtruar	1,80
10	Hani i Elezit – Dërmjak i Ulët	e shtruar	0,87
11	Rruga Nacionale N2 (Kashan) – Paldenicë	e shtruar	1,38
12	Paldenicë – Vërtomicë	e pashtuar	4,20
13	Paldenicë – Neçavc	e pashtuar	4,20
14	Gorancë – Krivenik	e pashtuar ²⁷	5,25
		Gjithsej	48,03

Tabela 15. Gjatësia e rrugëve lokale dhe gjendja e tyre

Nga të dhënat komunale rezulton se janë gjithsej 48.03 km rrugë lokale që lidhin vendbanimet e Komunës së Hanit të Elezit dhe 34.38 km nga to janë të shtruara dhe të shënuara.

Në kuadër të rrjetit rrugor janë gjithsej 5 ura mbi lumin Lepenc dhe disa ura të vogla mbi përrenjtë e tjerë, të gjitha të ndërtuara nga betoni dhe të kalueshme për automjete. Përderisa të gjitha kanë linjë për këmbësorë, Ura te Ranat dhe te Uji i Thartë janë një kahore.

Rrugët e vendbanimeve (urbane dhe rurale) – janë të shtruara në shumicën e rasteve. Nga 37,7 km rrugë gjithsej, janë shtruar 32,4 km.

Infrastruktura jo-motorike – janë gjithsej 14,2 km trotuare përgjatë të gjitha rrugëve lokale të lartpërmendura dhe kjo tregon për një rrjet jo të përfunduar për lëvizje të këmbësorëve. Në zonën urbane ky rrjet është kryesisht prezent duke ofruar lëvizje të sigurte nëpër të gjitha rrugët duke përfshirë edhe shtegun për këmbësorë në Qytezë përgjatë hekurudhës me 0,8 km'. Duhet përmendur edhe shtegun e këmbësorëve drejt SHFMU në Paldenicë me 0,42 km'.

Në rrugën nacionale N2 dhe hekurudhën Fushë Kosovë – Hani i Elezit kalimet nëpër to janë jo të sigurta. Përderisa kalimet nëpër nacionalen N2 realizohet përmes “zebrave” në 5 vende dhe kalimeve joformale në shumë vende tjera, ekziston vetëm një mbikalim hekurudhe por qytetarët bëjnë kalime joformale dhe jo të sigurta së paku në 4 vende tjera. Kalimet nëpër dy akset e lartpërmendura duhet trajtuar edhe në aspekt të lëvizjes së integruar të njerëzve për të pasur qasje në funksione të ndryshme urban por edhe në pronat e tyre

Edhe pse të identifikuar, nuk ka shtigje të rregulluara për biçikleta apo shtigje malore për ecje (të

²⁶Rrugë e shtruar nënkupton rrugën me shtresë asfalti apo pllaka betoni

²⁷Rrugë e pashtuar nënkupton rrugën me shtresë zhavorri apo dheu

rregulluara dhe shënuara).

Mirëmbajtja, siguria dhe ndriçimi

Gjendja e përgjithshme e rrugëve është relativisht e mirë dhe e sigurt. Në disa zona ka nevojë për përmirësim dhe zgjerim të rrugëve. Gjithashtu është evident fakti se zona urbane dhe vendbanimet në perëndim të hekurudhës kanë qasje shumë të kufizuara me vete për faktin se kanë vetëm një linjë komunikimi me makina nëpër nacionalen N2 dhe daljen ngjitur kufirit. Me këtë rast qasja vështirësohet dhe shpeshherë pamundësohet nga kolonat e kamionëve transportues duke pritur rend për në terminalin doganor. Kjo është një çështje prioritare që duhet zgjidhur.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve respektivisht pastrimi nga bora/akulli bëhet çdo sezonë. Edhe mirëmbajtja e përgjithshme dhe e vazhdueshme e rrugëve ndodh në vazhdimësi (pastrimi i kanaleve dhe lëshesave ujëmbledhëse, pastrimi i rrugëve nga gurët dhe dheu, intervenimi me zhavorr, etj).

Ndriçimi i rrugëve përfshin të gjitha rrugët kryesore urbane dhe të vendbanimeve rurale me gjithsej 17 km gjatësi. Shtrirja e ndriçimit të rrugëve urbane dhe të vendbanimeve rurale pritet të vazhdojë më tutje.

2.6.3 Transporti

Shërbimi i transportit ofrohet në kuadër të sektorit privat përmes autobusëve dhe minibusëve, si dhe shërbimit të taksive. Në Han të Elezit nuk ka Stacion Autobusi.

Transporti ndër-komunal – transporti publik ndër-komunal dhe ndërshtetëror realizohet përmes:

- rrugës nacionale N2. Nga qendra e Qytezës deri në Kaçanik dhe më tej si dhe anasjelltas ofrohet shërbimi me autobus 4 herë në ditë. Ekzistojnë edhe linjat me autobusë Prishtinë-Shkup dhe anasjelltas dhe Prizren-Shkup dhe anasjelltas (mbi 5 herë në ditë) të cilat shfrytëzojnë nacionalen N2 apo autoudhën R6, mirëpo në të shumtën e rasteve nuk ndalojnë në Han të Elezit;
- hekurudhës Fushë Kosovë – Shkup një herë në ditë (në mëngjes për në Shkup dhe në mbrëmje kthimi për në Fushë Kosovë) nga Stacioni i Hekurudhës në Qytezë²⁸.

Transporti lokal – po nga sheshi i Qytetit bëhet edhe transporti lokal i udhëtarëve i organizuar me minibus 3 herë në ditë për në Gorancë dhe një herë në ditë për Seçishtë/Krivenik (shkuarje/ardhje). Nga të dhënat më lart nënkuptohet se për shkak të distancave të shkurta në mes vendbanimeve dhe faktit se Hani i Elezit është komunë e vogël, transporti lokal i udhëtarëve dhe mallrave bëhet kryesisht me makina private dhe në këmbë. Në këtë mes është identifikuar fshati Paldenicë me 1723 banorë dhe me distancë mesatare 3 dhe maksimale 5 km nga Qyteza ku është i nevojshëm organizimi i transportit publik.

Gjithashtu mbetet nevojë për përmirësime të konsiderueshme në shërbimet e autobusëve në aspektin e kualitetit të shërbimit, shfrytëzueshmërisë dhe besueshmërisë. Është me rëndësi që të në të ardhmen të futen në funksion edhe mjete të transportit që kanë ndikim sa më të vogël negativ në mjedis.

Edhe përkundër mungesës së shtigjeve të rregulluara të ecjes dhe hiking-ut, natyra mundëson lëvizje nëpër mjediset shumë interesante të komunës. Ecjet bjeshkatore në zonën e Pustenikut dhe Gorancës, Paldenicës e Dremjakut si dhe tjera organizohen tradicionalisht për ditën e çlirimit dhe përgjatë tërë vitit nga mjedis dhe sport-dashësit.

2.6.4 Hapësirat për parkim

Konsiderohet se ka numër të mjaftueshëm të parkingjeve publike posaçërisht në Qytezën e Hanit të Elezit. Ky shërbim ofrohet pa pagesë. Në kontekst të përmirësimit të gjithmbarshëm të lëvizshmërisë

dhe inkurajimit të lëvizjes jo-motorike, duhet bërë analiza dhe potencialisht të prezantohet pagesa e parkingjeve publike sipas kohëzgjatjes së parkimit.

361 vend-parkimet ekzistuese të menaxhuara nga Komuna dhe të hapura për publikun janë të shpërndarë në 15 lokacione si më poshtë:

Vend parkimet	Nr i vend parkimeve
Oobjekti komunal	50
Rruga Xhemsedin Suma	23
Stacioni hekurudhor	11
SHFMU "Ilaz Thaçi" Hani i Elezit	30
SHFMU "Kështjella e Diturisë" Paldenicë	13
SHFMU "Veli Ballazhi" Gorancë	11
SHFMU (paralelja) "Ilaz Thaçi" Seçishtë	5
QKMF "Menduh Kaloshi" Hani i Elezit	6
AMF Gorancë	5
Ura e Seçishtes	40
Varrezat e Dëshmorëve Pustenik	40
Parku memorial "Bllaca 99"	30
Parku i qytetit "Isa Berisha"	25
Parkingu i rezervuar për Taxi (Rr. Adem Jashari)	50
SHF-të në Krivenik, Laç dhe Pustenik	22
Gjithsej	361

Tabela 16. Lokacionet dhe numri i vendparkingjeve

Funksionale janë edhe 2 vend parkingje private me mbi 75 vende ngjitur kufirit ku shërbimi ofrohet me pagesë. Në të shumtën e rasteve këto parkingje nuk janë të mbushura me më shumë se 10 vende.

Bizneset private kanë gjithashtu parkingje për konsumatorët/ punëtorët e tyre duke përfshirë zingjirët e marketeve Viva Fresh, ETC dhe disa markete, lokale, 2 stacionet e karburantit, Sharrcem, shumë lokale hoteliere-shërbyese etj. me gjithsej 327 vend parkime. Këto parkingje shfrytëzohen edhe nga banorë që nuk janë të Hanit të Elezit të cilët qarkullojnë nëpër infrastrukturën nacionale/ rajonale. Parkingje ekzistojnë edhe për kamionët transportues me gjithsej 67 vende.

2.6.5 Transporti hekurudhor

Në Komunën e Hanit të Elezit ka shtrirje të rrjetit hekurudhor. Nëse shikohet pozita në raport me rrjetin hekurudhor në nivel të Kosovës, mund të thuhet se Han të Elezit ka lidhje të përshtatshme rrugore me nyjet kryesore hekurudhore Fushë Kosovë dhe Shkup. Distanca deri në terminalin hekurudhor të Fushë Kosovës është 67 km. Sipas të dhënave nga komuna, prona e hekurudhës në komunën e Hanit të Elezit gjatësi 6.2 km' sipërfaqe prej 36.58.66 ha. Momentalisht hekurudha nuk është funksionale sepse Hekurudhat e Kosovës janë duke e rindërtuar rrjetin. stacioni hekurudhor në Qytezë dhe një mbikalim për këmbësorë po aty. Kalim formal me laurë për makina dhe këmbësorë është afër Urës së Seçishtës ndërsa kalime jo-formale janë të organizuara në 3 raste: te Uji i Thartë, te Ranat dhe në pjesën më jugore për nevoja të gurëthyesit dhe aktiviteteve bujqësore.

2.6.6 Transporti ajror

Për nevoja të lidhjes në distanca të largëta përmes transportit ajror, banorët e Hanit të Elezit përdorin Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, i cili gjendet në një distancë prej 79 km nga qendra komunale. Përveç Aeroportit të Prishtinës, si alternativë përdoren edhe aeroporti ndërkombëtar i Shkupit me vetëm 45 km' distancë dhe ai i Kukësit dhe Tiranës. Autoudhat ekzistuese Durrës-Merdarë si dhe ajo Prishtinë-Han i Elezit mundësojnë lidhje të shpejtë dhe cilësore me këto aeroporte.

Marrë parasysh tabelën më lart dhe legjislacionin në fuqi (UA Nr. 08/2017), ka mungesë të mjekëve dhe teknikëve familjarë, pediatri dhe stomatologut si për nga kualifikimi ashtu edhe për nga numri i tyre. Ka edhe mungesa tjera të stafit.

Në lidhje me rrezën e mbulimit gjeografik të territorit, janë banorët e Gorancës dhe Krivenikut që duhet të udhëtojnë maksimum 7km’ deri në QKMF për të marrë shërbim. Përderisa të tjerët janë më afër, 5548 banorët e Qytezës dhe vendbanimeve përreth kanë distancë 1km’ ose më pak. Në të njëjtën kohë, me shërbimet e ofruara nga AMF, janë banorët e Rezhancës të cilët duhet të udhëtojnë maksimalisht 2 km’ për ti marrë ato, përderisa Gorancasit i kanë në qendër të fshatit. Edhe pse kjo infrastrukturë e mbulon relativisht mirë të gjithë territorin e komunës, mungesa e stafit profesional adekuat mjekësor, si dhe mungesa e barnave esenciale dhe tjera të nevojshme janë sfidat kryesore me të cilat përballet shërbimi shëndetësor në të dy institucionet me theks në AMF. Prandaj, qytetarët në zonat rurale duhet të udhëtojnë për në qendrën komunale për të kërkuar kujdes mjekësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila duhet të përballojë numër të shtuar të pacientëve.

Sektori privat – në kuadër të sektorit privat funksionojnë: 4 klinikë dentare dhe 3 barnatore.

Burimi: Drejtoria e Shëndetësisë 2022

2.7.2 Arsimi

Procesi arsimor në Komunën e Hanit të Elezit është i organizuar në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 ((Para fillor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë). (shih Aneksin5, si dhe Hartën e Institucionet arsimore). Të gjitha institucionet arsimore funksionojnë në kuadër të sistemit të arsimit publik, dhe deri më tani nuk është hapur asnjë institucion arsimor privat.

Arsimi parashkollor – në Qendrën për Edukimin dhe Arsimin Parashkollor (QEAP) respektivisht Çerdhen në Qytezë me qëndrim tërë ditë zhvillohet edukimi dhe arsimi për fëmijët e moshës nga 9 muaj deri në 6 vjeç. Aktivitetet në këtë qendër edukimi bëhen në grupe: Grupi 9 muajsh deri në 2 vjeç, 2 -3 vjeç, 3 – 4 vjeç, 4 – 5 vjeç dhe 5- 6 vjeç. Objekti është i vitit 2019 me hapësirë të mjaftueshme, ndërkaq plotëson të gjitha nevojat për zhvillimin normal të aktiviteteve për fëmijë të këtyre grup moshave. Çerdhja aktualisht ka të regjistruar 32 fëmijë grup moshash të ndryshme duke përfshirë 6 fëmijë para fillor ose ata të grup moshës 5- 6 vjeç.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët – funksionimi institucional dhe hapësinor është i organizuar përmes 3 njësive primare: Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Ilaz Thaçi” në Han të Elezit, Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Kështjella e Diturisë” në Paldenicë dhe Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Veli Ballazhi” në Gorancë. Numrin e nxënësve dhe mësimdhënësve për shkolla e tregon tabela më poshtë:

Emri i institucionit	SHFMU “Ilaz Thaçi”, Hani i Elezit ²⁹	SHFMU “Kështjella e Diturisë”, Paldenicë	SHFMU “Veli Ballazhi”, Gorancë ³⁰	Gjithsej
Niveli edukativ				
Para fillor/ Numri i nxënësve	111	15	16	142
Fillor/ Numri i nxënësve	629	104	62	795
Mesme e ulët/Numri i nxënësve	468	102	51	621
Gjithsej/ Nxënës femra	511	103	49	663
Gjithsej/ Nxënës meshkuj	586	103	64	753
Gjithsej/ Nxënës³¹	1097	206	113	1416
Numri i mësimdhënësve	55	12	13	80

Tabela 18. Shkollat filllore/ të mesme të ulëta (SHFMU) dhe numri i nxënësve

Në SHFMU Hani i Elezit, si shkolla më e madhe në Komunë, gravitojnë fëmijët e Qytezës, vendbanimeve/ lagjeve përreth, fshatit Dimcë dhe lagjes Bardhi nga fshati Bllacë i Maqedonisë

²⁹Llogaria është bërë duke përfshirë edhe paralelet e ndara në Seçishtë, Krivenik dhe Laç

³⁰Llogaria është bërë duke përfshirë edhe paralelet e ndarë në Rezhancë

³¹Llogaria është bërë vetëm për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët

Veriore; duke shkaktuar “mbipopullim” të saj. Duke marrë parasysh edhe vështirësinë e ardhjes së nxënësve nga Lagja e Re për shkak të distancës 1.5km’ dhe rrezikut shtesë për shkak të kalimit të hekurudhës, Komuna duhet shikuar mundësinë e ndërtimit të një shkolle fillore (klasa 1-5) në atë zonë.

Nga tabela më lart shihet se nga 1,416 nxënës gjithsej në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët, 663 janë femra (47%) dhe 753 janë meshkuj (53%). Ndërkaq numri i mësimdhënësve në këto dy nivele është 80, që e jep një mesatare me 17.7 nxënës për një mësimdhënë. Kualifikimi i personelit edukativ është në nivelin e 95%.

Në të tri rastet, arsimi fillor dhe i mesëm i ulët funksionojnë si i njëjti institucion dhe në një objekt të përbashkët. Procesi mësimor zhvillohet në një ndërrim, përveç në SHFMU “Ilaz Thaçi” në Han të Elezit ku funksionojnë 2 ndërrime (ndërrimi i pasdites për arsimin fillor).

Të tri shkollat kanë biblioteka modeste me 3,359 tituj gjithsej.

Infrastruktura fizike është kryesisht e re dhe në gjendje shumë të mirë. Karakteristika të parcelave dhe objekteve arsimore i gjeni në tabelën në vijim:


Emri i institucionit	Parcela	Objekti	Fushë sporti e rregulluar	Palestra
SHFMU “Ilaz Thaçi”, Hani i Elezit	E mjaftueshme/ Oborri ka nevojë për rregullime	I mjaftueshëm	2 ³²	Po
SHFMU “Kështjella e Diturisë”, Paldenicë	E mjaftueshme/ Oborri ka nevojë për rregullime	I mjaftueshëm	1	Po
SHFMU “Veli Ballazhi”, Gorancë	E mjaftueshme/ Oborri ka nevojë për rregullime	I mjaftueshëm	1	Po

Tabela 19. Infrastruktura fizike në SHFMU-të

Nga tabela e mësipërme mund të kuptohet se fokusi kryesor i përmirësimeve fizike (parcela dhe objekte) duhet të jetë në vazhdimin e rregullimit të hapësirave të jashtme paralelisht me mirëmbajtjen e tyre. Edhe pajisja e tyre me mobile dhe mjete mësimore duhet të vazhdojë. Në vazhdimësi ka pasur furnizim të institucioneve me inventar për mbarëvajtje të procesit mësimor. Të gjitha klasat kanë video projektor përderisa të gjithë mësimdhënësit kanë laptop, krejt këto të freskuara vazhdimisht. Institucionet edukative kanë salla për mësim digjital, kabinetin e TIK-ut, përderisa SHFMU në Han të Elezit ka edhe pajisje për kabinete për fizikë, kimi, etj. Të 3 Institucionet kanë nevojë për përmirësime dhe furnizim të vazhdueshëm me inventar dhe pajisje të nevojshme.

Arsimi i mesëm i lartë – në kuadër të këtij niveli funksionon vetëm Shkolla e Mesme e Lartë “Dardania” në Han të Elezit me drejtimet matematikor dhe gjuhësor dhe punon me një ndërrim. Shkolla ka gjithsej 345 nxënës me 186 (54%) femra dhe 159 (46%) meshkuj. Nga numri total i 19 mësimdhënësve, mesatarja del të jetë 18 nxënës për 1 mësimdhënë. Për drejtime profesionale, nxënësit e interesuar vijnë në mësimin në Shkollën e Mesme Teknike “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka (Voskopojë)” në Kaçanik. Udhëtimi Hani i Elezit – Kaçanik dhe anasjelltas për këto nxënës mbulohet nga buxheti komunal, sikurse në rastin e nxënësve nga Goranca, Rezhanca dhe Kriveniku që udhëtojnë në SHML “Dardania” në distancë më shumë se 4 km’.

³²Këtu përfshihen fushat sportive të rregulluara në SHFMU të Hanit të Elezit dhe paralelen e ndarë në Seçishtë. Paralelet e ndara në Laç dhe Krivenik i kanë fushat të pa rregulluara



Harta 12. Institucionet arsimore

Gjendja fizike e ndërtesës është me cilësi mbi mesatare e arritur përmes intervenimeve dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme. Edhe pse e ndërtuar në vitin 2005 ajo ka pasur në vazhdimësi probleme infrastrukturore të cilat janë evituar me kohë. Ka kabinetin e TIK-ut dhe të gjitha sallat e mësimi janë me projektor. Ka edhe hapësirën për shumë qëllime.


Parcela e shkollës është shumë vogël duke mundësuar vetëm pjesën e qasjes për nxënës dhe një fushë të jashtme sportive të rregulluar. Nuk ka palestër sportive dhe mungon hapësira për të.

Burimi: Drejtoria e Arsimit 2022

2.7.3 Kultura

Infrastruktura – sapo është ndërtuar objekti i ri i Qendrës së Kulturës në Han të Elezit i inauguruar në qershor 2022 dhe i cili i plotëson të gjitha nevojat për të cilin është ndërtuar. Objekti ka gjithsej 3,000m² dhe përveç hapësirave kulturore të sallës së shfaqjeve, pjesës së ekspozitës, etj. ka edhe administratën, arkivin dhe Bibliotekën. Biblioteka ka sallë leximi dhe 6,178 tituj. Për aktivitete kulturore të caktuara shfrytëzohen edhe hapësirat (hapësira për shumë qëllime apo palestra) e 3 Shkollave Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU) (shih Aneksin 5, si dhe Hartën Institucionet e kulturës). Në Han të Elezit zhvillon aktivitetin edhe Shoqëria Kulturore Artistike (SHKA) Sharri nga Hani i Elezit që merret me aktivitete koncertale, letrare, valle. Në kuadër të këtyre aktiviteteve ka përkrahje dhe bashkëpunime me DKRS.

Shoqëria civile është pak e organizuar me OJQ Handikos, Këshilli për Veprim Rinor Lokal (KVRL) dhe Klubi Alpin Hani i Elezit.



Harta 13. Institutionet kulturore

2.7.4 Sporti dhe rekreacioni

Infrastruktura – edhe infrastruktura publike e sportit është e zhvilluar relativisht mirë dhe për një pjesë të mirë të disiplinave sportive ekzistojnë hapësirat e brendshme respektivisht të jashtme. Këto objekte/ hapësira janë si në vijim:

- Stadiumi i Qytezës gjendet në pjesën jugore të zonës urbane. Komuna ka investuar që nga themelimi i saj më 2005 për renovime dhe përmirësime të tij. Ai gjatë tërë kohës ka qenë dhe vazhdon të jetë funksional duke qenë shtëpi për Klubin e Futbollit “Sharri” nga Hani i Elezit. Stadiumi ka dhomat e zhveshjes dhe ulëset për 700 spektatorë.
- Nuk ka sallë sportive të Qytezës. Për nevoja të tilla shfrytëzohet salla sportive e SHFMU në Hani të Elezit në të cilën mund të zhvillohen sportet e hendbollit, futsallit, basketbollit, volejbollit, gjimnastikës dhe të ngjashme. Objekti i ndarë fizikisht nga shkolla amë ka zhveshtoret dhe ulëset për 250 spektatorë. Në këtë sallë zhvillojnë aktivitetin e tyre: Klubi i Mundjes “Dardania” dhe Klubi i Volejbollit nga Hani i Elezit. Cështje duhet trajtuar me PZHK, do të propozohet sigurimi i hapësirës e veçantë (sallë) për përdorim nga klubet sportive por edhe komuniteti.
- Sallat sportive në 2 SHFMU-të tjera shfrytëzohen për aktivitete sportive shkollore por edhe të fshatit. Të dyja janë ndërtuar së voni dhe kanë në dispozicion pajisjet për zhvillimin e sportit të basketbollit, volejbollit, gjimnastikës dhe të ngjashme që kërkon dimensione të tilla të hapësirës. Cështje që kërkon trajtim me PZHK, do të propozohet sigurimi i hapësirës së veçantë sporti për shfrytëzim nga komuniteti.
- Fusha e jashtme sportive në Qytezë është ndërtuar së voni me të gjitha pajisjet e nevojshme. Fusha e lojës është me material të butë (mase gome dhe betoni) dhe aty mund të zhvillohet sporti i futbollit të vogël dhe sporte tjera si më lart. Ka edhe ulëse të rregulluara për 400 spektatorë. Ekzistojnë edhe 6 fusha tjera sportive në SHFMU dhe paralelet e ndara.

4 nga to janë të rregulluara (Hani i Elezit, Gorancë, Paldenicë dhe Seçishtë) dhe shtruara me asfalt ndërsa në Krivenik dhe Laç janë me zhavorr. Këto fusha shfrytëzohen për nevoja shkollore dhe të komunitetit.

Sa i përket sektorit privat, ekziston një palestër e futbollit të vogël ("Toni Sport") si një objekt i mbuluar i ndërtuar nga struktura metalike dhe i mbuluar me tendë. Fusha e lojës është me tepih plastike respektivisht barë artificial.

Aktivitetet kulturore dhe sportive – në Han të Elezit tradicionalisht jepen shfaqje kulturore dhe organizohen turne sportive në rastet e shënimit të përvjetorëve të ndryshëm. Aktivitete më të larmishme kulturore (java kulturore) dhe sportive organizohen çdo vit me rastin e shënimit të Ditës të Çlirimit të Hanit të Elezit më 11 qershor:

- Festivali Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit (festival me pretendime për të qenë tradicional),
 - 1 qershori, Dita e Fëmijëve me aktivitete të ndryshme për fëmijë;
 - Ekspozitë;
 - Orë poetike;
 - Vizitë në Varrezat e Dëshmorëve në Pustenik;
 - Aktiviteti qendror me fjalime dhe program kulturo-aristik;
 - Turne në futboll të vogël,
 - Gara shkollore në futboll të vogël, volejbol dhe pingpong (për të dy gjinitë); dhe
 - Kroso (vrapimi).

Turne sportive kombëtare të mundjes organizohen tradicionalisht edhe me rastin e shënimit të Ditës së Dëshmorëve në Han të Elezit më 29 gusht dhe Ditës së Pavarësisë më 17 shkurt, përderisa turne ndërkombëtar i mundjes organizohet me rastin e shënimit të Ditës së Flamurit më 28 nëntor. Gjithashtu shënohen tradicionalisht edhe Dita e Krismës së Pushkës së Parë në Han të Elezit më 26 shkurt, Dita e Pikturës më 26 maj për zbulimin e talenteve për pikturë dhe ekspozim i pikturave të tyre, takim me bashkatdhetarë më 21 korrik dhe organizim të koncertit publik, Dita Ndërkombëtare e Paqes më 21 shtator me gara në vizatim në mes të shkollave, Përkujtimi i masakrës së Dërmjakut më 26 tetor, Dita e Fotografisë Artistike më 25 tetor me gara në mes të shkollave për talent në fotografi si dhe Dita e Flamurit më 28 nëntor me organizimin e turneut në futboll të vogël me institucionet publike

Me rastin e shënimit të shumicës nga datat e lartpërmendura jepen shfaqje kulturo-artistike. Të gjitha këto shfaqje përgatiten dhe jepen nga SHKA Sharri në HiE si organizata e vetme kulturore në Komunë. E formuar në vitin 1974, Shoqata Sharri ka marrë pjesë me shfaqje të ndryshme (këngë dhe valle) në festivale të kulturës tradicionale në tërë hapësirën mbarë-shqiptarë duke marrë shpesh edhe çmimet e para. Që nga 1999 është pjesëmarrëse gati në të gjitha eventet kulturore në HiE.

Skena e organizatave jo qeveritare që merren me rritjen e përfshirjes publike nëpër procese të ndryshme, avancimin e të drejtave të grave dhe grupeve të cenuara, mjedisin, ngritjen e çështjeve të ndryshme, etj.; është shumë e varfër në HiE. Me këtë rast vlen të përmendet Këshilli për Veprim Rinor Lokal (KVRL), Handikos dhe Klubi Alpin Hani i Elezit.

Klubi i Mundjes Sharri është klubi më i suksesshëm sportiv në HiE. Më herët por edhe tani, ka pasur mundës të suksesshëm që kanë fituar medalje të arta në nivel vendi dhe medalje ndërkombëtare.

KF Sharri është garon në garat formale të FFK-së. Për të siguruar edhe përgatitjen e gjeneratave të reja funksionon edhe Shkolla e Futbollit Sharri.

Kohët e fundit ka marrë hov edhe sporti i bjeshkatar me Klubin Alpin të HiE (jo i regjistruar). Ky klub është shumë aktiv me ecje gati të përjavshme. Rreth 10 ecje në vit organizohen nëpër bjeshkët e HiE

duke mbledhur bjeshkatarë nga shumë vend të Kosovës dhe Maqedonisë dhe duke promovuar trashëgiminë natyrore dhe kulturore të vendit.

Të gjitha organizatat e lartpërmendura (përveç Klubit Alpin të HiE) janë të regjistruara si OJQ dhe funksionojnë me subvencione vjetore nga qeveria lokale dhe në raste të caktuara nga organizata tjera.


Duke marrë për bazë nevojat e përgjithshme të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit, e sidomos strukturën demografike, mund të thuhet se ka nevojë për përmirësim të mëturjtshëm të rrjetit të infrastrukturës posaçërisht sportive me palestër sportive në Qytezë dhe fusha sportive në Lagjen e Re. Në ndërkohë janë të nevojshme kapacitete profesionale për të zhvilluar më tutje jetën kulturore dhe sportive.

2.7.5 Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit

Përkrahja për nevojat sociale dhe kategoritë e veçanta ofrohet përmes Qendrës për Punë Sociale. Kjo qendër funksionon në Han të Elezit dhe ofron mbështetje për tërë komunën. Për momentin janë gjithsej 123 familje nën asistencë sociale, ndërsa që nga 1999 strehimi është siguruar për 23 familje.

2.7.6 Institucionet fetare

Në komunën e Hani të Elezit funksionon Këshilli i Bashkësisë Islame (KBI) përmes të cilit menaxhohen 8 xhami (3 në zonën urbane, 2 në Paldenicë, 1 në Gorancë, 1 në Seçishtë dhe 1 në Krivenik). Periudha e ndërtimit të tyre daton që nga fillim-shekulli XX e deri tani.



Harta 14. Objektet fetare

2.7.7 Institucionet administrative dhe të sigurisë

Institucionet e administratës qendrore përfshijnë Doganën e Kosovës me terminal e cila është vendosur në pikën kufitare (rrugore/ hekurudhore), Policinë Kufitare e vendosur në hyrje të Parkut të Qytezës tek përroi Dimca (ish prona ushtresë) dhe që ofron shërbime te pika kufitare (rrugore/

hekurudhore) dhe ruajtjen e vijës kufitare, Stacionin Hekurudhor si dhe shërbimet civile (pasaporta, letërnjoftime dhe patentë shoferë).

Institucionet e administratës lokale janë si në vijim:

- Kuvendi dhe administrata komunale me lokacion në zonën urbane ofron shërbime administrative për tërë territorin e komunës. Objekti ishte ndërtuar në vitet '60-ta si administratë e kompleksit industrial "Sharrcem" për tu bartur pronësia më vonë te administrata publike. Objekti është rinovuar më 2015 dhe tani i plotëson të gjitha kushtet për punë.
- Përkrahja për nevojat sociale dhe kategoritë e veçanta ofrohet përmes Qendrës për Punë Sociale. Edhe kjo qendër funksionon në Qytezë dhe ofron mbështetje për tërë komunën.
- Stacioni i Zjarrfikësve gjendet në zonën urbane ngjitur rrugës nacionale N2 për qasje më të lehtë. Përmes këtij stacioni ofrohet mbrojtja nga zjarri dhe shërbime përkatëse të sigurisë për tërë territorin e komunës.
- Zyra e Postës - funksionon e vendosur në qendër të Qytezës. Aty ofron shërbim Posta e Kosovës, Telekom i Kosovës dhe Vala.
- Stacioni Policor - gjendet në hyrje të Parkut të Qytezës tek përroi Dimca (ish prona e ushtrisë). Ofrohen shërbime të sigurisë për të gjithë qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit. Shumë shpejtë pritet të kalojnë në objektin e ri në afërsi të stacionit të zjarrfikësve.

2.7.8 Hapësirat publike

Sheshet dhe hapësirat publike – shikuar përgjithësisht, si rezultat i strukturave kryesisht rurale në vendbanime të ndara në lagje, si dhe procesit më të vonshëm të urbanizimit të qendrës komunale, hapësirat në trajtë të shesheve janë në mungesë.

Ekziston sheshi i Qytezës i cili së bashku me hapësirën publike për ecje dhe hapësirën e gjelbër përreth paraqet rastin më pozitiv të një hapësire publike të rregulluar. Ky shesh shtrihet në vet bërthamën e Qytezës dhe ofron qasje të drejtpërdrejtë të funksionet kryesore urbane. Mes tjerash, shërben edhe për aktivitete të socializimit, rekreacionit pasiv, pushimit, lëvizjes, etj.

Hapësira publike të rreguluara ka edhe në qendër të Gorancës tek AMF-ja, në Paldenicë tek kroi mbi fshat; si dhe së fundmi është rregulluar edhe hapsira publike rekreative "Lepenci" tek ura Seçishtës dhe hapsira publike tek memoriali "ekzodi bllaca 99".

Shikuar përgjithësisht, hapësirat e reja potenciale për shndërrim në hapësira publike, si dhe përmirësimi i qasjes dhe krijimin e infrastrukturës së gjelbër, mbeten një kërkesë për të ardhmen, që do të varen edhe nga ritmi i zhvillimeve të reja në vendbanime.


Parku i Qytetit "ISA BERISHA" – është investimi i fundit nga Komuna dhe shumë mirëpritur me një ndikim shumë pozitiv tek banorët e Hanit të Elezit. Ka njëhapësira prej 18540 m² me hapsira të gjelbërta (mbi 250 fidane), staza për ecje dhe ciklistë, kënde të lodrave për fëmijë, ndriçim dhe vende tjera rekreative të mjaftueshme dhe mirë të rregulluar për të gjitha grupmoshat. Parku gjendet në pjesën qendrore të qytetit në rrugën ISA BERISHA afër institucionit parashkollorë (kopshtit për fëmijë) "Ardhmëria" dhe institucioneve shkollorë në qytet. Parkut i nevojitet mirëmbajtje e vazhdueshme dhe investime të herë pashërshme në gjelbërim të ulët (lule sezonale, fidane tjera apo të ngjashme), inventar urban dhe lodra të fëmijëve.

Parku i Qytetit tek përroi Dimca (ish prona ushtrisë) – hapësira prej 47419.20 m² (parcela 61-16 Z.K. Hani i Elezit) e planifikuar për Park të Qytetit (një pjesë e sajë jo e tëra) gjendet në pjesën lindore të zonës urbane. Sipërfaqja e gjelbër me pyje, shkurre e barë është unike përgjatë luginës së përroit Dimca. Lëvizjet për këmbësorë janë mesatarisht të rreguluara por nevojitet investime për përmisim dhe zgjerim i rrjetit të stazave për ecje, duke përfshirë edhe disa objekte ekzistuese për organizime të ndryshme. Parku ka nevojë për mirëmbajtje të rregullt dhe intervenime të mëtutjeshme për qasje

drejt tij nga zona urbane dhe më tej, investime në hapsira rekreative dhe të ngjashme.

Koridoret e gjelbra – shtegu për këmbësorë nga Uji i Thartë deri te Pika Kufitare (3.2 km) tashmë është shndërruar në një korridor të gjelbër që nga prezantimi i gjelbërimit në shumicën e segmentit të tij. Përderisa mirëmbajtja duhet të jetë më serioze, shirita gjelbërimi mund të rregullohen edhe për kufizim mjedisor të zonës industriale dhe në hapësira tjera të identifikuara.

Lumi Lepenc dhe përrojet Dimca, rezhanca dhe Laçi që kalon nëpër territorin e komunës me brigjet e tyre ofrojnë potencial për rregullim dhe shndërrim në shtigje atraktive për ecje dhe rekreacion.



Harta 15. Parqet dhe hapësirat për sport dhe rekreacion

2.7.9 Varrezat publike

Në përgjithësi, secili vendbanim i Komunës së Hanit të Elezit i ka të ndara sipërfaqet e veta që i shfrytëzon për varreza. Numri i sipërfaqeve të varrezave të komunës është 26, ndërsa sipërfaqja totale e tyre është 159535 m². Përveç funksionit primar, sipërfaqet e varrezave nuk posedojnë ndonjë përmbajtje tjetër plotësuese.

Sipërfaqe të veçantë paraqet Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve në Pustënik. Përveç sipërfaqes së ngushtë të varrezave dhe Lapidarit, kompleksi përfshin edhe hapësirën e gjelbër të rregulluar dhe mirëmbajtur si dhe hapësirën e parkingut. Në vijim janë dhënë lokacionet dhe sipërfaqet e varrezave publike:

Nr.	Emri, Lokacioni	Sipërfaqja (ha')
1.	Varrezat e Dëshmorëve	4357m ²
2.	Varrezat qytetit te Rrafshet Hani i Elezit	7585m ²
3.	Varrezat kryesore te f. Paldenicë	18376 m ²
4.	Varrezat e lagjes se Ramukve (Paldenicë)	2865 m ²
5.	Varrezat e Gorancës	22543 m ²
6.	Varrezat e Serbëve Gorancë	1522m ²
7.	Varrezat kryesore te fshatit Rezhançë	9560 m ²

është identifikuar edhe ndotja e ujit kryesisht nga ujërat e zeza, kontaminimi i brigjeve të lumit Lepenc nga mbetjet e asbest-çimentos dhe mbeturinave të ngurta, ndotja e tokës nga deponitë ilegale të mbeturinave, ndotja e përgjithshme dhe dëmtimi i peizazhit nga gurëthyesit, degradimi i pyjeve, si dhe humbja e tokës bujqësore përmes ndërtimit të paligjshëm (shih Harta Degradimi i mjedisit).

Edhe pse ekzistojnë të dhëna formale që do të tregohen më poshtë, studime hulumtuese dhe profesionale për përcaktimin e normës së ndotjes (ujit, tokës dhe ajrit) në komunë nuk janë bërë ende. Ky problem nuk është i pranishëm vetëm në komunë, por është i pranishëm edhe në nivel vendi. Por duke pasur parasysh ndotjen evidente posaçërisht të ajrit, reaksioni formal duhet të jetë më urgjent në këtë rast. Zgjidhja e këtyre çështjeve do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen në mbrojtjen e mjedisit.

2.8.2 Ndotja e ajrit

Përtej ndotjes së ajrit nga transporti nëpër infrastrukturën transportuese me pluhur të shtresuar për shumë vite si dhe nga gurëthyesit për nevoja të prodhimit të çimentos, ndotës kryesor i ajrit në Han të Elezit edhe më tutje mbetet industria respektivisht Fabrika për Prodhimin e Çimentos Sharrcem. Sharrcem e privatizuar nga Titan Group më 2010 edhe pas përmirësimeve të vazhdueshme që nga atëherë, vazhdon të bëjë ndotje të konsiderueshme. Më poshtë tregohen gjeneruesit e ndotjes brenda skemës prodhuese të Sharrcemit:




Fig. 1 – Skema e Procesit të prodhimit dhe ndikimit në mjedis të Sharrcemit

Nga matjet e Sharrcem-it për ndotjen në pika të caktuara brenda impiantit industrial kemi të dhënat në vijim³³:

Emetimet në ajër nga Sharrcem-i 2018-2020	Pluhur-furra (µg/Nm ³)	Pluhur-ftohësi i klinkerit (µg/Nm ³)	Pluhur-CEM2 (µg/Nm ³)	SO _x (µg/Nm ³)	NO _x (µg/Nm ³)
Matjet 2018	3.32	2.66	2.75	44.90	546.06
Matjet 2019	4.00	0.84	2.34	28.00	622.00
Matjet 2020	4.19	0.55	1.81	37.10	523.73
Normat e lejuara/ standardet kosovare	30.00	20.00	20.00	300.00	500.00

Tabela 21. Emetimet në ajër nga Sharrcem (2018-2020)

Në tabelën më lart pluhuri nuk specifikohet saktë nëse është fjala për PM 2.5 apo PM 10³⁴ (matet përmes njësisë µg/m³ – mikrogram për metër kub). Kufinj të lejuar sipas standardeve kosovare janë 25 respektivisht 50. Gjithnjë sipas tabelës më lart shihet se në të tri vitet e lartpërmendura ka pasur tejkalime të ndotjes në rastin e oksideve të azotit (NO_x).

Tabela më poshtë tregon numrin e tejkalimeve të ndotjes sipas standardeve kosovare bazuar në

³³Burimi: Annual Sustainability Report 2020, Sharrcem sh.p.k.

³⁴PM 2.5 - copëza ndotëse në këtë rast në formë pluhuri me dimensione 2,5 ose më pak mikrona

matjet e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHK) përmes stacionit në Han të Elezit³⁵:

Parametrat e mëposhtëm sipas matjeve nëpër vite (njësia e përqendrimeve vjetore $\mu\text{g}/\text{m}^3$)										
	2018		2019		2020		2021		2022	
Parametri	Përqendrimi mestar vjetor	Tejkali met 24h/8h /1h	Përqendrimi mestar vjetor	Tejkali met 24h/8h /1h	Përqendrimi mestar vjetor	Tejkali met 24h/8h /1h	Përqendrimi mestar vjetor	Tejkali met 24h/8h /1h	Përqendrimi mestar vjetor	Tejkali met 24h/8h /1h
PM10	63,3	85//	25,2	40//	25,6	34//	17,5	13//	19,7	8//
PM2.5	20,1		16,2		17,6		13,9		14,5	
NO2	60,5	//137	40,8	//128	18,0		16,6		15,4	
SO2	19,5	/2/	7,8		5,5		8,2		4,3	
O3	45,4		41,7	/1/	52,8	/1/	60,0	/13/	59,2	/13/
CO	2,5		0,7		0,2	/1/	0,4		0,3	

Tabela 22. Përqëndrimet vjetore dhe tejkaliimet e standardeve kosovare për ndotës të caktuar (2018-2022)

Nga informacioni më lart, është e qartë se ka pasur përmirësime nëpër vite, ndoshta edhe paralelisht me përmirësimet në burimet e ndotjes në Sharrcem. Në 2 vitet e fundit, edhe pse mesataret vjetore janë brenda standardeve të lejuara, tejkaliimet të ndotjes bazuar në të njëjtat standarde ka ende në rastin e PM10 dhe Ozonit.

Në rastin e Hanit të Elezit është evidente se përveç Sharrcem-it, ndotja me pluhur ka edhe kontribues tjerë si: 2 gurëthyesit, djegie të biomasës për ngrohje dhe transporti nëpër autoudhë, rrugën nacionale N2 si dhe rrugët lokale që e ngritin në ajër pluhurin e shtresuar me vite. Por pavarësisht këtyre pohimeve dhe të dhënave nga tabelat më lart, në Han të Elezit është ende aktuale dhe dëshmohej qartë (shihet me sy) ndotja me pluhur në përmasa shumë të mëdha. Sipërfaqet e reja të ndërtuara duke përfshirë edhe kulmet e shtëpive të reja mbulohen nga pluhuri dhe bëhen të hirta brenda vitit. Duke e ditur se transporti i ngjashëm e ndoshta edhe më i madh është edhe në qytetet fqinje si Kaçanik, Ferizaj dhe Viti përderisa në ato qytete nuk ka pluhur në sasi industriale ngjashëm si në Han të Elezit, vlerësohet se Sharrcem mbetet ende kontribues esencial për ndotjen nga pluhuri. Se ku qëndron arsyeja përse kjo ndotje nuk tregohet nga stacioni matës i IHMK-së apo nga matjet e Sharrcem, kjo mbetet për tu qartësuar.

Banorët ankohen edhe për vazhdimin e ndotjes nga gazrat e lartpërmendur. Kjo shpesh ndodh gjatë natës dhe mëngjeseve të hershme kur edhe ndjehen aroma jo të zakonshme në Qytezë.

Në fund duhet nënvizuar se përtej ekzistencës së stacionit për monitorim të cilësisë së ajrit, inventari i ndotësve nuk është zhvilluar ende nga kadastra e ndotësve të ajrit, ngjashëm sikur në asnjë vend të Kosovës. Si rezultat i kësaj gjendje nuk mund të flasim me kompetencë për nivelin aktual të ndotjes së ajrit dhe cilësisë së tij.

2.8.3 Ndotja e ujit


Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre (shih aneksin 10 - Harta e ndjeshmërisë së ujërave nëntokësor ndaj ndotjes). Ky rrjet shkakton derdhjen e ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimorë dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër. Në rastin e Hanit të Elezit, kjo ndotje grumbullohet edhe nga Komunitat e Kaçanikut, Ferizajt dhe Shtërpces, të cilat njëjtë ujërat e zeza i lëshojnë në lumenj (Nerodime dhe Lepenc) të pa trajtuara. Si përgjigje ndaj kësaj dukurie, dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore, komuna është duke e ndërtuar sistemin kryesor të kanalizimit duke përfshirë edhe kolektorët ku do të përfshihen të gjitha vendbanimet e komunës.

Karakteristike për Hanin e Elezit është edhe ndotja e lumit dhe bregut të Lepencit nga mbetjet e

³⁵<https://airqualitykosova.rks-gov.net/statistikat-vjetore/>

asbest-çimentos të derdhura për dhjetëra vite nga industria tashmë jo funksionale. Para 4 viteve, MMPHI realizoi një projekt ku gërmoi dhe transportoi këto mbetje në deponinë e përgatitur enkas në rrafshnaltën e Gorancës (Zheden). Megjithatë, vlerësimet nga qeveria lokale dhe banorë e Lagjes së Anëlumit (zona urbane) tregojnëse ka ende mbetje të tilla përgjatë breglumit të Lepencit.

Edhe ujërat industriale të pa trajtuara mund të shkaktojnë ndotjen e ujërave. Duke e ditur karakteristikat industriale të komunës, duhet bërë hulumtime dhe monitorime në këtë drejtim nga ndotës potencial.



Harta 17. Ndotja e mjedisit

2.8.4 Ndotja e tokës

Mbeturinat e ngurta të akumuluar në deponitë ilegale janë ndër ndotësit kryesorë të tokës në komunë. Këto janë kryesisht deponi ilegale të mbeturinave shtëpiake, dhe në disa raste mbetjeve të ndërtim/ rrënit, të cilat kryesisht gjenden në afërsi të rrugëve (shih aneksin 10 - Harta e deponive ilegale). Ndikimet negative të këtyre deponive janë të shumta, ku përveç kontaminimit të drejtpërdrejtë të tokës dhe ajrit, ndikimi i tyre mund të bartet në rrjedhat e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë nëpërmjet reshjeve. Drejtoria e Shërbimeve Publike për çdo vit e bën evidentimin e deponive ilegale dhe organizon pastrimin e tyre.

Në mungesë të një sistemi të kompletuar dhe të mjaftueshme të kanalizimit, ujërat e zeza duhet të trajtohen si ndotës potencial të tokës. Kjo ndotje mund të shkaktohet nga kalimi i ujërave të zeza në zonat e ujit sipërfaqësor apo rrjedhave nëntokësore, varësisht nga forma e shkarkimit të tyre - drejtpërdrejtë në rrjedhat e ujit (në shumicën e rasteve) ose në sipërfaqen e tokës.

Përveç ndotjes së drejtpërdrejtë, si një formë tjetër e degradimit të tokës është ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Po ashtu, problem të veçantë paraqet edhe degradimi i pyjeve përmes prerjes ilegale.

2.8.5 Ndotja akustike

Sa i përket ndotjes akustik, nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme. Fakti që përmes territorit të komunës kalon autoudha R6 dhe nacionalja N2 ndërsa asnjëra nga to nuk ka ndonjë formë mbrojtëse, tregon se zhurma është evidente . Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë industriale si Sharrcem, Kosovaplast (në zonën urbane) dhe gërmimet grumbulluese (gurthyesit) brenda territorit të komunës.

2.8.6 Fatkeqësitë natyrore dhe të tjera

Rreziqet në shumtën e rasteve kanë ndodhur, ose kanë ardhur në befasi dhe pa paralajmërim që do të thotë se fatkeqësitë sulmojnë të gjithë, në çdo kohë dhe kudo. Fatkeqësitë nuk zgjedhin kohën as vendin se ku do të ndodhin. Andaj te gjithë jemi te kërcënuar nga rreziqet e ndryshme që i kërcënojnë interesat e sigurisë në çdo kohë dhe në çdo vend. Lëndueshmëria më e madhe gjatë katastrofave është në vendet më pak të zhvilluara, në të cilat njerëzit shpeshherë janë më të pambrojtur ndaj rreziqeve që pasojnë pas përjetimit të një katastrofe.

Kërcënim për rrezikshmëri me përmasa të mëdha apo të vogla, mund të jetë çdo dukuri e shkaktuar nga vetë natyra ose nga ndikimi i njeriut, çdo proces ose çdo ngjarje me të cilën shkaktohet humbje në njerëz apo të mirave materiale, si:

- infrastrukturë, ambient,
- trashëgimi kulturore,
- shkatërrim i ekonomisë industriale, dhe
- bujqësore.

Mënyra më e mirë për tu mbrojtur për situata të tilla është Vlerësimi, Planifikimi dhe Programimi i veprimit të menduar për emergjencë duke udhëzuar kur veprimet emergjente janë të nevojshme.

Vërshimet – përgjatë viteve lumi Lepenc së bashku me përroin e Rezhancës, dhe përrenjtë e Seçishtes, Dimces e Laçit (3 të fundit më rrallë) kanë vërshuar një pjesë të zonës urbane dhe disa pjesë të fshatrave që gjenden rreth tyre. Përveç intensitetit të reshurave, vërshimet në këtë zonë janë pasojë e hedhjes së mbeturinave dhe materialeve inerte, si dhe ndërtimet ilegale dhe uzurpimet e shtratit të lumit të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në ngushtimin e shtratit të lumit.

Këto rrjedha ujore në rastin e reshjeve të mëdha atmosferike vërshojnë dhe shkaktojnë dëme të konsiderueshme në objekte të banimit, prona bujqësore, infrastrukturë, etj. Në vitet e fundit janë shënuar disa raste vërshimesh. Vërshimet më të mëdha kanë ndodhur kryesisht përgjatë përroit të Rezhancës duke filluar me Lagjen e Re të zonës urbane dhe duke vazhduar me zonat e rrezikuara nga lumi Lepenc që nga Lagja Uji i Thartë, Lagja Ranat, Lagja e Anëllumit, infrastruktura përreth dhe më tej në jug në tokat kualitative bujqësore. Duhet përmendur edhe përroin e Dimcës dhe përroin e Seçishtes që në të kaluarën kanë vërshuar një pjesë të zonës urbane respektivisht një pjesë të fshatit Seçishtë.



Foto 3. Vërshimet në Lagjen e Re (Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyre dhe tjera, HiE 2017)

Pjesa më sensitive dhe problematike mbetet në Lagjen e Re ku ndër dhjetëra vite në tokën bujqësore është ndërtuar e tërë Lagja. Përroi i Rezhancës që dikur shërbente për ujitje tani është potencial për probleme. Ndërtimet në tokat private përreth kanë lënë pronën e përroit për tu shfrytëzuar edhe si rrugë kryesore e Lagjes. Me shtimin e numrit të banorëve rruga është zgjeruar dhe në vitin 2012-2013 përroi është futur në tunel me dimensione 2.5*2.0 m' për gjatësi 1.2 km' duke filluar nga grykëderdhja në Lepenc e më lart. Mirëpo ky trajtim i përroit e shtoi ndjeshmërinë në pikën ku uji nga lugina e hapur hyn në tunel. Në disa raste më pastaj kur kishte të reshura, lumi solli ujë më shumë, mbeturinat e hedhura ilegalisht dhe materialin nga erozioni duke bërë që të bllokohet hyrja e kanalit dhe duke vërshuar nëpër rrugë dhe Lagje. Kjo ndodhi më 2014 (ku dëmet materiale ishin vlerësuar mbi 500,000 Euro) dhe 2017, plus disa raste tjera ku organet komunale intervenuan dhe hapën hyrjen e kanalit në momentin vendimtar.

Vërshimet nga lumi Lepenc nuk kanë qenë masive sikur vitet '70 dhe '80 të shekullit të kaluar. Megjithatë ka pasur raste edhe më vonë (2017) kur Lagja Ranat dhe toka bujqësore kualitative në jug (53 nga 103 ha) janë vërshuar. Potenciali i vërshimeve nga përrrenjtë Dimca dhe Seçishta janë reduktuar në maksimum pas intervenimeve në shtretërit e tyre.



Foto 5. Rrëshqitjet e dheut në nacionalen N2 dhe lokalen HiE-Gllloboçicë/ Kaçanik (PZHK HiE 2010-2025)

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave – sektori i Emergjencave, Han të Elezit 2022

Erozioni – në territorin e komunës së Hanit të Elezit faktori i erozionit natyror është i pranishëm dhe shkakton humbje të tokës bujqësore, dëmtim të infrastrukturës dhe dëme ekonomive familjare. Erozionet natyrore janë të pranishme në terrene malore si erozione vertikale. Erozioni anësor është i pranishëm në rrjedhjen e lumit Lepenc dhe përrenjve Rezhancës, Dimcës dhe Laçit (shih Aneksin 9, si dhe Harta Erozioni).

Shkalla e rreziqeve është në rritje si rezultat i faktorëve natyror dhe njerëzor. Procesi erozionit është i pranishëm në 60% të pellgut të lumit Lepenc i cili brenda vitit depoziton rreth $1800\text{m}^3/\text{km}^2$ ³⁶.

Siç u tha me lart territori i Hanit të Elezit është kryesisht malorë. Prandaj 10% të territorit të komunës ka shkallë shumë të lartë erozioni; dhe 28% ka shkallë të lartë e erozionit (tabela në vijim). Prerja ilegale e drurit është një nga shkaqet e erozionit dhe kjo është treguar në rastin e Përroit të Rezhancës gjatë vërshimeve të herëpashershme.



Shkalla e erozionit në ha	
Shkallë shumë e lartë	836 ha
Shkallë e lartë	2,275 ha
Shkallë e mesme	2,941 ha
Shkallë e ulët	2,330 ha

Fig 2 Shkalla e erozionit në ha dhe përqindje (Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020, MMPHI)

³⁶Burimi: Dr Riza Qavolli, Gjeografia regjionale e Kosovës f 224 Prishtinë 1997





Tabela 23. Shkalla e erozionit

Tërmetet –Tërmeti është fenomen i cili shkaktohet nga çlirimi i papritur i energjisë së grumbulluar, i cili shkakton krijimin e valëve sizmike (dallgëve sizmike). Në sipërfaqen e tokës, tërmeti shfaqet në dridhjet ose zhvendosjet e tokës (truallit). Tërmeti mund të shkaktojë dëmtime të mëdha njerëzore dhe materiale.



Harta 20. Sizmiciteti (epiqendrat e tërmeteëve në territorin e Kosovës 1456-2014)

Territori i Kosovës në aspektin sizmik përfaqëson një terren mjaft aktiv, në të cilin mund të ndodhin tërmete me karakter autokton, apo nga vatrat jashtë territorit të Kosovës - në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Territori i komunës së Hanit të Elezit i takon Zonës së V-të (pesë) të presionit (goditjes sizmike), 7-8 gradë në bazë të "MSC". Nuk ka të dhëna për mikro-zonat sizmike.

Kjo nënkupton që ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit duhet ti përmbahen shkallës së intensitetit të dridhjeve për minimizimin e fatkeqësisë në raste rreziku. Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+3, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, sidomos urave përmes aplikimit të ligjittë ndërtimit në zona sizmike. Objektet e vjetra, kryesisht ato publike dhe të trashëgimisë, duhet analizohen dhe vlerësohen dhe nëse është e nevojshme disa prej tyre do të forcohen për t'i rezistuar tërmeteëve.

Burimi; Plani Hapësinor i Kosovës, 2010

Zjarret – për shkak të karakterit malor të komunës, numri i zjarreve është mbi mesataren e Kosovës. Statistika e zjarreve të cilat kanë ndodhur prej 2008 e këtej tregojnë se ka pasur një numër të konsiderueshëm zjarresh urbane dhe rurale. Këto zjarre kryesisht ishin malore (pyje), por nuk munguan edhe zjarre në fusha, zjarre në ndërtesat e banimit familjar, në objektet afariste – lokale afariste, zjarre në automjete të udhëtarëve, në trafo për shpërndarjen e rrymës elektrike, deponi të

mbeturinave e tjera. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës – sektorit të Emergjencave, në periudhën 2015-2021 janë regjistruar gjithsej 432 zjarre, prej të cilave 37 vetëm në vitin 2021. Njësia e zjarrfikësve nuk ka resurse ose pajisje të mjaftueshme për t'u marrë me zjarret e pyjeve.

Aktualisht Njësia e Zjarrfikësve furnizohet me ujë nga hidranti i sistemit të ujësjellësit në bazën e tyre. Duke marrë parasysh karakterin e komunës si një luginë lumi me dy masive malore, ka nevojë për nga një hidrantë në Sharr (Gorancë) dhe Karadak (Paldenicë).

Mbrojtja nga zjarret do të bëhet përmes aplikimit të masave organizative dhe teknike. Rekomandohet të jenë permanente grupe vullnetare në secilin vendbanim të cilat në rast zjarri do të mund të ndihmonin Njësinë e zjarrfikësve dhe po ashtu stafi i zjarrfikësve duhet trajnuar. Po ashtu është shumë me rëndësi bashkëpunimi ndër-komunal me departamentet e zjarrfikësve në komunat fqinje.

2.9 Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

2.9.1 Asetet e trashëgimisë natyrore

Zonat dhe monumentet natyrore – komuna e Hanit të Elezit është e pasur me trashëgimi natyrore. Natyra me Sharrin magjik ofron zona dhe elemente që mund të veçohen për mbrojtje dhe atraksion për vendasit dhe vizitorët dhe mund të ndihmojë zhvillimin në sferën e turizmit. Edhe Karadaku në lindje, edhe pse me kodrina më të ulëta, me pyjet e lisit, ahut e pishave, lumenjtë dhe krojet e pastërta, lëndinat, etj., ofrojnë një miks interesant natyror. Rrjedhimisht Komuna dhe komuniteti duhet të punojnë që peizazhe dhe monumente të përzgjedhura natyrore që janë të bollshme në Han të Elezit të fusë formalisht në Listën e Zonave të Mbrojtura të IMN/ MMPHI.



Foto 6. Natyra unike e Maleve të Sharrit, Komuna e Hanit të Elezit

Fotocredit: Bedri Bushi, KAHIE, promovimi i natyrës 2012-2022

Por duhet nënvizuar edhe faktin se në veçanti pyjet e ahut në Malet e kardiakut janë duke u degraduar me të madhe për shumë vite nga druvarët ilegal për shfrytëzim të tyre si biomasë për dëgjie. Organet relevante lokale dhe qendrore duhet të bashkëpunojnë me komunitetin dhe shoqërinë civile për të ndërmarrë hapa për ndalimin e kësaj dukurie.

Biodiversiteti – si vend malor, edhe Komuna e Hanit të Elezit është pjesë e miksit shumë të pasur biodiversiv të Kosovës.

Fauna – Përfshihen shumë kafshë të rralla dhe të rrezikuara. Këtu bëjnë pjesë një numër gjitarësh, si ariu i murrme (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe shpendët si shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), thëllëza e malit (*Alectoris graeca*), skifteri kthetabardhë (*Falco naumanni*), bufi (*Bubo bubo*), dhe shkaba (*Gyps fulvus*). Mishngrënësit e mëdhenj përshkojnë distanca të mëdha, kalojnë kufijtë e shteteve duke bërë kështu të mundur mbijetesën e popullatave ndërkufitare të specieve të tyre. Më të shpeshta janë kafshët si lepur, ketri dhe shpezët korbi, laraskat, harabelat e fushës, qukapikët, thëllëzat, lejlekët dhe shpezët mishngrënës si shqiponjat, petritët, gjeraqinat e hutat.

Këtu jeton gjarpri i ujit (natrix natrix), gurit (vipera ammodytes), bollujca (tropidonatus natrix), kërmilli i vjeshtës (helix pomatia), breshka e rëndomtë (testudo bermanni). Peshq nuk ka shumë lloje, përderisa në lumin Lepenc më kryesorët janë trofta e përroskave që jeton në ujëra të shpejta dhe ftohta (lumi i Laçit) dhe krapit (kleni) shumë i shpeshtë i pjesëve të ulëta të Lepencit.

Flora – Janë shumë komunitete të ndryshme të bimëve që gjenden të shpërndara në habitate të ndryshme. Shfaqja e tyre varet nga lartësia mbi nivelin e detit, ekspozimi dhe lloji i tokës apo përmbajtja e shkëmbit. Këtu gjenden komunitete të ndryshme pyjore, që pjesërisht kanë degraduar në komunitete shkurrësh malore, veçanërisht në zona ku pyjet janë prerë në mënyrë të përsëritur. Pjesa më e madhe e zonave mbi brezin pyjor mbulohen nga kullota malore, nga bimësia e tokave shkëmbore-gëlqerore dhe, shkëmbore-silikate, nga bimët e lëndinave, vegjetacioni i tokave të lagështa që ndodhen lart në male dhe nga vegjetacioni i rrafshnaltave me bar.


Në pjesët kodrinore të Komunës dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjethërenëse si: ahu (fagus sylvatica), qarri (quercus cerris), bungu, shkoza (carpinus orientalis). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: bliri (tilia kordata), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipat tjerë që janë të ulëta lloji i shkurreve si thana (cornus mas), murrizi (crataegus monogyna), kaça (rosa canina), kulumbria (prunus spicosa), lajthia (corylus avellana), në vise të larta fieri shqiponje (pteridium aquilinum), etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjëve si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bime që pas trajtimit përdoren si është kantarioni (hypericum perforatum), kamomili (matricaria chamomila), dredhëza (fragaria vesca), manaferra etj.

Me pyje gjethembajtëse, janë vetëm 2 sipërfaqe të ndara (në Sharr/ Gorancë dhe Karadak/ Neçavc) Hapësira e rrafshët e komunës (lugina e Lepencit) është e vogël pa drunjë të dendur zakonisht rritet shelgu (salix alba) dhe verri në brigje të lumenjve, por edhe gështenja e egër. Ka edhe formacione të livadheve si tërfilli dhe shkurre të rralla.

Në Gorancë gjendet një bime e llojit me karakter endemik e quajtur “Convovulus cochlearis” (Dredhja e Kosovës).

Burimi: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, 2020-2022

Tabela 24. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2021) – trashëgimia arkitekturale, nënkategoria: monument/ ansambël; MKRS, 2021



Harta 22. Trashëqimia kulturore

Trashëgimia arkeologjike – lista e trashëgimisë arkeologjike ka një lokalitet dhe një objekt në Paldenicë. Është edhe lokaliteti i minierave të vjetra të kromit që Komuna/ MKRS duhet ti fusin në listë. Komuna nuk ka të dhëna rreth sipërfaqeve të parcelave në të cilat gjenden lokalitetet e trashëgimisë arkeologjike.

Emri	Periudha	Vendi	Nr unik në databazë
Lokalitet arkeologjik në Paldenicë	Romake	Paldenicë, HiE	3605
Kishë paleokristiane në Paldenicë	Shek. IV - VI	Paldenicë, HiE	797

Tabela 25. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2021) – trashëgimia arkeologjike, nënkategoria: lokalitet arkeologjik/ rezervat; MKRS, 2021

Trashëgimia shpirtërore – si monument i veçantë i trashëgimisë ku edhe Hani i Elezit ka pjesën e vet, është listuar Eposi i Kreshnikëve. Ky është një monument i trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare në pesë vendet të Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbi), i përbërë prej gjithsej 15 vëllimesh.

2.10 Vendbanimet

Komuna e Hanit të Elezit ka gjithsej 11 vendbanime: Hani i Elezit si qendër komunale dhe 10 fshatra (shih Aneksin 3, si dhe Hartën Vendbanimet dhe vendbanimi joformal). Qyteza si qendër komunale por edhe një lidhëse infrastrukturore (autoudha, nacionalja N2 dhe hekurudha) është edhe pikë

lidhëse e rëndësishme funksionale për të gjitha vendbanimet e Komunës. E tërë Komuna ka sipërfaqe prej 83.17km².

Komuna si tërësi ka dendësi të ulët të popullsisë që sillet 102.6 b/km², që është më e ulët se në nivel të Kosovës. Nga të cilat, zona kadastrale e Hanit të Elezit ka dendësinë më të madhe 2,203 b/km², pasuar nga Paldenica me 403 b/km², Seçishta me 250 b/km², ndërsa tjerat kanë dendësi më të ulët se 100 b/km².

Nr.	Vendbanimi	Karakteri	Popullsia 2011	Popullsia 2024 ³⁷	Sipërfaqja e zonave kadastrale (km ²)	Dendësia e popullsisë (b/km ²)	
						2011	2024
1.	Dimcë	Rural	249	147	2,12	117	69
2.	Dërmjak	Rural	121	100	6,15	20	18
3.	Gorancë	Rural	1,028	767	20.80	49	37
4.	Han i Elezit	Urban	2,533	2,555	1,16	2.184	2,203
5.	Krivenik	Rural	283	204	12,28	23	17
6.	Neçavc	Rural	110	102	4,38	25	23
7.	Paldenicë	Rural	1,723	1,629	4,04	426	403
8.	Pustenik	Rural	629	403	10,87	58	37
9.	Rezhancë	Rural	475	487	8,52	56	57
10.	Seçishtë	Rural	2,252	2,123	8,5	265	250
11.	Vërtomicë	Rural	0	8	4.38	/	2
Komuna			9,403	8,533	83,17	113	102

Tabela 26. Numri i banorëve dhe dendësia e popullsisë

2.10.1 Zona urbane – Qyteza

Vendbanimi urban – Qyteza e Hanit të Elezit - edhe pse vendbanimet përreth datojnë që nga antikiteti e mesjeta, fillet e zhvillimit të Hanit të Elezit si vendbanim datojnë me ndërtimin e hekurudhës dhe stacionit të rëndësishëm hekurudhor në fund të shekullit XIX. Në vitin 1920, Hani i Elezit kishte një stacion treni, një han, dy kafene dhe një dyqan të cilët shërbenin për banorët gravitues dhe kalimtarët. Në të vërtetë, nga pronari Elez Dimca që kishte Hanin ngjitur stacionit hekurudhor, i mbeti emri edhe vendbanimit të Hanit të Elezit. Në fillim shekullin XX, familjet shqiptare nga fshatrat përreth kanë filluar të vendosen në Han të Elezit. Numri i të ardhurve në këtë zonë është rritur, kur në vitin 1936 u ndërtua fabrika e çimentos. Pas Luftës së Dytë Botërore (dhe pas rindërtimit dhe zgjerimit të fabrikës së çimentos), Hani i Elezit ka evoluar në një vendbanim industrial, ku shumica e punonjësve të fabrikës së çimentos kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në mënyrë që të jenë më afër punës. Zona urbane u aprovua nga Asambleja komunale më 2009. Si qendër administrative komunale për 10 vendbanimet përreth u promovua në vitin 1913, përderisa në vitet '60-ta u bë pjesë e Komunës së Kaçanikut. Në kuadër të procesit të decentralizimit të filluar më 2005, Hani i Elezit u promovua përsëri si Komunë dhe qendër administrative për 10 vendbanimet përreth.

Forma urbane e ndërtuar e Hanit të Elezit zë fill me ndërtimet e barakave për banim dhe ndërtesave në bashkëpronësi 2-3 kateshe afër fabrikës së çimentos (tash zona e qendrës së qytetit) diku kah vitet '50 të shekullit të kaluar. Më vonë, me ndërtimin e pjesës së re të kësaj fabrike u vazhdua me

³⁷ Burimi: ASK, Regjistrimi i Popullsisë 2024

ndërtimin ndërtesave tjera në bashkëpronësi që tani formojnë tërësinë e ndërtesave ekzistuese. Atëbotë këto ndërtesa ishin ndërtuar në një vijë ndërtimore të rregullt dhe të shpërndara nga nacionalja N2 deri te stacioni hekurudhor. Njësitë e banimit u jepeshin në shfrytëzim punëtorëve të fabrikës. Me kohë u asfaltuan rrugët kryesore rreth tyre (diku 800 metra), u instalua sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit si pjesë e sistemit të fabrikës. Për nevoja të këtyre banorëve u ndërtua shtëpia e kulturës me kino e më vonë edhe shkolla fillore. Afërsia e Shkupit ndihmonte banorët në kryerjen e shërbimeve të tjera shoqërore dhe ekonomike që nuk i kishin në Han të Elezit.

Natyrisht se në këtë zhvillim të përgjithshëm pjesa e qendrës së qytezës kishte fjalën kryesore. Të gjitha ndërtesat në bashkëpronësi dhe objektet publike (stacioni hekurudhor, hani, xhamia e vjetër, administrata e fabrikës, shtëpia e kulturës, shkolla fillore e më vonë edhe posta, shkolla e mesme, etj.) u ndërtuan aty. Kjo sepse hapësira që më vonë do të shndërrohet në qendër paraqiste zgjerimin dhe zgjatimin më të madh të luginës së lumit Lepenc. Ky fakt bëri që edhe hekurudha dhe rruga e vjetër të kalonin nëpër këtë pjesë. Kjo infrastrukture ishte një ndihmesë e rëndësishme në zhvillimin e lartpërmendur të zonës urbane të tanishme (PRRU, 2015).

Shikuar në kontekstin hapësinor, qyteza është organizuar duke marrë për bazë vijën hekurudhore dhe lumin Lepenc që gjarpërojnë afër njëri tjetrit si dhe rrugën nacionale N2 e ndërtuar në fund të viteve gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Brenda këtyre elementeve infrastrukturore është e zhvilluar bërthama urbane e Hanit të Elezit ndër vite. Si pasojë e kësaj, sipërfaqja e trajtuar ka lidhje të mira fizike me nacionalen e hekurudhën, e së fundi edhe me autoudhën R6, por edhe me fshatrat përreth. Tani zona urbane është e ndarë 5 njësi.

Si qytezë përfshinë:

- zonën urbane me sipërfaqe 159.88 ha (1.6 km²) me 3.787 banorë respektivisht 37.5% të banorëve të komunës³⁸; dhe
- lagjet ngjitur respektivisht zonën kadastrale të Hanit të Elezit dhe pjesë të zonave kadastrale të Seçishtes, Rezhancës, Pustenikut, Dimcës dhe Paldenicës (më së shumti të Seçishtes).

Qyteza në tërësi ka 5,487 banorë³⁹ (përfshirë dhe banorët e fshatrave të lartpërmendura). Duke qenë qendër komunale, u tha më lart se përmbajtjet dhe funksionet kryesore publike në nivel komunal janë përqendruar aty. Rrjedhimisht, një pozitë e tillë ka joshur edhe përmbajtje të shumta biznesi, kryesisht tregti, hotelieri dhe shërbime. Dominojnë kryesisht ndërtime individuale dhe në bashkëpronësi me etazhitet P+2 deri P+3, me banim në katet e sipërme, derisa katet e poshtme shfrytëzohen për zhvillim të bizneseve. Vetëm 4 ndërtime në bashkëpronësi në qendër janë me etazhitet P+4 deri P+8.

2.10.2 Vendbanimet rurale – fshatrat

Vendbanimet rurale kryesisht janë zhvilluar në mënyrë spontane me ndërtime individuale të ulëta me etazhitet mesatar P+1 (në raste të rralla etazhiteti maksimal P+3).

Sa i përket tipologjisë së organizimit është dhënë tabela në vijim:

	Fshatrat
Të shpërndara	Pustenik, Rezhancë, Seçishtë, Paldenicë, Dërmjak (i fundit gati i depopulluar)
Të grupuara	Gorancë, Krivenik, Dimcë, Neçavc dhe Vërtomicë (2 të fundit të depopulluara)

Tabela 27. Tipologjia e fshatrave

³⁸Burimi: Drejtoria e Administratë dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike

³⁹Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike bazuar në të dhënat e klientëve të ujësjellësit dhe mbeturinave

2.11 Banimi

Komuna e Hanit të Elezit në pjesën më të madhe karakterizohet me banim me veçori rurale dhe me dendësi të ulët (shih Anekset 3 dhe 4). Shumica e njësive të banimit janë të reja, të ndërtuara pas luftës, si rezultat i shkatërrimeve të konsiderueshme. Nevoja për përmirësimin e kushteve të banimit, qoftë drejtpërdrejt në njësi të banimit apo në shërbime të tjera që ndikojnë në cilësinë e banimit është ende e dukshme, sidomos në zonat rurale. Ndërtimet nuk janë përcjellë gjithmonë me shërbime adekuate publike, duke ndikuar edhe në kushtet mjedisore. Ndërkaq kapacitetet e krijuara banimore nuk përputhen plotësisht me nevojat aktuale për banim, duke lënë një pjesë të kapaciteteve të pashfrytëzuara.

Sipas regjistrimit të vitit 2024 Komuna ka gjithsej 1,914 apo 2,193 njësi të banimit që përfshin rreth 0.3% të fondit të përgjithshëm banesor në Kosovë. Numri i ndërtesave sipas vendbanimit nga Regjistrimi i vitit 2024 nuk është publikuar, prandaj janë marrë të dhënat nga Regjistrimi i vitit 2011, sipas të cilit ishin 1,710 ndërtesa, nga të cilat në zonën urbane ishin rreth 993 ndërtesa respektivisht gjegjësisht 58%.

Tipologjia	Nr. i ndërtesave të banimit	Njësitë e banimit
Ndërtesat për banim në bashkëpronësi	31	138
Ndërtesat individuale deri në P+3 në zonën urbane	962	968
Ndërtesat individuale deri në P+3 në zonën rurale	717	721

Tabela 28. Tipologjia e banimit dhe etazhiteti, sipas vitit 2011

Ndërtesat	Numri i ndërtesave	Njësi të banimit
Ndërtesa me së paku një banesë të banueshme të zakonshme	1,468	1,914

Tabela 29. Numri i ndërtesave dhe njësive të banimit sipas regjistrimit 2024

Pjesën më të madhe në komunë e përbën banimi individual me shtëpi individuale, ndërsa shtëpitë në varg dhe dyshe pothuajse nuk ka.

Sipas të dhënave nga komuna në vitin 2023 në komunë ishin gjithsej 1,634 ndërtesa të banimit individual, etazhiteti i të cilave është mesatarisht P+2 dhe ai maksimal ishte P+3. Në afërsi të nyjeve kryesore rrugore, katet e poshtme kryesisht shfrytëzohen për afarizëm. Sa i përket banimit në bashkëpronësi është vetëm në qendër të Qytezës dhe aktualisht përfshinë 39 ndërtesa dhe rreth 232 njësi të banimit të shpërndara në 10 ndërtesa me etazhitet P+1, 24 ndërtesa P+2 dhe P+3, 3 ndërtesa P+4 dhe P+5 si dhe 2 të tjera P+6 e P+7. Ndërsa, sipas Regjistrimit të vitit 2024⁴⁰ në komunë janë gjithsej 1,468 ndërtesa.

Sipërfaqja e banimit në zonën urbane mbulon rreth 18.0 ha gjegjësisht 21% e sipërfaqes së ndërtuar, përderisa në fshatra është 160 ha gjegjësisht 56 % e sipërfaqes së ndërtuar në zonën rurale. Fondi i përgjithshëm i banimit në zonën rurale në tërësi përbëhet prej banimit individual, si banim me dendësi të ulët. Etazhiteti i njësive individuale të banimit shkon deri në P+3.

Pronësia e ndërtesave të banimit në komunë është kryesisht private dhe një përqindje e vogël është publike.

Ndërtesa të banimit individual								
Ndërtesa më vete	Pronar	Qirra marrës	Pronësia		Etazhiteti			
			Private	Publike	B+P+0	B+P+1	B+P+2	B+P+3
1634	1568	66	1,568	66	61	1,410	132	31

⁴⁰ Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, 2024, të dhënat e para finale

Tabela 30. Ndërtesa të banimit individual sipas shfrytëzimit, pronësisë dhe etazhitetit, 2023

Ndërtesa të banimit kolektiv								
	Numri i ndërtesave	Numri i njësive	Shfrytëzimi	Pronësia	Etazhiteti			
			Pronari	Private	B+P+1	B+P+2/ B+P+3	B+P+4/ B+P+5	B+P+6/ B+P+7
Ndërtesa në vete	28	201	201	28	4	21	2	2
Ndërtesa në varg	11	31	31	11	6	3	1	

Tabela 31. Ndërtesa të banimit kolektiv sipas shfrytëzimit, pronësisë dhe etazhitetit, 2023

Shërbimet publike							
	Burimet e ujësjellësit dhe zbrazja e kanalizimit			Burimi i energjisë	Burimi i energjisë për ngrohje		Burimi i energjisë për ngrohje të ujit
	Sistem publik i ujësjellësit	Bunar	Sistem publik i kanalizimit	Energji elektrike	Energji elektrike	Lëndë druri	Energji elektrike
Ndërtesa të banimit	1,389	284	1,673	1,673	220	1,453	1,673

Tabela 32. Qasja në shërbime publike dhe ngrohja, 2023

Sa i përket, situatës aktuale rreth 83% e ndërtesave kanë qasje në sistem publik të ujësjellësit dhe të gjitha në sistem publik të kanalizimit e të energjisë elektrike, ndërsa rreth 87% e ndërtesave përdorin lëndët e drurit për ngrohje.

Të dhënat nga regjistrimi i vitit 2024 për ekonomitë familjare sipas statusit të banimit tregojnë që komuna dominohet nga ato në pronësi (96.4%).

Ekonomitë familjare private sipas statusit të banimit të ekonomisë familjare			
Gjithsej	Në pronësi	Me qira	Forma tjera të shfrytëzimit
1,737	1,675	38	24

Tabela 33. Ekonomitë familjare private sipas statusit të banimit të ekonomisë familjare, 2024

Shikuar përgjithësisht, në nivel të komunës ekziston një mospërputhje në mes numrit të njësive të banimit (1,914) dhe numrit të ekonomive familjare (1,742). Nga fondi i tërësishëm i banimit në komunë, 14.6% mbetet i pashfrytëzuar, megjithatë mbetet më i ulët se në nivel vendi. Mendohet që shumica e këtyre njësive vakante të banimit janë në pronësi të njerëzve që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

	Njësitë e banimit	Të banuara	Vakante	Ekonomi Familjare	Banor për /km ²
Hani i Elezit	1,914	1,635 (85.4%)	279 (14.6%)	1,742	98
Kosova	556,779	373,930 (67.2%)	182,849 (32.8%)	366,595	146.9

Tabela 34. Fondi i banimit

Sa i përket periudhës së ndërtimit përqindja e ndërtesave me rreth 52% janë të reja dhe janë ndërtuar kryesisht pas vitit 2000.

Vendbanimit	Viti i ndërtimit									
Hani i Elezit	Gjithsej	Nuk di	< 1960	1960-1969	1970-1979	1980-1989	1990-1999	2000-2009	2010	2011<

	1,760	2	505	10	68	116	146	398	65	450
Kosova	414,273	636	193,661	3,823	12,012	25,770	28,936	69,826	8,497	71,109

Tabela 35. Periudha e ndërtimit të ndërtesave të banuara të zakonshme, sipas regjistrimit të 2024

Burimi: ASK, regjistrimi 2024

Vetëm 24 njësi banimi në komunë nuk e kanë të definuar pronësinë duke qenë në shfrytëzim nga pronarë të ligjshëm (janë dhënë në shfrytëzim gjatë viteve '70 dhe '80). Njësitë tjera të banimit janë private dhe asnjë nuk është në pronësi të Komunës.

Si çdo kund në Kosovë, çështja e pronës së ndërtesave në bashkëpronësi (prona në të cilën gjendet objekti dhe prona në afërsi) duhet trajtuar me urgjencë në kuadër të legjislacionit dhe mekanizmave të duhur në mënyrë që të mundësohet përmirësimi i infrastrukturës së banimit në ato raste apo zhvillimi i asaj toke sipas PZHK-së dhe planeve tjera lokale.

Burimi: Drejtoria e urbanizmit 2022

2.12 Vendbanimi joformal

Përderisa pas analizave paraprake në këtë dokument është konkluduar se nuk ka vendbanime joformale tjera, në Komunën e Hani të Elezit është ende një vendbanim joformal i cili ishte identifikuar nga PZHK e kaluar 2010-2025 (shih Aneksin 3, si dhe Aneksin 13 - Harta e Vendbanimeve). Bazuar në atë dokument, Lagja Brava ngjitur zonës urbane ishte identifikuar si joformal për shkak të pronës së padefinuar (shtëpitë individuale të banimit janë ndërtuar në pronë të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës) dhe për shkak të rrezikshmërisë së theksuar në rastin e rrëshqitjes së dheut në rrugën e cila të shpie në Lagje. Bazuar në veprimet e propozuara nga PZHK 2010-2025, Komuna kishte marrë masat e nevojshme dhe përmes intervenimeve e kishte larguar rrezikun e rrëshqitjes së dheut në rrugën në fjalë duke ofruar siguri të plotë për banorët, dhe në të njëjtën kohë e kishte hequr një arsye që e bënte vendbanimin joformal. Megjithatë pronësia në këtë Lagje nuk është definuar ende.

Sipas UA nr. 08 2017 për NTPH, ky vendbanim joformal i përket kategorisë „Vendbanime joformale të përmirësuara në zona të qendrave dhe periferive të vendbanimeve, që karakterizohet me okupim të paligjshëm të tokës, njësi të banimit joformale dhe pa leje të planifikimit, dhe vendbanim i pa integruar në një sistem më të gjerë të vendbanimit. Në të njëjtën kohë vendbanimi ofron kushte relativisht të mira për jetesë me vendndodhje në pjesët qendrore dhe periferike të vendbanimeve, me njësi të banimit me cilësi relativisht të mirë, qasje në infrastrukturë të transportit dhe në atë teknike, mundësi e integritimit në kuadër të vendbanimeve të organizuara dhe të planifikuara dhe mundësi evoluimi në lagje aktive me tregje të qëndrueshme të njësive të banimit me pronësi”.

Në këtë rast, karakteristikat e Lagjes Brava përshtaten me këtë lloj vendbanimi. Pra, është e zhvilluar në pronë publike, por është e lidhur me infrastrukturë dhe shërbime si vendbanimet tjera formale dhe ofron mundësi të qarta për rregullimin e tyre. Më shumë informacion në vijim:


- Lagja është në zonën kadastrale të Pustenikut dhe ka 2.82 ha. Nga 24 objekte individuale banimi që ishin më 2009⁴¹, në fund të vitit 2022 janë 34 të tilla dhe një objekt publik për nevoja të Lagjes.

Vendbanimi joformal Lagjeja Bravë								
Vendbanimi	Konteksti	Kodi	Pronësia	Nr. i banorëve	Numri i njësive të banimit (individual)	Qasja në infrastrukturë dhe shërbime	Instrumenti Rregullues	Prioriteti për intervenim
Pustenik-Lagja Bravë	Rural		Shoqërore	170	34	Infrastruktura dhe shërbimet	PZHK	Afatmesëm

⁴¹Burimi: PZHK Hani i Elezit 2010-2025

						publike		
--	--	--	--	--	--	---------	--	--

Tabela 36. Vendbanimi joformal




Harta 23. Vendbanimi joformal – Lagja Brava dhe lokacioni në raport me territorin komunal

2.13 Ndërtimet pa leje

Sikurse çdo komunë në Kosovë edhe Hani i Elezit ballafaqohet me një numër të madh të ndërtesave pa leje. Sipas regjistrimit të komunës së Hanit të Elezit (2015), në total janë 1822 ndërtesa pa leje, prej të cilave 1472 shtëpi banimi, 27 ndërtesa komerciale, 283 shtalla, 35 garazha dhe 6 depo.

Ky numër kaq i madh na bën të kuptojmë që mund të ketë një mungesë të planifikimit të mirëfilltë urban dhe kontrollë, që ka ndikuar në ndërtimin e ndërtesave në mënyrë të pakontrolluar, kështu duke rënduar infrastrukturën ekzistuese. Duhet theksuar se këto ndërtime shpesh nuk i përmbahen standardeve të sigurisë dhe paraqesin rrezik për banorët dhe mjedisin.

Identifikimi i saktë i numrit të ndërtesave pa leje është i domosdoshmëm për të siguruar që legjislacioni dhe rregulloret komunale janë duke u respektuar dhe zbatuar. Ndërtimet pa leje mund të anashkalojnë tatimet, prandaj njohja e numrit të tyre do të ndihmon komunën e Hanit të Elezit në rritjen e të ardhurave për komunën përmes taksave dhe tarifave. Është e nevojshme të konsiderohet krijimi i mekanizmave për raportimin e këtyre ndërtimeve, hartimi dhe përditësimi i planeve për të siguruar që ato përmbushin nevojat e qytetarëve dhe janë të qarta, thjeshtëmi i procedurave për marrjen e lejeve të ndërtimit, duke e bërë atë më të lehtë dhe më të shpejtë për qytetarët, organizimi i fushatave për të informuar qytetarët mbi rëndësinë e ndërtimit të ligjshëm dhe pasojat e ndërtimeve pa leje. ofrimi i informacionit të qartë dhe të qasshëm në lidhje me kërkesat për ndërtim dhe procedurat si dhe rritja e kontrollit përmes forcimit të inspektoratit ndërtimor për të monitoruar ndërtimet dhe për të zbatuar ligjet që janë në fuqi.



Harta 24. Ndërtimet pa leje

2.14 Shfrytëzimi i tokës

Nga sipërfaqja totale prej 83.17 km², pjesa më e madhe e territorit komunal përfshihet nga tokat pyjore me 52.02 km² (63.7%), të pasuara me tokat bujqësore me 26.06 km² (31.3%). Sa i përket sipërfaqeve të ndërtuara ato mbulojnë rreth 3.10 km² (3.6%) të territorit të komunës. Për më shumë shih Aneksin 11 dhe Hartën Shfrytëzimi i Tokës.

Kodi HILUCS 1	Klasa HILUCS 1	Kodi HILUCS 2	Klasa HILUCS 2	Sipërfaqja (ha)	%
1	Prodhim parësor	1.1	Bujqësi	2,606.4	31.3
		1.2	Pylltari	5,194.4	62.4
		1.3	Minierë dhe gurorë	47.3	0.6
2	Prodhim dytësor	2.1	Industria e prodhimit të lëndës së parë	24.2	0.3
3	Prodhim tretësor	3.1	Shërbim tregtar	4.6	0.05
		3.2	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit		
		3.3	Shërbim i komunitetit	22.7	0.3
		3.4	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	1.3	0.01
4	Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1	Rrjetet e transportit	130.5	1.6
5	Banim	5.1	Banim i përhershëm me një njësi	177.3	2.4

- DREJTORIA PËR SHENDETESI DHE MIREQENIE SOCIALE – 4
- TE PUNESUARIT NE ARSIM - 125
- TE PUNESUARIT NE SHENDETESI – 31
- KUVENDI KOMUNAL –40
- ZJARRFIKËSIT – 7

Pasqyra e kualifikimit të shërbyesve civil në administratë		
Kualifikimi	Fakultet	Shkollë e mesme
	50	16

Tabela 38. Pasqyra e shërbyesve civil sipas kualifikimit

Pasqyra e përvojës së shërbyesve civil në administratë					
Përvoja	0-5 vjet	6 – 10 vjet	11 – 15 vjet	16 – 20 vjet	Mbi 20 vite
	15	7	17	11	16

Tabela 39. Pasqyra e shërbyesve civil sipas përvojës

Të dhënat mbi kualifikimin e personelit të administratës publike tregojnë që përqindja më e madhe e tyre janë me fakultet (76%), kurse pjesa tjetër me shkollë të mesme. Ndërsa, sa i përket përvojës përqindja më e madhe prej 26% janë me përvojë 11-15 vjeçare pasuar nga ajo me mbi 20 vjeçare me 24% dhe 23% janë me më pak përvojë (0 – 5 vjet).

2.15.2 Kapacitetet financiare

Investimet publike në Komunën e Hanit të Elezit pothuaj se tërësisht kryhen përmes buxhetit komunal, granteve nga buxheti i Kosovës dhe donacionet. Bashkë-investime publiko-private me biznese deri më tani nuk ka pasur. Bashkë-investimet me komunitetin kanë qenë simbolike, por nuk janë aplikuar viteve të fundit (shih Aneksin 12).

Buxheti komunal – në vitin 2023 në krahasim me vitet paraprake buxheti i planifikuar komunal ka trend të rritjes me vlerë 4,252,808.11 Euro. Në vitin 2020 buxheti i përgjithshëm komunal i planifikuar ishte i lartë dhe ishte 3,277,467.77 Euro, i cili në vitin 2021 dhe 2022 kishte pësuar ulje deri në 2,679,093.81 (në vitin 2021).

Buxheti i planifikuar komunal								
Kategoria ekonomike	Buxheti i planifikuar				Trendet e rritjes/zvogëlimit			
	2020	2021	2022	2023	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2020-2023
Rroga dhe paga	1,584,776.7	1,645,045.1 1	1,782,139.5 8	2,065,494.32	-60,278.41	-137,094.47	-283,354.74	-480,727.62
Mallëra dhe shërbime	436,366.99	355,065.39	410,759.93	477,585.94	81,301.6	-55,694.54	-66,826.01	-41,218.95
Shpenzime komunale	62,000.00	65,100.00	67,700.00	96,500.00	-3,100.00	-2,600.00	-28,800.00	-34,500.00
Subvencione dhe transfere	161,240.87	80,290.00	87,000.00	101,033.00	80,950.87	-6,710.00	-14,033.00	-60,207.87
Shpenzime kapitale	1,033,093.21	533,593.31	650,269.78	1,512,194.00	499,499.9	-116,676.47	-861,925.07	-479,101.64
Gjithsej	3,277,467.77	2,679,093.8 1	2,997,869.2 9	4,252,808.11	593,373.96	-318,775.48	-1,254,938.82	-975,340.34

Tabela 40. Trendet e rritjes/zvogëlimit të Buxhetit të planifikuar komunal 2020 - 2023

Sa i përket strukturës së të hyrave, pjesa më e madhe e buxhetit komunal realizohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës apo Grantet Qeveritare. Gjatë periudhës 2020-2023, afërsisht 88% të buxhetit komunal është realizuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), 12.23% nga Të Hyrat Vetanake (THV), dhe 10.23% është rritur buxheti nga donatorët apo pranime tjera.

Të hyrat vetanake (THV) – viteve të fundit ne përgjithësi THV kanë pasur trend të rritjes vazhdimisht. Viti 2023 është viti me inkasimin më të lartë ku të hyrat komunale janë inkasuar në shumën prej 358,141.65 Euro. Në vitin 2020 të hyrat e inkasuara kishin shumën prej 230,238.85, duke vazhduar me trend të rritjes në vitet e ardhshme, ku në vitin 2021 shuma e inkasuar ishte 38% më shumë dhe në vitin 2022 për 5% më shumë se viti 2022.

Trendet e inkasimit të të hyrave								
Kategoria e të hyrave vetanake	Të hyrat				Trendet e rritjes/zvogëlimit			
	2020	2021	2022	2023	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2020-2023
Tatimi në pronë	97,071.13	139,134.35	163,301.29	160,834.64	-42,063.22	-24166.94	2,466.65	-63,763.51
Regjistrimi i automjeteve	17,480.00	19,350.50	19,890.00	21,471.00	-1,870.50	-539.5	-1,581.00	-3,991.00
Lejet e ndërtimit	12,209.76	10,317.43	2,717.98	25,834.88	1,892.33	7599.45	-23,116.90	-13,625.12
Regjistrimi i trashëgimisë	-	-	-	-	-	-	-	-
Ndërrim i destinimit të tokës	475.00	623.22	187.50	775.00	-148.22	435.72	-587.50	-300.00
Dokumentet e gjendjes civile	4,830.00	6,847.00	8,206.00	7,211.50	-2,017.00	-1359	994.50	-2,381.50
Veprimtaritë afariste	59,524.99	75,783.89	71,127.28	78,097.44	-16,258.90	4656.61	-6,970.16	-18,572.45
Shfrytëzimi i pronës publike	6,197.98	5,920.82	4,943.90	4,912.96	277.16	976.92	30.94	1,285.02
Participimet në arsim dhe shëndetësi	7,434.00	18,850.30	16,819.90	21,050.30	-11,416.30	2030.4	-4,230.40	-13,616.30
Tjera	25,015.99	39,829.89	46,807.82	37,953.93	-14,813.90	-6977.93	8,853.89	-12,937.94
Gjithsej	230,238.85	316,657.40	334,001.67	358,141.65	-86,418.55	-17,344.27	-24,139.98	-127,902.80

Tabela 41. Trendi i inkasimit për periudhën 2020 - 2023

Sipas strukturës së THV, gjatë periudhës 2020-2023 më së shumti të ardhura janë realizuar nga Tatimi në Pronë – 42% deri 49% të gjithsej THVK, duke u pasuar nga veprimtaritë afariste me deri në 26%, regjistrimi i automjeteve deri në 8%, dokumente të gjendjes civile deri në 2.0%, ndërrimi i destinimit të tokës kryesisht me 0.2%, dhe të hyra tjera prej 21% deri në 25%.

Shpenzimet – rreth 58% nga buxheti total prej 2,744,083 Euro është shpenzuar në paga dhe mëditje, duke e pasur parasysh kontingjentin e të punësuarve në sektorin publik, sidomos në arsim dhe shëndetësi. Mesatarisht gjatë periudhës 2020-2023, përafërsisht 58% të buxhetit komunal është shpenzuar për paga dhe mëditje. Investimet kapitale përbëjnë shpenzimin e dytë më të madh gjatë kësaj periudhe me 23% e gjithsej buxhetit vjetor. Shpenzimet tjera gjatë kësaj periudhe janë mallra dhe shërbime me 13.5%, shpenzime komunale me 2.4%, transfere dhe subvencione me 3.4%.

Buxheti i shpenzuar								
Kategoria ekonomike	Buxheti i planifikuar				Trendet e rritjes/zvogëlimit			
	2020	2021	2022	2023	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2020-2023
Rroga dhe paga	1,577,266.70	1,645,045.11	1,694,967.79	1,987,398.32	-67,778.41	-49,922.68	-292,430.53	410,131.62
Mallëra dhe shërbime	382,355.03	348,741.08	396,616.33	472,647.31	33,613.95	-47,875.25	-76,030.98	-90,292.28
Shpenzime komunale	61,959.21	64,899.87	67,684.20	88,797.56	-2,940.66	-2,784.33	-21,113.36	-26,838.35
Subvencione dhe	155,945.50	72,465.00	85,967.00	86,955.42	83,480.50	-13,502.00	-988.42	68,990.08

transfere								
Shpenzime kapitale	909,685.26	503,312.41	458,992.20	818,083.65	406,372.85	44,320.21	-359,091.45	91,601.61
Gjithsej	3,087,211.70	2,634,463.47	2,704,227.52	3,453,882.26	452,748.23	-69,764.05	-749,654.74	- 366,670.56

Investimet kapitale – investimet kapitale gjatë periudhës 2020-2023 janë karakterizuar me trend të rritjes dhe zvogëlimit. Në vitin 2020 vlera e investimeve kapitale ishte më e larta shuma e së cilës ishte 1,338,767.26 Euro (43% të buxhetit komunal), ndërsa në vitin 2021 vlera e shpenzimeve në investimet kapitale ishte zvogëluar në 474,921.41 Euro (18% të buxhetit komunal). Në vitin 2022 vlera e investimeve kapitale ishte përafërsisht e njëjtë me atë të vitit 2021 që ishte 458,992.20 Euro (17% të buxhetit komunal), ndërsa në vitin 2023 vlera e shpenzimeve ishte rritur në 818,083.00 (24% e buxhetit komunal).

Trendi i shpenzimeve kapitale								
Kategoria ekonomike	Buxheti i planifikuar				Trendet e rritjes/zvogëlimit			
	2020	2021	2022	2023	2020-2021	2021-2022	2022-2023	2020-2023
Infrastrukturë sociale e publike	351,990.54	101,722.46	75,358.57	149,541.07	250,268.08	26,363.89	-74,182.50	202,449.47
Planifikim urban dhe mjedis	948,757.44	183,744.10	295,932.46	603,727.85	765,013.34	-26,363.89	-307,795.39	345,029.59
Infrastrukturë teknike e transportuese	38,019.28	189,454.85	87,701.17	64,814.08	-151,435.57	101,753.68	22,887.09	-26,794.80
Gjithsej	1,338,767.26	474,921.41	458,992.20	818,083.0	863,845.85	15,929.21	-359,090.8	520,684.26

Tabela 42. Trendi i shpenzimeve kapitale për periudhën 2020 - 2023

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) – përfshinë periudhën 2024-2026. Sipas kësaj kornize të miratuar, parashihet një rritje e buxheti vjetor komunal nga 3,349,714.00 Euro sa është për vitin 2023, në 3,349,278.00 Euro për vitin 2024, në vitin 2025 3,521,381.29 Euro dhe në vitin 2026 3,693,420.00 Euro. Bazuar në këto të dhëna buxheti i komunës do të shënoj trende të rritjes përpos buxheti i vitit 2024 parashihet të ketë një rënie prej 1.30% në raport me vitin 2023, ndërsa për vitet 2025 dhe 2026 do të ketë trend të rritjes për rreth 5%. Ndërsa për investime kapitale kjo rritje do të jetë 17% për vitin 2024 dhe 20% për vitet 2025 dhe 2026.

Për pjesët që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e komunës, struktura e shpenzimeve nga buxheti i vitit 2024 përmban pjesëmarrje të investimeve kapitale me 576,278.00 (17%) dhe të subvencioneve/transferove me 113,000.00 Euro (3.3%). Linjat tjera janë paga dhe mëditje me 2,042,000.00 Euro (61%) dhe mallra/ shërbime me shpenzime komunale prej 524,500.00 Euro (16%).

Spektori privat dhe komuniteti – deri më tani nuk ka pasur bashkëpjesëmarrje në investime publike nga sektori privat, qoftë me mjete financiare, mjete/pajisje, apo kapacitete njerëzore. Sa i përket pjesëmarrjes së komunitetit dhe shoqërisë civile, bashkëfinancimet kanë qenë simbolike, mirëpo viteve të fundit, me rritjen e të hyrave nga BKK, nuk ka pasur bashkëfinancime të tilla.

Është me rëndësi të ceket se në lidhje me pjesëmarrjen e komunitetit, Asambleja Komunale në shtator 2014 ka miratuar vendimin i cili i përcakton nivelet e bashkëfinancimit nga qytetarët, në varësi të vlerës së investimit. Ky vendim mund të japë indikacione se mund të parashihet bashkëpjesëmarrje potenciale e qytetarëve në investime publike në të ardhmen.

8 Vlerësimi i gjendjes

8.1 Konstatime gjeografike dhe mjedisore

8.1.4 Konstatime gjeografike

Komuna e Hanit të Elezit karakterizohet me tërësi morfologjike kodrinore malore e malore dhe me pjesë fushore përgjatë rrjedhave ujore. Në perëndim dhe jugperëndim të saj shtrihen Malet e Sharrit dhe Jezercit dhe malet e Karadakut në pjesën lindore dhe verilindore. Ndërsa, pjesa fushore shtrihet përgjatë lumit Lepenc dhe përrenjve të saj.

Pjesa më e madhe e territorit të komunës shtrihet në lartësi mbidetare 500-700 m (vendbanimet Gorancë, Seçishtë, Rezhancë, Pustenik, Paldenicë dhe Dimcë, pjesa tjetër e vendbanimeve si Krivenik, Dremjak dhe Niçevc shtrihen në lartësi mbidetare prej 700 – 1000 m, ndërsa qyteza e Hanit të Elezit dhe një pjesë e vendbanimeve në afërsi të saj shtrihen në lartësi më të ulët mbidetare prej 400-500 m. Poashtu disa vendbanime shtrihen edhe në lartësi mbidetare 1000 – 1500 m. Karakteristikë që gjatë planifikimit do të duhet të merret në konsideratë për përcaktimin e llojit të shfrytëzimit, kushteve të ndërtimit, etj⁴².

Sa i përket strukturës pedologjike të tokës, pjesa jugore dhe lindore e komunës karakterizohet nga tipi i tokave rendzina, ndërsa ajo veriore dhe perëndimore nga tipi i tokave pseudoglej⁴³. Toka rendzina ka cilësi më të mira dhe është më pjellore në krahasim tokën pseudoglej që është më pak cilësore dhe pjellore. Toka bujqësore sipas bonitetit kryesisht i përket klasit 5 – 8.

Komuna dominohet nga shkëmbinjtë ultrabazik që shtrihen në pjesën më të madhe të Gorancës dhe në një pjesë të Pustenikut, Krivenikut, Rezhancës dhe Niçevcit, shkëmbinjtë kretakut të sipërm dhe kuaternarit që shtrihen në pjesën qendrore si Krivenik, Pustenik, Rezhancë dhe Seçishtë. Pjesa qytezës dhe zona përreth tij dhe një pjesë e vogël në veri-perëndim dominohet nga shkëmbinjtë e mermerit, ndërsa një pjesë e territorit në veriperëndim përkatësisht vendbanimi Dremjak përbëhet nga shkëmbinjtë paleziok⁴⁴.

Komuna ka pozitë të mirë gjeografike pasi kufizohet me Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke e bërë një pikë kyçe për rajonin dhe Kosovën. Përmes territorit të saj kalojnë rrugët me rëndësi si Autoudha „Arbë Xhaferi” (R6), rruga nacionale N2 Prishtinë – Shkup dhe linja kryesore hekurudhore e Kosovës Fushë Kosovë – Shkup. Pozita e saj dhe lidhja e mirë me arteriet kyçe nacionale ofrojnë mundësi për zhvillimin ekonomik të komunës.

Klima është e ndryshueshme mesdhetare, me dimër të ashpër me temperatura minimale nga -10°C deri 50°C, dhe verë të nxehtë me temperatura maksimale që arrijnë 40°C. Territori karakterizohet me reshje të dobëta me një mesatare prej 500ml/m², të cilat gjatë verës dobësohen më shumë kurse në dhjetor dhe janar kanë intensitet më të lartë.

Nëpër territorin e komunës së Hanit të Elezit rrjedhin lumenjtë dhe projet të cilat derdhen në pellgun e Detit Egje. Nëpër territorin e saj kalon lumi Lepenc dhe përrejt që kalojnë në anën perëndimore dhe lindore të luginës së tij. Tre përrenjtë kryesorë janë ai i Laçit/Kotlinës, Rezhancës dhe Dimcës, ndërsa ata më të vegjël janë përroi i Kallugjeres në Gorancë, Krivenikut, Konopit, etj. Në komunë gjendet edhe burimi i ujit të thartë në vendin e ashtuquajtur Uji i Thartë, që ndodhet në afërsi me rrugën nacionale N2. Komuna është e pasur me burime të ujerave sipërfaqësore që ekzistojnë në pothuajse të gjitha vendbanimet. Mirëpo, nuk ka mjaftueshëm ujëra nëntokësore. Këto burime gjatë sezonit të verës shteren dhe që ndikon në sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm për ujë të pijshëm gjatë gjithë vitit për të gjithë popullsinë e komunës.

3.1.2 Konstatime mjedisore

⁴² Burimi: Plani lokal i veprimit në mjedis për komunën e Hanit të Elezit 2021-2026, fq. 15

⁴³ Burimi: Plani lokal i veprimit në mjedis për komunën e Hanit të Elezit 2021-2026, fq. 16

⁴⁴ Burimi: Plani lokal i veprimit në mjedis për komunën e Hanit të Elezit 2021-2026, fq. 18

Si vend malor komuna ka një biodiversitet të pasur me kafshë të rralla dhe të rrezikuara ku perfishihen ariu i murrmë, derri i egër, ujku, kaprolli lepuri, gjarpër, breshka, ketri dhe shpendët si shqiponja e malit, thëllëza e malit, skifteri kthetrabardhë, bufi, shkaba, korbi, laraska, etj. Në lumin Lepec rritet trofta dhe krapit. Komuna poashtu ka një florë të pasur me lloje të ndryshme të bimëve. Pjesa më e madhe e zonave mbi brezin pyjor mbulohet nga kullota malore, bimësia e tokave shkëmbore-gëlqeror dhe shkëmbore – silikate, nga bimët e lëndinave, vegjetacioni i tokave të lagështa që ndodhen lart në male dhe nga vegjetacioni rrafshnaltave me bari. Në këto sipërfaqe rriten edhe bimët si kantarioni, kamomili, dredhëza, etj.

Në pjesët kodrinore mbizotërojnë pyjet gjetherënese si ahu, qarri, bungu, shkoza dhe më rrallë bliri, frashëri, thana, murrizi, kaça, kulumbara etj. Ndërsa, pyjet gjethembajtëse shtrihen në dy sipërfaqe të ndara (në Sharr/Gorancë dhe në Karadak / Neçavc). Në sipërfaqet përgjatë lumit Lepenc rriten shelgu, verri dhe gështenja e egër. Gjithashtu, shtrihen edhe formacionet e livadheve si tërfili dhe shkurret. Në Gorancë gjendet një bimë e llojit me karakter endmeku e quajtu Dredhja e Kosovë.

Komuna e Hanit të Elezit rrezikohet nga ndotja e mjedisit dhe cënohet nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera. Ndotja e mjedisit shkaktohet si pasojë e shumë faktorëve si industria, transporti, rrugët e pashtruara, mbeturinat, ujërat e ndotura, prerjet e pyjeve, përdorimi i drunjëve për djegje, ndërtimet e pakontrolluara, etj. Përpos ndotjes mjedisi i saj rrezikohet edhe nga ndikimi i fatkeqësive natyrore, si rezultat i faktorëve të shkakuar nga aktivitetet e pakontrolluara dhe faktori natyror, intensiteti i shfaqjes të të cilëve do të shtohet gjinjë e më tepër për shkak të ndryshimeve klimatike. Fatkeqësitë që shkaktojnë dhe do të mund të shkaktojnë dëme në të ardhmen janë tërmeti, vërshimet, erozioni, rrëshqitjet e dheut dhe të tjerat me intensitet më të ulët. Faktorët të cilët ndikojnë në shfaqjen e tyre janë intensiteti i reshjeve, prerjet e pyjeve, ndërtimet përgjatë brigjeve të lumenjve/përrockave, mos rregullimi i shtretërve të lumenjve, mbeturinat, ujërat e ndotura, etj.

Për të patur një zhvillim të qëndrueshëm, një nga prioritetet e PZHK-së sa i përket mjedisit do të duhet të ishte trajtimi i këtyre sfidave dhe ofrimi i masave adekuate për parandalimin apo zbutjen e ndotjes së mjedisit dhe dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.

Prandaj, për mbrojtjen nga ndotja e elementeve të lartëpërmendura komuna do të duhet të ndërmer masa si pyllëzimi, përdoren karburantet e pastra, shtrohen dhe rehabilitohen rrugët motorike dhe jomotorike si dhe promovohet përdorimi i mjeteve jomotorrike, shtohen hapësira të gjelbra dhe breza të gjelbra, promovohet përdorimi i burimeve të ripërtërishme si nga industria ashtu dhe nga institucionet, bizneset e ekonomitë familjare, aplikohen teknologjitë e pastra mjedisore.

Poashtu, prioritet tjetër i PZHK-së është sigurimi që qytetarët dhe të mirat e tyre do të mbrohen nga rreziku i shkakuar nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, kjo do të mund të arrihet përmes ndërmarrjes së masave parandaluese apo zbutëse si rregullimi i shtretërve të lumenjve/përrockave, pyllëzimi, kontrollimi i zhvillimeve përgjatë lumenjve dhe zonave të rrezikuara nga erozioni apo rrëshqitjet e dheut dhe sigurimi që përputhen me kushtet e përcaktuara me PZHK dhe ligjet apo aktet nënligjore në fuqi, sigurimi që ndërtesat dhe strukturat janë në përputhje me kushtet e përcaktuara me PZHK që të jenë të përballueshme ndaj fatkeqësive, etj, në këtë aspekt rol të rëndësishëm luan edhe ndërgjegjësimi i qytetarëve.

8.2 Popullsia, gjithëpërfshirja në vendimarrje

Projeksioni demografik për Komunën -Me qëllim të përcaktimit të nevojave zhvillimore dhe adresimit adekuat të tyre, si parakusht na paraqitet projeksioni demografik. Duke e pasur parasysh se dinamikat e zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale gjatë viteve '90 patën ndikim të madh në ndryshimet demografike, është vështirë të përcaktohen trendet nga kjo periudhë. Andaj do të merren parasysh të dhënat prej vitit 2011-2024.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), si organ i vetëm kompetent, bën projeksione demografike vetëm për nivelin e Kosovës dhe atë për tre variante (rritje e ulët, e mesme dhe e lartë), përderisa në nivel komunal bërë vlerësime të popullsisë.

Për të përcaktuar projeksione më të sakta të popullsisë, është analizuar numri i popullsisë për 12 vite (burimi: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2023). Në tabelën vijuese vërehet se Hani i Elezit në vitin 2011 kishte 9,514 banorë, në vitin 2012 i kishte 9,567 banorë pra ka një rritje rreth 1.79%. Në vitin 2013 kishte 9,613 banorë, ndërsa në vitin 2014 kishte 9,759 banorë, ku vërehet përsëri një shtim prej 146 banorëve. Në çdo vit pasues është vërejtur një shtim i lehtë, ku në vitin 2022 vlerësohet të ketë 10,155 banorë. Megjithatë nga të dhënat nga regjistrimi i vitit 2024 vërehet zvogëlim i konsiderueshëm i numrit të popullsisë në 8,533 banorë.

Numri i Popullsisë sipas viteve													
Vitet	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2024
Hani i Elezit	9,403	9,567	9,613	9,759	9,830	9,922	9,998	9,985	10,013	10,090	10,111	10,155	8,533

Tabela 43. Numri i popullsisë sipas viteve

Bazuar në vlerësimin e popullsisë për 12 vite, komuna e Hanit të Elezit kishte shtim të popullsisë për 752 banorë. Ky vlerësim është bërë duke marrë parasysh shtimin natyror dhe migrimin⁴⁵. Sipas vlerësimeve vjetore të popullsisë, trendi i migrimit është më i lartë në 4-5 vitet e fundit dhe kjo e ka ulur ndjeshëm ritmin mesatar të rritjes. Bazuar në projeksionet demografike në nivel vendi ky trend i migrimit do të ulet dhe do të jetë i një-trajtshëm në vitet në vijim (varianti me rritje mesatare)⁴⁶.

Mirëpo, regjistrimi i vitit 2024 tregoi që komuna ka pësuar zvogëlim të numrit të popullsisë dhe nëse krahasohet me numrin e popullsisë në vitin 2011 për 870 banorë më pak (9.2%).

Për të evidentuar nevojat specifike të grup-moshave të ndryshme, parashikuar fuqinë punëtore, identifikuar trendet e plakjes dhe popullsinë e re që kanë ndikim në shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale etj janë analizuar grup-moshat e popullsisë në komunën e Hanit të Elezit. Tabela vijuese përmbledh numrin e banorëve sipas grup-moshave të ndryshme. Në këtë tabelë vërehet se numri më i madh i banorëve është në mesin e grupmoshës prej 0 deri në 34 vjet, pastaj numri fillon të zvogëlohet. Një numër shumë i vogël vërehet në mesin e grup-moshës 70 deri në 79 vjet dhe mbi 80 vjet.

Popullsia e Hanit të Elezit sipas grup-moshëve																		
Moshë	0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+	Tot.
Numri	638	727	721	686	670	642	579	558	607	520	531	527	396	310	184	151	65	8,533

Tabela 44. Popullsia e Hanit të Elezit sipas grupmoshave, regjistrimi i popullsisë 2024

Për më tepër duhet theksuar se analiza e grup-moshave është një instrument thelbësor për të informuar vendimmarrjen në nivele të ndryshme dhe për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm në komunë.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, në komunën e Hanit të Elezit gjithsej janë 1,742 ekonomi familjare dhe 2,193 banesa të zakonshme. Nga numri total i banesave të shfrytëzuara janë 1,914 dhe 279 janë të pashfrytëzuara. Këto të dhëna ndihmojnë të hartohen politika për mbështetje të banimit për komunën e Hanit të Elezit dhe llogaritjen e të ardhurat nga taksat në të ardhmen.

⁴⁵Burimi: ASK, Vlerësimi i popullsisë 2021 <https://ask.rks-gov.net/media/6873/vlersimi-i-popullesise-ne-kosove-2021-final.pdf>

⁴⁶Burimi: ASK, Parashikimi i popullsisë 2011-2061, <https://ask.rks-gov.net/media/1610/parashikimi-i-popullsis%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2011-2061.pdf>

Banesa të zakonshme për banim			
Komuna	Numri i banesave të zakonshme (gjithsej)	Numri i banesave të zakonshme (të sfhrytëzuara)	Numri i banesave të zakonshme (të zbrazëta)
Hani i Elezit	2.193	1,914	279

Tabela 45. Banesat në komunë

Sa i përket, numrit të banorëve jo rezident në vitin 2024 vlerësohet të jetë rreth 1,238⁴⁷, pasi që nuk ka ende të dhëna për këtë kategori nga Regjistrimi i vitit 2024.

Në bazë të të dhënave të ASK-së për shtimin natyror dhe migrimet në komunë dhe me përdorimin e formulave adekuate, është kalkuluar numri i popullsisë për komunë dhe për secilin vendbanim për vitin 2033 e që është rreth 8,260 banorë dhe 2,359 ekonomi familjare (shih Tabela 29. Projektionet e popullsisë). Koeficienti i rritjes së popullsisë për periudhën 2025 – 2033 është rreth 0.7% në vit, që paraqet një rritje mesatare në vit. Mirëpo, të dhënat nga regjistrimi i vitit 2024 (ASK) tregojnë që popullsia e komunës është zvogëluar për 9% në krahasim me atë të vitit 2011, gjë që është një tregues që popullsia e komunës po migron për kushte më të mira jetësore, andaj nisur nga fakti që në komunë mbizotëron grupmosha e re, për të ndaluar këtë dukuri negative komuna duhet të zhvilloj strategji ekonomike, sociale, mjedisore, etj, në përputhje me kërkesat e nevojat e kësaj grupmoshe ashtu që ta motivojë të qëndrojë dhe kontribuojë në komunë. Parashikohet që në vitin 2033 numri i banorëve jo – rezident të jetë rreth 1,859.

Projektionet e popullsisë				
Nr	Vendbanimi	Regjistrim 2011	Regjistrimi 2024	Projeksion 2033
1	Hani i Elezit	2,533	2,555	2,555
2	Paldenicë	1,723	1,629	1,629
3	Gorancë	1,028	767	637
4	Seçishtë	2,252	2,123	2,123
5	Pustenik	629	403	322
6	Rezhancë	475	487	487
7	Krivenik	283	204	169
8	Dimcë	249	147	138
9	Drëmjak	121	108	100
10	Neçavc	110	102	97
11	Vërtomicë	0	8	4
Total		9,403	8,533	8,262

Tabela 29 Projektionet e popullsisë

Bazuar në trendin e zhvillimeve brenda periudhës 2011 – 2024, vërehet që në të gjitha vendbanimet ka pasur zvogëlim të numrit të banorëve përpos në zonën urbane që është rritur. Poashtu, Regjistrimi i popullsisë 2024 tregon tendencën e zvogëlimit të anëtarëve brenda ekonomive familjare, prandaj në kuadër të zhvillimeve (banim apo çfarëdo zhvillimi) do të merren parasysh edhe zvogëlimi i planifikuar i numrit të anëtarëve për familje (synim mesatar prej 3.5 anëtarë/ ekonomisë familjare) dhe banorët jo rezident (kryesisht në diasporë) që tashmë janë shtuar nga viti 2011 dhe priten të shtohen edhe më tej. Përcaktimi i numrit të ekonomive familjare për secilin vendbanim për vitin 2024 është bazuar në llogaritjet që janë bërë ku për bazë janë marrë të dhënat nga regjistrimi i vitit 2011 dhe të vitit 2024, me ç'rast madhësia mesatare e ekonomisë familjare është llogaritur të jetë rreth 5 anëtarë në familje, ndërsa për projeksione për vitin 2033 është marrë synimi për zvogëlim të ekonomisë familjare në 3 - 4 anëtarë, pasi që bazuar në të dhënat nga regjistrimi i 2024

⁴⁷ Vlerësim sipas të dhënave për migrimin ndërkombëtar dhe kombëtar në Vlerësimet e ASK-së për popullsinë (2012 deri 2023)

ekonomitë familjare me më pak anëtarë kanë pasur trendin e lartë të rritjes në krahasim me vitin 2011.

Projeksionet e ekonomive familjare				
Nr	Vendbanimi	Regjistrim 2011 ⁴⁸	Regjistrim 2024	Projeksion 2033
1	Hani i Elezit	430	521	730
2	Paldenicë	265	332	465
3	Gorancë	136	157	182
4	Seçishtë	340	433	607
5	Pustenik	89	82	92
6	Rezhancë	79	99	139
7	Krivenik	42	42	48
8	Dimcë	37	30	39
9	Drëmjak	18	22	29
10	Neçavc	16	21	28
11	Vërtomicë	0	2	1
Total		1,452	1,742	2,360

Përderisa, numri i ekonomive familjare që ndodhen jashtë komunës është vlerësuar të jetë rreth 400 në vitin 2024, ndërsa në vitin 2033 rreth 550 me nga 3 – 4 anëtarë. Komuna do të përcjellë situatën rreth shtimit të popullsisë për çdo vit dhe do të veprojë përkitazi.

Analiza SWOT

Përparësitë - Popullsi me moshë mesatare të re dhe me moshë ekonomiksht aktive (15-65 vjeç); - Popullsi relativisht mirë e arsimuar; - Publiku dhe palët e interesit të konsultuara kryesisht për projeksionet afatmesme të buxhetit, punët e Kryetarit dhe projektet e mëdha zhvillimore; - Shërbime kualitative dhe të larmishme sociale (kryesisht arsim, shëndetësi, kulturë/ sport) që kanë rritur atraktivitetin që rinia të mos migrojë; - Imazh shumë pozitiv i Komunës në Kosovë dhe rajon në kontekstin social, ekonomik dhe të administrimit	Dobësitë - Shkallë e lartë e papunësisë; - Shkallë e lartë e varfërisë; - Perceptimi i të tjerëve për Komunën si vend i ndotur; - Migrimi i banorëve nga komuna; - Rënja e trendit të rritjes së popullsisë; - Shkallë jo e kënaqshme e vendimmarrjes së bashku me publikun dhe palët tjera të interesit për zhvillimet madhore në vend duke përfshirë edhe zhvillimet mjedisore; -
Mundësitë - Zhvillime serioze ekonomiko-sociale që mund ta rrisin edhe më tej atraktivitetin Komunës; - Mbështetja e NVM-vë; - Dërgesat e bashkatdhetarëve (remitancat); - Bashkëpunime me organizata dhe OJQ për studime/ plane të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje;	Rreziqet - Ngadalësimi i zhvillimit ekonomik i “ndihmuar” edhe nga pasojat e Covid-19; - Dukuritë negative në shoqëri; - Vazhdimi i trendit të largimit të popullsisë ekonomiksht aktive jashtë vendit, duke përfshirë edhe të kualifikuarit; - Migrimet selektive-deformim i strukturës gjinore;

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

⁴⁸Burimi: ASK, REKOS, 2011

- Rritja e nivelit të punësimit;
- Ulja e varfërisë;
- Përfshirja më e madhe e të rinjve në sferën socio-kulturore;
- Përfshirja më e lartë e publikut dhe palëve të interesit në vendimmarrje;

Nevojat zhvillimore

- Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe aftësimi sipas kërkesave në tregun e punës;
- Përkrahja e të rinjve dhe femrave në zhvillimin e aftësive për punësim;
- Adaptimi i kurrikulave arsimore sipas potencialeve zhvillimore lokale (në bashkëpunim edhe me komunat fqinje);
- Zhvillimi i programeve për punësim, duke u bazuar në potencialet lokale;
- Zgjerimi i aranzhmanit socio-kulturor për të rinjtë;
- Hartimi i planeve për përfshirje të publikut në zhvillime lokale;

3.2 Ekonomia

Komuna e Hanit të Elezit me industrinë e materialeve ndërtimore, praninë e terminalit doganor, atraksionet në Pustenic, Gorancë, Neçavc, Vërtomicë dhe Dërmjak kanë potencial për zhvillim ekonomik. Sipas informatave nga komuna e Hanit të Elezit, numri i ndërmarrjeve private në vitin 2020 ka qenë 49, në 2021 ka qenë 31, në 2022 ka qenë 43 dhe në 2023 ka qenë 33. Këto të dhëna tregojnë që ekonomia ka pasur një zvogëlim të lehtë sepse janë mbyllur 16 ndërmarrje private nga viti 2020. Shumica e ndërmarrjeve janë me tregëti me shumicë dhe pakicë, pastaj vjen industria përpunuese, transporti, akomodimi etj.

Pas qendrës - Hanit të Elezit, Seçishta dhe Paldenica kanë numër më të madh të ndërmarrjeve private në krahasim me vendbanimet tjera. Përkundër zhvillimit jo të kënaqshëm ekonomik, Hani i Elezit me pozitën e saj gjeografike ofron mundësi për burime tjera të ardhurave që mund të vijnë nga bujqësia dhe aktivitetet bujqësore (perimekulturës, pemëtarisë, frutave të malit, bletarisë dhe blegtorisë). Prandaj, është shumë me rëndësi që komuna të konsiderojë zbatimin e metodave të qëndrueshme dhe të avancuara të kultivimit, përdorimin e teknologjive të reja, identifikimin e mundësive të reja të tregut dhe përf forcimin e lidhjeve tregtare që mund të sjellë kërkesë më të lartë për produktet bujqësore, trajnim për fermerët, krijimi i kooperativave bujqësore, etj

Komuna e ka të zhvilluar industrinë e materialeve ndërtimore, prandaj medoemos duhet të konsiderojë investimin në kërkim dhe zhvillim të materialeve të reja, të qëndrueshme dhe me performancë të lartë që mund të rrisë konkurrencën dhe të tërheqë investitorë. Për më tepër duhet konsideruar ofrimin e trajnimeve dhe edukimit për punonjësit në sektorin e ndërtimit dhe prodhimit të materialeve që ndihmon në rritjen e produktivitetit dhe cilësisë. Gjithsesi është i rëndësishëm edhe promovimi i produkteve dhe shërbimeve, ofrimi i mbështetjes financiare dhe këshillimit për SME-të në sektorin e materialeve ndërtimore mund të nxisë rritjen ekonomike.

Gjithashtu, identifikimi i zonave me potencial të prodhimit të energjisë nga dielli dhe era dhe interesimi i investitorëve për zhvillimin e kësaj fushe edhe në komunën e Hanit të Elezit, është një tregues që në të ardhmen duhet konsideruar përgaditjen e kuadrove për këtë sektor.

Për shkak të peisazhit të jashtëzakonshëm, vendbanimet me numër të vogël të banorëve apo edhe të depopulluara Dremjak, Vërtomicë, Neçavc, Dimcë dhe Krivnik do të mund të ringjallen përmes zhvillimit të turizmit malor, gjë që do të ndihmonte zhvillimin ekonomik të kësaj zone dhe inkurajonte kthimin e banorëve. Mirëpo, në këto zona janë të pranishme prerjet ilegale të pyjeve dhe për të zhvilluar turizmin malor kjo dukuri negative duhet të merret nën kontroll nga autoritetet

përgegjëse. Pothuajse të gjitha këto vendbanime karakterizohen me mungesë të infrastrukturës teknike si ujësjellësit, kanalizimit dhe grumbullimit të mbeturinave si dhe me infrastrukturë rrugore jo adekuate. Prandaj për të zhvilluar turizmin duhet të sigurohet infrastruktura teknike si dhe përmirësohet ajo rrugore me theks në transportin e pamotorizuar.

Përparësia më e madhe tek Hani e Elezit qëndron tek prezenca e fuqisë punëtore, pra të grup moshave që janë të aftë për punë. Sipas statistikave numri më i madh i banorëve është në grup moshat prej 20 deri në 40 vjet, potencial që mund të shfrytëzohet për zhvillim ekonomik. Për të rritur produktivitetin në fusha të ndryshme, duhet të ofrohen mundësitë për arsimim për grup moshat 20-30 vjet.

Sfidat ekonomike aktuale mund të tejkalohen përmes fuqizimit të bizneseve të vogla dhe të mesme, promovimit të turizmit malor, nxitja e shkëmbimit kulturor (festivalet), investimeve në trajnime dhe edukim, si dhe bashkëpunimi dhe partneriteti. Gjatë investimeve të ndryshme është me rëndësi të konsiderohet partneriteti publiko-privat. Sidoqoftë përmes përpjekjeve nga qeveria, organizatat ndërkombëtare dhe lokale si dhe me përkushtim të komunitetit lokal, Hani i Elezit mund të shndërrohen në qendër më të gjallë duke krijuar mundësi të qëndrueshme ekonomike.

Për më tepër, Raporti i VSM-së thekson se Hani i Elezit është komunë me një bujqësi të zhvilluar sidomos lider për hortikulturë dhe pylltari mjaft të zhvilluar. Gjithashtu theksohet se komuna është në avantazh për shkak të pozitës së saj që ka si zonë kufitare. Të gjitha të dhënat nga ky dokument dhe gjetjet e laetëpërmendura janë konsideruar për analiza vijuese dhe hartim të fazave të ardhshme të PZHK-së.

Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
- Industri e zhvilluar e materialeve ndërtimore (prodhuesi i vetëm i çimentos në Kosovë, prodhim i rërës dhe zhavorrit, dhe prodhim i stiroporit); - Ekzistenca e terminalit doganor; - Hotelieri me zhvillim mesatar (restorantet dhe kafenetë); - Turizëm malor/ kulturo-historik në fillet e zhvillimit të tij (pikat atraktive në Pustenik, Gorancë, Neçavc dhe Dërmjak); - Bujqësi në fillet e zhvillimit të saj (raste të pakta të perimekulturës, pemëtarisë, frutave të malit, bletarisë dhe blegtorisë); - Pyje të reja në zhvillim e sipër; - Qasje e mirë në infrastrukturën e transportit rrugor dhe hekurudhor (infrastrukturë rrugore e mirë dhe funksionale)	- Ballafaqimi me mungesën e lëndës së parë të çimentos në të ardhmen e mesme; - Kufizimi i shërbimeve në terminalin doganor; - Dëmtim i infrastrukturës rrugore nga industria; - Shfrytëzim jo i duhur i resurseve natyrore në raste të caktuara (prerja e pakontrolluar e pyjeve, gurëthyes që degradojnë mjedisin, hidrocentralet e planifikuara që dëmtojnë mjedisin dhe dëmtojnë shancin për turizëm); - Vështirësi e zhvillimit të industrisë së trashëguar si pasojë e privatizimit të asocuar me probleme (industria e çimentos dhe stiroporit); - Mungesa e zonës ekonomike/ industriale; - Shfrytëzimi jo i mjaftueshëm i potencialit bujqësor si pasojë e dëmtimit/ uzurpimit të tokës bujqësore, parcelizimit të skajshëm të saj, çështjeve të pazgjidhura pronësore, subvencioneve të limituara, mos-rregullimit të tregut të produkteve bujqësore, mos-vullnetit për tu marrë me bujqësi, etj.;

	- Infrastrukturë turistike me zhvillim nën mesatare; - Tregti që nuk plotëson nevojat e Komunës me përjashtim të asaj ushqimore dhe ndërtimore; - Mungesë e kuadrove profesionale të nevojshme për ekonomi; -
Mundësitë - Resurse atraktive natyrore (pyjet, ujërat, guri gëlqeror, etj.); - Resurse humane prezentë kryesisht të moshës së re; - Sipërfaqe bujqësore që mund të shfrytëzohen më mirë (rreth Lepencit, Krivenik, kullosat në Sharr, etj.); - Parakushte për zhvillim të turizmit (trashëgimia natyrore, kulturore dhe historike); - Bashkëpunimi me qeverinë qendrore për krijimin e depove doganore; - Grantet nga qeveria dhe donacionet për stimulimin e bizneseve me theks në ato start-up, bujqësore, turistike, zejtare, që punësojnë qytetarë, etj., (grante/ subvencione, trajnime profesionale, lirime nga taksa, bashkëfinancim për të punësuarit, partneritet publiko-privat, etj.); - Bashkëpunim me asociacionin e bizneseve dhe organizatat e ndryshme për studime bazë dhe prezantimin e mundësive për industrinë përpunuese të materialeve gjysmë të fabrikua ndërtimore; - Bashkëpunimi me qeverinë, donatorët dhe investitorët privat për studime bazike dhe bashkë-financimin e projekteve për zhvillim të turizmit; - Përcaktimi formal i zonave turistike (Pustenik, Gorancë, Neçavc dhe Dërmjak) - Bashkëpunimi me qeverinë, donatorët dhe investitorët privat për studime bazike rreth resurseve tjera minerale; - Përcaktimi i zonës ekonomike/ industriale; - Përshtatja e programeve profesionale shkollore të nivelit të mesëm të lartë, kërkesave të tregut - Dërgesat e bashkatdhetarëve (Remitancat) - Identifikimi i zonave potenciale për prodhim të energjisë nga era dhe dielli.	Rreziqet - Vazhdimësi në shfrytëzimin jo racional të resurseve natyrore me theks në prerjen e pyjeve; - Vazhdimësi e trendit të humbjes së tokës bujqësore; - Moszgjidhja e çështjeve pronësore edhe për një kohë të caktuar; Parcelizimi i mëtejshëm i tokave bujqësore; - Pagat e ulëta në sektorin privat edhe për një periudhë të caktuar kohore; - Konkurrence e padrejtë dhe joformale në ekonomi dhe treg të patundshmërive (ndryshimi i të ardhurave në diasporë dhe në Kosovë, etj.); - Përmbytjet, thatësira, zjarret e pyjeve; - Zhvillimi i ulët ekonomik në nivel vendi

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Rritja e shërbimeve në terminalin doganor (duke përfshirë edhe depot doganore)
- Stimulimi i prodhimit bujqësor dhe blegtorisë
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Zhvillimi dhe promovimi i potencialeve turistike
- Zhvillimi dhe promovimi i potencialeve për prodhim të energjisë nga dielli dhe era
- Promovimi dhe krijimi i kushteve për industri ndërtimore
- Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e resurseve minerale

Nevojat zhvillimore

- Konsolidimi dhe zgjerimi i kapaciteteve lokale bujqësore dhe blegtorale
- Zgjerimi i gamës së prodhimeve dhe promovimi i tyre
- Zhvillimi dhe konsolidimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duke u i shfrytëzuar potencialet lokale, raportet komplementare ndër-sektorale, si dhe kërkesat e tregut
- Mbrojtja dhe promovimi i i potencialeve lokale natyrore dhe kulturore, si dhe zhvillimi i kapaciteteve turistike të ndërlidhura
- Sigurimi që kapacitet ekstraktuese minerale dhe industriale të zhvillohen më tej dhe në të njëjtën kohë të mos e dëmtojnë zhvillimin e gjithmbarshëm të Komunitetit

3.3 Infrastruktura teknike

Ujësjellësi – analizat e gjendjes ekzistuese tregojnë që komuna nuk është e mbuluar plotësisht me sistem të ujësjellësit. I vetmi vendbanim që ka sistem publik të ujësjellësit dhe i cili menaxhohet nga KRUK Bifurkacioni është zona urbane respektivisht qyteza e Hanit të Elezit me lagjet përreth si dhe pjesa e epërme e vendbanimit Seçishtë, gjatësia e të cilit është gjithsej 23km dhe kapaciteti furnizues i burimeve në Dimcë dhe Gllloboçicë është rreth 29l/s. Megjithatë është sistem i menaxhuar dhe ka kapacitet të mjaftueshëm të ujit, gjatë thatësirave popullata ballafaqohet me reduktime të ujit si rezultat i defekteve në rrjet dhe keqpërdorimeve. Vendbanimi Gorancë, ka sistemin e ujësjellësit me gjatësi prej 4km dhe kapacitet furnizues i burimit është 5l/s, që si rezultat i mos menaxhimit të duhur, banorët ballafaqohen me mungesë të ujit sidomos gjatë thatësirave.

Ujësjellësi	Kapacitetet konzervuese (m³)	Kapaciteti furnizues (l/s)	Gjatësia e rrjetit (km)		Menaxhimi
			Tubacioni 01	Tubacioni 02	
Ujësjellësi i Dimcës, që furnizon pjesën lindore të qytezës	250	17.0	2.2	4.2	KRUK „Bifurkacioni”
Ujësjellësi i Gllloboçicës, që furnizon pjesën perëndimore të qytezës	860	11.0 – 12.0	13.1		KRUK „Bifurkacioni”
Gorancë	400	5.0	2.72	0.72	Komuniteti
Totali:	1510	34	18.0	4.9	

Tabela 46. Infrastruktura teknike, sistemet e ujësjellësit, 2023

Vendbanimet tjera nuk kanë sisteme ose nuk janë funksionale, prandaj nga 284 ndërtesa banimi përdoret uji nga pusët individuale. Megjithatë kryhen analiza nga IKSHP përsëri është e vështirë të

sigurohet cilësia e mirë e ujit që përdoret për ushqim dhe higjienë. Për vendbanimet Paldenicë është e nevojshme të ndërtohet sistemi i ujësjellësit, ndërsa për Dimcë, Krivenik, Dremjak, Neçavc dhe Vërtomicë të gjendet modaliteti më i përshtatshëm për sigurimin e ujit nga sistemet publike të ujësjellësit duke ditur që këto vendbanime kanë numër të ulët të popullsisë apo janë të zbrazura, por në vitet e ardhshme planifikohet të zhvillohet turizmi.

Bazuar në kriteret e përcaktuara me UA nr. 08/2017 për NTPH, për të plotësuar nevojat e popullsisë të zonës urbane dhe një pjese të fshatit Seçishtë është e nevojshme të shtohet kapaciteti i ujit për 6l/s dhe të rehabilitohet infrastruktura. Kapaciteti ekzistues i ujit në fshatin Gorancë do t'i plotësojë nevojat e popullsisë, mirëpo është i nevojshëm vetëm rehabilitimi i sistemit dhe marrja në menaxhim nga KRUK „Bifurkacioni”. Sa i përket fshatrave tjera kapaciteti i nevojshëm për mbulimin e nevojave të banimit, shërbimeve tregtare dhe publike e sociale është rreth 8.5-9l/s.

Kanalizimi – pothuajse të gjitha vendbanimet e komunës kanë qasje në sistemin e kanalizimit, i cili përfshinë edhe kolektorët të cilët derdhen në lokacionin e planifikuar për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza në afërsi me rrjedhën e Lumi Lepenc. Gjatësia e përgjithshme e sistemit është rreth 29,204m dhe aktualisht menaxhohet nga një kompani e kontraktuar nga Drejtoria e shërbimeve publike. Vendbanimet të cilat nuk kanë rrjet të kanalizimit janë Dimca, Pusteni dhe Dremjaku, Vërtomica dhe Neçavci kjo për arsye të depopullimit, për të cilat duhet të sigurohet pasi që planifikohet ringjallja e tyre përmes zhvillimit të turizmit.

Nr	Vendbanimet	Rrjet kanaliz.	Derdhet në	Nr. i banorëve (2022)	Nr. i klientëve	Gjatësia e rrjetit (m')
1	Qyteza me Paldenicë/ Seçishtë	PO	Lumi Lepenc	5,907	930	24,778
2	Gorancë	PO	Përroi i Gorancës	933	146	3,654
3	Rezhancë	PO	Përroi i Gorancës	431	67	1,371
4	Krivenik	PO	Përroi i Seçishtes	257	43	772
5	Dimcë	JO	Përroi i Dimcës	226		
6	Pusteni	JO	Përrockë	571		
7	Dremjak (i zbrazur)	JO		110		
8	Vërtomicë (i zbrazur)	JO		0		
9	Neçavc (i zbrazur)	JO		100		
			Gjithsej;	8,533	Rreth 1186	Rreth 29,204

Tabela 47. Infrastruktura teknike, sistemet e kanalizimit, 2023

Për të përmirësuar gjendjen është e nevojshme të:

- përmirësimi i rreth 8km të rrjetit të kanalizimit;
- rregullimi i lidhjeve të kanalizimit deri te kolektori kryesor të vendbanimeve Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Pusteni, Dimcë, Laç dhe disa lagje të Paldenicës;
- shtimi i gjatësisë së kolektorit kryesor nga lagja Kashan deri te impianti i planifikuar në pjesën jugore të Komunës;
- kyçja e ndërtesave të planifikuara në sistem;
- zgjerimi i rrjetit deri te vendbanimet Dremjak, Vërtomicë dhe Neçavc, pasi që me PZHK përcaktohen si zona për zhvillim të turizmit;
- negociimi me KRUK „Bifurkacioni” për marrjen në menaxhim të sistemeve.

Sa i përket, trajtimit të ujërave të zeza është një sfidë për komunën e cila planifikohet të zgjedhet përmes ndërtimit të impiantit me kapacitet të mjaftueshëm për të trajtuar ujërat e derdhura për popullatën e projektuar, lokacioni i të cilit duhet të përzgjedhet në përputhje me kushtet e përcaktuara me UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH Kap. Iv Neni. 15. Rregullimi i çështjes së ujërave të zeza do të parandaloj dhe minimizoj ndotjen e lumenjve dhe mjedisit.

Për sigurimin e kapacitetit të ujit, qasjes në infrastrukturë dhe përmirësimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për të gjithë banorët në mënyrë të barabartë, vlerësohet që komuna megjithëse me buxhet të kufizuar do të mund të arrijë t'i realizoj këto projekte me mbështetjen financiare të donatorëve si dhe të KRUK „Bifurkacioni”.

Ndër të cilat, hulumtimi i burimeve shtesë do të realizohet nga KRUK „Bifurkacioni”, organizatat ndërkombëtare apo lokale në bashkëpunim me komunën dhe me mbështetjen profesionale nga Departamenti i ujërave/ARRPL - MMPHI.

Ndërtimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit do të realizohet nga buxheti i KRUK „Bifurkacioni” dhe bashkëfinancimi i komunës (buxhet i siguruar nga të hyrat vetanake të komunës dhe granti i përgjithshëm) me donatorë, megjithëse mbështetja e donatorëve në këtë fushë ka pësuar rënje, komuna mund të përfitoj nga programet/projektet që synojnë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe ndryshimet klimatike.

Në përmirësimin e shërbimeve me ujë të pijshëm do të kontribuoj edhe zvogëlimi i përqindjes së humbjeve teknike e komerciale të ujit, aktivitet i cili është përgjegjësi e KRUK „Bifurkacioni”, e cila do të vazhdoj të bëj identifikimin dhe rehabilitimin e gabimeve teknike si dhe identifikimin e kyçjeve ilegale dhe legalizimin e tyre.

Në KAB 2025 – 2027 për sektorin e DSHP dhe DUKMM janë planifikuar investimet në këtë sektor, që është planifikuar të realizohen kryesisht me grantin e përgjithshëm të Qeverisë dhe në një përqindje të vogël edhe me të hyrat vetanake të komunës. Mirëpo, sipas nevojës do të mund të sigurohet edhe nga burimet tjera si MMPHI, MAPL, MZHR, apo donatorët si SDC, SIDA, GIZ, USAID, BE, etj.

Sa i përket kapacitetit teknik DSHP dhe DUKMM posedojnë personel të kualifikuar dhe me përvojë në këtë fushë, të cilët sëbashku me personelin e KRUK „Bifurkacioni” do të menaxhojnë realizimin e projekteve të tilla. Përderisa, menaxhimi i projekteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës në përgjithësi, realizimit të kyçjeve në sistem dhe instalimit të ujëmatësve do të kryhet nga personeli i kualifikuar të KRUK „Bifurkacioni” duke përdorur personelin dhe teknologjinë e pajisjet e saj.

Sistemi i ujërave atmosferike është i shtrirë pothuajse përgjatë të gjitha rrugëve të zonës urbane dhe të vendbanimeve rurale. Në disa segmente të rrugëve ekzistuese lokale sistemi është i dëmtuar apo dhe nuk ekziston.

Nr	Vendbanimet	Sistemi i ujërave atmosferik		Gjatësia e rrjetit (m')
		Mbyllur	Hapur	
1	Hani i Elezit	Po		3,516
2	Seçishtë	Po		503
3	Gorancë	Po		3,710
4	Hani i Elezit		Po	913
5	Paldenicë		Po	1,157
6	Rezhancë		Po	641
7	Seçishtë		Po	669
Gjithsej				11,109

Tabela 48. Infrastruktura teknike, sistemi i ujërave atmosferik, 2023

Për përmirësimin e gjendjes është e nevojshme që rrjeti ekzistues të rehabilitohet dhe të shtrihet përgjatë rrugëve që ju mungon dhe atyre që planifikohen.

Për realizimin e projekteve të tilla komuna me KAB 2025-2027, në kaudër të sektorit të DSHP-së dhe DUKMM-së janë planifikuar investimet në rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e kësaj infrastrukture, që do të mund të sigurohen nga të hyrat vetanake dhe granti i përgjithshëm i Qeverisë, por sipas nevojës mund sigurohet mbështetje edhe nga burimet tjera si MMPHI, MAPL apo MZHR.

Menaxhimi i projekteve të rehabilitimit dhe mirëmbajtjes do të kryhet nga personeli i kualifikuar i DUKMM dhe DSHP, mirëpo në rastet e ndërtimit sipas nevojës do të angazhohen ekspertë të jashtëm.

Ujitja e tokave bujqësore - ujitja e një pjese të tokave bujqësore sigurohet përmes kanaleve, mirëpo është e nevojshme të shtrihet edhe në tokat tjera sidomos është e rëndësishme të sigurohen për tokat e planifikuara për konsolidim që shtrihen përgjatë Lumit Lepenc.

Për realizimin e projekteve të tilla komuna nuk ka kapacitete financiare dhe nuk ka planifikuar investime me KAB 2025 - 2027, mirëpo mund të siguroj nga NH „Ibër – Lepenc” si dhe do të mund të përfitoj nga grantet e MBPZHR dhe fondet e organizatave ndërkombëtare si USAID, GIZ, SIDA, etj.

Sa i përket kapaciteteve për menaxhim të projekteve të tilla, komuna nuk ka personel të kualifikuar për këtë fushë, që do të mbikqyrë hartimin e projektit dhe zbatimin e tij, mirëpo kjo detyrë do të kryhet nga personeli i kualifikuar i NH „Ibër-Lepenc” dhe MBPZHR-së. Ndërsa mirëmbajtja e sistemit do të realizohet nga personeli i NH „Ibër-Lepenci”.

Energjia elektrike dhe energjia për ngrohje – vendbanimet e komunës furnizohen me energji elektrike përmes një sistemi të veçantë për komunë, ndërsa dy vendbanime si Pusteniku dhe Laçi furnizohet nga rrjeti i komunës së Kaçanikut. Energji elektrike sigurohet nga njësia punuese e KEDS në Han të Elezit dhe Kaçanikut.

Furnizimi me energji elektrike është i kënaqshëm dhe nuk ka reduktime, mirëpo rrjeti dhe shtyllat janë të vjetëruara. Për të ardhmen është e nevojshme rehabilitimi i sistemit dhe zgjerimi për nevojat e popullsisë së projektuar. Në komunë nuk ka prodhues tjerë të energjisë elektrike, megjithëse ishte planifikuar ndërtimi i dy hidrocentraleve të vogla mirëpo lejet ndërtimore dhe pëlqimet mjedisore nga MMPHI dhe autorizimet e ZRRE kanë skaduar si rezultat i vonësës së fillimit të punëve. Sa i përket ngrohjes, rreth 90% e ndërtesave të banimit, shërbimeve tregtare e industriale dhe të institucioneve dhe ngrohen me dru, ndërsa përqindja e mbetur me energji elektrike dhe biomasë (pellet/briket).

Me qëllim të kursimit të energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit përmes granteve e subvencioneve të qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare do të mbështeten investimet e qytetarëve në efikasitet të energjisë dhe energji të ripërtërishme. Kjo do të ndihmonte në reduktimin e përdorimit të drurit për ngrohje në institucione dhe ndërtesa private të banimit dhe bizneseve, ashtu që do të parandalohet apo minimizohet dukuria e degradimit të pyjeve nga prerjet ilegale. Për më tepër, komuna tashmë ka përzgjedhur lokacionet që konsiderohen si të përshtatshme për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Projektet për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit do të financohen dhe mbikqyren nga KEDS të cilët do të mbështeten nga komuna në rastet e negociatave me pronarë të tokave dhe marrjes së pëlqimeve të nevojshme.

Për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e efikasitetit të energjisë në institucionet publike komuna ka planifikuar një buxhet minimal, mirëpo për ndërtesat private të banimit dhe bizneseve si dhe të përdorimit të burimeve të ripërtërishme, komuna nuk ka dhe nuk ka planifikuar, mirëpo investimet e tilla do të mund të realizohen nga programet e Qeverisë

respektivisht ME-së, FKEE-së (Fondit Kosovet për Eficiencë të Energjisë) dhe donatorëve. Në kuadër të projekteve, hyjnë edhe aktivitetet ndërgjegjësuere me qytetarë dhe zhvillimi i kapaciteteve të komunës për auditim të ndërtesave dhe menaxhim të projekteve të përmirësimit të eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtërishme.

Mbeturinat – shërbimi i grumbullimit të mbeturinave mbulon gjithë territorin e komunës. Menaxhimi i mbeturinave në komunë kryhet nga Ndërmarrja publike lokale – NPL „Pastrimi”, që bën grumbullimin dy herë në javë në zonën urbane, ku numri i përgjithshëm i klientëve është 520 respektivisht 430 amvisëri, 82 biznese dhe 8 institucione dhe një herë në javë në vendbanimet rurale, ku numri i përgjithshëm i klientëve është 1017, respektivisht 1006 amvisëri, 9 biznese dhe 2 institucione. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nuk ofrohet në fshatrat Vërtomicë dhe Neçavc për shkak që janë vendbanime të depopuluara.

Mbeturinat e grumbulluara transferohen në stacionin e transferit në Gërlicë të Ferizajit dhe deponinë rajonale në Velekincë të Gjilanit. Megjithëse, që nga viti 2017 shërbimi i grumbullimit është i rregullt, në komunë ende ekzistojnë dy deponi jo –formale, të cilat janë krijuar si pasojë e mungesës së menaxhimit në vitet para vitit 2017. Gjithashtu, në komunë ekziston edhe deponia e mbeturinave ndërtimore, mirëpo për këtë çështje komuna tashmë ka ndërmarrë masa duke caktuar lokacionin të mihja sipërfaqësore e mergeles. Dy deponitë tjera duhet të pastrohen e rehabilitohen dhe të shëndrohen në hapësira të gjelbra. Në komunë ekziston edhe deponia e mbeturinave të azbestit të minierat e vjetra të kromit në Gorancë, e cila është krijuar nga largimi i mbeturinave nga shtrati i lumit Lepenc dhe uzinat e fabrikës. Megjithatë, duhet të vlerësohet nëse janë pastruar në tërësi këto mbetje.

Për të ardhmen është e nevojshme të zgjerohet shërbimi edhe në vendbanimet Vërtomicë dhe Neçavc duke pas parasysh që do të jenë zona për zhvillimin e turizmit.

Në aspektin e zvogëlimit të mbeturinave, ka zhvillime pozitive ku ka filluar reciklimi i mbeturinave organike përmes komposterëve individual, aktivitet i cili duhet të vazhdojë edhe me mbeturinat tjera. Komuna është e përkushtuar në këtë drejtim, prandaj që nga viti 2023 posedon Planin 5 vjeçar për menaxhim të mbeturinave për periudhën 2023 – 2027, i cili përcakton masat, veprimet dhe përgjegjësit e burimin financiar të tyre, që duhet ndërmarrë me qëllim të menaxhimit adekuat të mbeturinave.

Për të përcaktuar vëllimin e deponisë për popullsinë e projektuar, është e nevojshme që të merret parasysh norma e gjenerimit vjetor të mbeturinave për kokë banori e përcaktuar me UA MMPH nr. 08/2017 për NTPH prej 1m³ në gjendje jo të ngjeshur që për popullsinë shtesë vëllimi do të jetë përafërsisht 761 m³.

Ofrimi i shërbimeve në vendbanimet Vërtomicë dhe Neçavc do të realizohet nga ndërmarrja „Pastrimi”, e cila do të negociojë fillimisht më pronarët e njësive të banimit tjetër (bujtinave, vilave) dhe të shërbimeve tregtare. Ndërsa, për projektet e reciklimit komuna dhe ndërmarrja „Pastrimi” do të mund të sigurojnë buxhetin nga programet qeveritare respektivisht MMPHI, MAPL apo MZHR dhe të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në sektorin e mbrojtjes së mjedisit gjegjësisht GIZ, BE, SIDA, etj.

Me KAB 2025 – 2027 në kuadër të saj në linjën buxhetore për DSHP-në, komuna ka planifikuar investime për rregullimin e lokacionit të deponisë së mbeturinave të ndërtimit, që do të realizohen nga hyrjet vetanake por edhe granti i përgjithshëm. Mirëpo, buxheti i nevojshëm do të mund të sigurohet edhe nga programet/projektet e donatorëve të përmendur më lartë.

Për menaxhimin e projekteve të tilla DSHP dhe ndërmarrja „Pastrimi” ka personel të kualifikuar, mirëpo sipas nevojës do të angazhojë edhe ekspert të jashtëm. Në rastin e projekteve për zvogëlim të gjenerimit të mbeturinave apo riciklim personeli i DSHP-së dhe Pastrimit do të mund të mbështetet nga ekspertë të organizatave zbatuese të projekteve të tilla.

Telekomunikacioni – komuna mbulohet nga rrjeti i telefonisë mobile nga operatorët Vala, IPKO dhe në afërsi të kufirit nga operatorët e Maqedonisë e Veriut. Telefonia fikse, TV kabllor dhe internet ofrohet nga Telekom i Kosovës dhe Elektra/ Telkos për Qytezën, lagjet përreth dhe vendbanimet Seçishtë e Paldenicë, Dimcë, Krivenik, Gorancë dhe Rezhancë, ndërsa në Pustenic dhe Laç nuk ofrohet ky shërbim.

Nisur nga fakti që pikat me rëndësi turistike nuk mbulohen me këtë shërbim, është nevojshme që rrjeti të zgjerohet edhe në këto pika në mënyrë që të shërbehen banorët e këtyre vendbanimeve, turistët dhe vizitorët e komunës. Për nevojat e popullsisë së projektuar është e nevojshme vetëm të sigurohet qasja në këto rrjete, pasi që rrjeti ekziston dhe është cilësor.

Për Investimet në përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve të telekomunikacionit komuna nuk ka kapacitete financiare dhe teknike, përpos që personeli i DSHP-së dhe DUKMM-së do të mund t'i mbështesë operatorët përkatës për çështjet e pëlqimeve.

Gjithashtu dhe Raporti i VSM-së, potencon mangësitë në trajtimin e infrastrukturës, kanalizimit të ujërave të zeza, mungesës së pastrimit të ujërave të zeza, menaxhimit të dobët të mbetjeve komunale. Prandaj, duke marrë parasysh këto gjetje, në fazat e ardhshme PZHK-ja përmes veprimeve adreson mangësitë e cekura në VSM.

Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
Sistem funksional i furnizimit me ujë të pijes për zonën urbane dhe vendbanimet përreth (i menaxhuar nga KRU Bifurkacioni-Njësia në HiE), si dhe në fshatin Gorancë;	Vështirësi menaxhimi dhe shërbim i pjesshëm me ujësjellës në Qytet me vendbanimet përreth dhe në Gorancë;
Kontroll i vazhdueshëm i ujit të pijes në sistemet e menaxhuara të ujësjellësit;	Vështirësi në ofrimin e shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit (sfida në relacionet KRU Bifurkacioni-Njësia në HiE, vështirësi në funksionalizimin e impiantit të ujësjellësit në Dimcë, vështirësi furnizimi për banorët e pjesëve më të larta gjeografike gjatë verës, humbje të mëdha të ujit në rrjet nga dëmtimet e rrjetit dhe nga mos-faturimi në rastin e keqpërdoruesve në amvisëri, prishje të shpeshta, përzierja e ujërave të zeza me ato atmosferik, vështirësi në inkasim);
Mbulueshmëri pothuajse e plotë (95%) të banorëve komunal me shërbime të kanalizimit;	Mos-ekzistenca e infrastrukturës së përbashkët dhe të menaxhuar të ujësjellësit për vendbanimet tjera (banorët kanë sisteme private ose të lagjeve);
Mbulueshmëri e plotë e banorëve komunal me shërbime të mbeturinave (e menaxhuar nga Kompania Publike Lokale e krijuar së voni);	Mos-kontrollim i cilësisë së ujit në rastet e puseve dhe sistemeve private;
KR e mbeturinave-Njësia në Hani i Elezit e furnizuar së voni me mekanizëm;	Kufizim i mundësive për burime uji nga shfrytëzimet joformale të burimeve publike për nevoja private;
Mbulueshmëri e plotë e banorëve me shërbime të energjisë elektrike;	Mostrajtim i ujërave të zeza;
Prodhim i planifikuar në masë të ulët i energjisë elektrike nga 2 hidrocentralet që do të ndërtohen;	
Mbulueshmëri pothuajse e plotë e banorëve komunal me shërbime të telekomunikacionit (telefoni mobile, internet, TV kabllor).	

	Mungesë e mekanizmit për Kompaninë Publike Lokale të Mbeturinave “Pastrimi” Deponim i shumicës së volumit të mbeturinave dhe ngecje në ndarjen dhe rishfrytëzimin/ riciklimin e tyre; Deponitë ilegale të mbeturinave; Vështirësi në ofrimin e shërbimeve të energjisë elektrike (ndërprerjet e rrymës, tensioni i ulët dhe rrjeti i vjetërsuar në disa vendbanime), Ngrohje e objekteve në mënyrë individuale dhe shfrytëzimi kryesisht i drurit për ngrohje nga shumica e amvisërive dhe bizneseve.
Mundësitë Burime prezente dhe konfiguracion i përshtatshëm i terrenit për liqen akumulues për nevoja të ujësjellësit/ ujitjes (Dimcë-Skallavac); Konfiguracion i përshtatshëm i terrenit për kompletimin e sistemit të kanalizimit përmes kolektorëve; Bashkëpunimi me KR-të si dhe grantet nga qeveria dhe donacionet për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit, trajtimin e ujërave të zeza dhe ofrimin e shërbimeve kualitative dhe të qëndrueshme duke përfshirë edhe grumbullimin e mbeturinave; Shfrytëzimi i mundësive dhe njohurive nga përvojat brenda dhe jashtë vendit për prezantimin e ndarjes si dhe ri-shfrytëzimit të mbeturinave, si dhe për trajtimin e mbeturinave të rrënim-ndërtimit; Investimet nga Kesco për ofrimin e shërbimeve kualitative dhe të qëndrueshme të energjisë elektrike Shfrytëzimi i mundësive/ njohurive nga përvojat brenda dhe jashtë vendit dhe i granteve/ donacioneve për prezantimin e prodhimit/ ruajtjes së energjisë nga përdoruesi i fundit (end user) (me theks në objektet publike); Mundësitë për joshjen e operatorëve tjerë për shërbime kualitative dhe të përballueshme të	Rreziqet Vazhdimi i raporteve të vështirësuar të KRU Bifurkacioni me Njësinë në HiE mund të vështirësojë përmirësimin e shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit; Ndotja e burimeve të ujit (kryesisht atyre private) në rast të shirave, vërshimeve, etj.; Krijimi i mëtutjeshëm i deponive ilegale të mbeturinave; Mos-ofrimi i alternativave tjera të përballueshme për ngrohje dhe shfrytëzimi i mëtutjeshëm i drurit; Shtyllat elektrike të dëmtuara derisa të ndërrohen.

telekomunikacionit;	
Bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për planifikimet bazë për ngrohje qendrore të përbashkët.	

Sfidat kryesore të identifikuar janë:

- Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në tërë komunën
- Trajtimi i ujërave të zeza
- Përmirësimi i infrastrukturës energjetike
- Ndarja dhe reciklimi i mbeturinave
- Ofrimi i alternativave tjera për ngrohje

Nevojat zhvillimore

- Sigurimi i furnizimit me ujë përmes sistemit publik të ujësjellësit për të gjitha vendbanimet
- Promovimi i masave për shfrytëzimin racional të resurseve ujore
- Sigurimi i sistemit për shkarkimin e ujërave të zeza në të gjitha vendbanimet
- Kompletimi i kolektorëve kryesor të ujërave të zeza
- Sigurimi i furnizimit adekuat me energji elektrike në të gjitha vendbanimet
- Përfshirja e të gjitha vendbanimeve me shërbimin e rregullt për menaxhimin e mbeturinave
- Studimet sektoriale në lidhje me ngrohje të qëndrueshme të ndërtesave

3.4 Infrastruktura e transportit dhe transporti

Për shkak të pozitës së saj në afërsi me kufirin ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë Veriore, komuna ka lidhje të mirë me komunat tjera si dhe me rajonin.

Rrugët e nivelit lokal

Autoudha (R6) Prishtinë – Hani i Elezit – cilësia e segmentit që shtrihet brenda territorit të komunës së Hanit të Elezit është mjaft e mirë.

Rruga nacionale (N2) Prishtinë – Shkup – cilësia e segmentit që shtrihet brenda territorit të komunës vlerësohet të jetë mesatare. Për shkak të shembjeve dhe rënjes së gurëve ky segment konsiderohet jo i sigurtë për pjesëmarrësit në trafik, gjithashtu vend kalimet e banorëve që ndodhen përgjatë këtij segmenti vlerësohen si jo të sigurta.

Nr	Rruga	Gjatësia (km)
1	Autoudha Prishtinë - Hani i Elezit	6.0
2	Rruga Nacionale Prishtinë - Shkup	6.0

Tabela 49. Infrastruktura e transportit, rrugët e nivelit qendror brenda territorit të komunës, 2023

Rruga Hani i Elezit – Gllaboçicë/Kaçanik - lidh dy pikat kufitare Hani i Elezit dhe Gllaboçicë që kalon nëpër Malet e Sharrit dhe fshatit Gorancë duhet të promovohet si rrugë rajonale. Segmenti i rrugës që kalon brenda territorit të komunës është 9.79 km i gjatë dhe është në gjendje relativisht të mirë, përpos një pjese ku ndodh rrëshqitja e dheut dhe e bajpasit në Gorancë që nuk është i shtruar.

Për të përmirësuar gjendjen e rrugëve është e nevojshme që të përmirësohet siguria në rrugën nacionale N2 përmes sigurimit të qasjes së lehtë dhe kalimit të sigurtë të banorëve sidomos për ata që dëshirojnë të kalojnë nga zona në perëndim të hekurudhës në qytezë pasi që kanë vetëm një qasje për makina nëpër rrugën nacionale N2 dhe daljen ngjitur me kufirin. Sa i përket parandalimit të rënjes së gurëve duhet të merren masa të përcaktuara nga inxhinierë të fushës. Gjithashtu, duhet të përmirësohet edhe qarkullimi jo motorik si dhe menaxhimi i shpejtësisë përmes shiritave të gjelbër apo me pengesa tjera.

Duke pas parasysh që infrastruktura e rrugëve të nivelit nacional dhe rajonal janë përgjegjësi e nivelit qendror, kapacitetet financiare dhe teknike për mirëmbajtjen e tyre sigurohen nga MMPHI sektori i Infrastruktura, MAPL, MZHR, e ministritë tjera. Ndërsa, komuna respektivisht DSHP dhe DUKMM do t'i mbështesë sipas nevojës.

Rrjeti i rrugëve lokale - e njëjta gjë vlen edhe për rrugët lokale, të gjitha vendbanimet kanë lidhje të mira me njëra tjetrën dhe ndriçim si dhe gjendja e tyre dukshëm është përmirësuar si rezultat i interevenimeve që janë bërë viteve të fundit me buxhetin komunal. Rreth 72% e rrugëve lokale janë të asfaltuara apo betonuara dhe shënuara, përpos rrugëve drejt vendbanimeve të shpopuluara si dhe segmente të rrugëve lidhëse me pikat turistike.

Nr	Rruga lokale	Statusi	Gjatësia (km)
1	Hani i Elezit – Paldenicë	e shtruar ⁴⁹	4,36
2	Ura e Seçishtës – Seçishtë – Krivenik	e shtruar	6,40
3	Lagja Maliq – Pusteni	e shtruar	5,13
4	Rruga Nacionale N2 (Hani i Elezit) – Dimcë	e shtruar	1,30
5	Rruga Nacionale N2 (Kashan) – Laç	e shtruar	2,87
6	Rruga Nacionale N2 (Dheu i Bardhë) – Paldenicë	e shtruar	0,93
7	Hani i Elezit– Dërmjak–Neçavc – Gjurgjedell (Kaçanik)	e shtruar	8,80
8	Hani i Elezit – Lagja Curri	e shtruar	0,54
9	Rruga Nacionale N2 (Uji i Thartë) – Bush (Pusteni)	e shtruar	1,80
10	Hani i Elezit – Dërmjak i Ulët	e shtruar	0,87
11	Rruga Nacionale N2 (Kashan) – Paldenicë	e shtruar	1,38
12	Paldenicë – Vërtomicë	e pashtuar	4,20
13	Paldenicë – Neçavc	e pashtuar	4,20
14	Gorancë – Krivenik	e pashtuar ⁵⁰	5,25
		Gjithsej	48,03

Tabela 50. Infrastruktura e transportit, rrugët e nivelit lokal, 2023

Në të ardhmen është e nevojshme që të përmirësohet qarkullimi dhe siguria në trafik, përmes rehabilitimit dhe shtruarjes së rrugëve të pashtuara si dhe mirëmbajtja së vazhdueshme të tyre. Gjithashtu, për nevojat e zhvillimeve të reja është e nevojshme që të zgjerohet rrjeti dhe të sigurohet qasja e lehtë dhe e sigurtë për qytetarët në këto pjesë.

Rrjeti i transportit jo motorik - nuk është i shtrirë në të gjitha rrugët, përpos në zonën urbane i cili është i shtrirë përgjatë shumicës së rrugëve dhe hekurudhës. Ndërsa, në vendbanimet tjera nuk është i shtrirë në të gjitha rrugët.

Për të përmirësuar gjendjen është e nevojshme që të planifikohet shtrirja e shtigjeve përgjatë atyre rrugëve ku ka hapësirë të mjaftueshme. Gjithashtu, mungojnë shtigjet e shtruar dhe ndriçuar nëpër zonat malore dhe duke u nisur nga fakti që zhvillimi ekonomik i komunës bazohet edhe në turizmin malor është e nevojshme që të planifikohet shtrirja e tyre edhe në këto anë.

⁴⁹Rrugë e shtruar nënkupton rrugën me shtresë asfalti apo pllaka betoni

⁵⁰Rrugë e pashtuar nënkupton rrugën me shtresë zhavorri apo dheu

Hekurudha – nëpër territorin e komunës kalon edhe hekurudha Fushë Kosovë – Shkup, dhe gjatësia e segmentit që kalon është 8.21km. Përgjatë këtij segmenti ekziston një vendkalim formal dhe 1 tunel, si dhe 3 vendkalime joformale, si dhe në qytezë ndodhet stacioni i trenit.

Punët rehabilituese të hekurudhës janë përgjegjësi e Hekurudhave të Kosovës, e cila tashmë është duke i zhvilluar punët rehabilituese, ndërsa sa i përket rregullimit të vendkalimeve ilegale komuna do të negocioj me Hekurudhat e Kosovës për formalizimin e këtyre vendkalimeve.

Transporti - komuna nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë me komunat tjera, përpos me komunën e Kaçanikut, ndërsa linjat Prishtinë – Shkup dhe Prizren – Shkup dhe anasjelltas e mundësojnë udhëtimin për në komunat tjera. Komuna nuk ka stacion të autobusëve vetëm ndalesa në vendbanime të cilat nuk kanë mbuloja.

Transporti hekurudhor ofrohet përmes linjës Fushë Kosovë – Shkup njëherë në ditë, mirëpo aktualisht nuk është funksional për shkak të punimeve që bëhen nga Hekurudhat e Kosovës.

Transporti lokal sigurohet përmes mini busëve dhe veturave private për shkak të afërsisë ndërmjet vendbanimeve, përpos rastit të vendbanimit Paldenicë që ndodhet më largë qytezës.

Është e nevojshme që në të ardhmen të ndërtohet stacion në përputhje me kushtet e përcaktuara me rregullore të veçanta dhe të ndërtohen mbulojat për ndalesat në vendbanimet Gorancë, Rezhancë, Krivenik, Seçishtë dhe Paldenicë. Gjithashtu duhet të fillohet të punohet në drejtimin e sigurimit të linjave të drejtëpërdrejta me Prishtinën dhe Ferizajin ashtu që të lehtësohet qasja e banorëve nëpër këto komuna.

Në të ardhmen është e nevojshme që të përmirësohen shërbimet, dhe të futen në përdorim mjete të transportit me ndikim sa më të vogël negativ në mjedis si dhe të promovohet dhe inkurajohet përdorimi i transportit jo motorrik.

Edhe Raporti i VSM-së e rekomandon rritjen e cilësisë së transportit publik. Për më tepër e vë në pah se komuna e Hanit të Elezit është një territor transit në mes të qendrave nacionale dhe ndërkombëtare pasi që është komunë kufitare ku vjen në shprehje infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli qendror dhe e cila ka ndikimet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra.

Vend parkingjet - në përgjithësi, në komunë ka numër të mjaftueshëm të parkingjeve për t'i plotësuar nevojat e popullatës ekzistuese deh vizitorëve. Në komunë ekzistojnë gjithsej 361 vendparkime të menaxhuara nga Komuna, të cilat janë të shpërndara në 15 lokacione si dhe 2 private. Gjithashtu, edhe në ndërtesat afariste ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për konsumatorët/klientet e tyre që shfrytëzohen edhe nga vizitorët e komunës.

Mirëpo ka mungesë të parkingjeve në pikat turistike të cilat duhet të ofrohen për vizitorë në hyrje të këtyre pikave, numri i të cilave duhet të jetë në përputhje me normat e përcaktuara me UA nr. 08/2017 për NTPH Kapitulli IV Nen kapitulli 11, 11.8 Vend - parkimet. E njëjta gjë vlen edhe për sigurimin e parkingjeve për nevojat e zhvillimeve të reja të planifikuara si banimi, bizneset, institucionet publike, hapësirat rekreative, etj. Numri i të cilave do të përcaktohet me UA nr. 08/2017 për NTPH Kapitulli IV Nen kapitulli 11, 11.8 Vend - parkimet.

Sa i përket kapaciteteve financiare megjithëse me KAB 2025 – 2027 ka planifikuar linjë buxhetore për DSHP dhe DUKMM për investimet në ndërtimin, asfaltimin dhe rehabilitimin e rrugëve si dhe të trotuareve, vendparkingjeve dhe shtigjeve me buxhet të siguruar nga të hyrat vetanake, granti i përgjithshëm dhe nga grantet e MMPHI, MAPL, MZHR për shtigje mund të sigurohen edhe përmes bashkëfinancimit me organizatat ndërkombëtare.

DSHP dhe DUKMM posedojnë personel të kualifikuar dhe me përvojë për menaxhimin e projekteve të tilla, mirëpo sipas nevojës do të angazhoj ekspertë të jashtëm, mirëpo në rastet e projekteve të financuara / bashkëfinancuara nga donatorët do të mbështeten nga personeli i organizatave zbatuese.

Në rastin e parkingjeve komuna në bashkëpunim me sektorin privat do të mund të investojë në krijimin e vendparkingjeve të reja, ku mbikqyrja e projektimit dhe zbatimit të projekteve do të mund të realizohet nga personeli i DSHP-së.

Analiza SWOT

Përparësitë - Autoudha dhe rruga nacionale e shtrirë në territorin e Komunës; - Qasja shumë e përshtatshme në autoudhë dhe qasje funksionale në rrugë nacionale - Rrjeti hekurudhor prezent; - Rrjet shumë i mirë dhe funksional i rrugëve lokale (nga vendbanimi në vendbanim); - Rrjet shumë i mirë i rrugëve urbane dhe rurale; - Trotuare prezente në rrugët lokale (përgjatë vendbanimeve) dhe rrugët kryesore urbane; - Rrjet shumë i mirë i ndriçimit publik në qytet dhe vendbanimet rurale; - Rrjet i konsoliduar i kanalizimit atmosferik (i hapur dhe i mbyllur) në rrugët rurale dhe rrugët kryesore urbane; - Numër i mjaftueshëm i parkingjeve publike; - Transport ndër-urban dhe lokal i organizuar mirë.	Dobësitë - Mungesa e stacionit të autobusëve; - Disa kyçje në rrugët nacionale jo të sigurta; - Ndërtimet në disa raste afër rrugëve nacionale dhe lokale jashtë rregullave ndërtimore; - Transporti hekurudhor minimal dhe jo funksional; - Disa rrugë të ngushta në vendbanime posaçërisht në zonën urbane (ndërtime në skaj, etj.); - Mungesa e shtigjeve për biçikleta; - Rrjet jo i zgjeruar i shtigjeve të rregulluara për këmbësorë dhe për hiking në zonat malore; - Mungesë transporti lokal në Paldenicë; - Transporti ndër-urban dhe urban me mekanizma të vjetërsuar - Mungesa e parkingjeve për taksì; - Vështirësi në mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore.
Mundësitë - Bashkëpunimi me qeverinë qendrore për ti bërë më të sigurta disa kyçje në rrugë nacionale; - Grante qeveritare dhe donacione për përmirësimin e infrastrukturës dhe transportit hekurudhor; - Grante qeveritare dhe donacione për kompletimin e rrjetit rrugor lokal duke përfshirë kanalizimin atmosferik dhe ndriçimin; - Bashkëpunime me OJQ dhe organizata tjera për rregullime të shtigjeve për hiking.	Rreziqet - Rrezik i vazhdueshëm i banorëve dhe i udhëtarëve të disa kyçjeve në rrugë nacionale deri në rregullimin e tyre; - Rrezik nga të reshurat e dendura dhe shembjet e dheut në rrugën nacionale; - Siguri e pamjaftueshme në komunikacionin rrugor; - Cilësi e ulët infrastrukturës dhe funksionimit për shkak të buxhetit të kufizuar.

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Përmirësimi i sigurisë në trafik
- Përmirësimi i kushteve për qarkullim jo motorik
- Përmirësimi i rrjetit të transportit publik
- Rregullimi final i lëvizjeve të sigurta për këmbësorë në qytet dhe fshatrat e mëdha;

Nevojat zhvillimore

- Kompletimi i rrjetit të infrastrukturës me elementet që mundësojnë qarkullim për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, duke përfshirë edhe qarkullimin jomotorik (këmbësor dhe çiklistik)
- Kompletimi/konsolidimi i rrjetit rrugor në të gjitha lagjet e vendbanimeve rurale
- Sigurimi i elementeve që mundësojnë menaxhim adekuat të qarkullimit dhe mbajtje të nivelit të sigurisë
- Sigurimi i mbulueshmërisë së të gjitha vendbanimeve me transport adekuat dhe të rregullt publik
- Planifikimi i rrjetit të parkingjeve të planifikuara

3.5 Infrastruktura publike dhe sociale

Komuna e Hanit të Elezit edhe pse posedon infrastrukturë publike dhe sociale, për një vlerësim më të thukët është analizuar numri i banorëve (vlerësimi për vitin 2022) me sipërfaqen e kërkuar për ndërtesë të institucioneve parashkollore.

Arsimi - Hani i Elezit i ka 2,736 banorë, standardi i kërkuar është $0.30\text{m}^2/\text{banorë}$, pra në total duhet të jenë 820 m^2 ndërtesë për çerdhe vetëm për qytezën e Hanit të Elezit. Institucioni parashkollor Ardhmëria i ka 603 m^2 , kjo na bën të kuptojmë që për nga sipërfaqja standardi i kërkuar sipas normave të U.A MMPH Nr. 08/2017 mbi NTPH nuk është i plotësuar. Për më tepër janë edhe dy qendra të mëdha si Paldenica me 1,860 banorë që duhet të ketë një ndërtesë çerdhe prej 558 m^2 dhe Goranca me 1,110 banorë me ndërtesë të çerdhes 330 m^2 . Kërkesat sipas standardeve janë që Hani i Elezit të ketë ndërtesë të kopshtit të ndarë, me $1\text{ m}^2/\text{banorë}$, pra në total duhet të jenë $2,736\text{ m}^2$ vetëm për

këtë destinim, por aktualisht Ardhmëria përmbledhë edhe grup moshën e fëmijëve të kopshtit, pra nuk ka ndërtesë të ndarë për kopsht.

Sa i përket infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar, sipas U.A MMPH Nr. 08/2017 mbi NTPH shkolla fillore duhet të ketë $1.60\text{ m}^2/\text{për banorë}$, pra shkolla në Han të Elezit duhet të jetë me $4,377\text{ m}^2$. Sipërfaqja jo e mjaftueshme detyrimisht reflektohet në zhvillimin e mësimin në dy ndërrime në Han të Elezit që do të thotë se në të ardhmen duhet të konsiderohet ndërtimi i një shkolle shtesë. Nërsa, shkolla fillore Veli Ballazhi në Paldenicë i ka 783m^2 , por në bazë të numrit të banorëve duhet të ketë $2,976\text{ m}^2$. Ndërsa, shkolla fillore Kështjellat e Diturisë në Gorancë i ka $1,247\text{ m}^2$ por sipas standardeve duhet të ketë $1,776\text{ m}^2$. Edhe pse janë me sipërfaqe më të vogla se kërkesat, përparësi është që mësimi organizohet vetëm në një ndërrim, gjë që na bën të kuptojmë që nuk ka nevojë për hapësira shtesë. Në të ardhmen duhet konsideruar pajisjen e shkollave me teknologji moderne.

Komuna me KAB 2025-2027 për sektorin e arsimit ka planifikuar investime në përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe pajisje, që do të realizohen përmes buxhetit specifik të arsimit të plotësuar me grantin e përgjithshëm, mirëpo do të mund të sigurohen edhe nga burimet tjera si MASHT, MAPL, MZHR apo MKRS.

Ndërsa, sa i përket kapaciteteve teknike për menaxhimin e realizimit të punëve rehabilituese apo ndërtuese DASH nuk ka personel të kualifikuar por do të angazhoj ekspertë të jashtëm apo do të angazhohet personeli i kualifikuar i DSHP-së dhe DUKMM-së. Ndërsa, për një arsim më cilësor, komuna duhet konsideruar angazhimin e një këshilltari të politikave arsimore, një ekspert të kurrikulës dhe metodologjisë mësimore, gjë që do të ndihmojë në përditësimin e vazhdueshëm të materialeve mësimore. Duke qenë që shëndeti i nxënësve është mbi të gjitha, atëherë komuna duhet të sigurojë angazhimin e psikologëve dhe pedagogëve për secilën shkollë. Në këtë mënyrë do të sigurohet mbështetja emocionale dhe këshillimi për secilin nxënës në territorin e kësaj komune.

Për më tepër me orar të caktuar secila shkollë një herë në javë duhet të vizitohet nga një mjek dhe infermierë të QKMF-së.

Shëndetësia - infrastruktura e institucioneve shëndetësore është e organizuar në nivelin parësor, i cili përfshinë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Han të Elezit dhe Ambulancën e Mjekësisë Familjare (AMF) në Gorancë. Norma minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelit parësor është 0.20 m²/banor, pra për Hanin e Elezit duhet të jetë 547.2 m², ndërsa QKMF në këtë komunë është prej 1,470 m² (me 699m² sipërfaqe të ndërtuar), gjë që reflekton që standardi është i plotësuar. Vlen të theksohet se të gjitha vendbanimet janë të mbuluara me shërbime shëndetësore. Për nga aspekti i distancës, banorët nga Goranca dhe Kriveniku duhet të udhëtojnë 7km për në QKMF, ndërsa banorët e vendbanimeve tjera rreth 2km.

Komuna me KAB 2025 – 2027 për sektorin e shëndetësisë ka planifikuar mirëmbajtjen e infrastrukturës shëndetësore dhe sigurimin e pajisje të nevojshme shëndetësore, që do të realizohen me buxhetin specifik për shëndetësi por dhe me grantin e përgjithshëm.

Sa i përket kapaciteteve teknike, DSHMS nuk ka personel adekuat për mbikqyerjen e zbatimit të punëve rehabilituese në ndertesa, por ato do të sigurohen përmes angazhimit të personelit të kualifikuar të DUKMM e DSHP. Për një sistem shëndetësor më të zhvilluar, komuna duhet të sigurojë kapacitetet e nevojshme njerëzore, duke filluar nga shërbimet e përgjithshme deri tek ato psikologjike dhe sociale (psikologë, punëtorë social për fëmijë dhe grupe të marginalizuara). Pra, duhet të punësohen së paku ka një specialist i fushës përkatëse (internist, kardialog, gjinekolog, psikiatër, etj) dhe të jenë të mirëkoordinuara dhe të mbështetura nga teknologjia moderne për të garantuar kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët. Po ashtu komuna duhet të konsideroj angazhimin e IT-ve në QKMF dhe AMF në mënyrë që të bëhet regjistrimi elektronik të pacientëve. Meqenëse buxheti i komunës është i limituar, atëherë mbështetja nga niveli qendror dhe donacionet duhet të jenë alternativë për të konsideruar.

Institucionet publike - komuna e Hanit të Elezit posedon administratën komunale në Han të Elezit, Stacionin e Zjarrfikësve, Zyren e Postës dhe Stacioni Policor. Duhet theksuar se disa nga ndërtesat kanë mungesë të shkallëve emergjente.

Përkrahja për nevojat sociale dhe kategoritë e veçanta ofrohet përmes Qendrës për Punë Sociale. Kjo qendër funksionon në Han të Elezit dhe ofron mbështetje për tërë komunën. Dhe ka vetëm 180 m². Standardi i kërkuar për parcelë në bazë të numrit të banorëve për ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare është 2,538 m², gjë që na bën të kuptojmë se duhet të ofrohet një sipërfaqe më e madhe e parcelës. Ndërsa, për ndërtesat e institucioneve të komunitetit duhet të ofrohet minimum parcela prej 2,031m². Duke qenë që nuk ka numër të madh nga komunitetet tjerë, atëherë këto shërbime mund të ofrohen edhe në ndërtesën komunale. Në kuadër të këtyre ndërtesave është edhe Dogana e Kosovës me terminalin e saj në pikën kufitare (rrugore/hekurudhore), Policia e Kufitare e vendosur në hyrje të Parkut të Qytezës tek përroi Dimca (ish prona ushtrisë) dhe që ofron shërbime të pika kufitare (rrugore/hekurudhore) dhe ruajtjen e vijës kufitare, Stacioni Hekurudhor si dhe shërbimet civile (pasaporta, letërnjoftime dhe patentë shoferë). Të gjitha këto ofrojnë shërbime cilësore për qytetarë.

Sa i përket kapacitetit teknik për menaxhimin e projekteve, komuna ka të punësuar inxhinierë të kualifikuar mirëpo me numër të limituar. Për të përgaditur dhe hartuar projektet në fusha të caktuara, komuna duhet të konsiderojë angazhimin e profesionistëve/konsulentëve si dhe do të mbështetetjen e personelit të kualifikuar të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare që i zbatojnë projektet e tilla. Ndërsa, Stacioni i Zjarrfikësve, Zyra e Postës dhe Stacioni Policor kanë kapacitetet njerëzore që mund të përgjigjen nevojave të qytetarëve të Hanit të Elezit.

Kultura - në kuadër të infrastrukturës së institucioneve kulturore, Han të Elezit posedon Qendrën e Kulturës me 3,000m². Kjo sipërfaqe nëse krahasohet me sipërfaqet e kërkuara me standarde është jo e mjaftueshme, por meqenëse është komunë jo e madhe atëherë mund të akomodohen aktivitete e kulturës. Ndërtesa përveç hapësirave kulturore të sallës së shfaqjeve, pjesës së ekspozitës, etj.; ka administratën, arkivin dhe bibliotekën me sallë leximi dhe 6178 tituj.

Sporti dhe rekreacioni - infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative përfshinë Stadiumin e Qytezës që gjendet në pjesën jugore të zonës urbane, me sipërfaqe prej 12,344 m². Përveq stadiumit, Hani i Elezit ka edhe Fushën Sportive të Çerdhja, me sipërfaqe prej 25,585 m² dhe Fushën Sportive të Lepenci me sipërfaqe prej 3,762 m². Sporti dhe rekreacioni sjellin përfitime nga aktiviteti fizik dhe janë të rëndësishme për sa i përket zhvillimit mendor. Prandaj, është thelbësore të sigurohet që banorët e Hanit të Elezit të kenë mundësi të marrin pjesë në sport dhe aktivitete fizik. Për të arritur këtë, duhet të ofrohen në të ardhmen ndërtesa, qendra të sportit që plotësojnë standardet e përcaktuara me UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH, ashtu që komuniteti dhe klubet e sportit të mos kenë nevojë t'i shfrytëzojnë ndërtesat e shkollave për të zhvilluar aktivitetet e tyre.

Hapësirat e gjelbra - Hani i Elezit e ka Parkun e Qytetit, Hapsirën gjelbëruese rreth ndërtesës së komunës, hapësirën gjelbëruese rreth ndërtesës së shkollës fillore "Ilaz Thaçi", Parkun të Ura e Seçishtës, Parkun të Memoriali "Bllaca-99", hapësirën gjelbëruese të Lapidari i të rënëve për liri, hapësirën gjelbëruese të Pishat, hapësirën gjelbëruese të varrezat e deshmoreve, hapësirën gjelbëruese të ambulanta e fshatit, hapësirën gjelbëruese të Pishat, etj. Të gjitha këto hapësira ofrojnë mundësinë e socializimit. Ajo çka është e rëndësishme është mirëmbajtja e vazhdueshme që duhet të ofrohet nga autoritetet komunale.

Ndërtesat fetare - numri i konsiderueshëm i xhamive (11) tregon që ka shërbime të ndryshme për komunitetin, përfshirë aktivitete arsimore, kulturore dhe sociale, që mund të ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të komunës së Hanit të Elezit. Duhet theksuar se çdo vendbanim ka edhe varrezat e veta, gjithsej janë 32. Sipërfaqe të veçantë paraqet Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve në Pustënik.

Realizimi i investimeve në përmirësimin e infrastrukturës sociale e publike dhe sigurimin e shërbimeve cilësore do të mund të arrihet përmes kapaciteteve njërëzore dhe financiare që i posedon komuna dhe mbështetjes nga grantet qeveritare (MMPHI, MAPL, MZHE, etj) por edhe projektet e organizatave ndërkombëtare.

Duhet theksuar se VSM-ja identifikon si kërcënim blerjen e sipërfaqeve për parqe dhe hapësirave për pushim. Një gjë e tillë kërkon financime të mëdha dhe nëse konsiderohet buxheti i limituar i Hanit të Elezit atëherë kjo mund të paraqet sfidë serioze. Një gjetje e tillë do të konsiderohet në fazat e ardhme dhe do të shërbejë si bazë për të hartuar strategjinë për PZHK-në e komunës së Hanit të Elezit.

Sa i përket kapacitetit financiar, komuna e Hanit të Elezit edhe pse me rritje për secilin vit, buxheti i planifikuar për zhvillim nuk mjafton për të adresuar të gjitha nevojat.

Me KAB 2025 – 2027 buxheti i planifikuar për investime në infrastrukturën publike e sociale përfshihet në linjat buxhetore të DKRS-së, DUKMM-së, administratës së përgjithshme, që sigurohet nga të hyrat vetanake dhe granti i përgjithshëm. Mirëpo, buxheti për këto projekte mbetet kryesisht në nivel të plotësimit të nevojave më elementare, ku përveç pagave/ mëditjeve mund të plotësohen nevojat për kompletimin e infrastrukturës teknike dhe deri diku përmirësimin të rrjetit të shërbimeve sociale dhe publike. Mirëpo, me mbështetje të donatorëve dhe MAPL, MKRS, MMPHI, MZHR, komuna e Hanit të Elezit mund të arrijë të adresojë të gjitha sfidat e lartpërmendura.

Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
- Çerdhja e re e ndërtuar dhe funksionale; - Rrjet i konsoliduar i ndërtesave shkollore të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (të gjitha objektet ofrojnë kushte optimale për ofrim të shërbimit); - Organizimi i mësimi me një ndërrim në të gjitha shkollat përveç në SHFMU në Qytet; - Hapësira sportive të brendshme dhe të jashtme në të gjitha shkollat (palestrat në Paldenicë dhe Gorancë në përfundim e sipër); - Të gjitha shkollat të pajisura me hapësira dhe mjete kabinetike (duke përfshirë edhe kabinetet e TIK, dhomat e mësimi me projektor, mësimdhënësit me laptop dhe sisteme tjera funksionale); - Infrastrukturë shumë e mirë e objekteve shëndetësore dhe shërbim optimal i ofruar (QKMF me shërbim 24 orë dhe AMF 8 orë); - Shërbime shtesë shëndetësore të ofruara (vizita gjinekologjike dhe përkujdesje shëndetësore shtëpiake); - Hapësirë e përcaktuar për banim social dhe qendër ditore për të moshuar; - Ekzistimi i mekanizmit lokal kundër dhunës në familje si dhe për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; - Infrastrukturë e mirë dhe shërbime administrative kualitative të ofruara; - Infrastrukturë relativisht e mirë sportive-kulturore (qendra e kulturës në ndërtim e sipër në Qytet, palestra e SHFMU-së kryesore shfrytëzohet edhe për nevoja të qytetit, hapësira të jashtme sportive në Qytet); - Spektër relativisht i pasur me aktivitete socio-kulturore-sportive të organizuara kryesisht për ditën e çlirimit por edhe në data tjera përkujtimore; - Ekzistenca e shoqërive kulturore-artistike dhe klubeve sportive	- Organizimi i mësimi në dy ndërrime në SHFMU në Qytet; - Mos-shfrytëzimi i duhur i mjeteve të TIK nëpër shkolla; - Qasje e vështirë në shkolla në disa raste të fëmijëve me nevoja të veçanta; - Mungesa e pajisjeve shëndetësore specifike kryesisht për QKMF; - Vështirësi në rekrutimin e stafit profesional shëndetësor (Komuna jo atraktive për profesionistë shëndetësor) që ka si pasojë edhe vështirësinë për rritjen e kualitetit të shërbimit shëndetësor (shërbimi specialistik); - Vështirësi në disa raste me furnizimin me barna esenciale; - Vështirësi në identifikimin e rasteve me nevoja sociale; - Qasje e vështirë në disa objekte publike për persona me nevoja të veçanta; - Mungesa e shtëpisë për të moshuar; - Vështirësi në arritjen e barazisë gjinore të shërbyesit publik; - Infrastrukturë jo e kompletuar sportive (mungesa e sallës së dedikuar sportive në Qytet); - Agjenda socio-kulturore vjetore me mundësi zgjerimi; - Buxhet i ulët për shërbimet sociale në përgjithësi me theks të veçantë në kulturë dhe sport; - Mungesa e OJQ-ve në Komunë; - Mungesë e shkallëve emergjente funksionale në disa objekte publike dhe objekte me apartamente; - Numër i pamjaftueshëm i hapësirave publike të rregulluara; -

Mundësitë	Rreziqet
- Shfrytëzimi i granteve dhe donacioneve për përmirësimin/ kompletimin e infrastrukturës dhe shërbimeve shkollore, shëndetësore, kulturore dhe sportive; si dhe mirëmbajtjen e asaj infrastrukture; - Bashkëpunimi me nivelin qendror, organizata dhe OJQ për avancimin profesional të stafit arsimor, shëndetësor dhe për kulturë/ rini/ sport; - Stimulimi shtesë i stafit profesional shëndetësor; - Bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për planifikim dhe aktivitete implementuese banimi (duke përfshirë banimin social) dhe të mirëqenies sociale; - Bashkëpunimi me organizata dhe OJQ-të për organizime të ndryshme socio-arsimore; dhe planifikimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike; Rritja e dendësisë së banimit në Qytet duke përfshirë edhe rritjen e etazhitetit brenda legjislacionit në fuqi;	- Zhvendosja ad-hoc e popullatës nga zonat rurale në Qytet, në vende tjera në Kosovë dhe jashtë saj që sjell rënie të numrit të nxënësve dhe vështirësi shtesë për planifikimin e infrastrukturës sociale; - Ikja e vazhdueshme stafit shëndetësor jashtë Kosovës dhe ndërrimi shpeshtë i mjekëve; - Mungesë e tokës ndërtimore në zonën urbane; - Numër i ulët i parcelave në pronësi komunale që vështirëson joshjen e investorëve të brendshëm dhe të jashtëm;

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Ngritja e cilësisë në arsim
- Ofrimi i shërbimeve sa më cilësore shëndetësore dhe shërbimeve sociale
- Zgjerimi i aktiviteteve kulturore
- Zgjerimi i rrjetit të objekteve të sportit dhe rekreacionit
- Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike dhe mirëmbajtja e tyre
- Orientimi i të rinjve drejt sportit, rekreacionit dhe kulturës

Nevojat zhvillimore

- Sigurimi i arsimit adekuat për të gjitha moshat shkollore nëpër të gjitha vendbanimet
- Përmirësimi i mëtejme i infrastrukturës shkollore në aspekt të përmbajtjeve dhe kapaciteteve
- Sigurimi i stafit profesional shëndetësor dhe shërbimeve adekuate shëndetësore nëpër të gjitha vendbanimet
- Zgjerimi i mëtejme i aktiviteteve kulturore në qendrën komunale dhe vendbanimet tjera
- Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës sportive
- Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike duke i shfrytëzuar potencialet në qendrën komunale dhe pjesët rurale

3.6 Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Prania e Dioksidit të Sulfurit - SO₂ (µg/m³), Monoksidit të Karbonit CO (µg/m³), Dioksidit të Azotit NO₂ (µg/m³), Ozonit (O₃) (mg/m³), Grimcat PM₁₀ (µg/m³), Grimcat PM_{2.5} (µg/m³) e bën Komunën e Hanit të Elezit të konsiderohet si njëra ndër komunat më të ndotura të Kosovës. Sipas matjeve, në vitin 2020 dhe 2021 sasia e SO₂ ka qenë më e lartë se në vitin 2022 dhe 2023, ndërsa sasia e CO ka qenë në rritje. Prania e Dioksidit të Sulfurit ndikon si në shëndet ashtu edhe në mjedis. O₂ kontribuon në formimin e shiut acid, i cili ndikon negativisht në ekosistemet dhe mund të

dëmtojë tokën, ujërat dhe bimësinë. Po ashtu ndihmon në formimin e aerosolëve atmosferikë që reflektojnë dritën e diellit, duke ndikuar në klimën globale.

Prania e grimcave në ajër gjatë 4 viteve ka qenë relativisht e njëjtë, PM10 ka qenë prej 16.95/m³ - 25.3/m³, ndërsa PM2.5 13.1 µg/m³- 17.62µg/m³. Duhet penguar rritjen e sasisë së grimcave PM2.5, sepse ndikimi i saj në shëndetin publik dhe mjedisin mund të jetë shumë i dëmshëm. PM2.5 përbëhet nga grimca të vogla, më të vogla se 2.5 mikrometra, që mund të depërtojnë thellë në sistemin respirator dhe të shkaktojnë një sërë probleme shëndetësore. Është shumë e rëndësishme monitorimi i niveleve të PM2.5 dhe marrjen e masave për të reduktuar sepse këto grimca ndikojnë në ekosistemet natyrore.

Për të menaxhuar dhe reduktuar ndotjen në ajër, duhet të vendosen rregullore dhe standarde për cilësinë e ajrit, si dhe inkurajohet përdorimi i teknologjive të pastra dhe burimeve të rinovueshme. Duke qenë që Sharrcem është ndotës kryesor i ajrit, atëherë duhet të parashihet aplikimi i masave teknologjike sikurse instalimi i filtrave dhe sistemeve për pastrimin e ajrit. Po ashtu përrreth Sharrcemit është më se e domosdoshme të parashihen breza mbrojtës me gjelbërim, të bëhet spërkatja dhe larja e rregullt e rrugëve për të parandaluar ngritjen e pluhurit nga automjetet dhe aktivitetet industriale si dhe të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i emetimit përmes instalimit të sensorëve për matjen e cilësisë së ajrit.

Karakteristikë për Hanin e Elezit është edhe ndotja e lumit dhe bregut të Lepencit nga mbetjet e asbest-çimentos të derdhura për dhjetëra vite nga industria tashmë jo funksionale. Si burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre. Ndotja e ujit sikurse ajo e ajrit ndikon në shëndetin e njeriut, ekosistemet si dhe në ekonomi sepse zonat e ndotura mund të ndikojnë në turizmin dhe bujqësinë, duke shkaktuar humbje ekonomike. Për të trajtuar dhe reduktuar ndotjen e ujit, është e rëndësishme të zbatohen politika strikte dhe praktika të qëndrueshme për menaxhimin e ujit, si dhe edukimi i publikut në lidhje me rëndësinë e përdorimit të ujit të pastër dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

Si ndotësit kryesorë të tokës në komunën e Hanit të Elezit janë evidentuar edhe mbeturinat e ngurta të akumuluar në deponi. Duhet theksuar se mbeturinat e deponuara mund të përmbajnë substanca të dëmshme, të cilat mund të shkaktojnë sëmundje infektive dhe alergjike për ata që jetojnë afër deponive. Menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave kërkon burime financiare dhe përpjekje të konsiderueshme për të parandaluar ndotjen, prandaj komuna duhet të konsiderojë edhe mbështetjen e donatorëve. Për të menaxhuar ndikimet e mbeturinave të ngurta në deponitë, është e rëndësishme të zhvillohen dhe zbatohen strategji të qëndrueshme, sikurse Riciklimi, Rritja e Ndërgjegjësisë, Planifikimi dhe Menaxhimi i Deponive.

Si rrezikshmëri janë evidentuar vërshimet (lumi Lepenc së bashku me përroin e Rezhancës, dhe përrenjtë e Seçishtes, Dimces e Laçit), rrëshqitja e dheut, erozioni dhe termeti. Menaxhimi efektiv i vërshimeve kërkon një qasje të koordinuar, duke përfshirë institucionet qeveritare, organizatat joqeveritare, komunitetet dhe individët. Përmes parashikimeve të sakta, infrastrukturës të fortë dhe një qëndrim proaktiv, është e mundur të zvogëlohen pasojat e vërshimeve në jetën dhe pronat e njerëzve. Duhet theksuar se identifikimi i cenueshmërive ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zvogëlimin e pasojave negative nga vërshimet.

Për të menaxhuar rrëshqitjet e dheut duhet konsideruar analizat gjeologjike për të kuptuar faktorët kontribues si shpërbërja e tokës, lëvizjet e ujit, dhe ndërtimi. Duke qenë që edhe erozioni është i pranishëm në komunën e Hanit të Elezit, duhet konsideruar menaxhimin e bimësisë, përdorimin e barrierave natyrore (drunjëve), sistemet e drenazhimit dhe monitorimin e rregullt me teknologji. Fatkeqësisht Hani i Elezit ndodhet në një zonë me rrezik të lartë nga termeti. Këtë dukuri natyrore nuk mund të parandalojmë, por ajo që mund të bëhet është zvogëlimi i pasojave. Prandaj duhet konsideruar ndërtimin e strukturave të qëndrueshme, projektimin dhe ndërtimi i ndërtesave dhe infrastrukturës që janë të rezistueshme ndaj tërmeteve, duke përdorur materiale dhe teknika speciale. Ndërgjegjësimi i popullatës është shumë me rëndësi, prandaj organizimi i stërvitjeve të rregullta për të përgatitur popullatën për të reaguar në mënyrë të shpejtë dhe efikase pas një

tërmeti është e domosdoshme. Krijimi i një plani emergjent për të udhëhequr ndihmën dhe evakuimin e njerëzve pas një tërmeti, përcaktimi i vendeve të sigurta dhe të përgatitura për strehim të përkohshëm, monitorimi sizmologjik, pjesëmarrja e komunitetit janë të domosdoshme për zvogëlimin e pasojave.

Pikat e dobëta të identifikuara me VSM janë ndodhet nga fabrika e çimentos, ndotja e ujerave, mos trajtimi i hot spoteve mjedisore, mos trajtimi i zonave të mbrojtura mund të shkaktojnë kërcënime serioze mjedisore dhe shëndetësore. Më tutje theksohet se zbatimi i standardeve më strikte, për “Sharr Cem”, gazrat në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve, menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. PM10 mund të reduktohet nëpërmjet përdorimit të teknikave më të mira të ndërtimit dhe shtrimit të më shumë rrugëve. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së dobët të ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së sëmundjeshmërisë me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën.

Raporti i VSM-së thekson se studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmike në rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet hartuar raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit me standard të lartë. Po ashtu potencohet se duhet të behën studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënës, kohën dhe lokacionet më të atakuara. Sa i përket ndotjes së tokës, komuna duhet të hartojë Planin e menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim, analizë dhe VNM të detajuar; Masat adekuate për shëndetin e njerëzve; Masat tjera për konsolidim të tokës, mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dhe Biodiversitetit dhe ekosistemeve tjera. Të gjitha këto konstatime nga VSM do të shërbejnë si bazë për të hartuar startegjinë, objektivat dhe aktivitetet për komunën e Hanit të Elezit.

Rekomandimet e dala nga Raporti i VSM-së për mbrojtjen e mjedisit janë:

- Studime mbi gjendjen e biodiversitetit dhe habitateve natyrore në komunën e Hanit të Elezit;
- Definimi i korridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara si dhe atyre të ndërtuara siç është rasti me propozimin e urës kaluese të shtazëvenë autostradë;
- Hartimi i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e erozionit dhe vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industrisë apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në PZHK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si masë të rëndësishme mjedisore;
- Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundësisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi transite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujërat nëntokësor dhe sipërfaqësor;
- Definimi i peizazheve, parqeve me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;
- Projekti për ngrohjen kolektive të qytetit të Hanit të Elezit por edhe vendbanimeve;
- Projekte për caktimin e zonave të zhurmës;
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

Analiza SWOT

Përparësitë - Mjedis relativisht i pastër në zonat rurale; - Aktivitetet të shpeshta për pastrimin e natyrës dhe hapësirave publike (Komuna, OJQ-të, bizneset) - Zonat natyrore në fillet e promovimit të tyre (Pustenic, Gorancë, Neçavc dhe Dërmjak); - Shtretër të përrenjve të rregulluar që kanë reduktuar në minimum vërshimet (zona urbane dhe zonat përreth); - Planet dhe rregulloret e hartuara lokale për menaxhimin e rrezikut; - Shërbimi i zjarrfikësve, shtabi i emergjencave dhe njësia për intervenimin në situata emergjente; - Aparate për zjarr fikje në objekte publike.	Dobësitë - Ndotje e ajrit në zonën urbane dhe vendbanimet përreth (në lindje të Lumit Lepenc) nga industria e çimentos; - Zona të caktuara të ajrit të ndotur nga gurëthyesit dhe infrastruktura; - Vendosja e stacionit për monitorim të ajrit jo në lokacionin e duhur; - Ndotje e ujërave ujërat e zeza; - Ndotje e tokës dhe ujërave nga materialet e mbetura të asbestit; - Ndotje e tokës nga deponitë ilegale të mbeturinave; - Humbje e peizazhit nga gurëthyesit; humbje e peizazhit dhe potencialit turistik nga prerjet ilegale të pyjeve; - Kapacitete të ulëta (staf i kufizuar që ka nevojë për ngritje profesionale) në administratën komunale për tu marrë me mjedisin; mungesa e OJQ-ve mjedsiore; - Mungesa e hidrantëve në vendbanime; - Kapacitete jo të duhura të stafit dhe pajisjeve për zjarrfikës.
Mundësitë - Mjedis/ trashëgimi natyrore shumë e pasur (dy masivet malore Sharri dhe Karadaku, lugina e Lepencit dhe Dimces, peizazh i mrekullueshëm që kufizon të gjitha horizontet, etj.); - Biodiversiteti i pasur; - Pyje atraktive; - Bashkëpunime me organet kompetente për reduktimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; - Bashkëpunime me organizata dhe OJQ për planifikimet bazë për mjedisin; - Grante dhe donacione për planifikim dhe përmirësime mjedsiore (shirita të gjelbër, pyllëzime, shtretër të lumenjve, hapësira publike, rehabilitim të mihjeve sipërfaqësore, etj.); - Bashkëpunimi me qeverinë qendrore dhe donatorë për ngritjen e kapaciteteve (stafit dhe pajisjeve) për zjarrfikës.	Rreziqet - Vazhdim i mëtutjeshëm i ndotjes/ degradimit të mjedisit/ trashëgimisë natyrore (ajri, uji dhe toka); - Ndikimi negativ i ndotjes në shëndet të banorëve; - Humbje potenciale e biodiversitetit, - Rrezik i mëtejshëm për humbjen e trashëgimisë kulturore; - Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu (vërshimet, erozioni, zjarret e pyjeve, rrëshqitjet e tokës dhe shembjet e dheut, etj.); - Mos-koordinimi i institucioneve kompetente mjedsiore dhe për mbrojtjen nga rreziku.

Sfidat kryesore të identifikuar janë:

- Reduktimi i ndotjes së ajrit
- Mbrojtja e ujërave dhe pyjeve
- Mbrojtja nga fatkeqësitë

Nevojat zhvillimore

- Reduktimi i ndotjes së ajrit nga industria e çimentos, transportit dhe gurëthyesve
- Pastrimi dhe rregullimi i brezave dhe shtretërve të lumenjve me qëllim të sigurimit të rrjedhjes dhe shmangies së vërshimeve
- Largimi i deponive joformale dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes
- Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave dhe riciklimi i tyre
- Trajtimi i ujërave të para shkarkimit në rrjedha natyrore ujore
- Monitorimi i përdorimit të plehrave kimike në toka bujqësore

3.7 Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

Trashëgimia natyrore - Komuna e Hanit të Elezit edhe pse e pasur me peisazhe natyrore nuk ka asete që janë të përfshira në listë të mbrojtjes nga MMPHI. Duke qenë qënë që pyjet e ahut në Malet e Kardiakut paraqesin atraksion turistik atëherë autoritetet përgjegjëse duhet të punojnë në drejtim të futjes në listë të mbrojtjes. Prania e ahut (*fagus sylvatica*), qarrit (*quercus cerris*), bungut, shkoza (*carpinus orientalis*), bliri (*tilia kordata*), frashri, lloji i shkurreve si thana (*cornus mas*), murri (crataegus monogyna), kaça (*rosa canina*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*), si dhe lloji me karakter endemik e quajtur “*Convovulus cochlearis*” (Dredhja e Kosovës) e bën edhe më të veçantë këtë komunë. Të gjitha këto kontribuojnë në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke lejuar që ato të funksionojnë në mënyrë efektive dhe të përballojnë ndryshimet mjedisore prandaj, mbrojtja e tyre është e domosdoshme. Duhet theksuar se prania e një numër gjitarësh, si ariu i murrmë (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe shpendët si shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), thëllëza e malit (*Alectoris graeca*), skifteri kthetrabardhë (*Falco naumanni*), bufi (*Bubo bubo*), dhe shkaba (*Gyps fulvus*) ndihmojnë në funksionimin e shëndetshëm të ekosistemeve. Prandaj, mbrojtja e faunës është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve të qëndrueshme.

Sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë natyrore mund të kenë një ndikim të madh hapësinor dhe të krijojnë mundësi të shumta për zhvillim të qëndrueshëm. Duhet theksuar se ato ndikojnë në disa aspekte duke filluar nga aspekti *Hapësinor* ku përfshihet ruajtja e Ekosistemeve (në ruajtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit, duke siguruar mbrojtjen e specieve të rralla dhe të rrezikuara). Krijimi i korridoreve ekologjike është një tjetër aspekt që ndihmon në lidhjen e zonave të mbrojtura, duke mundësuar migrimin e kafshëve. Përmirësimi i menaxhimit të tokës dhe ndalimi i shfrytëzimit të tepruar të resurseve natyrore ndihmon në ruajtjen e cilësisë së tokës dhe ujit.

Këto sipërfaqe ofrojnë mundësi të reja të zhvillimit, si ekoturizmi, punësimi lokal dhe edukimi. Të gjitha këto drejtëpërsëdrejti ndërlidhen me përfitime ekonomike nga të ardhurat nga turizmi. Duhet theksuar se ekoturizmi mund të gjeneron të ardhura të konsiderueshme për komunitetin e Hanit të Elezit dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në nxitjen e sjelljeve të përgjegjshme ndaj natyrës. Implementimi i praktikave të qëndrueshme në menaxhimin e sipërfaqeve të mbrojtura ndihmon në ruajtjen afatgjatë të resurseve natyrore në komunën e Hanit të Elezit.

Mund të konkludohet se trashëgimisë natyrore e Hanit të Elezit është një potencial i madh me ndikime pozitive hapësinore dhe zhvillim të qëndrueshëm. Këto sipërfaqe jo vetëm që ruajnë biodiversitetin dhe ekosistemet, por gjithashtu krijojnë mundësi për zhvillim ekonomik, edukim, dhe ndërgjegjësim publik.

Trashëgimia kulturore - komuna e Hanit të Elezit me një numër prej 10 astetve të trashëgimisë arkitekturore dhe 2 të asaj arkeologjike pasqyron identitetin dhe historinë e popullatës që jetojnë në

këtë zonë. Lista e larmishme e monumenteve: shtëpi, mulli dhe ndërtesa fetare ngërthejnë në vete vlera historike, kulturore dhe artistike. Trashëgimia kulturore duke qenë një katalizator i rëndësishëm për zhvillim të turizmit, mbrotja e këtyre vlerave është e domosdoshme sepse ofrojnë burime të pasura për edukimin e brezave të rinj dhe janë atraksion për turistë të huaj dhe vendor. Turizmi kulturor dhe natyror ka potencial të madh për të rritur të ardhurat e një vendbanimi sikurse që është Hani i Elezit. Fokusi në këtë sektor do të mund të krijonte shumë mundësi për punësim në fushën e hotelërisë, transportit, dhe shërbimeve turistike dhe përvojë të mirë për vizitorët që shpenzojnë në ushqim, suvenire, dhe aktivitete turistike në male. Në të njëjtën kohë, njohja e vizitorëve me kulturën, trashëgiminë, dhe traditat, do të kontribuonte në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe peizazheve nga komuniteti lokal.

Sidoqoftë, mundësitë e kufizuara financiare për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore janë një ndër sfidat kryesore që përballet komuna. Autoritetet komunale duhet të konsiderojnë avokimin dhe lobimin për rritje të buxhetit për kulturën dhe trashëgiminë nga niveli qendror, përdorimi i fondacioneve/granteve, bashkëpunimi me OJQ, shkëmbimi i eksperiencave etj. Sipërfaqet/monumentet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore (në kuadër të listës së trashëgimisë arkitekturale përfshihen 10 monumente/ansamble, një i ndërtuar në shek. XVII kurse tjerat të ndërtuara gjatë shekujve XIX dhe XX) kanë ndikime të mëdha hapësinore dhe krijojnë shumë mundësi për zhvillim të qëndrueshëm. Sikurse edhe trashëgimia natyrore, trashëgimia kulturore ndikon në disa aspekte. Aspekti i parë është ai *hapësinor* që përfshinë ruajtjen e strukturës historike të zonave, duke parandaluar zhvillimin e pakontrolluar dhe degradimin e mjedisit të ndërtuar. Gjatë zhvillimeve medoemos duhet konsideruar Zonat Mbrojtëse sipas rregullores të MKRS-së, rreth lokaliteteve arkeologjike dhe trashëgimisë arkitekturale (100-50m). Nxitja e restaurimeve dhe rikonstruimeve është një tjetër ndikim që ndihmon në mbrojtjen e vlerave estetikës, historike dhe kulturore.

Aspekti tjetër është se ofron mundësi për zhvillimin e turizmit kulturor që sjellin vizitorë dhe gjeneron të ardhura për ekonominë lokale. Kjo përfshin zhvillimin e shërbimeve turistike si guidat, muzetë dhe shfaqjet kulturore. Është me rëndësi të theksohet se mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Hanit të Elezit ofron mundësi për investime dhe fonde për konservim dhe zhvillim, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve lokale dhe në të njëjtën kohë mund të shërbejnë si qendra për edukim dhe ndërgjegjësim, duke ofruar mundësi për mësim dhe hulumtim për studentët, studiuesit dhe publikun e gjerë. Ndikimi tjetër është se rrit ndjenjën e krenarisë dhe përkatësisë të banorëve që jetojnë në Han të Elezit duke kontribuar në kohezionin social dhe mirëqenie.

Duhet potencuar se edhe Raporti i VSM-së, si pika të dobëta ka potencuar mangësitë në trajtimin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, të ndërtuar dhe natyrore. Në VSM theksohet se humbjet e vlerave kulturore dhe turistike, do të rezultojnë me vendbanime pa asnjë banor, me kosto të lartë që shkaktojnë sfida sociale dhe ekonomike. Raporti i VSM-së ka rekomanduar konservimin e veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) si objekte natyrore dhe si zona. Duke i marrë për bazë të gjitha konstatimet në faza të ardhshme do të hartohet strategjia për komunën e Hanit të Elezit.

Analia SWOT

Përparësitë	Dobësitë
- Zonat natyrore në fillet e promovimit të tyre (Hani i Elezit, Pusteni, Gorancë, Neçavc, Dimcë dhe Dërmjak); - Trashëgimi i rregulluar historike e luftës së fundit (varrezat e dëshmorëve, lapidarët, pikat e rëndësishme);	- Humbje e peizazhit nga gurëthyesi; humbje e peizazhit dhe potencialit turistik nga prerjet ilegale të pyjeve; - Sfida buxhetore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të identifikuar; - Mungesa e hidrantëve në vendbanime;

- Lista e objekteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme; - Shtretër të përrenjve të rregulluar që kanë reduktuar në minimum vërshimet (zona urbane dhe zonat përreth); - Planet dhe rregulloret e hartuara lokale për menaxhimin e rrezikut; - Shërbimi i zjarrfikësve, shtabi i emergjencave dhe njësia për intervenimin në situata emergjente; - Aparatë për zjarr fikje në objekte publike dhe të aseteve të trashëgimisë kulturore.	
Mundësitë - Mjedis/ trashëgimi natyrore shumë e pasur (dy masivet malore Sharri dhe Karadaku, lugina e Lepencit dhe Dimces, peizazh i mrekullueshëm që kufizon të gjitha horizontet, etj.); - Pyje atraktive; - Trashëgimi kulturore/ historike e pasur (trashëgimi antike, mesjetare dhe e luftës së fundit); - Bashkëpunime me organizata dhe OJQ për aktivitete të promovimit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore; - Grante dhe donacione për planifikim dhe përmirësime mjedisore (shirita të gjelbër, pyllëzime, shtretër të lumenjve, hapësira publike, rehabilitim të mihjeve sipërfaqësore, etj.); - Mbështetje nga MKRS për intervenime në asetet e trashëgimisë kulturore.	Rreziqet - Vazhdim i mëturjeshtëm i ndotjes/ degradimit të mjedisit/ trashëgimisë natyrore (ajri, uji dhe toka); - Humbje potenciale e biodiversitetit, - Rrezik i mëtejshëm për humbjen e trashëgimisë kulturore;

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Reduktimi i ndotjes së natyrës
- Mbrojtja e ujërave dhe pyjeve
- Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore nga fatkeqësitë

Nevojat zhvillimore

- Reduktimi i ndotjes së ajrit nga industria e çimentos, transportit dhe gurëthyesve
- Pastrimi dhe rregullimi i brezave dhe shtretërve të lumenjve me qëllim të sigurimit të rrjedhjes dhe shmangies së vërshimeve
- Largimi i deponive joformale dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes
- Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave dhe riciklimi i tyre
- Trajtimi i ujërave të para shkarkimit në rrjedha natyrore ujore
- Monitorimi i përdorimit të plehrave kimike në toka bujqësore
- Mbrojtja e monumenteve të trashëgimisë natyrore
- Mbrojtja e monumenteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore (arkitektonike, arkeologjike) nga ndërtimet, ndotja dhe llojet tjera të degradimeve

3.8 Vendbanimet

3.8.1 Vendbanimet sipas karakterit

Komuna e Hanit të Elezit ka 11 vendbanime zona urbane (qyteza) Hani i Elezit me 10 vendbanime rurale.

3.8.2 Vendbanimet sipas madhësisë dhe numrit të banorëve

Bazuar në kushtet e U.A MMPH Nr. 08/2017 mbi NTPH për klasifikimin e vendbanimeve sipas madhësisë dhe numrit të banorëve rezulton të ketë një vendbanim të madh rural që është zona urbane, tre vendbanime të mesme të mëdha rurale, dy të mesme rurale, dy të vogla rurale dhe dy vendbanime shumë të vogla rurale.

Vendbanimi	Klasifikimi i vendbanimeve	Numri i banorëve 2024 ⁵¹
Hani i Elezit	Vendbanim i madh rural	2,555
Seçishtë	Vendbanim i mesëm i madh rural	2,123
Paldenicë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,629
Gorancë	Vendbanim i mesëm rural	767
Pustenik	Vendbanim i vogël rural	403
Rezhancë	Vendbanim i vogël rural	487
Dimcë	Vendbanim shumë i vogël rural	147
Krivenik	Vendbanim i vogël rural	204
Dërmjak	Vendbanim shumë i vogël rural	108
Neçavc	Vendbanim shumë i vogël rural	102
Vërtomicë	Vendbanim shumë i vogël rural	8

Tabela 51. Klasifikimi i vendbanimeve sipas UA 8/2017 (banorët për vendbanime sipas vlerësimit 2022)

Sipas tabelës vërehet që në komunë mbizotërojnë me 36% vendbanimet shumë të vogla rurale dhe ato shumë të vogla rurale me 27%.

3.8.3 Vendbanimet sipas funksionit

Zona urbane – qyteza Hani i Elezit është qendër e administrative, në të cilën ofrohen shërbimet administrative, shëndetësore, arsimore, kulturore dhe tregtare për të gjithë banorët e komunës. Në qytezë gjendet komuna, QKMF, çerdhja, shkolla fillore dhe e mesme, bizneset, industria etj. Numri i banorëve në vitin 2024 është 2,555 banorë rreth 30% e popullsisë së komunës.

Vendbanimet rurale – fshatrat – përmbajtjet dhe funksionet që mbizotërojnë janë banimi dhe në disa vendbanime edhe shërbimet shëndetësore, arsimore e tregtare. Shërbimi shëndetësor ofrohet në Gorancë ndërsa ai fillor dhe i mesëm i ulët në Paldenicë, Gorancë dhe përmes paraleles në Seçishtë. Sa i përket shërbimeve tregtare ofrohen kryesisht në Gorancë, Paldenicë dhe Seçishtë.

3.8.4 Vendbanimet sipas llojit dhe lartësisë mbidetare

Komuna e Hanit të Elezit karakterizohet me reliev kodrinor malor dhe malor si dhe fushor përgjatë rrjedhave ujore. Komuna rrethohet nga Malet e Sharrit dhe Karadakut.

Zona urbane, Hani i Elezit shtrihet në lartësinë mbidetare më të ultë prej 350 – 800m, Dimca, Dremjaku, Pladenica, Seçishta dhe Rezhanca prej 350 – 1000m, Vërtomica dhe Neqavci prej 800 – 1218 m, Kriveniku prej 600-800m, Goranca prej 600-1000m dhe Pusteniku 350 – 1000m lartësi.

⁵¹ Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë 2024

Vendbanimet rurale Kriveniku, Seçishta, Goranca, Rezhanca dhe Pusteniku shtrihen në Malet e Sharrit, ndërsa Paldenica, Dimca, Dërmjaku, Neçavci dhe Vërtomica në Malet e Karadakut.

Vendbanimi	Numri i banorëve 2024 ⁵²	Morfologjia	Lartësia mbidetare (m)	Tipologjia e zhvillimit
Hani i Elezit	2,555	Fushore	350 - 800	E shpërndarë
Seçishtë	2,123	Kodrinoro - malore	350 – 1,000	E shpërndarë
Paldenicë	1,629	Kodrinoro - malore	350 – 1,000	E shpërndarë
Gorancë	767	Kodrinoro - malore	600 – 1,000	E grupuar
Pustënik	403	Kodrinoro - malore	350 – 1,000	E shpërndarë
Rezhançë	487	Kodrinoro - malore	350 – 1,000	E shpërndarë
Dimcë	147	Kodrinoro - malore	350 – 1,000	E grupuar
Krivenik	204	Malore	600 – 800	E grupuar
Dërmjak	108	Kodrinoro - malore	350 – 1,000	E shpërndarë
Neçavc	102	Malore	800 – 1,218	E grupuar
Vërtomicë	8	Malore	800 – 1,218	E grupuar

Tabela 52. Vendbanimet sipas lartësisë mbidetare

3.8.5 Trendi i zhvillimit të vendbanimeve

Analizat e trendit të zhvillimeve ndër vite, tregojnë zhvillim jo të barabartë ndërmjet zonës urbane dhe rurale. Zona urbane karakterizohet me një intensitet të lartë të zhvillimit për shkak të koncentrimit të të gjitha shërbimeve publike e sociale dhe atyre tregtare. Pjesëmarrja e sipërfaqes së ndërtuar në raport me sipërfaqen e përgjithshme të zonës urbane është rreth 88 ha respektivisht 76% e sipërfaqes së përgjithshme të saj. Sa i përket vendbanimeve rurale zhvillim mesatar të banimit dhe shërbimeve tregtare dhe bujqësi kanë pasur Paldenica, Goranca dhe Seçishta, një numër tjetër kanë pasur zhvillim të ulët të banimit dhe bujqësisë, përderisa disa nuk kanë pasur zhvillim si rezultat i largimit të popullsisë.

Cështja e zbrazjes së disa vendbanimeve është theksuar edhe nga Raporti i VSM-së. Sipas tij, zbrazja e vendbanimeve dhe presioni i rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime është si rezultat i mungesës së vendeve të punës, papunësisë, shërbimeve dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të menaxhohen.

3.8.6 Sipërfaqet e ndërtuara në kuadër të vendbanimeve

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Hanit të Elezit është 8,317 ha, brenda së cilës hapësira e ndërtuar zënë 400 ha, në kuadër së cilës përfshihet banimi i përhershëm dhe funksione në pajtueshmëri, industri e prodhimit të lëndës së parë, shërbime, rrjeti i transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike, ndërsa pjesa tjetër është bujqësi, pylltari, minierë e gurore dhe tokë ujore.

⁵² Burimi: ASK, Regjistrimi i popullsisë 2024

Klasa Hilucs 1	Klasa Hilucs 2	Klasa Hilucs 3	Sipërfaqja (ha)	%
Prodhim parësor	Bujqësi	Tokë e punueshme dhe kullësë	2,606.4	31.3
Prodhim parësor	Pylltari	Pylltari	5,194.4	62.4
Prodhim parësor	Minierë dhe gurorë		47.3	0.6
Prodhim dytësor	Industri e lëndës së parë	Prodhim i produkteve jo metalike minerale	24.2	0.3
Prodhim tretësor	Shërbim tregtar	Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake, i patundshmërisë, akomodimit dhe ushqimit, etj.	4.6	0.05
Prodhim tretësor	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	Shërbim financiar dhe i sigurimit, administrativ dhe mbështetës, të informimit dhe komunikimit		
Prodhim tretësor	Shërbim i komunitetit	Shërbim i administratës publike, mbrojtjes dhe sigurisë sociale, arsimor, shëndetësor dhe shoqëror, fetar, etj.	22.7	0.3
Prodhim tretësor	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	Shërbim kulturor, argëtues, infrastrukturë sportive, hapësirë e hapur rekreative, etj	1.3	0.01
Rrjetet e transportit, ligjistikës dhe infrastrukturë publike	Rrjetet e transportit	Infrastruktura e transportit rrugor, hekurudhor	130.5	1.6
Banim	Banim i përhershëm		177.3	2.1
Banim	Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri		6.8	0.08
Shfrytëzim tjetër		Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	86.3	1.0
		Gjithsej	8,317	

Pjesëmarrja e sipërfaqes ndërtimore në vendbanimet rurale është shumë e ulët me rreth 5% e sipërfaqes së përgjithshme të zonave kadastrale. Zona urbane së bashku me vendbanimet afër saj kanë sipërfaqe më të madhe të ndërtuar në krahasim me vendbanimet tjera të cilat e kanë sipërfaqen mjaft të ultë. Gjatë planifikimit të zhvillimeve në zonën urbane dhe sidomos në vendbanimet Paldenicë dhe Gorancë do të inkurajohet me shumë plotësimi dhe zgjerimi minimal i kufirit aktual ndërtimor për t'i akomoduar nevojat e popullsisë aktuale dhe asaj të projektuar për banim, punësim, rekreim e argëtim, hapësira të gjelbra gjithashtu do të ndërmerren masa të duhura që do të ndikojnë në parandalimin dhe minimizimin e ndikimit negativ në mjedis.

Nr.	Vendbanimi	Sipërfaqja e zonës kadastrale (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar 2018 (ha)	Raporti i sipërfaqes së ndërtuar ndaj sipërfaqes së vendbanimit (%) ⁵³
1.	Dimcë	212	6	3
2.	Dërmjak	615	10	2
3.	Gorancë	2080	42	2
4.	Han i Elezit	116	82	70
5.	Krivenik	1228	22	2
6.	Neçavc	438	10	2
7.	Paldenicë	404	90	22
8.	Pustenik	1087	35	3
9.	Rezhancë	852	24	2

⁵³ Mungojnë të dhënat për sipërfaqet e lira Brenda zones së ndërtuar të vendbanimit

10.	Seçishtë	850	46	5
11.	Vërtomicë	438	1	0
	Komuna	8317	370	4

Tabela 53. Përqindja e tokës ndërtimore në raport me sipërfaqen e vendbanimit

Vendbanimi	Popullsia Regjistrimi 2024	Sip. e banimit (ha) - 2018	Dendësia e banimit ban/ha
Dimcë	249	4	58
Dremjak	121	6	22
Gorancë	1,028	21	49
Han i Elezit	2,533	23	112
Krivenik	283	9	9
Neçavc	110	2	48
Paldenicë	1,723	50	34
Pustenik	629	20	32
Rezhancë	475	14	35
Seçishtë	2,252	35	64
Vërtomicë	0	0	0

Tabela 54. Dendësia e banimit

Zhvillimet do të monitorohen vazhdimisht nga ana autoriteteve komunale për të siguruar që të realizohen në përputhje me këtë plan.

3.8.7 Vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje

Në komunë ekziston një vendbanim formal i ashtuquajtur Lagja Brava, që gjendet në zonën kadastrale të vendbanimit Pustenik në afërsi me zonën urbane. Vendbanimi identifikohet si vendbanim joformal si rezultat in ndërtimeve në pronën e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe rrezikut nga rrëshqitjet e dheut në rrugën që shpie për në lagje.

Sipërfaqja e tij është 2.82 ha dhe numëron 170 banorë, 34 ndërtesa të banimit dhe një ndërtesë publike që i shërben nevojave të vendbanimit.

Deri më sot komuna ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe qasjes në shërbime publike dhe sociale.

Cështja e cila duhet të trajtohet është vetëm ajo e pronësisë, ku komuna do të hartoj një plan/program për rregullimin e saj duke bashkëpunuar ngusht me komunitetin dhe pastaj të negocioj me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës.

Rregjistri i komunës për ndërtimet pa leje pasqyron që në komunë ekzistojnë gjithsej 1,822 ndërtesa pa leje, ndër të cilat 1,472 janë shtëpi banimi, 27 ndërtesa komerciale, 283 shtalla, 35 garazha dhe 6 depo. Megjithëse, komuna ka ndërmarrë masat në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, interesimi i qytetarëve për legalizim është ende i ulët.

Do të duhet të ndërmerren më shumë aktivitete informuese dhe vetëdijësuese me qëllim të inkurajimit të qytetarëve për aplikim.

Komuna do t'i planifikoj dhe organizoj këto organizata në bashkëpunim me OJQ lokale apo ndërkombëtare dhe me mbështetje financiare të Qeverisë respektivisht MMPHI dhe donatorët.

Për shkak të zhvillimit të hovshëm komuna rrezikohet nga krijimi i VBJ të reja dhe ndërtimeve pa leje, ku për të penguar këtë dukuri është i domosdoshëm kontrollimi i vazhdueshëm i zhvillimeve dhe zbatimi i plotë i PZHK-së dhe HZK-së në të ardhmen.

Analiza SWOT

Përparësitë - Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën komunale; - Të gjitha vendbanimet janë tashmë të konsoliduara dhe me shërbime publike të ofruara; - Plani Zhvillimor Komunal në fuqi (PZHK e re në hartim e sipër); Harta Zonale e Komunës në hartim e sipër; Plani Rregullues Urban i hartuar.	Dobësitë - Shtrirje joformale hapësinore përgjatë rrugës nacionale që mund të rezultojë në joformalitet; - Sipërfaqe shumë e kufizuar e pronës komunale; - Sfida të shumta gjatë zbatimit të planeve hapësinore (strategjike dhe operative).
Mundësitë - Zgjerimi i zonës urbane në pronat komunale; - Bashkëpunime me organizata dhe OJQ për planifikimin dhe rregullimin e vendbanimit joformal.	Rreziqet - Vazhdimi i trendit të zhvillimit hapësinor pa kriterë që mund të rezultojë me probleme sociale; - Kufizime fizike gjeografike që e vështirësojnë zgjerimin të zonës urbane.

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore
- Ofrimi i kushteve më të mira të planifikuara brenda zonave të ndërtuara
- Zhvillimi i vendbanimeve me dendësi adekuate
- Menaxhimi i migrimit brenda-komunal
- Gjetja e fondeve për zhvillim social dhe punësim
- Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera

Nevojat zhvillimore

- Konsolidimi i strukturës së ndërtuar të qendrës komunale brenda zonës aktuale të ndërtuar
- Konsolidimi i strukturës së ndërtuar të vendbanimeve tjera brenda zonave aktuale të ndërtuara, duke e ruajtur karakterin e tyre lokal
- Kompletimi i shërbimeve adekuate sociale dhe publike në të gjitha vendbanimet rurale
- Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimit

3.9 Banimi

Komuna e Hanit të Elezit karakterizohet me banim individual me 97.7% dhe me një përqindje të vogël të banimit kolektiv. Sipas të dhënave nga zyra komunale e tatimit në pronë në vitin 2023 gjithsej janë 1673 ndërtesa të banimit respektivisht 1,866 njësi të banimit, ku në zonën urbane ndodhen rreth 484 njësi të banimit kurse në zonën rurale 1,382, nuk ka të dhëna të sakta rreth numrit të njësive për vendbanimet rurale. Sipas të dhënave nga Regjistrimi i popullsisë në vitin 2024 në komunë janë gjithsej 1,914 njësi të banimit, dhe nga këto njësi rreth 14.7% janë të pa banuara që është numri më i ulët nëse e krahasojmë me numrin nga regjistrimi i popullsisë të vitit 2011, e që ishte 16.60%, që mund të jetë një tregues i rritjes së numrit të familjeve në komunë.

Numri me i madh i ndërtesave të banimit janë ndërtuar në periudhën e pas luftës dhe janë në gjëndje të mirë. Përkundër faktit që ndërtesat janë të reja, ato nuk janë përcjellë gjithmonë me shërbime adekuate publike, duke ndikuar në mjedis por edhe në shëndet të qytetarëve. Prandaj përmirësimi qoftë i njësive të banimit poashtu edhe i shërbimeve përcjellëse është i domosdoshëm.

Ashtu si në shumicën e komunave të Kosovës edhe në komunën e Hanit të Elezit familjet me të ardhura të ulëta dhe ato sociale e kanë të pabërballueshme të sigurojnë strehimin, andaj është e nevojshme që të përpilohet programi për ofrim të banimit të përbalueshëm për këto familje si dhe programe të punësimit për të zvogëluar deri në një masë nevojat për banim social. Një aspekt pozitiv është që Komuna tashmë e ka të hartuar programin 3 vjeçar për banim për periudhën 2022-2024, i cili e ndihmon Komunën në trajtimin e duhur e kësaj çështje.

Nevojat për banim – sipas projesionit të popullsisë në vitin 2033 komuna e Hanit të Elezit parashikohet të ketë gjithsej 8,262 banorë dhe rreth 2,360 ekonomi familjare (bazuar në mesataren e synuar 3 - 4 anëtarë për ekonomi familjare). Bazuar në këto të dhëna, zona urbane vlerësohet që do të ketë 209 ekonomi familjare më shumë, ndërsa zona rurale 409 ekonomi familjare më shumë se në vitin 2024.

Për llogaritjen e dendësisë së banimit në zonën urbane dhe rurale është marrë për bazë numri i njësive të banimit sipas të dhënave të ofruara nga komuna, pasi që Regjistrimi i 2024 ofron vetëm numrin e njësive të banimit prej 1,914 në nivel komune, për përcaktimin e nevojave për banim jemi bazuar në të dhënat për njesi të banimit sipas të dhënave nga komuna. Bazuar në këto të dhëna dendësia e njësive të banimit në zonën urbane vlerësohet të jetë 21 njësi banimi në hektarë dhe në zonën rurale rreth 7.5, ndërsa në nivel komune është rreth 9 njësi banimi në hektarë që është vlerë e njëjtë edhe bazuar në numrin e njësive të banimit sipas Regjistrimit 2024.

Nr.	Zona	Sipërfaqja e banimit (ha)	Njësitë e banimit (2024)	Dendësia – njësi banimi/ha
1.	Urbane	23	484	21
2.	Rurale	184	1,382	8
Komuna		207	1,866	9

Tabela 55. Dendësia e banimit, gjendja ekzistuese

Sipërfaqja e nevojshme për banim për të plotësuar nevojat e ekonomive familjare të parashikuara është përcaktuar nga dendësia e banimit, që është llogaritur nga raporti i sipërfaqes aktuale të banimit dhe njësive të banimit. Duke u bazuar në këto llogaritje sipërfaqja e nevojshme për banim për zonën urbane do të jetë rreth 10 ha, e cila për shkak të mungesës së sipërfaqes do të sigurohet përmes rritjes së dendësisë dhe plotësimit brenda sipërfaqes së ndërtuar.

Ndërsa për plotësimin e nevojave për banim në zonën rurale është e nevojshme rreth 50 ha, e cila sipërfaqe në masë të madhe do të sigurohet kryesisht përmes plotësimit apo rritjes së dendësisë brenda hapësirave ndërmjet zhvillimeve ekzistuese, ndërsa për disa vendbanime do të sigurohet me zgjerimin minimal të kufirit ndërtimor. Sa i përket, ekonomive familjare jo rezidente që ndodhen jashtë komunës dhe vlerësohet që do të jenë rreth 150 më shumë, konsiderohet që njësitë vakante të banimit shfrytëzohen nga një pjesë e atyre familjeve, ndërsa për pjesën tjetër do të sigurohet brenda sipërfaqes së lartpërmendur me rritjen e dendësisë/etazhitetit, si rezultat është e nevojshme që për disa vendbanime të rritet sipërfaqja e dedikuar për banim.

Nr.	Zona	Dendësia – njësi banimi/ha	Sipërfaqja e nevojshme për banim	
			E. familjare shtesë	Sip. e nevojshme (ha)
1.	Hani i Elezit	21	209	10
2.	Rurale	8	409	50
Gjithsej			550	60

Tabela 56. Sipërfaqja e nevojshme për banim dhe shfrytëzimet tjera

Nevoja për sigurimin e sipërfaqes së nevojshme për akomodimin e njësive të banimit për familjet jo rezidente të komunës që supozohet do të jenë rreth 150 familje më shumë, do të ndikoj në rritjen e dendësisë së banimit në zonën qendrore të qytezës, dhe të sipërfaqes se alokuar për banim në zonën periferike të saj dhe në fshatra për rreth 10 ha.

Sa i përket ofrimit të banimit për familjet me të ardhura të ulëta, komuna ka të hartuar një program 3-vjeçar të banimit ne baze të cilit jepen kriteret dhe përzgjedhja për mbështetje për familjet që kanë nevojë për strehim. Gjithashtu ka konsideruar llojet e zhvillimeve të nevojshme (ndërtimi i njësive të reja banesore të cilat jepen me qira joprofitabile, adaptimi i objekteve ekzistuese për banim, banesat me bonus të banimit, sigurimi i banimit me kushte të volitshme për banim, etj.).

Raporti i VSM-së nxjerr në pah problemin e pronësisë së tokës sidomos mungesën e pronave komunale për zhvillime të reja. Dokument i PZHK-së përcakton destinimin e tokës për vitet 2025-2033 ku prezantohen edhe kufijtë e rinj ndërtimor dhe zhvillime tjera. Kjo sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me pjellshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Konfliktet e mundshme për hapësira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila kërkon hartimin e planeve rregulluese dhe planeve tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. VSM-ja këtë e identifikon si një sfidë të madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet edhe në Planin Zhvillimit Komunal të Hanit të Elezit. Analizat dhe konstatimet e lartëpërmendura do të shërbejnë si bazë për të përcaktuar strategjitë, objektivat e PZHK-së.

Sa i përket, ofrimit të banimit social dhe të përballueshëm komuna nuk ka kapacitete financiare, mirëpo një aspekt pozitiv është që ato do të mund të sigurohen përmes investitorëve privat, partneritetit publiko-privat, mbështetjen nga Qeveria etj.

Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
- Njësi relativisht të reja të banimit (20 ose më pak vite të vjetra); - Shumica e njësive të banimit kanë cilësi të mirë në aspekt ndërtimor; - Mungesa e kontesteve pronësore të njësive të banimit; - Pjesa dërmuese e njësive të banimit në pronësi private;	- Mungesa e politikave të banimit; - Kosto e papërballueshme për strehim/banim për çiftet e reja si pasojë e çmimit të lartë të patundshmërive dhe ndërtimit; dhe për familjet në nevojë për strehim; - Njësitë e pashfrytëzuara të banimit (kryesisht të ndërtesat e vjetra me apartamente);

- Ekziston programi 3 vjeçar i banimit; - Një numër relativisht i madh i ndërtesave të banimit të ndërtuara për rastet në nevojë; - Plani Zhvillimor Komunal në fuqi (PZHK e re në hartim e sipër); Harta Zonale e Komunës në hartim e sipër; Plani Rregullues Urban i hartuar.	- Sipërfaqe shumë e kufizuar e pronës komunale; - Sfida të shumta gjatë implementimit të planeve hapësinore (strategjike dhe operative).
Mundësitë - Bashkëpunimi me organizata dhe OJQ për studime sektoriale të banimit në qëllim të ngritjes së standardit dhe ofrimit të banimit të përballueshëm; - Grante dhe donacione për njësi banimi të përballueshme; - Aplikimi i densifikimit në banim dhe rigjenerimit të disa pjesëve të zonës urbane.	Rreziqet - Kapacitetet e pashfrytëzuara të banimit si pasojë e migrimit; - Kufizime fizike gjeografike që e vështirësojnë zgjerimin të zonës urbane; - Vazhdimi i trendit të ndërtimeve ilegale.

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore;
- Sigurimi i banimit financiarisht të përballueshëm;
- Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara/paligjshme të banimit;
- Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ofrimi i shërbimeve adekuate.

Nevojat zhvillimore

- Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të banimit dhe nevojave për banim;
- Sigurimi i banimit adekuat për kategoritë në nevojë, të përcjellë edhe me masa konkrete për integrim social dhe aftësim për punë;
- Monitorimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i zhvillimit hapësinor të banimit;
- Ofrimi i shërbimeve adekuate publike dhe sociale që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të banimit.

3.10 Vendbanimi joformal dhe ndërtimet pa leje

Trajtimi i vendbanimit joformal duhet të bëhet në përputhje me U.A MMPH Nr. 11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Komuna e Hanit të Elezit ka punuar dhe vazhdon të punoj në përmirësimin e kushteve jetësore në këtë vendbanim, duke siguruar kyçjen në infrastrukturë dhe lehtësuar qasjen në shërbime. Mirëpo, çështja e pa zgjidhur është ajo e pronës, andaj është e nevojshme që në bashkëpunim me banorët dhe autoritetet përgjegjëse komunale (juridike) të hartohet një program për trajtimin e çështjes së pronësisë.

Sa i përket, ndërtimeve pa leje, nga ana e komunës janë ndërmarrë masat të kërkuara me Ligjin Nr. 08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, mirëpo interesimi i qytetarëve për legalizim është ende i ulët. Për të shtyer qytetarët që të aplikojnë për legalizimin e ndërtesave është e nevojshme që të organizohen aktivitetet vetëdijësuese nga ana e komunës në bashkëpunim me OJQ lokale apo ndërkombëtare.

Për shkak të zhvillimit të hovshëm komuna rrezikohet nga krijimi i VBJ të reja dhe ndërtimeve pa leje, ku për të penguar këtë dukuri është i domosdoshëm kontrollimi i vazhdueshëm i zhvillimeve dhe zbatimi i plotë i PZHK-së dhe HZK-së në të ardhmen.

Analiza SWOT

Përparësitë - Vendbanim joformal i identifikuar; - Ekzistenca e doracakut për rregullimin e VJ dhe vetëdijesimi për to; - Plani Zhvillimor Komunal në fuqi (PZHK e re në hartim e sipër); Harta Zonale e Komunës në hartim e sipër;	Dobësitë - Vendbanim joformal prezent (Lagja Brava, Pustenik); - Vështirësi në zgjedhjen e çështjes pronësore.
Mundësitë - Bashkëpunime me organizata dhe OJQ për planifikimin dhe rregullimin e vendbanimit joformal.	Rreziqet - Vazhdimi i trendit të zhvillimit hapësinor që mundë të rezultojë me krijim të vendbanimeve joformale dhe problemeve sociale.

Sfidat kryesore të identifikuara janë:

- Kontrollimi i zhvillimeve në vendbanime për të penguar krijimin e vendbanimeve joformale të reja.

Nevojat zhvillimore

- Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimit;
- Trajtimi i vendbanimit joformal.

3.11 Shfrytëzimi i tokës

Sipërfaqja dërmuese e territorit të komunës së Hanit të Elezit mbulohet nga tokat pyjore dhe tokat bujqësore ndërsa toka e shfrytëzuar për zhvillim/ndërtim merr pjesë me një përqindje shumë të vogël prej rreth 5.3%.

Mungesa e bazës së të dhënave të PZHK-së në fuqi, e pamundëson vlerësimin se deri në çfarë mase janë realizuar zhvillimet e planifikuara me këtë PZHK.

Megjithatë, analizat tregojnë që vendbanimet e komunës nuk kanë pasur zhvillim të hovshëm, përpos zonës urbane dhe vendbanimet përreth saj, vendbanimet që kanë pësuar zhvillim nga periudha e miratimit të PZHK-së në fuqi deri më sot janë Hani i Elezit, Seçishtë, Paldenicë dhe Goranca.

Kodi HILUCS 1	Klasa HILUCS 1	Kodi HILUCS 2	Klasa HILUCS 2	Sipërfaqja (ha)	%
1	Prodhim parësor	1.1	Bujqësi	2,606.4	31.3
		1.2	Pylltari	5,194.4	62.4
		1.3	Minierë dhe gurorë	47.3	0.6
2	Prodhim dytësor	2.1	Industria e prodhimit të lëndës së parë	24.2	0.3
3	Prodhim tretësor	3.1	Shërbim tregtar	4.6	0.05
		3.2	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit		

		3.3	Shërbim i komunitetit	22.7	0.3
		3.4	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	1.3	0.01
4	Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1	Rrjetet e transportit	130.5	1.6
5	Banim	5.1	Banim i përhershëm me një njësi banimi	177.3	2.4
		5.2	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri	6.8	0.08
6	Shfrytëzim tjetër	6.3	Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	86.3	1.0

Tabela 57. Shfrytëzimi ekzistues i tokës

3.12 Vlerësimi i kapaciteteve investive

Kapacitetet investive duhet të shqyrtohen duke marrë për bazë kapacitetet ekzistuese dhe ato potenciale, duke përfshirë sektorin publik dhe atë privat.

Sa i përket buxhetit komunal, të dhënat kryesore mund të prezantohen edhe një herë në mënyrë të përmbledhur. Vlera e buxhetit komunal është rritur vazhdimisht:

- 3.277,467.77 Euro ishte në vitin 2020,
- 2,679,093.81 Euro në vitin 2021,
- 2,997,869.29 Euro në vitin 2022,
- 4,252,808.11 Euro në vitin 2023,
- 3.75 milion euro e planifikuar në vitin 2024, dhe
- 3.71 milion euro e planifikuar në vitin 2025.

3.12.1 Kapacitetet potenciale në të ardhmen

Brenda strukturës së buxhetit vjetor, pagat dhe mëditjet planifikohen edhe më tej të marrin mesatarisht gjysmën e buxhetit vjetor. Duke qenë evident fakti i numrit të lartë të stafit të angazhuar (më së i mjaftueshëm), komuna duhet të sigurohet që të adresojë sfidat në relacion të ngritjes së kapaciteteve të stafit ekzistues për të udhëhequr zhvillimin e planifikuar lokal. Profesionalizimi që duhet adresuar ka kryesisht të bëjë me realizimin projekteve publike dhe mirëmbajtjen e tyre.

Kategoritë që ndikojnë drejtpërdrejtë në arritjet e qëllimeve/ objektivave të kësaj PZHK-je si Investimet kapitale së bashku me subvencionet e transferet kanë pasur dhe planifikohet të kenë një rritje të lehtë nëpër vite brenda strukturës së buxhetit komunal:

- Për vitin 2020 ishin 1,19 milion euro;
- Për vitin 2021 ishin 0.61 milion euro;
- Për vitin 2022 ishin 0,73 milion euro;
- Për vitin 2023 ishin 1,6 milion euro;
- Për vitin 2024 janë planifikuar 0.69 milion euro;
- Për vitin 2025 janë planifikuar 0,82 milion euro; (natyrishtë se këto shuma do të jenë më të larta falë donacioneve të mundshme nga Ministritë e linjës po edhe donatorëve të huaj).

Edhe pse me rritje për secilin vit, buxheti i planifikuar drejtpërdrejtë për zhvillim nuk mjafton për të adresuar nevojat e identifikuar në profilin komunal. Ky fakt nuk mund të jetë i kënaqshëm, duke e pasur parasysh se buxheti komunal mbetet i kufizuar në raport me nevojat zhvillimore në aspekt social dhe ekonomik. Buxheti komunal do të mbetet kryesisht në nivel të plotësimit të nevojave më elementare, ku përveç pagave/ mëditjeve mund të plotësohen nevojat për kompletimin e infrastrukturës teknike, dhe deri diku përmirësimit të rrjetit të shërbimeve sociale dhe publike. Në këtë nivel, është vështirë e pritshme që përmes buxhetit komunal të ndikohet substancialisht në rritje të punësimit, si dhe në zhvillim të qëndrueshëm komunal.

Në plan më afatgjatë komuna duhet të synojë që ta ndryshojë këtë qasje. Sa i përket menaxhimit të buxhetit komunal, duhet të synohet në rritjen e THV, racionalizimin e shpenzimeve, si dhe uljen e nivelit të varshmërisë nga BKK. Gjithashtu, duhet të shqyrtohen mënyrat për identifikimin dhe mobilizimin e kapaciteteve financiare në kuadër të sektorit privat, të cilat përveç përfitimeve për këtë sektor, mund të ofrojnë përfitime edhe nga aspekti publik.

Sa do që në situatën aktuale ekonomike nuk janë lehtë të arritshme, këto janë një varg masash që mund të ndërmerren hapa pas hapi, që mund të rezultojnë me një bazë më të gjerë buxhetore, drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm të sektorit publik dhe privat. Disa prej këtyre masave janë dhënë në vijim:

- Hartimi i dokumenteve strategjike komunale apo sektorale apo në raporte komplementare me komunat fqinje, ku identifikohen qartë nevojat, mundësitë, potencialet, prej të cilave derivojnë projekte të qëndrueshme. Dokumentet strategjike si kjo PZHK por edhe tjera mbështesin prezantimin e komunës pranë investitorëve potencial dhe donatorëve, me qëllim të përfitimit të përkrahjes për projekte zhvillimore, me interes të balancuar publik dhe privat. Identifikimi dhe vlerësimi i potencialeve komunale në funksion të nxitjes së partneriteteve publiko-private, duke përfshirë edhe asetet komunale (prona, infrastrukturë, shërbime), si dhe mbështetjes me kornizë rregullative lokale dhe procedura administrative
- Shtimi i vlerës së tokave në pronësi komunale dhe futja e tyre në shfrytëzim përmes identifikimit dhe vlerësimit të potencialeve, planifikimit të shfrytëzimit adekuat, furnizimit me infrastrukturë etj.
- Azhurnimi i bazës së të dhënave pronësore dhe kadastrale, duke përfshirë edhe shfrytëzimin aktual, do ta mbështeste përmirësimin e të hyrave nga tatimi në pronë.
- Trajtimi i ndërtimeve pa leje sipas ligjit përkatës në fuqi, do të mundësojë të hyra nga taksat e legalizimit dhe zgjerimin e bazës së tatimit në pronë.
- Nxitjen e pagesës së rregullt të tatimit në pronë përmes sigurimit të qytetarëve se ato ju kthehen në infrastrukturë të nevojshme për ta si dhe ofrimin të ngritjes së cilësisë në shërbime komunale.

9 Korniza e zhvillimit hapësinor

9.1 Vizioni

Vizioni për zhvillimin e ardhshëm shprehë një përcaktim se çfarë synon të arrijë në plan afatgjatë Komuna e Hanit të Elezit (8 vite). Ai gjithashtu është një përcaktim detyrimor së pari i Administratës Komunale si udhëheqëse e zhvillimit lokal në përgjithësi dhe e zhvillimeve publike në veçanti, por edhe e të gjithë akterëve tjerë relevant (zhvilluesve privat, komuniteteve, përfaqësuesve të OSHC-ve, publikut e qytetarëve duke përfshirë edhe kontribuuesit tjerë) për tu mobilizuar dhe dhënë kontributin e tyre në mënyrë që të arrihen ato qëllimet afatgjata të synuara. Përtej që është një vegim i së ardhmes, Vizioni i mëposhtëm është unik dhe i mbështetur në potenciale reale të Hanit të Elezit. Ai është dakorduar ngatë gjitha palët të interesit përmes analizave shumë-sektoriale (punëtorja e Vizionit dhe Skenarëve si dhe debate/ takime të shumta publike), duke u nisur nga gjendja aktuale dhe potencialet lokale, sfidat e identifikuar dhe nevojat për zhvillim.

Vizioni për Komunën e Hanit të Elezit:

“Një ‘Han’ ku punohet me dinjitet për një të ardhme të sigurtë”

Zhvillimi i propozuar i Komunës së Hanit të Elezit e plotëson zhvillimin e gjithmbarshëm të planifikuar të Kosovës kryesisht përmes zhvillimit ekonomik me turizmin në Sharr e Karadak, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, industri të materialeve ndërtimore dhe industri tjera të lehta, shfrytëzim i potencialeve për prodhim të energjisë, pylltari ekstensive dhe bujqësi të kufizuar.

Përtej këtij zhvillimi i cili do të sillte të hyra, një zhvillim i strukturuar social do të mundësojë qytetarëve vendas shërbime cilësore, mirëqenie dhe zhvillim social të gjithmbarshëm përmes infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme ekzistuese dhe të planifikuar.

Vlerat natyrore dhe trashëgimia do të jenë të mbrojtura si elemente thelbësore në përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit të shëndoshë në njërin anë, por edhe si vlera që e përfaqësojnë identitetin e Hanit të Elezit. Këto vlera e ruajnë karakterin si vend me zhvillim të ardhshëm solid, mikpritës dhe me fokus ndaj përmirësimit të mjedisit për jetë dhe punë.

Një përshkrim më i gjerë i vizionit dhe si planifikohet të arrihet ai dhe qëllimet/ objektivat është dhënë te pjesa e konceptit për zhvillim hapësinor

9.2 Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

Përcaktimi i qëllimeve për fusha përkatëse paraqet hapin e mëtejshëm dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identifikuar, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet e mundshme në dispozicion. Për secilin qëllim janë përcaktuar edhe objektivat përkatëse, si elemente më specifike, të matshme dhe të arritshme, në mënyrë që të jepet një kornizë më konkrete për zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Pas vlerësimit dhe rekomandimeve të VSM-së është bërë shkrimi i objektiveve të VSM-së në objektivat e PZHK-së me qëllim të minimizimit të ndikimeve negative.

9.2.4 Vendbanimet

Qëllimi 1 – Zhvillimi hapësinor i vendbanimeve sipas modelit kompakt

Objektivat

1.1 Rritja e densitetit të zhvillimit dhe konsolidimi i vendbanimeve, në vazhdimësi

9.2.5 Banimi

Qëllimi 2 – Përmirësimi i kushteve të banimit

Objektivi

2.1 Rritja e eficiencës së energjisë në 50% të ndërtesave të banimit në komunë, deri në vitin 2033;

Qëllimi 3 – Sigurimi i banimit të përballueshëm

Objektivi

3.1 Ndërtimi i njësive të banimit të përballueshëm (për rreth 10% të familjeve me të ardhura të ulëta);

9.2.6 Popullsia dhe gjithë përfshirja në vendimmarrje

Qëllimi 3 – Qytetarët e informuar/ me njohuri të nevojshme dhe të përfshirë në vendim-marrje, në vazhdimë

Objektivat

3.1 Rritja e nivelit të gjithë përfshirjes në vendim-marrje lokale, deri në vitin 2027

3.2 Rritja e njohurisë së të rinjve/popullsisë ekonomikisht aktive dhe joshja e tyre për të mos migruar, në vazhdimësi

9.2.7 Infrastruktura publike dhe sociale

Qëllimi 4 – Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve sociale e publike baras për të gjithë qytetarët

Objektivat

4.1 Mirëmbajtja dhe freskimi i infrastrukturës parashkollore dhe parafillore sipas nevojave të identifikuar, në vazhdimësi;

4.2 Organizimi i mësimit tërë-ditor në të gjithë komunën, në vazhdimësi

4.3 Ngritja e cilësisë së arsimit (mësimor dhe përcjellës) në tërë komunën, në vazhdimësi

4.4 Përkrahja financiare dhe sociale e kategorive në nevojë, në vazhdimësi

4.5 Rregullimi i infrastrukturës për shërbime sociale, deri në vitin 2033

4.6 Rregullimi i infrastrukturës fizike dhe shtimi i shërbimeve shëndetësore, deri në vitin 2033

4.7 Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të administratës publike lokale, deri në vitin 2033

4.8 Funksionalizimi i infrastrukturës dhe organizimi i eventeve kulturore/ sportive, deri në vitin 2030

4.9 Rritja e sipërfaqeve të hapësirave publike të rregulluara, në vazhdimësi

4.10 Rregullimi/ mirëmbajtja e rrjetit të varrezave për të gjitha vendbanimet, në vazhdimësi

9.2.8 Infrastruktura e transportit dhe transporti

Qëllimi 5 – Ofrimi i lëvizshmërisë optimale dhe të sigurtë për qytetarët dhe vizitorët

5.1 Përmirësimi i rrjetit hekurudhor, deri në vitin 2030

5.2 Përmirësimi i rrjetit rrugor në territorin komunal, në vazhdimësi

5.3 Ofrimi i shërbimeve të sigurtë të transportit sipas karakterit të vendbanimeve, deri në vitin 2033

5.4 Shtimi i linjave të lëvizshmërisë jo-motorike (këmbësorë dhe çiklistë), deri në vitin 2033

9.2.9 Infrastruktura teknike

Qëllimi 6 – Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve teknike baras për të gjithë qytetarët

6.1 Sigurimi i qasjes së integruar në sistem të përbashkët të furnizimit me ujë dhe menaxhim nga KRU, deri në vitin 2027;

6.2 Kompletimi i rrjetit të kanalizimit dhe trajtimi i ujërave të zeza, deri në vitin 2033;

6.3 Ofrimi i shërbimit cilësor të mbledhjes dhe menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave, deri në vitin 2027;

6.4 Zgjerimi i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore në konsolidim (përgjatë lumit Lepenc), deri në vitin 2033;

6.5 Promovimi i ndarjes së mbeturinave dhe kompostimit, deri në vitin 2033

6.6 Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike në vendbanimet e Komunës dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të telekomunikacionit, deri në vitin 2033

6.7 Promovimi i energjisë së ripërtërishme dhe i eficiencës së energjisë, deri në vitin 2033

6.8 Prezantimi i ngrohjes qendrore për objekte publike, deri në vitin 2033

9.2.10 Ekonomia

Qëllimi 7 - Nxitje e zhvillimit ekonomik bazuar në potenciale lokale

Objektivat

7.1 Stimulimi i industrisë së materialeve ndërtimore dhe ndërmarrësisë në lidhje me të, deri në vitin 2033

7.2 Zhvillimi i turizmit natyror dhe kulturor, deri në vitin 2027

7.3 Përmirësimi i infrastrukturës dhe shtimi i kapaciteteve bujqësore (lavërtari, blegtori, kultura ekstensive, pemëtari dhe tjera), deri në vitin 2033

7.4 Promovimi i prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme, në vazhdimësi;

7.5 Promovimi i pylltarisë industriale, deri në vitin 2033

7.6 Stimulimi i ndërmarrësisë dhe aktiviteteve ekonomike sipas potencialeve lokale, në vazhdimësi

9.2.11 Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Qëllimi 8 – Krijimi i një mjedisi të sigurve përmes përmirësimeve organizative, mjedisore dhe adresimit të ndryshimeve klimatike

Objektivat

8.1 Reduktimi i efekteve të ndotjes dhe parandalimi i ndotjes së mëtutjeshme, në vazhdimësi

8.2 Adresimi i ndryshimeve klimatike përmes masave të reduktimit dhe adaptimit, në vazhdimësi deri në vitin 2033

8.3 Reduktimi ndikimeve të fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njeriu, në vazhdimësi

9.2.12 Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

Qëllimi 9 – Mbrojtja e trashëgimisë natyrore/ biodiversitetit dhe kulturore

Objektivat

9.1 Marrja e masave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, deri në vitin 2030

9.2 Marrja e masave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, deri në vitin 2031

9.2.13 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Qëllimi 10. Shfrytëzimi racional i tokës me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm

Objekti 1. Kontrollimi i zhvillimeve përmes hartimit të politikave të planifikimit hapësinor, deri në vitin 2028.

9.3 Koncepti i Zhvillimit Hapësinor

9.3.4 Koncepti i zhvillimit hapësinor të Komunës së Hanit të Elezit

Koncepti kryesor i zhvillimit hapësinor të komunës është zhvilluar duke u bazuar në analizën paraprake, vizionin për të ardhmen, qëllimet dhe objektivat si dhe skenarin e dakorduar. Elementet në të cilat është bazuar koncepti i propozuar për zhvillim hapësinor janë **zhvillimi kompakt** dhe i **qëndrueshëm** i komunës. Zhvillimi i komunës është bazuar në konceptin e nyjeve/qendrave me karakter të ndryshëm funksional që mundësojnë zhvillimin më intensiv të korridoreve që lidhin ato, plotësim dhe dendësim të sipërfaqeve të ndërtuara, mbajtjen nën kontroll të zhvillimeve të dëmshme, mbrojtjen e resurseve natyrore, kulturore dhe ekonomike dhe rritjen e zhvillimit në zonat ekzistuese. Koncepti do të siguroj:

- Infrastrukturë dhe shërbime cilësore teknike, sociale e publike;
- Infrastrukturë dhe shërbime cilësore të transportit motorrik dhe jo motorrik;
- Banim cilësor dhe të përbalueshëm;

- Ekonomi të zhvilluar bazuar në potencialet lokale;
- Mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Të gjitha këto funksione do të zhvillohen duke i mbrojtur resurset natyrore dhe trashëgiminë kulturore.

Me koncept planifikohet që komuna të ketë një strukturë të zhvillimit hapësinor policentrit, që do të ketë qytezën si nyjen kryesore dhe nyjet sekondare vendbanimet Gorancë dhe Paldenicë.

Zhvillimi administrativ dhe i ofrimit të shërbimeve publike planifikohet me qytezën si Qendër e rendit të mesëm ku ofrohen dhe koordinohen këto shërbime. Shërbimet arsimore të nivelit të mesëm do të vazhdojnë të ofrohen për gjithë banorët e Komunës në tri SHFMU-të dhe në SHML-në në Qytezë. Sa i përket, shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe ato sociale, përveç qendrës komunale do të kenë prioritet shtesë edhe 2 vendbanimet më të mëdha rurale si Qendra të rendit të ultë (Gorancë dhe Paldenicë) për arsye të numrit më të madh të banorëve dhe lidhjeve gravituese të fshatrave përreth. Aty planifikohen shërbime shëndetësore të nivelit të AMF-ve dhe arsimore të nivelit fillor dhe parashkollor. Për më shumë do të jenë këto dy fshatra dhe Seçishta që do të kenë zhvillim kompakt dhe dendësim me qëllim të mbrojtjes së tokës për zhvillime tjera të planifikuara dhe së bashku me qytezën për të akomoduar numër më të madh të banorëve.

Zhvillimi ekonomik do mundësohet kryesisht përmes ruajtjes së industrisë ekzistuese dhe promovimit të industrive të reja të ndërlidhura. Industria ekzistuese është ajo e materialeve ndërtimore. Prodhuesi i çimentos në Komunë është i vetmi në Kosovë, ndërsa guri gëlqeror shfrytëzohet relativisht mirë për të prodhuar rërë dhe zhavorr. Këto industri planifikohen të mbeten ndërsa do të promovohen industritë e ndërlidhura ndërtimore si p.sh. prodhimi i gëlqeres, materialet ndërtimore gjysmë të fabrikuara që shpejtojnë procesin e ndërtimit me theks te objektet banuese dhe hapësirave të mëdha për prodhim serik. Të gjitha këto zhvillime vlerësohet se do ti mbajnë në nivel edhe veprimtaritë tjera të ndërlidhura si transporti i mallrave, shërbimet e akomodimit dhe ushqimit, etj. Për të mundësuar këtë zhvillim është paraparë edhe krijimi i hapësirës për zhvillim ekonomik në Gorancë e cila do të jetë shtysë e këtij zhvillimi. Natyrisht se parashihi hapësira më të vogla komerciale në Qytezë që për qëllim do ta kenë joshjen e shërbimeve tregtare si biznese industriale të vogla, rrjetit të qendrave tregtare, bizneseve tregtare, bizneseve shërbyese, etj. Shtysë për ndërmarrjet e vogla do të jetë edhe zgjerimi i planifikuar i shërbimeve të terminalit doganor i cili gjendet në Han të Elezit. Për më tepër, komuna do të konsiderojë zbatimin e metodave të qëndrueshme dhe të avancuara të kultivimit, përdorimit e teknologjive të reja, identifikimin e mundësive të reja të tregut dhe përf forcimin e lidhjeve tregtare që mund të sjellë kërkesë më të lartë për produktet bujqësore, trajnim për fermerët, krijimi i kooperativave bujqësore, etj.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm dhe i cili do të mundësojë edhe zhvillimet ekonomike të mëposhtme, mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes do ti kushtohet vëmendje e veçantë. Përkundër investimeve të industrive në kontekstin mjedisor, Hani i Elezit mbetet ende hot spot i ndotjes, prandaj në kuadër të PZHK-së planifikohet qasje më serioze në reduktimin e ndotjes me synim arritjen e standardeve në fuqi. Inspektorati komunal në bashkëpunim me inspektoratin qendror të mjedisit, OJQ-të mjedisore dhe organizatat tjera do të arrijë deri te rezultatet e vazhdueshme nga analizat e pavarura për të pasur gjendje reale mjedisore. Dhe bazuar në ato rezultate do të veprojnë si mekanizëm i pa-kompromis për të ndaluar/ parandaluar ndotjen. Parimi ndotësi paguan do të jetë prioriteti bazë.

Turizmi planifikohet të jetë një shtysë e rëndësishme e zhvillimit të gjithmbarshëm të Komunës. Duke shfrytëzuar të mirat unike të natyrës si Sharri e Karadaku, pyjet e pishave, lugina e Lumit Dimcë, etj, planifikohen të krijohen nyjet turistike p.sh. në Pustenic, Gorancë e Neçavc, ku do të promovohen sportet malore, etj.; të lidhura ndërmjet veti përmes korridoreve ekologjike. Si nyje

tjetër turistike do të ketë edhe në Dërmjak, lugina e përroit të Dimcës dhe tjera. Duke pas parasysh që këto resurse janë pasuri jo vetëm për komunën por edhe për komunat fqinje dhe mbarë Kosovën, koncepti paralelisht me planifikimin e zhvillimeve rekomandon edhe masat dhe kufizimet për parandalimin e degradimit dhe për mbrojtjen e tyre. Gjithashtu, edhe trashëgimia kulturore dhe historike planifikohet të jetë pjesë integrale e këtij sistemi e cila do t'i jepte një shtysë të rëndësishme zhvillimit të tij, edhe në këtë rast planifikohen masat mbrojtëse për parandalimin dhe kufizimin e veprimeve që do të dëmtonin atë. Duke qenë që trashëgimia kulturore është katalizator i zhvillimit ekonomik, planifikohet që monumentet të revitalizohen dhe të promovohen. Për më tepër planifikohet që Hani i Elezit të jetë edhe pjesë e agjendave turistike të vendeve tjera. I gjithë ky aranzhman turistik planifikohet të koordinohet nga qyteza me pikat orientuese në Pusteni dhe zonat turistike kryesore,

Edhe përkundër resurseve të kufizuara të tokës bujqësore, planifikohet shfrytëzimi maksimal i atyre sipërfaqeve si hapësira për zhvillim të bujqësisë (toka pjellore ngjitur Lepencit, lavërtaria në Krivenik si dhe livadhet/ kullosat në të gjithë Komunën). Për blegtori, prioritet do të jenë shfrytëzimi i kullosave të Sharrit dhe në Paldenicë. Pemëtaria, perimtaria dhe frutat e pyllit do të kenë gjithashtu fokus të veçantë.

Fshatrat do të përbëjnë rrjetin bartës të zhvillimit rural, dhe do t'i takojnë modelit të zhvillimit si Qendër bazike. Pra do të zhvillohet kryesisht banimi dhe bujqësia me blegtori. Me qëllim të ofrimit të zhvillimit të qëndrueshëm, fshatrat do të jenë të mbështetura me shërbime të cilësore publike e sociale, si dhe infrastrukturë adekuate. Në aspekt të zhvillimit hapësinor parashihet konsolidimi i strukturave të ndërtuara, deri në pikën ku karakteri i fshatit nuk ndryshohet dukshëm.


Të gjitha zhvillimet janë shtjelluar më hollësisht poshtë në kapitullin e zhvillimit sipas sektorëve.

9.3.5 Elementet e konceptit hapësinor

Organizimi hapësinor i Hanit të Elezit është strukturuar përmes elementeve konceptuale të cilat do të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të parapara për zhvillimin e planifikuar të komunës.

- **Nyjet** – janë përqendrimet e aktiviteteve zhvillimore-funksionale sipas një apo disa karaktereve të veçanta të zhvillimit bazuar në potenciale të caktuara që i ka zona. Komuna planifikohet të ketë tre nyje kryesore të zhvillimit si Hani i Elezit, Paldenica dhe Goranca si dhe nyjet turistike në Pusteni, Gorancë, Neçavc dhe Dremjak. Hani i Elezit si qendër e rendit të mesëm (qendër kryesore) e cila do të mbetet si qendër administrative dhe do të ofroj shërbimet publike, sociale, dhe tregtare për të gjithë komunën, dhe Paldenica e Goranca si qendra të rendit të ultë (qendra sekondare) që do të ofrojnë shërbimet elementare sociale dhe tregtare për vendbanimet përreth. Ndërsa, nyjet turistike do të ofrojnë shërbimet e nevojshme për të plotësuar nevojat e vizitorëve në mënyrë që të krijohen kushte sa më të mira për joshjen e tyre.
- **Korridoret** – janë lidhjet funksionale në mes të nyjeve të lartpërmendura dhe me komunat tjera. Lidhja në mes të Hanit të Elezit dhe Paldenicës do të bëhet përmes rrugës lokale dhe nacionale që lidh Hanin e Elezit me Kaçanikun, Ferizajin dhe Shkupin, korridore me rëndësi përgjatë të cilave planifikohet të zhvillohen shërbimet tregtare. Lidhja në mes të Hanit të Elezit dhe Gorancës bëhet përmes rrugës lokale, korridor i cili ofron një peisazh të jashtëzakonshëm të tokës bujqësore dhe pyjore, ndërsa lidhja me komunat tjera dhe Maqedoninë e Veriut bëhet përmes rrugës nacionale N2 dhe Autoudhës R6. Ndërsa, lidhja në mes Paldenicës dhe Gorancës bëhet përmes qytezës së Hanit të Elezit.

- **Zonat e rritjes** – janë hapësira në territorin komunal ku parashihen zhvillime të reja nga ato ekzistuese, që bëhet fjalë kryesisht për zona banimi dhe ekonomike. Koncepti parasheh kryesisht kompaktësim të vendbanimeve, prandaj zgjerimi i sipërfaqes ndërtimore do të jetë minimal dhe atë vetëm në periferi të nyjeve kryesore.
- **Plotësimi dhe dendësimi** – janë zonat e planifikuara për plotësim dhe dendësim. Bëhet fjalë kryesisht për zonat ekzistuese të ndërtuara në qendrën urbane të cilat kanë hapësira për t'u plotësuar dhe dendësuar përmes ndërtimeve më të dendura dhe rritjes së etazhitetit ku planifikohet inkurajim i ndërtimeve më të larta. Këtu përfshihen edhe vendbanimet rurale të caktuara në të cilat do të inkurajohet dendësi më e lartë banimore kryesisht përmes shfrytëzimit më kompakt të hapësirës dhe parcelave më të vogla për banim.
- **Mbajtja nën kontroll** - ky koncept ka për qëllim mbajtjen nën kontroll të hapësirave të ndërtuara, rritjen e dendësisë kryesisht në qendrën urbane dhe në ato vendbanime që ka një rritje të shtuar, duke e dekurajuar zhvillimin horizontal dhe dëmtimin e tokës bujqësore/pyjeve.
- **Mbrojtja** -përmes këtij koncepti është planifikuar mbrojtja e resurseve natyrore, ekonomike, dhe trashëgimisë kulturore. Pra koncepti zhvillimit parasheh mbrojtjen e tokave bujqësore përmes kufizimit të shtrirjes ndërtimore të pakontrolluar dhe mbrojtjen e resurseve natyrore dhe kulturore si aset për zhvillim të turizmit. Mbrojtja e resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore do të bëhet përmes planifikimit të masave të percaktuara me ligjet dhe aktet nënligjore të fushave përkatëse dhe UA MMPH Nr.08/2017 për NTPH si dhe rekomandimeve të Raportit të VSM-së, të cilat janë prezantuar në nën kapitujt më poshtë të sektorëve përkatës.



Harta 25 Koncepti i zhvillimit të planifikuar hapësinor

9.4 Zhvillimi sipas sektorëve

9.4.4 Mbrojtja e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Mbrojtja e mjedisit – duke përjashtuar pjesën lindore të Qytezës e cila në kontekst të ndotjes së ajrit do të adresohet si më poshtë, pjesa tjetër e komunës ka natyrë dhe mjedis të jashtëzakonshëm. Natyra e Sharrit dhe Karadakut dhe e korridoreve përgjatë rrjedhave ujore përbëjnë rrjetin e gjelbër unik të shtrirë në mbi 75% territorit komunal. Ky ekosistem natyror deri së voni kryesisht i paprekur ofron ujin e pastër nga krojet dhe përrenjtë e shumtë, pastrimin e ajrit dhe ujit të ndotur, resursin për energji dhe ngrohje, lokacionin shumë të përshtatshëm për relaksim dhe socializim për banorët si dhe kushte esenciale për botën ujore dhe jashtë saj.

Me qëllim të mbrojtjes së këtij mjedisi natyror dhe shijimit/ shfrytëzimit të tij të qëndrueshëm, sipas legjislacionit aktual të zbatueshëm, planifikohet që organet relevante por edhe të gjithë akterët që veprojnë në mjedis të shfrytëzojnë dhe mbrojnë këtë resurs kyç sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Rekomandimet të përgjithshme janë dhënë në vijim:

- shfrytëzimi i resurseve natyrore (uji, pyjet, guri gëlqeror, etj.) të jetë i planifikuar në mënyrë integruese dhe gjithmonë bazuar në këtë dokument. Edhe zbatimi i këtyre projekteve të jetë serioz duke aplikuar parimin e “zhvillimit të projektit dhe kthimit të tij në gjendje të pranueshme për segmente apo faza të projektit”, si dhe duke monitoruar në mënyrë permanente shfrytëzimin e resursit dhe përmirësimet mjedisore sipas marrëveshjes paraprake;
- të gjithë operuesit duhet të ndërtojnë apo instalojnë pajisje/ impiante përkatëse në mënyrë që mbetjet nga operacioni tyre që kalojnë në natyrë të jenë sipas standardeve në fuqi. Këtu përfshihen mbetjet industriale, ujërat e zeza, mbeturinat dhe çdo lloj externalje tjetër. Në rast të kundërt, organet relevante operojnë sipas parimit “ndotësi paguan”.

Komuna gjatë zhvillimit të hapësirave në zonat me vlerë natyrore dhe kulturore historike duhet të ketë parasysh masat e mbrojtjes së vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike, e caktuara me PHK.

Përtej mbrojtjes së këtij mjedisi natyror, ai planifikohet të përmirësohet dhe shfrytëzohet si rrjet alternativ i lëvizshmërisë jo-motorike i cili do ta plotësojë konceptin e përgjithshëm zhvillimor. Brezet e zhvilluara përgjatë rrjedhave të lumenjve si korridore natyrore të gjelbra do të paraqesin mundësi ideale për vija të shëndetshme dhe funksionale qarkullimi dhe në të njëjtën kohë do të paraqesin disa prej atraksioneve kryesore në kuadër të komunës.

Zonimi i propozuar nga PZHK-ja krijon mundësinë për struktura të gjelbra, kryesisht për përdorim të ndryshëm, pyllëzim, ripyllëzim etj. Rekomandohet hartimi i udhëzuesit për:⁵⁴

- *projekte pyllëzimi konform planit;*
- *projekte ripyllëzimi dhe mirëmbajtje konform planit;*
- *numrin e strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;*
- *përdorimin e strukturave, të themi për grupe/festa të mëdha, gjë që do të kishte ndikime negative;*
- *arkitekturën e strukturave për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;*
- *shërbimet e infrastrukturës për ofrimin e energjisë, ujit dhe menaxhimit të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndikimeve vizuale dhe ndotjet e mundshme.*

⁵⁴ Burimi: *Raporti i Vlerësimi strategjik mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2024 - 2032*

Mbrojtja e ajrit – edhe pse me përmirësime gjatë viteve të fundit, problematika e ndotjes së ajrit në Qytezë në pjesën lindore prej lumit Lepenc, ende përbën çështje e cila duhet adresuar seriozisht. Komuna së bashku me organet relevante të qeverisë qendrore do të bashkëpunojnë ngushtë për të reduktuar ndotjen nga pluhuri dhe gazrat brenda standardeve kosovare. Do të bëhen studime për të ditur pse matjet nga stacioni i IHMK-së dhe Sharrcem tregojnë kryesisht jo ndotje me tejkalime minimale ndërsa situata në terren ndryshon. Studimi gjithashtu do të krijojë listën formale të ndotësve dhe do të mundësojë analiza mikro-hapësinore për pjesë të caktuara të qytezës sipas potencialit që kanë për tu ndotur. Rekomandimet nga studimet do të përfshijnë hapat e mëtutjeshëm në reduktim përfundimtarë të ndotjes, pastrim të Qytezës nga pluhuri dhe monitorim të vazhdueshëm për të mos lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme. Krijimi i brezave të gjelbër mbrojtës përreth industrive duhet të jetë pjesë e përmirësimeve në këtë fushë. Edhe pse deri tani organet relevante qendrore kanë qenë dhe janë përgjegjëse për monitorim të ndotjes së ajrit (marrja/ analiza e rezultateve nga stacioni monitorues dhe aplikimi i gjobave sipas rastit), duke marrë parasysh gjendjen e krijuar dhe vështirësinë e monitorimit, organet lokale duhet të bëhen bashkëpërgjegjëse në këtë rast. Kjo do të rezultojë me reagim më të shpejtë dhe efikasitet më të lartë. Parimi “ndotësi paguan” duhet të aplikohet patjetër ndërsa gjobat duhet të jenë në raport të drejtë me dëmet eventuale.

Përtej këtyre hapave, bazuar në ligjet në fuqi do të behet kontrollimi i emetimeve të pluhurit dhe tymit nga çdo operues duke përfshirë industritë tjera, gurëthyesit, bizneset/ administrata/amvisëritë (ngrohja), djegiet e mbeturinave, etj. Përgjatë rrugëve rekomandohet të mbillen pemë për të krijuar tamponë të gjelbërimit. Në planin afatgjatë, PZHK synon zhvillim më kompakt dhe përdorim më të vogël të automjeteve me qellim të zvogëlimit të dioksidit të karbonit. Gjithashtu është planifikuar eliminimi i mbeturinave ilegale në një afat sa më të shkurtër.

Ndërtimi i rrugëve cilësore do të ulë trafikun nëpër vendbanime të mëdha, duke sjellë përmirësim të cilësisë së ajrit, ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2022 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përqeshohet, veçanërisht për Pb, SOx, NOx, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte, për “Sharr Cem”, për çlirimet në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përqeshimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. PM10 mund të reduktohet nëpërmjet përdorimit të teknikave më të mira të ndërtimit dhe shtrimit të më shumë rrugëve.⁵⁵

Nisur nga fakti që komuna e Hanit të Elezit ka një industri të zhvilluar sidomos për prodhimin e cimentos, duhet që në mënyrë permanente ti kushtoj vëmendje ndotjes së mjedisit. Me aktivitetin aktual dhe atë që do të ketë në perspektivë Hani i Elezit do të ndikoj pak në klimën globale. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë mos marrja e masave me PZHK e cila nuk ndihmon në ruajtjen e zonave të gjelbra dhe që lejon zhvillimin e pakontrolluar në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mezoklimë, jo vetëm në rritjen e temperaturave, por edhe stuhi më të rralla, por më të fuqishme, të cilat do të shkaktojnë përmbajtje.⁵⁶

Për një cilësi më të mirë të ajrit VSM-ja propozon masat vijuese:

- *studime mbi pyllëzimin;*
- *studime mbi transportin;*
- *inkurajimi i përdorimit të karburanteve më të pastra;*
- *studimin për të përcaktuar ndikimin dhe koston e ajrit të dëmshëm në shëndetin publik dhe në ekonominë në tërësi;*

⁵⁵ *Burimi: Raporti i vlerësimit strategjik mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2024 - 2032*

⁵⁶ *ibid*

- *përmirësimin e teknikave të ndërtimit për të pakësuar ndotjen;*
- *shtrimin e rrugëve, përmirësimin e trafikut dhe futjen e korsive të biçikletave;*
- *edukimin më të mirë të publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit;*
- *përmirësimin e furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve;*
- *vendosjen e kriterëve strikte për pyllëzimin;*
- *vendosjen e kriterëve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore).*

Mbrojtja e ujit – bazuar në U.A MMPH Nr.08/2017 mbi NTPH kapitulli II, neni 3 është planifikuar mbrojtja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor përmes përcaktimit të 3 zonave mbrojtëse ujore dhe aplikimit të masave konkrete për eliminimin e ndotësve - deponive joformale përmes menaxhimit të mbeturinave; ujërave të zeza përmes sistemeve të kanalizimit dhe aktiviteteve tjera të faktorit njeri. Komuna do të marrë masa për mbrojtjen e zonave ujore, burimeve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, si dhe vet ujërave sipërfaqësor dhe ujë-rrjedhave të hapura.

Për cilësi sa më të mirë të ujit të lumenjëve Raporti i VSM-së propozon si në vijim:

- *zëvendësimin e tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqërohet edhe me minimizimin e rrjedhjeve;*
- *maksimizimi i lidhjeve;*
- *rregullimin e lidhjeve të paligjshme;*
- *reduktimin e përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave dhe ndërtimi i impiantit të planifikuar.*

Mirëmbajtja e ujërave, kontrollimi i zhvillimeve dhe ndërtimet do të ndalohen dhe kufizohen në bazë të dispozitave të ligjit për ujërat dhe UA MMPH Nr.08/2017 për NTPH kapitulli 3 paragrafi 3, që kërkohej përcaktimi i zonave mbrojtëse me qëllim të ndalimit dhe kufizimit të zhvillimeve përgjatë sipërfaqeve ujore. Sipas dispozitave kemi tri zona mbrojtëse si:

1. *zona e I-rë – zona e kufizimit përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit dhe objekteve ujëmarrëse si dhe zonës së drejtëpërdrejtë të tyre nga cfarëdo dëmtimi, ndotje ose ndikime tjera të dëmshme, të rastësishme ose të qëllimshme.*
2. *zona e II-të – zona e kontrollimit përcaktohet me qëllim të parandalimit të kontaminimit dhe rrezikut të ndotjes nga mikroorganizmat ose materjet tjera të dëmshme për cilësinë e ujit.*
3. *zona e III-të – zona e mbikqyerjes përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit nga ndotja me materiale të rrezikshme ndotëse që vështirë zbërthehen dhe për pasojë dëmtojnë në të gjatë shfrytëzimin e ujit të burimit.*

Zonat e mbrojtjes të burimeve të ujërave nëntokësore në akuifer intergranular

Zona I, zona e kufizimit

- paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 10m nga të gjitha anët e veprës ujëmarrëse dhe objekteve përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit.

- kufiri i zonës duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të forte dhe stabile, e cila duhet të jetë e lartë së paku 2m, në mënyrë që të pengohet hyrja e shtazëve apo e personave të pa-autorizuar;

- kufiri i zonës shënohet me shenja të dukshme sic janë përkshkruar në shtojcën 1 të UA MMPH 15/2017 për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare, të cilat vendosen nga shfrytëzuesi i burimit në hyrjet e zonës si dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës.

Masat mbrojtëse

Në zone ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtëpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.

Në këtë zone lejohet: kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit, punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit

të ujit nga burimi, me c'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

Zona II, zona e kontrolluar

- kufiri i zonës së II-të të mbrojtur për burime dhe puse duhet të jetë së paku 100m nga zona e I-rë;
- Kufiri i zonës shënohet me shenja të dukshme sic janë përshkruar në shtojcën 1 të UA MMPH 15/2017 për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare, të cilat vendosen nga shfrytëzuesi i burimit në hyrjet e zonës si dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës.

Masat mbrojtëse

Në zone ndalohen zhvillimet e aktiviteteve dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin, në mënyrë specifike: përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafsheve, përdorimi i pesticideve, herbicideve dhe insekticideve, ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cialt nuk shfrytëzohen për furnizim publik, ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve, ndërtimi dhe puna e reparteve industriale, ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme, eksploatimi i zhavorrit dhe rërës, si dhe aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.

Zona III, zona e mbikqyrur

- Përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të të mbrojtur deri te ujëndarësi hidrogeologjik;
- Në rastet kur kufiri hidrogeologjik nuk është i njohur, zona e III-të përfshin hapësirën deri te kufiri prej të cilit ujit nëntokësor i nevojiten së paku 200 ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse;
- Kufiri i zonës duhet të jetë së paku 500m nga vepra ujëmarrëse;

Masat mbrojtëse

Në këtë zone ndalohen kryeraj e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cialt mund të ndoten ujërat e burimit dhe në mënyrë specifike si shkarkimi i ujerave të ndotura të patrajtuara të kanalizimit, ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cialt lëshojnë materie radiokative dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave, etj), deponimi i përkohshëm ose i perhershëm i mbeturinave, përpunimi, deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit, ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin mbeturinave të rrezikshme, ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient, kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore, deponimi i hapur dhe aplikimi i sibstancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve, ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i varrezave ekzistuese, aktivitetet tjera të cilat konstatohense mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilesor.

Zonat e mbrojtura sanitare në burimet nëntokësore në akuifer karstik

Zona I, zona e kufizimit

- Kufiri i zones paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 20m nga vepra ujëmarrëse. Kjo zonë duhet të përfshijë edhe të gjitha objektet përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit;
- Në rastet kur nuk mund të sigurohet largësia prej 20m, kjo largësi duhet të jetë së paku 10m nga të gjitha objektet jëmarrëse me kusht që të vërtetohet se burimi nuk rrezikohet;
- Kufiri i zones duhet të jetë i rrethuar me rrethojë të forte dhe stabile, e cila duhet të jetë e lartë së paku 2m, në mënyrë që të pengohet hyrja e shtazëve apo e personave të pa-autorizuar;
- Kufiri i zonës shënohet me shenja të dukshme sic janë përshkruar në shtojcën 1 të UA MMPH 15/2017 për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare, të cilat vendosen nga shfrytëzuesi i burimit në hyrjet e zonës si dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës.

Masat mbrojtëse

Në zonë ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë. Ndërsa lejohen aktivitetet të listuara nën masat mbrojtëse për zonën e I-rë të burimeve të ujërave nëntokësor në akuifer intergranular.

Zona II, zona e kontrollimit

- Kufiri I zones përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zones së I-rë deri te vija prej së cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 24 orë për të arritur te vepra ujëmbërse, me c'rast ky kufi nuk mund të jetë më afër se 500m prej veprës ujëmbërse;
- Kufiri i zonës shënohet me shenja të dukshme sic janë përshkruar në shtojcën 1 të UA MMPH 15/2017 për përcatimin e zonave të mbrojtura sanitare, të cilat vendosen nga shfrytëzuesi i burimit në hyrjet e zonës si dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës.

Masat mbrojtëse

Në këtë zonë ndalohet zhvillimi i aktiviteteve dhe kryerja e punimeve të përshkuara në zonën e II-të të burimeve të ujërave nëntokësore në akuifer intergranular.

.Zona III, zona e regjimit të lehtë të mbrojtjes dhe mbikqyerjes

- Përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të deri te vija prej të ciles ujit nëntokësor i nevojite së paku 20 ditë për të arritur te vepra ujëmbërse;
- Kufiri i zonës së III-të sanitare duhet të jetë së paku 100m larg veprës ujëmbërse në drejtim të rrjedhjes së ujit.

Masat mbrojtëse

Në këtë hapësirë ndalohet kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve të përshkuara në masat mbrojtëse për zonën e III-të të burimeve të ujërave nëntokësore në akuifer intergranular.

Zonat e mbrojtura sanitare në burimet sipërfaqësore

Zonat e mbrojtura sanitare në këto burime janë dhënë me UA MMPH 15/2017 për përcatimin e zonave të mbrojtura sanitare dhe UA për NTPH, si në vijim:

Zona e I-rë përfshinë territorin përreth veprës ujëmbërse në largësi së paku 10m nga të gjitha anët e veprës ujëmbërse dhe të gjitha objekteve përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit dhe objektet për ruajtjen e burimit.

Zona e I-re duhet të jetë e rrethuar me rrethojë të lartësisë minimale 2m dhe të ketë shenjën e dukshme të punuar sipas modelit të dhënë në shtojcën 1 të UA MMPH 15/2017 për përcatimin e zonave të mbrojtura sanitare, cila vendoset nga shfrytëzuesi i burimit në hyrje të zones.

Masat mbrojtëse - në kuadër të kasaj zone ndalohet përdorimi i plehrave dhe preparative për mbrojtjen e bimëve dhe kryerja e të gjitha llojeve të punimeve dhe aktiviteteve, përpos të atyre për marrjen, trajtimin dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit.

Zona e II-të, zona e kontrollimit përcaktohet në bazë të elaboratit për mbrojtjen e burimit të ujit me c'rast kufiri I kasaj zone nuk duhet të jetë më I vogël se 1000m nga vepra ujëmbërse në rrjedhën e sipërme të ujërrjedhës duke përfshirë ujërrjedhën dhe brezin prej 30 m në të dyja anët e ujërrjedhës.

Kufiri i kasaj zone shënohet me vendosjen e shenjave të dukshme të punuara sipas modelit të dhënë në shtojcën i të UA MMPH 15/2017 për përcatimin e zonave të mbrojtura sanitare, në hyrjet e zonës si dhe dhe në lokacione tjera të përshtatshme të kufirit të zonës. Këto shenja vendosen nga shfrytëzuesi i burimit të ujit.

Masat mbrojtëse :

- kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimitarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
- prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermtat deri në 20 krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikatat e mira të bujqësisë;
- ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
- transporti rrugor i materieve kimike, karburanteve të lëngëta dhe materieve tjera të rrezikshme;
- ndërtimi i autoudhave, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
- ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
- stacionet e reciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
- ndërtimi i objekteve tjera të cialt mund të rrezikojnë cilësinë e ujit si dhe

Mbrojtja e tokave bujqësore – bazuar në U.A MMPH 08/2017 mbi NTPH, kapitulli II neni 1 toka bujqësore, si aset ekonomik dhe mjedisor, do të mbrohet nga fragmentimi, erozioni dhe degradimet tjera si ndërtimi i shpërhapur. Si masë e veçantë në këtë drejtim do të jetë respektimi i kufijve të zonave ndërtimore. Ndërkaq toka bujqësore përgjatë lumenjve do të ketë trajtim të veçantë sa i përket mbrojtjes nga ndotja, për shkak të ndikimeve që mund të shkaktohen në rrjedhën e tyre nga herbicidet/ pesticidet/ ushqimet bujqësore të përdorura përmes monitorimit dhe kufizimit të përdorimit të tyre.

Masat të cilat do të ndërmerren për mbrojtjen e tokës nga erozioni përfshijnë:

- ndalimi i përkohshëm apo i përhershëm i lërimit të livadheve dhe kullosave dhe tokave tjera bujqësore për shkak të konvertimit në tokë të punueshme me kulturat bujqësore vjetore;
- prezantimi i kulturave bujqësore në rotacion;
- Kultivimi i plantacioneve shumëvjeçare;
- Ngritja e ndërtesave specifike përkatëse;
- Përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore;
- Ngritja dhe kultivimi i brezave mbrojtës bujqësor apo mbjellja e bimëve drunore shumëvjeçare;
- Ndalimi i kullotjes së bagëtive në një kohë të caktuar ose kufizimi i numrit të kafshëve që mund të lirohen në hapësira të caktuara;
- Ndalimi i prerjes së pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar.

Masat që do të ndërmerren për mbrojtjen nga fragmentimi përfshijnë:

- Toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela;
- Toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e së cilës është ≤ 0.50 ha, të mos mund të fragmentohet tutje.

Mbrojtja e tokës – për mbrojtjen e qëndrueshme të tokës, raporti i VSM-së propozon hartimin e një plani për identifikimin e një vendi për ngritjen e një deponie të përhershme dhe pastrimin e fushës aktuale të grumbullimit të mbeturinave; iii) për menaxhimin më të mirë të mbetjeve të ngurta në komuna iv) për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të ndërtimit dhe atyre klinike; dhe v) rekomandimin e rregullimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë.⁵⁷

Mbrojtja e pyjeve – bazuar në U.A MMPH Nr.08/2017 kapitulli II neni 2 pyjet do të jenë të mbrojtura nga degradimet dhe prerjet ilegale (shpyllëzimi). Pjesët e degraduara do të rigjenerohen përmes ripyllëzimit. Përveç rolit mjedisor dhe zhvillimit të biodiversitetit, mbrojtja dhe rehabilitimi i pyjeve do të ketë ndikim pozitiv edhe në shmangien e erozioneve. Pyllëzimi do të bëhet përmes mbjelljeve të bimëve apo farës.

Masa të veçanta mbrojtëse do të aplikohen edhe për mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit. Bimësia e rrallë ruhet me kujdes duke i përfshirë edhe ato të cilat identifikohen në vazhdim (fruta pylli dhe shumë tjera duke i përfshirë edhe ato shëruese).

Për të mbrojtur pyjet, raporti i VSM-së propozon si në vijim:

- ngritja e një mekanizmi bashkëpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte;
- kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjelbërim dhe tampon zona;
- aktivizim i gjykatave, policisë inspektorëve në mënyrë cilësore. Në ish vend depozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjelbërim ose gjelbërim.

Trungjet e identifikuar për mbrojtje do të futen në listën formale të IMN-së dhe do të mbrohen përmes ekspertizës profesionale, duke i digjitalizuar, monitoruar gjendjen e tyre dhe intervenuar sipas karakterit të mbrojtur (rëndësi shkencore, mjedisore, kulturore, historike, peizazhi, etj.). Gjatë intervenimeve përmes projekteve zhvillimore duhet të ruhet me kujdes biodiversiteti.

⁵⁷ Burimi: Raporti i Vlerësimit strategjik mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit 2024 - 2032

harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje; ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale, zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë, instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përcësve digjital.

Për të mbrojtur vlerat e trashëgimisë kulturore, raporti i VSM-së propozon si në vijim:

- *përditësimin, zgjerimin dhe mbajtjen/pasurimin e listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar.*

4.4.2 Mbrojtja nga rreziqet natyrore dhe rreziqet tjera

Mbrojtja e mjedisit dhe përgatitja për tu përballur me fatkeqësitë është me rëndësi jetike. Shumë faktorë duhet të merren parasysh në faza të hershme gjatë planifikimit në mënyrë që ndikimi në mjedis dhe dëmet nga fatkeqësitë të parandalohen apo të jenë sa më minimale.

Komuna e Hanit të Elezit ndodhët në një terren të thyeshëm malor ndërsa qyteza gjendet në një luginë të zgjeruar ku bashkohen disa përrenj. Masat për parandalimin e fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre janë paraparë duke pasur parasysh UA MMPH Nr.08/2017 mbi NTPH, kapitulli II, neni 3.

Vërshimet – zonat ndërtimore janë përcaktuar në hapësirat tokësore të cilat nuk janë të rrezikuara nga përmbytjet. Në raste specifike kur ndërtimi (kryesisht bizneset) lejohet në ato zona, janë paraparë masa mbrojtëse si: hapësirat e volumit të ujëmbledhësit si dhe infrastrukturës kulluese deri te rrjedhat ujore.

Masat e përgjithshme të mbrojtjes nga vërshimet përfshijnë rregullimin natyror dhe mirëmbajtjen e shtretërve dhe përmirësimin dhe menaxhimin brezave hapësinor përgjatë rrjedhave ujore.

Në zonën e identifikuar të vërshimeve përgjatë lumit Lepenc (Nga lagja Laçi/ Pustenic deri në kufi në jug) zhvillimi kufizohet në distancë të caktuar nga lumenjtë (sipas kushteve të dhënat për zona mbrojtëse të burimeve ujore sipërfaqësore). Në rastin e rrjedhave tjera lumore që kalojnë përgjatë vendbanimeve do të ndërmerren masa për rregullimin e shtratit ujr duke ruajtur vlerat natyrore dhe biodiversitetin. Para ndërmarrjes se masave nevojitet që të bëhen vlerësimet hidrologjike dhe vlerësime të biodiversitetit me qëllim të ruajtjes së bimësisë dhe drunjëve. Rekomandohet që të iket nga praktikatat e betonimit të shtratit të lum enjve apo përrenjve.

Masat parandaluese ndaj vërshimeve janë:

- *rregullimi natyror i shtratit të lumit Lepenc dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tij;*
- *mirëmbajtja e vazhdueshme e shtratit të lumit Rezhancë (pastrimet nga mbeturinat dhe lëndët erozive) si dhe mirëmbajtja e pjesës ku uji hyn në tunel;*
- *ndërtimi i pendave – argjinaturave*
- *ndërtimi i sistemit të drenimit*
- *gërryerja e fundit ose zgjerimi i lumit*
- *përcjellja e ndërrimeve të rrjedhjes së ujit në degën e lumit*
- *ndërtimi i mureve ndaj vërshimeve që i bllokojnë ato*
- *ndërtimi i sistemit të mbrojtjes nga vërshimet*
- *mirëmbajtje afatgjate e sistemit të mbrojtjes nga vërshimet.*
- *përdorimi i portave të vërshimit që e lejojnë ujin të kalojë në lum në mënyrë të kontrolluar.*
- *menaxhimi i rreziqeve në rast të vërshimeve.*
- *punimi i projektit për mbrojtje nga vërshimet.*

Erozioni dhe rehabilitimi i sipërfaqeve erozive – bazuar në UA MMPH Nr.08/2017 mbi NTPH, kapitulli II neni 1 paragrafi 1.2.1 në zonat erozive të identifikuar në hartën e erozionit, do të ndalohet prerja e pyjeve dhe lërimi i tokës si dhe do të merren masa mbrojtjeje përmes mbjelljes së vegetacionit si masë natyrore për parandalimin e erozionit te mëtejshëm. Komuna do bashkëpunojë me Agjencinë e Pyjeve dhe komunitetin që të marrin fidane dhe të pyllëzojnë hapësirat erozive.

Komuna në bashkëpunim me shoqata mjedisore do të bëjë fushata vetëdijesimi për rëndësinë e ruajtjes së bimësisë si masë parandaluese. Ndërsa, masat tjera që do të ndërmerren përfshijnë:

Masat hidroteknike

- *ndërtimi i teracave, gabioneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjëve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.*
- *ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes*
- *mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve*
- *ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve*

Masat bujqësore

- *të mirëmbahen tokat bujqësore*
- *të aplikohen drejtë praktikat bujqësore*
- *përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve*
- *rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.*


Tërmetet – ligji i ndërtimit në zona sizmike do të aplikohet për ndërtimet e reja. Objektet e vjetra, kryesisht ato publike dhe të trashëgimisë, duhet të analizohen dhe vlerësohen dhe nëse është e nevojshme disa prej tyre do të forcohen për t'i rezistuar tërmeteve. Sektori i emergjencës në komunë, në bashkëpunim me nivelin qendror do të përgatis planin e emergjencës.

Ndërsa, raporti i VSM-së propozon si në vijim:

- *studim të terreneve për qëndrueshmëri sizmike në rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet pasur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.*

Zjarret pyjore dhe të tjera – mbrojtja nga zjarret do të bëhet përmes aplikimit të masave organizative dhe teknike. Rekomandohet që të mbahen permanente grupe vullnetare në secilin vendbanim të cilat në rast zjarri do të mund të ndihmonin Departamentin e Zjarrfikësve. Stafi i Zjarrfikësve do të vazhdojë të ketë trajnime permanente. Komuna në bashkëpunim me Njësinë e Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim dhe Kompaninë regjionale të ujësjellësit do të shtojnë rrjetin e hidrantëve në dy vendbanimet rurale kryesore dhe korridoret kyçe ku zjarrfikësit mund të furnizohen me ujë. Bashkëpunimi ndër-komunal me departamentin e zjarrfikësve në komunat fqinje (Kaçanik dhe Ferizaj) dhe Departamentin e Emergjencave (MPB) do të jetë i domosdoshëm për ndërmarrjen e masave në rast të paraqitjes së zjarreve në pyje.

Sa i përket Raportit të VSM-së, propozon të bëhen studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënjes, kohën dhe lokacionet më të atakuara.



Harta 26 Plani i mbrojtjes nga rreziqet natyrore

9.4.5 Zhvillimi ekonomik


Potencialet kryesore mbi të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i punësimit/ të hyrave për Komunën e Hanit të Elezit janë nyja zhvillimore e Qytezës, zona shtesë ekonomike në Gorancë, nyjat ndihmëse turistike dhe bujqësia/ pylltaria.

Politikat zhvillimore komunale luajnë rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kushteve për zhvillim të shërbimeve tregtare. Zhvillimi ekonomik është planifikuar të arrihet duke u bazuar në resurset, kapacitetet dhe traditën (industriale dhe mikpritëse) si dhe duke marrë për bazë pozitën e komunës së Hanit të Elezit, gjithnjë duke respektuar kushtet e dhëna ne PHK për vendosjen e veprimtarive ekonomike në hapësirë, të cilat duhet të plotësojnë standardet e mbrojtjes së mjedisit të dhëna në PHK⁵⁸, të cilat kanë parasysh plotësimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit, minimizimi i ndikimeve negative, ofrimi i qasjeve për të gjithë, etj.

Ndërmarrjet dhe biznesi – zhvillimi i ndërmarrjeve në Han të Elezit është në lidhje të drejtpërdrejtë me nyjat zhvillimore dhe qasja në korridoret që i lidhin këto nyje si dhe rrjetin e vendbanimeve. Përderisa:

- Qyteza si qendër/ nyje e vetme zhvillimore kryesore socio-ekonomike do të mbështesë kryesisht zhvillimin e ndërmarrjeve industriale, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme tregtare, shërbyese hotelerie, profesionale dhe të ngjashme. Lokacioni shtesë i zonës ekonomike në Gorancë do të jetë shtesë e kësaj nyje.
- Nyjet ndihmëse zhvillimore turistike në Pustenik, Gorancë, Neçavc dhe luginës së lumit të Dimces të cilat do të mbështesin kryesisht ndërmarrjet shërbyese hoteliere dhe tregtare të vogla.

⁵⁸PlaniHapësiroriKosovës2010Kushtetevendosjessëveprimtariveekonomikenëhapësirëfaqe184



Harta 27Plani i Zhvillimit Ekonomik

Kyçja në autoudhë dhe nacionalja N2 janë elemente përmes të cilave do të joshen vizitorët për të shijuar atraksionet natyrore dhe kulturore të Hanit të Elezit që do të vihen në dispozicion duke gërrshetur traditën/ kulturën mikpritëse dhe produktin e ridizajnuar të bizneseve krijuese dhe shërbyese i cili duhet të jetë së paku i kualitetit të afërt me produktin që e ofron natyra. Përtej kësaj, produktet e bizneseve të Hanit të Elezit do të plasohen në treg përmes kësaj kyçje në autoudhë dhe formave më të reja digjitale.

Bizneset tregtare dhe shërbyese do të mbështeten edhe në korridoret rrugore që lidhin këto nje sipas karakteristikave të lokacionit. Këto korridore paraqesin një potencial shtesë që e plotëson zhvillimin e gjithmbarshëm.

Ndërmarrjet dhe biznesi do të zhvillohen edhe në terminalin doganor dhe vendbanimet tjera sipas potencialeve lokale dhe kërkesave. Veprimtaritë ekonomike që do të zhvillohen në vendbanime duhet të jenë në harmoni me karakterin e tyre, dhe që në asnjë mënyrë të mos cenojnë vlerat dhe potencialet e tyre lokale, sidomos ato bujqësore, natyrore dhe të trashëgimisë. Për më tepër, duhet të përkrahen veprimtaritë ekonomike të cilat i promovojnë vlerat lokale dhe i përfshijnë ato në zhvillimet bashkëkohore.

Zhvillimet e këtij sektori do të planifikohen duke i marrë parasysh rekomandimet e dala nga Raporti i VSM-së, i cili rekomandon hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme për industri dhe shërbime tregtare, dhe profesional financiar dhe informacionit, në të cilën duhet të trajtohen duke përfshirë masat për fizike, natyrore dhe teknologjike ashtu që zhvillimet të jenë miqësore edhe në aspektin mjedisor.

Me qëllim të mbështetjes së plotë të zhvillimit të ndërmarrjeve, sidomos atyre të vogla dhe të mesme (NVM), duhet të ofrohen edhe masa tjera më “të buta”. Fillimisht, është e nevojshme të bëhen studime përkatëse për profilet e ndërmarrjeve të cilat do të ishin më të suksesshme në Han të

Elezit, duke i marrë parasysh potencialet lokale, si dhe mundësinë e plasimit të prodhimeve dhe shërbimeve në tregun kosovar dhe më gjerë. Po ashtu, është e nevojshme që të avancohen më tej aftësitë për punë dhe të kapaciteteve lokale njerëzore sipas nevojave të tregut, përmes organizmit të trajnimeve profesionale. Avancimi i aftësive ndërmarrëse lokale do të bëhet përmes organizmit të trajnimeve, nxitjes së bashkëpunimit në mes bizneseve, dhe krijimit të kushteve për aktivitete komplementare ndër-sektoriale komunale dhe ndër-komunale.

Turizmi – është ky lloj zhvillimi i cili është i rëndësishëm për të komplementuar zhvillim e gjithmbarshëm komunal. Qyteza në veçanti do të strukturojë paketën mikse kulturo-natyrore dhe industriale ku natyrës ikonike të Sharrit, Karadakut dhe luginave të lumenjve iu gërshetohet historia industriale e Qytezës me pjesët e vjetra industriale dhe banimit të ndërtuar enkas dhe lokacionet e ndryshme kulturore duke përfshirë edhe ato të luftës së fundit. Natyrisht se lista e monumenteve kulturore është shumë më e gjerë me monumente dhe lokacione arkeologjike të shpërndara në tërë Komunën. Duke i pasur parasysh potencialet, mund të pritët që këto lista të zgjerohen edhe më tej në të ardhmen.

Nyje shumë e rëndësishme turistike mbetet në Sharr/ zona turistike Pustenike, e cila do të jetë fokusi kryesor me natyrë të bukur dhe lokacionet me vlerë kulturo-historike. Përveç bizneseve shërbyese hoteliere dhe vilave private aty do të ofrohet rekreacion dhe lëvizje në natyrë, qëndrim dhe socializim, etj. Krejt këtij aranzhmani i shtohen edhe zonat turistike të Gorancës dhe Neçavcit e Vërtomicës (sipërfaqe me pisha), zona turistike e luginës së lumit Dimca si dhe pikat tjera turistike në Laç/Pustenik, Krivenik dhe Dërmjak.

Vlerat unike natyrore do të plotësohen me vlerat krenare të trashëgimisë historikeshumë të rëndësishme të luftës së UÇK-së. Gjithandej nëpër komunë e posaçërisht në Sharr janë Zonat, lokacionet, përmendoret dhe përkujtimoret e luftës për çlirim të grave dhe burrave të Komunës së Hanit të Elezit. Gjatë prezantimit të ofertës turistike, këto asete do të jenë vlerë shtese e tregimit Hanelezas për traditën e përpjekjes së pakufishme dhe të vazhdueshme për jetë të lirë dhe të sigurte të banorëve dhe për të mundësuar shijimin e kësaj natyre nga vizitorët.

Përmes transportit të organizuar, vizitave private dhe dhënies së informacionit, ky funksionalitet turistik organizohet nga Qyteza dhe pikës informuese në Pustenik. Shpërndarja dhe qasja në informacion digjital është pjesë e domosdoshme e këtij funksionaliteti.

Për zhvillimin e turizmit do të nevojiten një varg masash shtesë, të cilat duhet të mundësojnë shfrytëzimin e potencialeve lokale por pa i cenuar vlerat e tyre. Këtu fillimisht bëjnë pjesë studimet e nevojshme për profilet e mundshme të turizmit në Han të Elezit dhe vizitorët potencial, të pasuara me aktivitete për promovimin e vlerave lokale. Po ashtu, është e nevojshme që të ngritën kapacitetet profesionale për ofrimin e shërbimeve turistike, duke u bazuar në përvojat e mira ndërkombëtare për turizëm të qëndrueshëm. Ndërkaq, infrastruktura fizike që do ti mbështesë aktivitetet turistike duhet të zhvillohet me kujdes dhe në harmoni me vlerat natyrore dhe kulturore, duke shmangur çfarëdo cenimi të tyre.

Duke pas parasysh që në pothuajse të gjitha vendbanimet në të cilat planifikohet zhvillimi i turizmit ka mungesë të infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, shtrirja dhe organizimi i shërbimeve si dhe përmirësimi i qasjes në vendbanimet përkatëse do të jetë një nga masat që do të ndërmerren.

Në të gjitha sipërfaqet tjera rekreative turistike jashtë nënzonave të lartpërmendurat, nuk do të lejohet kurfarë zhvillimi që do ti dëmtonte vlerat natyrore të atyre sipërfaqeve.

Sipërfaqet turistike në Pustenik dhe Neçavc të përcaktuara me këtë dokument – PZHK, duhet të jenë të sigurta, të qëndrueshme dhe të mbrojtura nga zhvillimet e pakontrolluara dhe dëmtimet.

Gjatë planifikimit të zhvillimeve në këto zona duhet të merren parasysh rekomandimet e dala nga Raporti i VSM-së, i cili kërkon të ndërmerren masat për pyllëzim dhe ripyllëzim, konservim të veçorive natyrore, mbrojtje e biodiversitetit e habitateve natyrore, të peisazheve e parqeve me vlera ose ndikime mjedisore.

Poashtu, është i domosdoshëm edhe aplikimi masave mbrojtëse të përcaktuara me NTPH për të gjitha sipërfaqet turistike dhe jo vetëm. Këto masa ndalojnë apo kufizojnë aktivitetet vijuese: ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës; ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve; mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve; deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura; ndryshimi i regjimit të ujërave; përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike; kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës; mbjellja e monokulturave; grumbullimi i kërpudhave, bimëve dhe pjesëve të tyre; shqetësimi, vrasja ose kapja e shtazëve, gjuetia, peshkimi; veprimtaritë rekreative- sportive; vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera; aktivitete të tjera të cilat mund të rrezikojnë vlerën e mbrojtur të natyrës.

Është me rëndësi që në këto sipërfaqet duhet të sigurohet që turizmi të jetë i qëndrueshëm dhe të mos dëmtojë resurset natyrore. Për të siguruar një gjë të tillë duhet identifikuar ndikimet e mundshme negative nga aktivitetet turistike (dëmtimi i habitateve, ndotja, dhe humbja e biodiversitetit), si dhe duhet të krijohet një ekuilibër mes zhvillimit turistik dhe mbrojtjes së mjedisit, për më tepër komuna e Hanit të Elezit duhet të sigurohet që zhvillimet në këto sipërfaqe të jenë në harmoni me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Duke i marrë në konsideratë të gjitha çështje e lartëpërmenduar hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për çdo zhvillim është i domosdoshëm.

Bujqësia – sipërfaqet bujqësore kanë shtrirje të përhapur brenda territorit komunal me ato kualitative përgjatë Luginës së Lepencit në pjesën më jugore të tij, si dhe ato më pak kualitative në pjesët kodrinore. Bazuar në cilësinë e tyre dhe impaktit që në to kanë zhvillimet tjera hapësinore, janë të rëndësishme masat që duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes në njërën anë, si dhe rritjes së nivelit të shfrytëzimit, vlerës dhe prodhimtarisë në anën tjetër. Në lidhje me mbrojtjen, është e domosdoshme që toka bujqësore si aset zhvillimor të mbrohet nga ndërtimet joformale dhe shpërhapjet zhvillimore të paplanifikuara. Kjo arrihet përmes respektimit të kufijve të zonave të ndërtimit dhe zgjerimit minimal të tyre. Po ashtu është planifikuar të sigurohet mbrojtja e tokave bujqësore nga format e ndryshme të ndotjes, vërshimeve dhe fatkeqësive (kjo komponentë do të prezantohet me thellësisht në 5.1).

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik në Han të Elezit është bazuar në potenciale lokale, që duhet zbatuar deri në vitin 2032. Kjo realizohet duke bërë përmirësimin e infrastrukturës bujqësore dhe shtimin e kapaciteteve bujqësore. Shtimi i kapaciteteve bujqësore planifikohet të bëhet me përdorimin e teknologjisë moderne, me përdorimin e makinerive sikurse traktorët, kombajnët dhe mjete të tjera moderne - teknologjitë të bazuara në GIS për monitorimin dhe menaxhimin e tokës bujqësore. Rekomandohet aplikimi i praktikave të qëndrueshme sikurse përdorimi i ferilizuesve organikë që njëkohësisht redukton ndikimin negativ në mjedis. Formimi i kooperativave dhe partneriteti publiko-privat për të bashkuar burimet dhe për të përmirësuar fuqinë negociuese janë masa që ndihmojnë në rritjen e produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në sektorin bujqësor. Paraprakisht komuna e Hanit të Elezit duhet të konsideroj organizimin e programeve të trajnimit për bujqit mbi teknikat moderne të lavërtarisë dhe menaxhimit të tokës si dhe mbështetjen financiare nga qeveria dhe organizatat ndërkombëtare.

Pas një studimi të fushës, planifikohet konsolidimi i tokave bujqësore në:

- rrafshnaltën e Krivenikut e cila është e përshtatshme për lavërtari (kryesisht me kulturën e grurit). Konsolidimi mund të arrijë edhe mbi 200 ha ndërsa aty nuk parashihet ujtitje;
- tokat kualitative bujqësore përgjatë pjesës jugore të lumit Lepenc (nën urën e Seçishtes). Këto sipërfaqe bujqësore do të kenë trajtim të veçantë. Në këtë zonë PZHK ka planifikuar

kufizimin e ndërtimit, në mënyrë që të parandalohet zgjerimi i vendbanimit ekzistues Lagja e Re por edhe zgjerimi i gjithë kufirit të ndërtuar që shtrihet përgjatë lumit. Poashtu, është planifikuar aplikimi i masave të veçanta agro-teknike në këto lokacione duke përfshirë plehrat kimike dhe substancat tjera, do të jenë të kufizuara për shkak të pranisë së lumit. Konsolidimi i këtyre tokave bujqësore përgjatë lumit është gjithashtu i planifikuar në favor të kultivimit të kulturave të përshtatshme (kryesisht misër dhe perime në serra) si rezultat i mundësisë për ujtime nga kanalet ekzistuese dhe të planifikuara. Ujitja bëhet drejtpërdrejtë nga lumi Lepenc.

Sa i përket përmirësimit të kushteve të qasjes në toka bujqësore më lart, parashihet ngritja e cilësisë së rrugëve rurale në nivel të arsyeshëm për këtë rang të rrugëve (p.sh. shtrimi me zhavorr).

Fshatrat e Hanit të Elezit përbëjnë rrjetin bartës të zhvillimit rural. Brenda tyre, terrenet e rrafshëta apo luginore do të jenë bartëse të zhvillimit të veprimtarive bujqësore individuale duke i pasur parasysh potencialet që i ofron toka në të cilat ato shtrihen. Fshatrat e terreneve kodrinore të komunës do të jenë kryesisht bartëse të zhvillimit të blegtorisë, duke iu përshtatur kushteve dhe terrenit. Në përgjithësi, sipas potencialeve të tokës bujqësore nëpër fshatra dhe interesit individual të bujqve, do të promovohet edhe pemëtaria si dhe kultivimi i frutave të pyllit (dredhëza, mjedra, aronia, boronica e të ngjashme). Është me rëndësi që në zhvillimin hapësinor të fshatrave të ruhet potencialet që i ofron struktura hapësinore e tyre për zhvillimin e jetës së shëndoshë dhe veprimtarive ekonomike rurale.

Me qëllim të ofrimit të një spektri të plotë të masave përkrahëse për zhvillimin e bujqësisë, grantet dhe subvencionet targetohen specifikisht në tokat bujqësore të konsoliduara (për grurë, misër dhe perime në serra apo të jashtme) dhe në tokat tjera bujqësore në rastet e pemishteve dhe frutave të pyllit. Përveç mbrojtjes së tokës, mbështetjes nga aspekti hapësinor dhe fizik me infrastrukturë përkatëse dhe subvencionet/ grantet, ofrohen edhe masa tjera më “të buta”. Mbështetja e vazhdueshme në ngritjen e njohurive dhe kapaciteteve profesionale, sidomos për qasjet bashkëkohore në bujqësi, si dhe avancimi i teknikave të aplikuara bujqësore, janë kushte të domosdoshme që potencialet bujqësore të shfrytëzohen në shkallë sa më të lartë dhe në mënyrë të qëndrueshme. Identifikimi i llojeve të prodhimeve që ofrojnë cilësi në territorin e Hanit të Elezit, si dhe krijimi i rrjetit të furnizimit/plasimit, janë të domosdoshme për kthimin e bujqësisë në gjenerues të punësimit dhe zhvillimit.

Zhvillimi eventual kapaciteteve përpunuese bujqësore mbetet në varshmëri nga kapacitetet dhe cilësia e prodhimit bujqësor, e sidomos nga nevojat e tregut ku mund të plasohen prodhimet e përpunuara. Komuna do të bëjë përpjekje për të bërë një analizë për sigurimin e tregut për shitjen e prodhimeve bujqësore (bashkëpunim edhe me komuna fqinje).

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II, neni 1 paragrafi 1.2.2), tokat bujqësore mbrohen nga fragmentimi duke marrë masat kundër fragmentimit. Pra toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela. Kjo masë mbrojtjeje duhet të respektohet në dokumentet e planifikimit hapësinor. Për më shumë, toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e së cilës është ≤ 0.50 ha, të mos mund të fragmentohet tutje.

Startegjia për Zhvillim Ekonomik deri në vitin 2032 parasheh shtimin e kapaciteteve në blegtori. Ky objektiv planifikohet të realizohet me përdorimi i teknologjisë automatike për ushqyerjen e kafshëve, pastaj përdorimin e robotëve të mjeljes dhe ushqyesit automatikë. Është me rëndësi të përdoret ushqimi i balancuar me vitamina dhe minerale për të përmirësuar shëndetin dhe produktivitetin e kafshëve. Planifikohet që përmes granteve të bëhet përmirësimi i kushteve në shtalla ekzistuese dhe ndërtimi i shtallave të reja, duke ofruar një ambient më të pastër për kafshët. Mbi të gjitha ofrimi i programeve të trajnimit mbi teknikat e reja dhe praktikat më të mira, është më

se i domosdoshëm për blegtorë. Këto aktivitete duhet të mbështeten nga komuna e Hanit të Elezit dhe MBPZHR . Sikurse në bujqësi edhe në blegtori duhet të konsiderohet partneriteti publiko-privat.

Pylltaria – sipërfaqet e bollshme pyjore të Hanit të Elezit kryesisht në Malet e Karadakut por edhe të Sharrit do të mbrohen nga prerja dhe degradimi. Kjo do të arrihet në bashkëpunim me të gjithë akterët e përfshirë publik, privat dhe të shoqërisë civile. Planifikohen projekte voluminozë të pyllëzimit sipas karakteristikave të lokacionit. Rëndësi të veçantë do ti kushtohet mbrojtjes dhe rivitalizimit të sipërfaqeve pyjore të identifikuara si të mbrojtura në kuadër të zonave turistike.

Me strategji parashihet të bëhet promovimi i pylltarisë industriale që duhet realizuar deri në vitin 2026. Kjo kërkon një qasje që përfshin edukimin, mbështetjen financiare, teknologjinë e avancuar dhe zhvillimin e tregut. Në kuadër të edukimit planifikohet zhvillimi i fushatave informuese sikurse organizimi i fushatave për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet ekonomike dhe mjedisore të pylltarisë industriale. Përfshirja e moduleve mbi pylltarinë në kurrikulat shkollore, edukimi i të rinjve mbi rëndësinë dhe praktikën e qëndrueshme të pylltarisë është një tjetër aktivitet i rëndësishëm që propozon plani. Për më tepër, për të inkurajuar investimet në pylltari plani parasheh zhvillimin e politikave lehtësuese fiskale nga ana e nivelit lokal dhe qendror. Për të monitoruar dhe menaxhuar pyjet në mënyrë të qëndrueshme, PZHK propozon përdorimi i teknologjive të reja sikurse sistemi GIS. Paralelisht me këto aktivitete përmes marketingut dhe brendimit planifikohet të zhvillohet tregu për këtë fushë.

Sipërfaqe tjera pyjore të identifikuara (publike dhe private) ku nuk dëmtohet peizazhi natyror apo urban si i domosdoshëm për standard optimal jetësor dhe si aset për zhvillim të turizmit, do planifikohet për zhvillim të pylltarisë. Pjesë të caktuara në Karadak dhe Sharr të jepen në shfrytëzim për pylltari komerciale (partneritet publiko-privat apo modalitet tjetër) për të prodhuar lëndë druri për industri, ndërtimtari apo biomasë. Përderisa në Sharr do të lejohet vetëm kultivimi i drurit lokal (ahu, bungu, pisha, etj), me kujdes të veçantë në Karadak do të lejohet edhe prezantimi i drunjëve industrial jo endemik (pauloënia apo të ngjashme).

Si rezultat i identifikimit nga komuna (bazuar në hulumtimet paraprake) të lokacioneve potenciale për prodhimin energjisë nga burimet e ripërtërishe sidomos nga dielli dhe era, me PZHK planifikohet të promovohet ky sektor dhe të inkurajohen bizneset që të fillojnë zhvillimin e këtij aktiviteti si për prodhimin e energjisë për nevojat e veprimtarisë së tyre ashtu edhe për tregti. Gjithashtu komuna përmes mbështetjes së Qeverisë dhe donatorëve do të bëjë ngritjen e kapaciteteve për përgaditjen e kuadrove për t'u punësuar në këtë sektor.

9.4.6 Infrastruktura teknike

Infrastruktura teknike përfshinë shtrirjen e ndërtesave, instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore për furnizimin e energjisë elektrike dhe termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, telekomunikacionit dhe instalimeve të tjera të ngjashme. Kapacitetet e këtyre sistemeve dhe cilësia e shërbimit do të përmbushin nevojat e banimit, si dhe do ta mbështesin zhvillimin ekonomik.

Ujësjellësi – sipas vlerësimit të situatës, me rrjet të ujësjellësit janë të mbuluara vetëm zona urbane me një pjesë të fshatit Seçishtë i cili sistem menaxhohet nga KRU „Bifurkacioni, dhe fshati Gorancë i cili menaxhohet nga vet komuniteti. Kapaciteti i ujit të dy burimeve nga të cilat furnizohet sistemi është 29l/s, mirëpo gjatë sezonës së verës, zvogëlohet dhe KRU obligohet të aplikoj reduktime gjatë ditës, kjo ndodh edhe për shkak të keqpërdorimeve dhe kyçjeve ilegale por edhe të defekteve në sistem.

Fshati Gorancë e posedon rrjetin me kapacitet furnizues prej 5l/s, mirëpo edhe këtu gjatë sezonës së verës si rezultat i mungesës së reshjeve dhe menaxhimit jo të mirë nga komuniteti, kapaciteti i ujit të zvogëlohet dhe qytetarët ballafaqohen me mungesë të ujit të pijshëm.

Vendbanimet tjera nuk kanë sisteme, kështu që qytetarët detyrohen të furnizohen me ujë nga pusët

individuale. Me qëllim të ofrimit të shërbimit optimal për të gjithë banorët e komunës, do të merren hapat në vijim:

- rrjeti i përbashkët i Qytezës, Seçishtes dhe vendbanimeve përreth do të përmirësohet dhe shtohet duke përfshirë të gjitha amvisëritë dhe bizneset (pjesën e mbetur të Seçishtes dhe pjesë të vendbanimeve përreth). Duke qenë se për 8 vitet e ardhshme këtu do të akomodohen shumica e banorëve shtesë të Komunës, diasporës dhe vizitorëve turistik, do të planifikohet përkritazi për sasi të shtuar të ujit deri në 6l/ sekondë.
- njëjtë do të vepohet me fshatin Gorancë, i cili sistem do të futet në menaxhim formal të KRU Bifurkacionit, Njësia në Han të Elezit.
- për fshatin Paldenicë komuna do të bëjë projektin dhe do të ndërtojë sistemin e përbashkët të ujësjellësit i cili do të menaxhohet nga KRU respektive.
për fshatrat Dimcë, Krivenik, Dremjak, Neçavc dhe Vërtomicë do të bëhen hulumtime dhe analiza për modalitetin më të përshtatshëm për ofrimin e shërbimit.
- për nevoja turistike planifikohet të rregullohen burime të ujit të pijes në lokacione të caktuara.

Për të arritur këtë qëllim të shërbimit të banorëve lokal por edhe veprimtarive ekonomike sipas konceptit zhvillimor, do të bëhen studime dhe hulumtime për kapacitete shtesë të burimeve ujore. Paralelisht me burime të reja ujore, menaxhimi i shërbimit do të avancohet me ofrim permanent të ujit cilësor sipas standardeve në fuqi dhe e fundit jo për nga rëndësia, planifikohet menaxhim më i mirë i komplet sistemit për të ulur ndjeshëm humbjet komerciale dhe teknike të ujit në më pak se 20% nga mbi 50% sa është tani. Masat e lartëpërmendura janë rekomanduar edhe me Raportin e VSM-së. Racionalizimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare në raport me të hyrat si dhe aplikimi i gjobave do të jetë i domosdoshëm duke pasur në konsideratë kufizimet me ujë që mund të ndodhin nga sasia e çrregulluar e reshjeve atmosferike të ndikuara potencialisht nga ndryshimet klimatike.

Kanalizimi – pothuajse të gjitha vendbanimet kanë qasje në sistemin e kanalizimit të cilat derdhen në një kolektor në afërsi të lumit Lepenc (lokacion i planifikuar për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza). Vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në këtë shërbim janë Dimcë, Pustenik, Dremjak, Vërtomicë dhe Neçavc (tri të fundit vendbanime të depopulluara).


Me PZHK planifikohen përmirësime të nevojshme dhe rritje të kapacitetit paralelisht me kërkesat zhvillimore të planifikuara, si dhe ndarja e ujërave atmosferik nga ujërat e zeza në pika të caktuara.

Kolektorit ekzistues në lindje të lumit Lepenc i cili përmbledh të gjitha vendbanimet dhe lagjet e asaj ane do të shtohet edhe kolektori i planifikuar perëndimor që nga Laçi/ Pustenik e deri në pikën më jugore të Komunës (afër kufirit me RMV) ku është planifikuar të ndërtohet impianti për trajtimin e ujërave të zeza. Me kompletimin e sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza do të ndalohet njëri nga burimet e ndotjes së mjedisit.

Poashtu do të merren parasysh edhe masat e rekomanduara nga Raporti i VSM-së si në vijim:

- *zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqërohet edhe me minimizimin e rrjedhjeve;*
- *rritja e lidhjeve;*
- *rregullimi i lidhjeve të paligjshme;*
- *zvogëlimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave dhe ndërtimi i impiantit të planifikuar.*


Komuna e Hanit të Elezit do të bashkëpunojë ngushtë me Komunitet Ferizaj dhe Kaçanik duke përfshirë edhe presionin e duhur nga OSHC-të në mënyrë që të shpejtohet realizimi i projekteve të impianteve të tyre që do të sillte ndikim vendimtar në mjedis (në lumin Lepenc).



Harta 28 Plani i ujësjellësit dhe kanalizimit

Ujitja dhe drenazhimi – vëmendje e veçantë do të kushtohet ujitjes së tokave bujqësore të planifikuara për konsolidim përgjatë luginës së Lepencit (shih pjesën e bujqësisë). Kanaleve ujitëse ekzistuese do të shtohen edhe kanale të reja për të arritur zhvillimin bujqësor të planifikuar.

Menaxhimi i ujërave atmosferik do të bëhet përmes sanimit të sistemeve ekzistuese në zonën urbane, si dhe ndërtimit të sistemeve të hapura përgjatë rrugëve ku ato mungojnë duke përfshirë edhe mirëmbajtjen dhe mbajtjen funksionale të tyre gjatë tërë kohës. Si masë për zvogëlimin e riskut nga vërshimet por edhe për të larguar kundërmimet nga ujërat e zeza do të bëhet pastrimi permanent i shtretërve të Lepencit dhe përrenjve më të mëdhenj posaçërisht nëpër dhe afër vendbanimeve, si dhe do të rregullohen shtretërit e tyre në segmente të caktuara. Zona përgjatë luginës së Lepencit, Dimces dhe Laçit është i shpallur si zonë me interes të veçantë nga Komuna prandaj gjatë rregullimit të lumit duhet kushtuar kujdes ruajtjes së biodiversitetit dhe pasazhit përgjatë lumit.



Harta 28 Plani i ujitjes dhe drenazhimit

Mbeturinat – kompania publike lokale “Pastrimi” mbulon tërë territorin komunal me shërbim (100%) dhe deponimin e mbeturinave e bën te stacioni i transferit në Gerlicë të Ferizajt dhe në deponinë rajonale në Velekincë të Gjilanit. Komuna synon që kjo deponi të shfrytëzohet për derdhje të mbeturinave edhe në vitet e ardhshme. Në komunë ekzistojnë 2 deponi joformale dhe ajo e mbeturinave ndërtimore që janë sfidë për komunën. Komuna synon të ofroj shërbime cilësore për qytetarët e saj dhe eliminoj deponitë ilegale ekzistuese dhe të parandaloj krijimin e të rejave. Ky synim do të arrihet përmes zvogëlimit apo minimizimit të gjenerimit të mbeturinave dhe ndarjes së tyre. Tashmë është duke u punuar rreth minimizimit apo zvogëlimit të vëllimit të mbeturinave përmes ndarjes së plastikës, metalit, letrës dhe mbeturinave organike. Komuna në bashkëpunim me ndërmarrjen „Pastrimi” do të vazhdojnë të punojnë në këtë drejtim, me mbështetjen e GIZ. Gjithashtu, OJQ Gjethi e cila operon në rajonin e Ferizajt, tashmë ka bërë një sërë studimesh e analizash në këtë kontekst. Sa i përket, ndarjes së plastikës, metalit, letrës do të reciklohen nga kompania REX në Kaçanik, e cila është e njohur në këtë mes për plastikë, ndërsa mbeturinat organike tashmë kanë filluar të riciklohen përmes komposterëve individual. Komposterët e mbeturinave organike planifikohet të shtohen në fshatra ndërsa Komuna do të bëjë studime të fisibilitetit për mundësinë e subvencionimit të një recikluesi të madh për mbeturinat organike. Modalitetet mund të jenë të ndryshme që nga ndërmarrjet private apo publike apo publiko/private. Gjithashtu, planifikohen subvencione dhe iniciativa të ndryshme për kohë të caktuar në njërën anë si pakoja stimuluese për bizneset „zero ambalazhim” dhe „zero mbeturina”, pagesa për volum të mbeturinave të gjeneruara⁵⁹ dhe aplikimi strikt i gjobave.


Komuna, gjithashtu planifikon edhe vetëdijësimin e qytetarëve të saj për mos hudhjen e mbeturinave jashtë kontejnerëve dhe reciklimin, përmes bashkëpunimit me OJQ-të lokale apo ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë.

⁵⁹ Burimi: Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave 2023 - 2027

Duhet theksuar se edhe VSM ka trajtuar këtë fushë dhe propozon si në vijim:

- grumbullimin më të mirë në vendbanime dhe nivel komunal;
- vënien në jetë të strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin;
- ndarjen më të mirë e materialeve të rrezikshme;
- për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohshme drejt asaj regjionale njëjtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina;
- zbatimin i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit.

Sa i përket çështjes së mbeturinave inerte, komuna ka caktuar lokacionin në afërsi të mihjes sipërfaqësore të mergeles, kapaciteti i së cilës do të përcaktohet në përputhje me normat e UA MMPH Nr. 08/2017 mbi NTPH kapitulli IV neni 17. Për më tepër, në bashkëpunim me gurëthyesit do të mundësohet ndarja dhe riciklimi i pjesshëm i këtyre mbeturinave duke përfshirë betonin dhe armaturën.




Harta 29 Plani i menaxhimit të mbeturinave

Energjia – vlerësimi i situatës tregon që KEDS mbulon të gjithë territorin e komunës me furnizim të kënaqshëm me energji elektrike, mirëpo rrjeti shpërndarës dhe shtyllat janë të vjetëruara.

Rehabilitimi dhe ndërimi i rrjetit shpërndarës dhe shtyllave është përgjegjësi e KEDS, mirëpo komuna do të negociojë me KEDS për zgjerimin e rrjetit edhe në zonat e planifikuara për zhvillim, banim, sektorë të ndërlidhur me banimin, zhvillim të shërbimeve tregtare, etj. Kushtet për vendosjen e infrastrukturës energjetike (gjenerim dhe transfer) duhet bazuar në UA MMPH Nr. 08/2017 mbi NTPH kapitulli IV neni 16 ku përcaktohen kushtet për distancën e vendosjes së tyre nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, vija ndërtimore apo ndërtesat.

Shfrytëzimi i potencialeve hidrike për prodhimin e energjisë elektrike do të merret në konsideratë duke respektuar Ligjin për Ujrat e Kosovës, Strategjinë Shtetërore të Ujrave, Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Planin e Menaxhimit të Pellgut të lumit Lepenc. Në përputhje me këto dokumente procesi do të përfshijë identifikimin dhe vlerësimin e potencialeve hidrike, kryerjen e studimeve të detajuara mbi prurjet ujore dhe kapacitetin e shfrytëzimit të tyre, integrimin e kriterëve mjedisore dhe ligjore si dhe organizimin e konsultimeve publike për të përfshirë qytetarët dhe palët e interesuara në procesin e planifikimit.



Harta 30 Plani i energjisë elektrike dhe termike

186

Megjithatë, fillimisht do të kryhen hulumtime për të vlerësuar nëse këto lokacione janë të përshtatshme sa i përket kapacitetit të rrezatimit dhe erës.

Perzgjedhja e këtyre lokacioneve është bërë në pajtim me UA MMPH 08/2017 për NTPH Kapitulli IV neni 16 si dhe është konsultuar Udhëzuesi – Analizë Ligjore – Harta Zonale e Komunës i hartuar nga MMPHI me mbështetjen e USAID-it. Parcelat e përzgjedhura për zhvillim të energjisë së ripërtërishme (kryesisht janë sipërfaqe të zhveshura dhe me shkurre), janë të klasit mbi katër (IV), nuk janë zona të mbrotjura apo në afërsi të zonave mbrojtëse, janë larg vendbanimeve, nuk ka burime të ujit, trashëgimi natyrore, arkeologjike, etj. Për më tepër, lokacionet e përzgjedhura janë në afërsi të rrugëve ekzistuese lokale por edhe atyre të planifikuara lokale dhe rajonale. Kështu që konsiderohen si shumë të përshtatshme për zhvillim të energjisë së ripërtërishme.

Ky udhëzim poashtu jep disa kritere të cilat duhet respektuar gjatë përcaktimit të lokacionit për këtë lloj shfrytëzimi, si duhet të ndërtohet të paktën 2 km prej zonës së mbrojtur, ndërsa nuk parashihet të ndërtohet në hapësira ku ka burime të rralla minerale, në zona të mbrojtura ujore të kategorisë 1 dhe në toka të vlefshme bujqësore.


Ndërsa, përgjegjësitë dhe procedurat administrative, të drejtat dhe obligimet e subjekteve, procesi i aplikimit, kushtet e kualifikimit, kushtet e zhvillimit, tarifat nxitëse janë caktuar me Ligjin Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme dhe me UA ME Nr. 01/2024 për Procesin e Ofertimit Konkurrues për Dhënien e Mbështetjes për Energji të Ripërtërishme si dhe me rregulloret e vendimet e ZRRE-së.

Ngrohja – komuna ashtu si shumica e komunave të Kosovës nuk ka sistem të ngrohjes qendrore, andaj ngrohja ndërtesave të banimit, shërbimeve tregtare (bizneset, hotelet, restorantet), komunitetit (administrata, shkollat, shendetesia), kulturore, argëtuese dhe rekreative, industrisë, sigurohet kryesisht nga druri dhe energjia elektrike, dhe rreth 10% nga pelleti dhe briketi.

Për të qenë sa më eficient dhe racional gjatë shfrytëzimit të energjisë për ngrohje, komuna planifikon studime për promovim të ngrohjes qendrore në zonën urbane si prioritet. Deri në aplikimin e ngrohjes qendrore në Qytezë, por edhe Seçishtë, Gorancë e Paldenicë do të promovohet aplikimi i pompave termike për ngrohje para kaldajave me biomasë. Ndërsa në rastin e vendbanimeve më të vogla kaldajat me biomasë do të promovohen dhe lejohen si burim i ngrohjes duke mos i përjashtuar edhe pompat termike. E tërë kjo do të zhvillohet paralelisht me aplikimin e masave të lartpërmendura të efijencës së energjisë në ndërtesa në tërë Komunën. Ngrohja qendrore është një sfidë duke ditur buxhetin e limituar të Komunës, megjithatë Komuna angazhohet të tërheqë donatorë të mundshëm apo mbështetje nga qeveria qendrore.

Interneti dhe telefoni – edhe pse shumë funksional, shërbimi me telefoni mobile dhe internet planifikohet të shtrihet edhe te nyjat zhvillimore turistike dhe korridoret infrastrukturore. Përtej ofrimit të shërbimit bazë për banorët, kjo është shumë e rëndësishme për të suplementuar promovimin e zhvillimit dhe ndarjen digjitale të informacionit në kohë reale për vizitorët dhe mysafirët.


Nëse i krahasojmë rekomandimet aktuale me ato të planifikuara me PZHK-në në fuqi nuk ka ndonjë ndryshim.



Harta 31 Plani i telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme

9.4.7 Infrastruktura e transportit dhe transporti

Rrjeti rrugor në Komunën e Hanit të Elezit i përmban të gjitha nivelet e hierarkisë rrugore në nivel kombëtar dhe komunal, si rrjet bartës i zhvillimit dhe komunikimit. Qasja në rrugët e rangut të lartë i mundëson Hanit të Elezit lidhje të shpejtë me qendrat e mëdha të Kosovës dhe komunat e rajonit, si dhe me korridoret ndërkombëtare (shih Aneksin 14 - Harta e Konceptit të Zhvillimit të Infrastrukturës Rrugore). Infrastruktura e transportit rrugor është planifikuar duke u bazuar në UA MMPH Nr.08/2017 mbi NTPH, kapitulli IV, paragrafi 11, andaj dizajnimet e rrugëve, brezave të gjelbër, brezit rrugor, brezit mbrojtës rrugor do të bëhen bazuar në normat teknike të përcaktuara me udhëzimin e përmendur më lartë.



Harta 32 Plani i infrastrukturës së transportit

Rrugët e nivelit kombëtar – në kuadër të këtyre rrugëve janë autoudha R6 (Prishtinë-Hani i Elezit), rruga nacionale N2 (Prishtinë-Shkup) përmes të cilave Komuna e Hanit të Elezit ka qasje dhe lidhje të gjithanshme me shtetet fqinje, rajonet dhe komunat fqinje, pika të rëndësishme transporti (pika kufitare në Gllloboçicë dhe aeroportet e Prishtinës dhe Shkupit) dhe vende tjera strategjike.

Si masa për përmirësimin e gjendjes në këtë nivel janë ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e qarkullimit jomotorik dhe përmirësimin e sigurisë së qarkullimit. Po ashtu, do të aplikohen masa për menaxhimin e shpejtësisë së qarkullimit motorik (shirit gjelbërimi të lartë apo pengesa tjera) me qëllim të uljes së rrezikut në trafik.

Rrugët e nivelit lokal – vlerësimi i gjendjes tregon që shumica e rrugëve lokale janë të shtrua me mbulesë nga asfalti apo betoni, dhe për të ardhmen komuna planifikon konsolidimin e këtij rrjeti dhe rrjetit rrugor nëpër vendbanime (zonë urbane dhe rurale) me qëllim të krijimit të rrjeteve funksionale të qarkullimit. Rruga alternative që lidh Qytezën me fshatrat perëndimore është prioritet për Komunën për të funksionalizuar lëvizjen e domosdoshme e cila potencialisht bllokohet nga fluksi i pikë kalimi kufitar. Komuna planifikon edhe asfaltimin e rrugëve lokale Gorancë – Gllloboçicë (Kaçanik) dhe Gorancë - Krivenik që janë të rëndësishme në kuadër të kornizës zhvillimore të propozuar duke ndërlidhur zonën turistike të Gorancës me pjesën tjetër të Komunës dhe Kosovës.

Masat për krijimin e kushteve për qarkullim të sigurtë të këmbësorëve do të ndërmerren nëpër lagjet e vendbanimeve ku mungojnë (këtu përfshihen trotuare dhe/ apo shtigje për këmbësorë dhe çiklistë) dhe asfaltimi i rrugëve të pa mbulesë. Për të ofruar siguri të plotë të qarkullimit në trafik, do të ndërmerren masa si aplikimi i brezit të gjelbër i cili ndikon në uljen e shpejtësisë së qarkullimit motorik, krijimin e brezave mbrojtës dhe të gjitha hapave tjera sipas udhëzimit administrativ të lartpërmendur.

Hekurudha – segmenti i hekurudhës nëpër territorin e komunës është i gjatë 6.2km dhe posedon një kalim formal në afërsi të Urës së Seçishtës dhe kalime joformale te Uji i Thartë, lagja Ranat, qerdhja e qytetit dhe stadiumi i qytetit.

Rregullimi dhe mirëmbajtja e kësaj infrastrukture dhe transportit mbetet kompetencë e Hekurudhave të Kosovës dhe Departamentit/ Ministrisë së linjës. Në aspektin e sigurisë së kalimeve në hekurudhë, Komuna do të bashkëpunojë me Hekurudhat e Kosovës për të zgjidhur çështjet dhe ofruar siguri optimale për banorët që lëvizin nga njëra anë në tjetrën (lëvizje motorike apo jomotorike). Emergjencë mbetet rregullimi funksional i vendkalimeve në zonën urbane (Lagja Rana dhe Ura e Fejzës), por masa për rregullimin e vendkalimeve duhet të merren edhe te Uji i Thartë, Qerdhja e qytetit dhe te stadiumi i qytetit.

Shtigjet jo motorike – shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta do të jenë funksion shumë i rëndësishëm që do ta plotësojë rrjetin e gjithmbarshëm të linjave rrugore mes nyjeve zhvillimore dhe definitivisht konsiderohen të jetë pjesa më atraktive e këtij mozaiku. Vlerësimi gjendjes tregoi që në një pjesë e rrugëve sidomos në zonën urbane shtrihen shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, mirëpo në një pjesë të madhe të rrugëve në vendbanimet rurale ka mungesë të tyre. Andaj komuna planifikon që aty ku është e mundur të vazhdoj me ndërtimin e shtigjeve përgjatë rrugëve motorike, si dhe të krijoj korridore të gjelbra dhe të shëndetshme për lëvizje të qytetarëve dhe vizitorëve (në këmbë dhe biçikleta). Përtej këtyre, në kontekst të lidhjeve të nyjeve të hapësirave të parapara për zhvillim, në bashkëpunim me OSHC-të (OJQ Gjethi si liderë në rajon), shtigjet ekzistuese për ecje/ hiking nga Hani i Elezit drejt zonave turistike në Pustenik, Gorancë, Dimcë/ Dërmjak, Vorba, Paldenicë/ Neçavc/ Vërtomicë dhe nga Laçi në Pustenik/ Gorancë do të rregullohen dhe do të mirëmbahen vazhdueshëm. Për më shumë, do të bëhen analiza terreni për të shtuar linjat lëvizëse drejt aseteve tjera natyrore dhe kulturore dhe drejt nyjave zhvillimore sipas konceptit të treguar më lart.


Transporti publik – në të ardhmen Komuna do të koordinojë planin e transportit dhe përdorimit të tokës me qëllim të zvogëlimit të kërkesës për udhëtime brenda zonës urbane sidomos me makina private. Si një nga këto masa u përmend më lart simulimi i transportit jomotorik por edhe masa tjera që do të tregohen më poshtë. Cilësia e ofrimit të shërbimit, në kuptim të frekuencës, infrastrukturës përcjellëse, dhe mjeteve të transportit do të jetë e nivelit të kënaqshëm. Si shërbim i mirëfilltë, transporti publik do të ofrohet si alternativë ndaj qarkullimit me automjete individuale.

Transporti ndër-komunal, vlerësimi i gjendjes tregoi që komuna nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë me komunat tjera, përpos me komunën e Kaçanikut, ndërsa udhëtimi me komunat tjera bëhet me linjat e autobusit Prishtinë – Shkup dhe Prizren – Shkup. Situata do të mbetet pak a shumë e ngjashme me atë ekzistuesen pasi që konsiderohet se i përmbush kërkesat e qytetareve. Në këtë mes do të bëhet përpjekje për të prezantuar udhëtime të drejtëpërdrejta një herë në ditë Han i Elezit-Prishtinë dhe anasjelltas, si dhe Han të Elezit-Ferizaj të dielave.

Transporti lokal, sigurohet përmes minibusëve dhe veturave private për shkak të afërsisë së qytezës me vendbanime, përpos rastit të vendbanimit Paldenicë që ndodhet më largë qytezës. Ky itinerar mbulon zonën urbane përmes linjave transportuese lokale duke marrë parasysh se zona urbane është e vogël. Përtej linjave ekzistuese të transportit lokal të cilat mbeten dhe përmirësohen, do të prezantohen linjat lidhëse lokale me Paldenicën. Përtej kësaj, do të shikohet mundësia e themelimit të linjave sezonale të transportit drejt nyjave turistike (Gorancë dhe Neçavc). Në kuadër të kësaj shpërndarjeje, Komuna do të vazhdojë të funksionalizojë vend-ndalime adekuatë për autobus të rrugëve në zonën urbane, rurale dhe pika të caktuara brenda nyjave turistike, gjithashtu dhe promovimin e futjes së mjeteve të transportit me ndikim sa më të vogël në mjedis (nisur nga fakti se tashmë kanë filluar iniciativat e tilla me mbështetjen e donatorëve dhe granteve të Qeverisë) si dhe përdorimit të transportit jo motorik.

Stacioni autobusëve dhe ai hekurudhor, përderisa stacioni hekurudhor do të mbetet në lokacionin ekzistues ku parashihen përmirësime krahas modernizimit të hekurudhës nga organet relevante, komuna ka planifikuar ndërtimin e stacionit të autobusëve në lokacionin në afërsi të pompës së

Nëse i krahasojmë rekomandimet aktuale me ato të planifikuara me PZHK-në në fuqi nuk ka ndonjë ndryshim.



Harta 33 Plani i transportit lokal

Vend-parkimet – situata me vend-parkime në Komunën e Hanit të Elezit është e kënaqshme.

Për nevoja të zhvillimit të propozuar, bazuar në udhëzimin administrativ MMPH Nr. 08/2017 për NTPH kapitulli IV, neni 8 plani propozon masat në vijim:

- të organizohen vend-parkime funksionale në hyrje të nyjave zhvillimore me fokus zonat turistike por edhe në Qytezë sipas nevojës. Parkimet mund të jenë publike apo private;
- të organizohen vend-parkime jashtë rrugore publike apo privatesi pjesë përbërëse e ndërtesave publike, komerciale, qendër biznesi, etj.
- të organizohen vend-parkime jashtë rrugore private të ndërtesave private dhe në bashkëpronësi.

Te gjitha zhvillimet e reja duhet të i përmbahen UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH për të siguruar hapësirë të mjaftueshme për parking sipas standardeve.

9.4.8 Infrastruktura publike dhe sociale

Zhvillimi i mëtejshëm social i Hanit të Elezit, përmes ofrimit të shërbimeve përkatëse, është parakusht për ngritjen e mëtejme të potencialit njerëzor dhe mundësitit të një jete cilësore. Si pjesë e këtij zhvillimiparashihen masa brenda sektorëve të arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit dhe shërbimeve tjera publike,që ofrohen për banorët dhe vizitorët.

Arsimi – bazuar në UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH, kapitulli IV neni 3 shikuar përgjithësisht, infrastruktura e institucioneve dhe shtrirja e rrjetit të ndërtesave shkollore të nivelit fillor dhe të

mesëm në Han të Elezit konsiderohet e kënaqshme. Hierarkia e institucioneve shkollore përputhet edhe me hierarkinë dhe organizimin e vendbanimeve.

Përtej çerdhes ekzistuese, paralelisht me zhvillimet e planifikuara, do të shqyrtohen mundësi që të plotësohen nevojat shtesë me çerdhe shtesë publike apo private.

Në PZHK-në e kaluar (2010-2025) është potencuar nevoja për punësimin personelit shtesë në qytetin e Hanit të Elezit. Vendbanimet e tjera kanë personel të mjaftueshëm. Gjithashtu është theksuar se ka mungesë të personelit me kualifikim përkatës. Është rekomanduar punësimi i më shumë mësuesve për të përmbushur kriterin e raportit të mësuesit me studentët, trajnimi i personelit, faza e dytë e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në Hanin e Elezit, renovimi dhe mirëmbajtja e shkollave të fshatit, ndërtimi i ndërtesave dhe sallave të sporteve dhe ndërtimi i kabineteve. Analizat e bëra mes dy planeve tregojnë se nuk ekziston ndonjë ndryshim mes çështjeve të planifikuara me planin e kaluar, përveç parimeve nga UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH që ky plan duhet t'i zbatoj. Zgjerimi i kapacitetit të shkollave është bërë në bazë të dendësisë dhe rritjes së numrit të banorëve, gjithnjë duke u bazuar në UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH.

- Në nivel të shkollimit fillor/ të mesëm të ulët parashihet shtimi i hapësirave mësimore në 2 lokacione të Hanit të Elezit. Aktualisht SHFMU Veli Ballazhi është me 783.00 m², ndërsa SHFMU Kështjella e Diturisë është me 1247 m², pra në total janë rreth 2100m². Sipas U.A MMPH Nr. 08/2017 për NTPH shkolla fillore duhet të ketë 1.60 m² /për banorë, pra shkollat ekzistuese në Han të Elezit duhet të jetë me 4,377 m², që do të thotë se në total duhet të shtohen rreth 2200m² në dy lokacione.
- Në bazë të standardeve të kërkuara me UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH në të ardhmen duhet të ndërtohet një shkollë shtesë në Lagjen e Re (klasat 1-5). Sipërfaqja minimale e parcelës duhet të jetë rreth 0.15 ha për të plotësuar nevojat e popullsisë shtesë;

Gjatë përzgjedhjes së lokacionit është siguruar që të ketë kushtet vijuese: në kuadër të zonës së banimit; në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël; në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta; në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik; në largësi nga lokacionet e ndotura; në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet; në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore); në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret; në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

- Në Han të Elezit në lokacionin aktual të shkollës parashihen kapacitete të reja për shkollim të mesëm të ulët (klasat 6-9), sipërfaqja minimale e parcelës për të plotësuar nevojat e popullsisë shtesë duhet të jetë rreth 0.1ha. Përderisa hapësirat aktuale mjaftojnë për shkollimin fillor për nxënësit e Komunës nga Qyteza me vendbanimet përreth, Dimca, Kriveniku dhe Pusteniku; për të arritur kualitetin e dëshiruar të shkollimit të mesëm të ulët (këtu shtohen edhe nxënësit nga Seçishta dhe Lagja e Re) dhe synimin për mësim tërë-ditor, komuna planifikon shtimin e hapësirave shkollore. Komuna tashmë siguron transportin e nxënësve nga këto vendbanime.

Sipas analizave të bëra në kapitullin paraprak, gjithnjë duke u bazuar në UA MMPH Nr. 08/2017 mbi NTPH, SHFMU-të në Paldenicë dhe Gorancë mbesin të tilla.

Sa i përket infrastrukturës së institucioneve të arsimit para-universitar, sipas UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH sipërfaqja e parcelës në bazë të numrit të banorëve duhet të jetë prej 8100m² deri në 10 000m² me Indeks të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) prej 60%. Shkolla e Mesme e Lartë- Dardania, me sipërfaqen prej 1968.32m² edhe pse më e vogël se kërkuar mbetet funksionale ndërsa prioritet mbetet ndërtimi i palestrës. Sa i përket arsimit të mesëm profesional, ai do të avancohet më tej si platformë e zhvillimit social dhe rrjedhimisht edhe atij ekonomik. Në këtë mes do të bëhen studime të nevojshme për të plotësuar nevojat e suplementimit të zhvillimit të planifikuar si industri, tregti, bujqësi dhe shërbyes (hotelieri/ turizëm). Analizat për drejtimet e duhura do të bëhen bashkë me Komunën e Kaçanikut dhe Ferizajt për shkak të afërsisë dhe hapësirës më të gjerë zhvillimore. Të gjitha shkollat do të furnizohen vazhdimisht me pajisjet e duhura me fokus laboratorët e nevojshëm. Kujdes i veçantë do ti kushtohet qasjes së lehtë dhe të

sigurte të nxënësve në të gjitha objektet shkollore, ku intervenim urgjent nevojitet në rastin e shkollës në Han të Elezit.

Shëndetësia – ofrimi i shërbimeve shëndetësore për banorët dhe vizitorët e planifikuar do të bëhet përmes rrjetit aktual të institucioneve (QKMF në qendrën komunale dhe AMF-së në Gorancë) dhe infrastrukturës së planifikuar (objekti i ri QMF-së në Paldenicë).

Në PZHK-në 2010-2025 është rekomanduar ndërtimi i hapësirës shtesë për qëllime të emergjencës, ngjitur me objektin ekzistues të qendrës kryesore të mjekësisë familjare në qytetin e Hanit të Elezit. Edhe pse disa nga rekomandimet janë realizuar, në ndërkohë ka filluar aplikimi i UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH që kërkon standarde shtesë.

Prandaj, në kapitullin II. Vlerësimi i Gjendjes, janë bërë analiza të sipërfaqeve të kërkuara me NTPH edhe sipërfaqeve të ndërtesave si dhe mbulueshmëria e vendbanimeve me këto shërbime. Është vërejtur se ndërtesat janë me sipërfaqe të kërkuara dhe të gjitha vendbanimet janë të mbuluara me shërbime prandaj edhe nuk ka nevojë për ndërtesa shtesë. Në kuadër të zhvillimit të planifikuar, përmes QKMF-së planifikohet ofrimi i shërbimeve kryesore shëndetësore në Komunës. QKMF do të mbajë shërbimet ekzistuese duke përfshirë edhe pediatriinë, ndërsa me ndërtimin e një AMF në Paldenicë do të jenë 2 që do të kenë së paku shërbimin e infermierisë (8-orësh), dhe njëkohësisht do të përmbushet distanca optimale shërbyese sipas UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH (3km). Sipërfaqja minimale e parcelës duhet të jetë rreth 0.6 ha. Përtej kësaj Komuna do të bëjë përpjekje që edhe AMF-të të ofrojnë shërbime të rregullta shëndetësore të mjekësisë familjare.

Gjatë përzgjedhjes së lokacionit është siguruar që të ketë kushtet vijuese (UA MMPH Nr. 08/2017 për NTPH): në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen; në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël; në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta; në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik; në largësi nga lokacionet e ndotura; në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore); në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet; në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret, në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së shërbimeve cilësore, institucionet shëndetësore do të përkrahen përmes sigurimit të pajisjeve dhe materialeve të nevojshme shëndetësore. Të 3 qendrat shëndetësore do të pajisen me pajisje mjekësore varësisht nga nevoja dhe shërbimet që duhet të kryejnë.

Kultura – qendra e re kulturore plotëson të gjitha nevojat dhe planifikohet të shërbejë të gjithë banorët e Komunës. Ndërtesa Qendrës së Kulturës ka 3000m² dhe kjo sipërfaqe sipas NTPH është jo e mjaftueshme, por meqenëse është komunë jo e madhe atëherë mund të akomodohen aktivitete e kulturës. Për më shumë, zhvillimi i kulturës në Han të Elezit do të bëhet edhe përmes rrjetit ekzistues të ndërtesave shkollore të cilat do të jenë edhe në shërbim të komunitetit në periudhat kohore kur nuk pengohet procesi mësimor.


Duhet theksuar se PZHK-ja 2010-2025 ka rekomanduar; themelimin e bibliotekës publike dhe themelimin e muzeut të qytetit. Aktivitetet e këtyre dy ndërtesave tanimë janë të sistemuara në ndërtesën e Qendrës së Kulturës që na bën të kuptojmë se ka pasur progres në zbatimin e planit të kaluar dhe nuk është vërejtur ndonjë ndryshim në mes të rekomandimeve të planifikuar dhe atyre të zbatuara.

Biblioteka e Qytezës do të përmirësohet, me synim futjen e sistemit digjital i cili do të përdoret për tituj, lexim dhe mirëmbajtje/ shtim të fondit. Kjo bibliotekë do të mbështesë me tituj esencialë SHFMU-të në Paldenicë dhe Gorancë.

Komuna do të bëjë analizat dhe hapat e duhur për themelimin e Muzeut kulturo/etnografik për të cilin do të planifikojë edhe objektin në kohën e duhur. Hapësira të caktuara brenda Qendrës

Lepenc dhe përrenjve (Dimca, Rezhanca, dhe Laçi) dhe në nyjat turistike (sporte malore).

Në PZHK-në 2010-2025 është theksuar se është mungesë e ndërtesave sportive. Ky plan ka rekomanduar: zhvillimin e sportit dhe rekreacionit, krijimin e hapësirave për sport dhe rekreacion në kontekst të vendbanimeve urbane dhe rurale, përmirësimin e fushës së futbollit. Ndërsa, ndërtimi i sallave të sportit është rekomandim afatgjatë. Nëse analizohen rekomandimet e lartpërmenduar dhe gjendja ekzistuese e Hani të Elezit vërehet se ka pasur progres në zhvillimin hapësinor. Edhe pse Hani i Elezit ka stadiumin e qytetit dhe fushat sportive, me këtë plan vijnë në konsideratë parimet nga NTPH dhe kërkesa për t'i zbatuar ato. Duhet potencuar se nuk ekziston ndonjë ndryshim në çështjet e propozuara nga plani i kaluar.



Harta 35 Plani i hapësirave sportive

Tashmë u përmend se për një shërbim më kualitativ dhe të shpërndarë baras, do të shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese dhe ato të planifikuara në kuadër të shkollave. Rrjedhimisht, këto hapësira do të ju shërbejnë moshave shkollore, si dhe komunitetit. Natyrisht, ky shfrytëzim i zgjeruar duhet të menaxhohet ashtu që të mos cenohet procesi i rregullt mësimor. Në këtë mënyrë do të mundësohet një shtrirje e gjerë e hapësirave sportive për të gjithë banorët, duke mbetur brenda kufijve të arsyeshëm të investimeve financiare.

Përveç zgjerimit dhe përmirësimit të kapaciteteve hapësinore për sport, ky sektor duhet të zhvillohet edhe përmes vetëdijesimit për jetë të shëndetshme dhe mbështetjes së aktiviteteve sportive. Këto aktivitete do të përkrahen në radhë të parë nga drejtoritë komunale përgjegjëse për sport dhe arsim, me pjesëmarrjen e klubeve sportive dhe grupeve të komunitetit dhe me organizimin e turneve tradicionale lokale, ndër-komunale dhe ndërkombëtare.

Hapësirat publike – propozohet të strukturohet një sistem i integruar i hapësirave të hapura publike dhe parqeve (ekzistuese dhe të reja të krijuara) që mbështet një gamë të gjerë të aktiviteteve

rekreative dhe kulturore që i shërbejnë grupeve të shoqërisë, të moshave të ndryshme, nivelet e të ardhurave dhe nivelet e aftësive. Sigurimi i këtyre hapësirave është esenciale në plotësimin e nevojat e banorëve dhe vizitorëve në Han të Elezit. Për më shumë do të bëhet nxitja e përdorimit të shumëfishtë të parqeve dhe hapësirave të hapura publike midis një shumëllojshmërie të grupeve të shfrytëzimit dhe aktiviteteve të përdoruesve. Kjo do të arrihet edhe me përfshirjen e një gamë të objekteve rekreative dhe kulturore që pasqyrojnë shumëllojshmërinë rekreative dhe ndjekjet kulturore dhe interesat në Han të Elezit.

Këto hapësira në të gjitha vendbanimet do të lidhen përmes një sistemi të vazhdueshëm të shtigjeve me zonat natyrore përreth që janë me bollëk në Han të Elezit.

Bazuar në UA MMPH nr 08/2017 mbi NTPH kapitulli IV neni 9, normat minimale për sipërfaqen e parcelës së hapësirave të gjelbra janë si në vijim:

- Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banor;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor.


Andaj, për nevojat e popullsisë shtesë nevojiten minimum rreth 0.14 ha sipërfaqe të gjelbra. Shtigjet duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standardet dhe normat teknike, gjithnjë duke pasur në konsideratë gjithëpërfshirjen, qasjen për të gjithë dhe duke ruajtur vlerat natyrore të zonës, lagjes apo ekosistemit lumor. Ndër tjerash planifikohen rregullimi i korridoreve të gjelbra përgjatë lumit Lepenc dhe përrenjve Dimca, Rezhanca dhe Laçidhe përgjatë pikave tjera natyrore të cilat do të ketë përmbajtje të ndryshme (shtigje për ecje, biçikleta, kënde lojërash, pajisje për fitnes të hapur, hapësira sportive rekreative, hapësira për t'u ulur, etj.;

Sheshi i Qytezës do të përmirësohet dhe mirëmbahet. Përtej hapësirës publike të rregulluar në qendër të Gorancës, edhe në Seçishtë dhe Paldenicë është planifikuar krijimi i hapësirave publike me funksione të ndryshme për të gjitha grupmoshat. Në vendbanimet tjera rurale do të ruhen hapësirat e lira publike dhe shikohet mundësia e intervenimeve të vogla për ti përmirësuar ato. Të gjitha hapësirat e rregulluara do të mirëmbahen vazhdueshëm.

Parku i Qytezës tek përroi Dimca (ish prona ushtrisë- një pjesë e sajë) është planifikuar gjithashtu për përmirësim / investime për rregullim. Me këtë është paraparë rregullimi i qasjes me të mirë për personat me aftësi të veçanta dhe ofrimi i kushteve më të mira për vizitorët, ambient më të pastër për shkak të sipërfaqeve pyjore në park, sidomos për fëmijët duke krijuar hapësira socializimi dhe hapësira rekreative dhe sportive.

Sipërfaqet e reja në zonën urbane që planifikohen të zhvillohen duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për hapësira publike me qasje për të gjithë banorët. Do të synohet që çdo banor të ketë qasje në hapësira publike në largësi jo më shumë se 500 metra apo 15 minuta ecje në këmbë. Gjithashtu rekomandohet lidhja e hapësirave publike, parqeve, korridoreve të gjelbra dhe hapësirave malore ndërmjet veti përmes korridoreve të gjelbra.


Hapësirat e gjelbra në pronësi të shkollave në bashkëpunim me shkollën dhe komunitetin do të rregullohen për shfrytëzim primarë dhe nga komuniteti. Janë këto kryesisht kënde të vogla lojërash apo hapësira sportive, me orar të caktuar në shërbim të komunitetit.



Harta 36 Plani i hapësirave publike dhe të gjelbra

Objektet fetare dhe varrezat – bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit hapësinor MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli IV neni 10), si dhe duke llogaritur hapësirat e lira në varrezat ekzistuese dhe vdekshmërinë sipas statistikave të Kosovës është konstatuar se në Han të Elezit ka hapësira të mjaftueshme për varreza për shumë vite (e mjaftueshme për 8 vitet e ardhshme sa do të jetë në fuqi PZHK). Në zonat ku mungon rrethoja në bashkëpunim me komunitetin dhe institucionet fetare do të rregullohen rrethojat, si dhe do të nxitet një organizim më i mirë sa i përket menaxhimit fizik dhe elektronik të tyre (databaza, mikrolokacionet e secilit varr, mirëmbajtjadhe pastrimi i hapësirave etj.).

Edhe rrjeti ekzistues i objekteve fetare vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për 8 vitet në vijim dhe nuk planifikohen objekte të reja. Në bashkëpunim mes institucioneve dhe komunitetit fetar bashkë me administratën publike do të mund të sigurohet qasja në hapësira të mjaftueshme për data të caktuara.



Harta 37 Plani i menaxhimit të varrezave

9.4.9 Vendbanimet

Analiza e trendit të zhvillimeve të vendbanimeve të komunës brenda viteve tregon që përqindja më e madhe e vendbanimeve të komunës nuk kanë pasur intensitet të lartë të zhvillimit, përpos zonës urbane – Qytezës dhe fshatrave përreth saj Paldenicë, Gorançë dhe Seçishtë.

Komuna synon që zhvillimi i vendbanimeve të bëhet duke shfrytëzuar tokën në mënyrë sa më racionale me synim të ruajtjes së tokës bujqësore dhe konsolidimit të saj përgjatë lumit Lepenc dhe ofrimit të shërbimeve sociale optimale me kosto sa më të ulët. Sipas konceptit zhvillimor është propozuar strukturim qendror i vendbanimeve me fokus njëjën kryesore zhvillimore socio/ekonomike - Qytezën si Qendër e rendit të mesëm që përfshinë edhe Lagjet përreth dhe vendbanimin e Seçishtës. Në kontekst të zhvillimit social vendbanimet Paldenicë dhe Gorançë do të jenë qendra sekondare apo Qendra të rendit të ultë dhe fshatrat tjera do t'i përkasin modelit të qendrave bazike.

Ndërsa, bazuar në shpërndarjen e përmbajtjeve e funksioneve dhe të instensitetit të planifikuar të zhvillimit në të ardhmen si dhe madhësisë vendbanimet e komunës së Hani të Elezit do të klasifikohen si në vijim:

Vendbanimi	Popullsia e projektuar 2033	Sipërfaqja e vendbanimit (Zonës Kadastrale) (ha)	Kodi Hierarkik i Rregullimit Plotësues	Klasifikimi i vendbanimeve sipas madhësisë
Dimcë	138	212	Qendër bazike	Vendbanim shumë i vogël rural
Dremjak	100	615	Qendër bazike	Vendbanim shumë i vogël rural
Gorancë	637	2,080	Qendër e rendit të ultë	Vendbanim i mesëm rural
Han i Elezit	2,555	116	Qendër e rendit të mesëm	Vendbanim i madh rural
Krivenik	169	1,228	Qendër bazike	Vendbanim shumë i vogël rural
Neçavc	97	438	Qendër bazike	Vendbanim shumë i vogël rural
Paldenicë	1,629	404	Qendër e rendit të ultë	Vendbanim i mesëm i madh rural
Pustenik	322	1,087	Qendër bazike	Vendbanim i vogël rural
Rezhancë	487	852	Qendër bazike	Vendbanim i vogël rural
Seçishtë	2,123	850	Qendër e rendit të ultë	Vendbanim i mesëm i madh rural
Vërtomicë	4	438	/	Vendbanim shumë i vogël rural

Tabela 58. Klasifikimi i vendbanimeve sipas madhësisë

Vendbanimi	Gjendja ekzistuese				Projeksionet 2033					
	Popullsia 2024	Sip. e banimit (ha)	Dendësi ^{60a} njësi banimi/ha	Popullsia	Ekonomit e familjare shtesë	Dendësi a e banimit (njësi banimi/ha)	Sip. e banimit shtesë (ha)	Sip. e nevojshme për banim në total (ha)	Dendësi a e banimit b/ha	Intensiteti i zhvillimit
Dimcë	147	4	8	138	9	9	1	5	30	I ulët
Dremjak	108	6		101	7	9	1	7	30	I ulët
Gorancë	767	21		637	24	15	2	23	30	I mesëm
Han i Elezit	2,555	23	21	2,555	209	9-40	5	28	30-140	I lartë
Krivenik	204	9	8	169	6	9	1	10	30	I ulët
Neçavc	102	2		97	7	9	1	3	30	I ulët
Paldenicë	1,629	50		1,629	133	15	9	59	50	I mesëm
Pustenik	403	20		322	10	9	1	21	30	I ulët
Rezhancë	487	14		487	40	9	5	20	30	I ulët
Seçishtë	2,123	35		2,123	174	15	11	44	50	I mesëm
Vërtomicë	8			4	1					I ulët
Gjithsej	8,533	184		8,262	2,360		41	218		

Tabela 59. Sipërfaqja e banimit ekzistuese dhe e planifikuar për banorët rezident

⁶⁰ Si rezultat i te dhënave për njësi të banimit në nivel të vendbanimeve rurale, dendësia e llogaritur është e përgjithshme

Vendbanimi	Gjendja ekzistuese			Gjendja e planifikuar		
	Sipërfaqja e banimit (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Raporti sipërfaqe e banimit dhe sipërfaqja e ndërtuar (%)	Sipërfaqja e banimit (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar ⁶¹ (ha)	Raporti sipërfaqe e banimit dhe sipërfaqja e ndërtuar (%)
Dimcë	4	6	75	4	8	62
Dremjak	6	10	57	6	11	54
Gorancë	21	42	50	23	201	23
Han i Elezit	23	82	28	28	95	31
Krivenik	9	22	42	10	87	11
Neçavc	2	10	24	3	53	6
Paldenicë	50	90	55	59	112	53
Pustenik	20	35	57	21	55	38
Rezhancë	14	24	58	20	56	36
Seçishtë	35	46	77	44	66	66
Vërtomicë	/	1	/	/	2	

Tabela 60. Sipërfaqja e banimit në raport me sipërfaqen e ndërtuar

Qyteza e Hanit të Elezit – do të jetë një kryesore, e cila për nga madhësia është klasifikuar si vendbanim i madh rural dhe sipas funksioneve që do të zhvillohen si Qendër e rendit të mesëm. Për shkak të lokacionit gjeografik, lidhjeve të mira përmes infrastrukturës nacionale dhe traditës industriale e mikpritëse, qyteza do t'i ofrojë shërbimet për fshatrat përreth dhe fshatrat e largëta përmes lidhjeve të mira infrastrukturore të cilat planifikohen të përmirësohen në të ardhmen. Strategjia e zhvillimit të qytezës do të bazohet në modelin e zhvillimit hapësinor kompakt dhe të qëndrueshëm. Prandaj, qendra e qytezës në krahasim me pjesën periferike do të ketë intensitet më të lartë të zhvillimit, në të cilën kryesisht do të akomodohet shfrytëzimi i përzier, që në mungesë të tokës për ndërtim do të arrihet përmes plotësimit dhe dendësimit vertikal, në mënyrë që të sigurohet hapësira e mjaftueshme për shfrytëzimet tjera si komerciale, gjelbërim, rekreim, etj. Përderisa, pjesa periferike e qytezës do të ketë intensitet të ulët të zhvillimit, në të cilën do të zhvillohet banimi individual me etazhitet të ulët, si dhe shërbimet sociale e tregtare. Poashtu, ashtu si qendra edhe pjesa periferike e qytezës do të zhvillohet me modelin e kompaktësimit por me zgjerim minimal të kufirit ekzistues të ndërtimit. Me koncept synohet të kufizohet zgjerimi i zhvillimeve drejt tokës bujqësore, me ç'rast siguri i sipërfaqes së nevojshme për zhvillimet e planifikuara do të arrihet përmes plotësimit dhe dendësimit.

Paldenica dhe Goranca – një sekondare/mbështetëse të njëjës kryesore, për nga madhësia janë klasifikuar si vendbanim i mesëm i madh rural dhe i mesëm rural, ndërsa sipas funksioneve që zhvillohen në to i përkasin modelit të Qendrave të rendit të ultë. Për shkak të pozitës gjeografike dhe intensitetit të zhvillimit vendbanimet Pladenicë dhe Gorancë janë përcaktuar si nën qendra. Për dallim nga përcaktimi i PZHK-së në fuqi të një njeje sekondare që ishte vendbanimi Gorancë, me këtë PZHK janë caktuar dy njëje, me qëllim të ofrimit të shërbimeve elementare sa me afër qytetarëve të vendbanimeve përreth, ashtu që të parandalohet migrimi në qytezë, Gorancë apo edhe jashtë komunës.

Këto dy vendbanime do të shërbejnë si korridore që do të lidhin vendbanimet tjera me një kryesore qytezën e Hanit të Elezit në të cilat do të zhvillohen funksionet elementare të shërbimeve

⁶¹ Përfshihet sipërfaqja e planifikuar për Prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme

sociale si shkollat fillore dhe AMF-të, në Gorancë do të zhvillohet zona ekonomike, dhe shërbimet tregtare të vogla, bujqësia e blegtoria përfshirë dhe shfrytëzimet në funksion të tyre në të dy vendbanimet. Në këto dy nyje do të ofrohen shërbimet sociale, kulturore dhe publike për vendbanimet rurale më të vogla që ndodhen në afërsi të tyre dhe do të shërbejnë si korridore që do të lidhin këto vendbanime me nyjen kryesore qytezën e Hanit të Elezit. Duke pasur parasysh që do të inkurajohet zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë koncepti do të kufizoj zgjerimin drejt tokës bujqësore e pyjore ku do të planifikoj zhvillimin bazuar në modelin kompakt. Ky model do të arrihet përmes plotësimit dhe dendësimit dhe zgjerimit minimal të kufirit ekzistues të ndërtimit. Qendrat e vendbanimeve do të kenë intensitet të mesëm të zhvillimit ndërsa periferia të ulët.

Vendbanimi Seçishtë në krahasim me vendbanimet tjera rurale, ka intensitet të mesëm të zhvillimit, dhe është klasifikuar si vendbanim i mesëm i madh rural dhe bazuar në funksionet që do të zhvillohen si qendër e rendit të ulët. Për shkak të afërsisë me qytezën e Hanit të Elezit, banorëve do t'ju ofrohen shërbimet nga qyteza.

Vendbanimet tjera si Pusteniku, Rezhancë dhe Krivenik për nga madhësia janë klasifikuar si vendbanime të vogla rurale, Dimca si vendbanim shumë i vogël rural, ndërsa sipas funksioneve që planifikohen të zhvillohen janë kategorizuar si Qendra bazike. Në këto vendbanime do të ketë intensitet të ultë të zhvillimit të banimit dhe shërbimeve tregtare, ndërsa te lartë të bujqësisë, blegtorisë dhe shfrytëzimeve në funksion të tyre. Duke pas parasysh që inkurajohet zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë, koncepti planifikon mbrojtjen e tokës bujqësore e pyjore dhe kufizimin e zhvillimit drejt saj. Si rrjedhojë nevojat për zhvillime në të ardhmen do të sigurohen brenda sipërfaqes ekzistuese ndërtimore. Banimi mbetet individual me mundësi për zhvillim të 2-3 njësive brenda një tërësie në rastet e lidhjeve familjare.

Vendbanimet e depopulluara Dërmjak, Neçavc dhe Vërtomicë për nga madhësia janë klasifikuar si vendbanime shumë të vogla rurale dhe sipas funksioneve janë përcaktuar si qendra bazike. Me qëllim të ringjalljes së këtyre vendbanimeve koncepti planifikon t'i zhvilloj si nyje turistike në të cilat do të zhvillohen me intensitet të mesëm të shërbimeve tregtare, hoteliere, rekreative e argëtuese, bujqësia, blegtoria dhe vila, përderisa shërbimet sociale do të ofrohen nga nyjet sekondare.

Për t'i shtuar vlerë zhvillimeve të planifikuara planifikohet rehabilitimi dhe zgjerimi i infrastrukturës teknike dhe të transportit dhe transportit publik për të gjithë dhe hapësirat e gjelbra. Gjatë planifikimit të zhvillimeve është marrë parasysh mbrojtja e resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore.

Raporti i VSM-së ka propozuar masat që duhet ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit, e të cilat janë:

- *përgaditja e ekipit dhe nje plani të menaxhimit të ndërtimeve;*
- *përgaditja e projekteve për gjelbrim, parqe dhe tampon zona;*
- *aplikimi i moratoriumit për ndërtimet edhe në të gjitha zonat jashtë kufinjve të propozuar ndërtimor;*
- *hartimi i PRrH-ve për vendbanimet në konceptin e zhvillimit policentrik.*

9.4.10 Banimi

Vlerësimi i gjendjes tregon që në komunë mbizotëron banimi individual me 97.7% ndërsa pjesa tjetër me banim kolektiv. Sipas të dhënave nga Regjistrimi i popullsisë në vitin 2024 në komunë janë gjithsej 1,914 njësi të banimit, dhe nga këto njësi rreth 14.7% janë të pa banuara që kryesisht banohen nga banorët jo rezident të komunës. Etazhiteti aktual i ndërtesave të banimit në komunë sillet nga P+1, P+2 dhe P+3, vetëm në qendër të qytezës shkon deri në P+8 kate.

Bazuar në gjendjen ekzistuese, dendësia njësi banimi ne hektarë për zonën urbane është 21 njësi banimi/ha, ndërsa për zonën ruale është 7-8 njësi banimi/ha, në mënyrë që të arrihet kompaktësimi i vendbanimeve është planifikuar që në disa vendbanime të rritet dendësia e tyre. Prandaj, për plotësimin e nevojave të ekonomive familjare rezidente të projektuara është vlerësuar që sipërfaqja neto e nevojshme të jetë rreth 50ha. Sa i përket, popullsisë jo rezidente, nisur nga interesimi gjithnjë e më i madh i tyre për të jetura në qytezë, sipërfaqja për nevojat e banimit është planifikuar përmes dendesimi respektivisht rritjes se etazhitetit, që në zonën qendrore të sja do të jetë deri në 40 njësi banimi/ha gjegjësisht 140b/ha, kurse në periferi deri në 9 njësi banimi/ha apo 30b/ha.

Në nënqendrat Paldenicë dhe Gorancë si dhe në vendbanimin Seçishtë në krahasim me vendbanimet tjera është rritur dendësia e banimit deri në 15 njësi banimi/ha apo 50 b/ha, sa i përket Gorancës dendësia është rritur pasi që janë llogaritur edhe familjet e banorëve jo rezident por edhe ndërtimi i vilave duke marrë parasysh qe do të jetë njëra nga nyjet turistike.

Në vendbanimet Dimcë, Dremjak, Pusteni, Rezhancë, Krivenik dhe Neçavc dendësia e planifikuar është deri në 9 njesi banimi / ha apo 30b/ha, sa i përket fshatit Neçavc për shkak të zhvillimeve dhe interesimit është alokuar siperfaqe edhe për ndërtimin e vilave pasi që është njëra nga nyjet me rëndësi turistike.

Vendbanimi	Popullsia e projektuar 2033	Ekonomitë familjare			Sipërfaqja neto e nevojshme e banimit (ha)	Dendësia e planifikuar e banimit njësi banimi/ha	Dendësia e planifikuar e banimit b/ha
		2024	2033	Shtesë	Shtesë		
Dimcë	138	30	39	9	1	9	30
Dremjak	100	22	29	7	1	9	30
Gorancë	637	157	182	24	2	15	50
Han i Elezi	2,555	521	730	209	5	9 - 40	30 - 140
Krivenik	169	42	48	6	1	9	30
Neçavc	97	21	28	7	1	9	30
Paldenicë	1,629	332	465	133	9	15	50
Pusteni	322	82	92	10	1	9	30
Rezhancë	487	99	139	40	5	9	30
Seçishtë	2,123	433	607	173	11	15	40
Vërtomicë	4	/	/	/	/	2	50
Gjithsej					41		

Tabela 61. Sipërfaqja e banimit për ekonomitë familjare shtesë

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të banimit dhe mbrojtjes se mjedisit zhvillimet në te ardhmen do te promovohen dhe mbështeten masat qe kanë të bëjnë me eficiencën e energjisë dhe sigurimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, poashtu dhe do të sigurohet që kushtet apo standardet për ndërtime, mbrojtje të resurseve natyrore të respektohen si nga qytetarët poashtu dhe ndërtuesit.

Me PZHK gjithashtu planifikohet ofrimi i banimit të qëndrueshëm për ngritje të standardit të jetesës duke ofruar kushte për banim të përballueshëm dhe zvogëlim të nevojave për banim social përmes zhvillimit ekonomik dhe punësimit.

Përmes hartimit të politikave të banimit, zhvillimit me dendësi adekuate do të ofrojë kushte për shërbime adekuate urbane dhe sociale që mbështeten ne zhvillimin qëndrueshëm të banimit. Ketë do ta bëjë:

- duke ofruar sipërfaqe të mjaftueshme për banim për të gjitha kategoritë përmes planifikimit të shfrytëzimit të tokës dhe duke hartuar politika adekuate të banimit;

- dendësimi të planifikuar dhe krijimit të hapësirave adekuate për banim;
- ofrimin e shërbimeve infrastrukturore teknike dhe sociale, krijimit të hapësirave publike; dhe
- monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimit hapësinor të banimit

Komuna gjithashtu do të zhvillojë politika që të krijojë kushte për banim të përballueshëm dhe për të zvogëluar nevojat për banim social. Përmes programeve të banimit do të adresohen kërkesat e banimit social duke siguruar banim adekuat për familjet në nevojë dhe duke marr masa për integrim social dhe punësim për të zvogëluar kërkesat. Të monitorojë dhe menaxhojë zhvillimin hapësinor të banimit të ofrojë kushte adekuate publike sociale të cilat mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të banimit.

Komuna ka të hartuar një program 3-vjeçar të banimit në bazë të cilit jepen kriteret dhe përzgjedhja për mbështetje për familjet që kanë nevojë për strehim. Gjithashtu ka konsideruar llojet e zhvillimeve të nevojshme (ndërtimi i njësive të reja banesore të cilat jepen me qira joprotabile; adaptimi i objekteve ekzistuese për banim; sigurimi i banimit me kushte të volitshme për banim, etj.).

(Burimi: Programi i Banimit, Komuna Han të Elezit (2022-2024))

Nëse krahasohen me zhvillimet e planifikuara me PZHK-në në fuqi nuk ka ndonjë ndryshim, përpos rritja e numrit të njësive të banimit për popullatën shtesë.

9.4.11 Vendbanimet joformale

Në komunë ekziston një vendbanim joformal në Lagjen Brava ngjitur me Qytezën, i cili është i ngritur në tokën publike pronë e Agjencionit të Pyjeve të Kosovës. Vendbanimi banohet nga 170 banorë dhe ka 34 njësi individuale të banimit. Komuna ndër vite është përkushtuar ka investuar në infrastrukturë teknike, të transportit dhe sociale në mënyrë që të krijoj kushte të njëjta si vendbanimet formale. Mirëpo problematike mbetet çështja e pazgjidhur e pronës.

Komuna është e përkushtuar në zgjidhjen e çështjes përmes hartimit të programit me metodologjinë për rregullimin e vendbanimit joformal, respektivisht rregullimin e çështjes së pronësisë në Lagjen Brava.

Gjate hartimit të programit Komuna do të bazohet në udhëzimin administrativ MMPH Nr. 8/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, në doracakun për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga MMPHI dhe do të kërkojë ekspertizë nga MMPHI dhe organizatat ndërkombëtare për të ju qasur sa më mire kësaj problematike.

9.4.12 Ndërtimet pa leje

Si rezultat i mungesës së planifikimit të mirëfilltë e të kontrollit dhe mungesës së njohurisë dhe informimit të qytetarëve sidomos në zonat rurale në komunë ka mjaft ndërtesa të ndërtuara pa leje. Sipas kërkesës ligjore komuna ka krijuar regjistrin e ndërtimeve pa leje në mënyrë që të ketë një pasqyrë të qartë të ndërtimeve ilegale brenda territorit të komunës. Sipas vlerësimit Komuna e Haniti të Elezit ka ndërtime pa leje si rezultat i Sipas regjistrin të komunës së Hanit të Elezit të përpiluar në vitin 2015, në komunë janë gjithsej 1,822 ndërtesa pa leje, prej të cilave 1,472 shtëpi banimi, 27 ndërtesa komerciale, 283 shtall, 35 garazha dhe 6 depo.

Kjo bazë e të dhënave do të ndihmojë në trajtimin e ndërtimeve pa leje që do të behët bazuar në Ligjin 08/L-184 për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr.06/L-024 për trajtimin ndërtimeve pa leje. Në bazë të përgjegjësisë të caktuar me ligj Komuna pas shqyrtimit të kërkesave do të vazhdojë të trajtojë ndërtimet tjera pa leje në territorin komunal. Komuna planifikon të krijoj mekanizma për raportimin, thjeshtësoj procedurat për marrjen e lejeve të ndërtimit, duke e bërë atë më të lehtë dhe më të shpejtë për qytetarët, organizimi i fushatave për të informuar qytetarët mbi rëndësinë e ndërtimit të ligjshëm dhe pasojat e ndërtimeve pa leje. Për më tepër do të ofroj informacione në lidhje me kërkesat për ndërtim dhe procedurat.

9.4.13 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Përcaktimi i llojit të shfrytëzimeve për 8 vitet e ardhshme është bërë duke u bazuar në vlerësimet e situatës në komunë si dhe nevojave të identifikuara në bashkëpunim me palët e interesit gjatë takimeve dhe punëtorive të mbajtura. Si përfundim, është rekomanduar që zhvillimet të planifikohen duke pas parasysh shfrytëzimin racional të tokës dhe mbrojtjen e resurseve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, gjë që do të arrihet përmes plotësimit dhe dendësimit si dhe zgjerimit minimal të kufinjve ndërtimor të Qytezës dhe vendbanimeve Gorancë dhe Paldenicë. Tabela më poshtë jep një pasqyrë të llojit të shfrytëzimeve të planifikuara në komunë dhe sipërfaqet e tyre.

Kodi HILUCS 1	Klasa HILUCS 1	Kodi HILUCS 2	Klasa HILUCS 2	Sipërf. (ha)	%
1	Prodhim parësor	1.1	Bujqësi	2,270	27.3
		1.2	Pylltari	4,785	57.6
		1.3	Minierë dhe gurore	338	4.1
2	Prodhim dytësor	2.1	Industria e prodhimit	35	0.4
			Prodhim i energjisë së ripërtërishme	271	3.3
3	Prodhim tretësor	3.1	Shërbim tregtar	6	0.07
		3.2	Shërbim profesional financiar dhe i informacionit		
		3.3	Shërbim i komunitetit	39	0.5
		3.4	Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	110	1.3
4	Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukt urës publike	4.1	Rrjetet e transportit	150	1.8
5	Banim	5.1	Banim i përhershëm me një njësi banimi	217	2.6
		5.2	Banim me funksione tjera në pajtueshmëri	10	0.1
6	Zonë e mbrojtur ujore	6.3	Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	86	1.0
Gjithsej				8317	

Tabela 62. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës


Sipërfaqet për shfrytëzim të banimit, shërbimeve të komunitetit, tregtare kanë zgjerim minimal, si rezultat i shfrytëzimit të hapësirave brenda kufirit ndërtimor, vetëm në vendbanimet më të mëdha është planifikuar zgjerim minimal i tokës ndërtimore.

Banim - sipërfaqja e banimit në vendbanimet Gorancë dhe Naçevc të planifikuara si nyje turistike është rritur për ndërtim të vilave dhe për të akomoduar nevojat e popullatës jo rezidente.


Minierë dhe gurore – sipërfaqja e rezervuar për këtë shfrytëzim ka rritje për shkak të potencialit që kanë këto zona për nxjerrjen e mineraleve, megjithatë zonat e sakta do të definohen nga gjetjet e hulumtimeve që do të kryhen.

Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ - sipërfaqja e planifikuar për këtë shfrytëzim është rritur për 109 ha si rrjedhojë e përfshirjes së sipërfaqes pyjore në vendbanimet Vërtomicë/Necavc dhe Gorancë për rekreim të qytetarëve dhe vizitorëve, e cila tashmë shfrytëzohet nga vizitorët e kësaj ane për piknik dhe rekreim. Sipërfaqja është tokë publike prandaj do të mbetet kryesisht si hapësirë gjelbëruese në të cilën planifikohet të vendoset mobilia urbane dhe ndërtohen shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta. Kjo sipërfaqe do t'i shtojë vlerë vendbanimeve tashmë të zbrazura e me PZHK planifikohet të ringjallen përmes përcaktimit të tyre si nyje të rëndësishme për zhvillim të turizmit.


Prodhim i energjisë së ripërtërishme – sipërfaqet potenciale për zhvillim të këtij shfrytëzimi janë alokuar në disa pjesë të territorit, mirëpo studimet që planifikohen do të përcaktojnë lokacionet e sakta.




Harta 26. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës



Harta 27. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në zonën urbane



Harta 28. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës, nën – qendra Paldenicë




ndërsa 2 nyjet tjera si Qendra të rendit të ultë ku përveç shërbimeve administrative dytësore dhe sociale të nivelit të njëjtë me Qytezën, do të kishin të zhvilluar edhe ekonominë përmes turizmit, shërbimeve sociale e publike dhe tregtare. Me atë rast, për shkak të vështirësive të kompaktësimit, 2 qendrat e rendit të ultë do të zhvilloheshin horizontalisht kryesisht me banim, funksione përcjellëse dhe funksione ekonomike.


Përparësitë – zhvillim më i shpërndarë territorialisht sipas potencialit të lokacioneve; numër i caktuar i shërbimeve tregtare të konsoliduara, shërbime sociale cilësore të shpërndara më mirë për banorët lokal.

Mangësitë – vështirësi e kontrollit të zhvillimit dhe udhëheqjes së tij në 3 nyjet e përzgjedhura, dëmtimi fondit të tokave bujqësore dhe pyjore, dëmtim i resurseve turistike nga zhvillime individuale, pamundësi e plasimit të paketës së tërësishme turistike komunale, etj.

Sipas vlerësimit, aspektet pozitive nga ky skenar janë planifikuar të futen në skenarin respektivisht konceptin zhvillimor të dakorduar.



Harta 30. Skenari 1



Harta 31. Skenari 2


Skenari i dakorduar–Skenari 1 (zhvillim qendror) - me propozime pozitive të integruara nga skenari 2 (zhvillim i decentralizuar) - me këtë skenar zhvillimi të dakorduar parashihet zhvillim i qëndrueshëm dhe i balancuar mes Qytezës si një kryesore dhe dy nën qendrave si një sekondare, në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve të saj.

Skenari i dakorduar propozon zhvillimin e Qytezës si një kryesore, e cila do të ofroj shërbimet kryesore administrative, sociale, publike, kulturore dhe komerciale për të gjithë qytetarët e komunës në mënyrë të barabartë. Përpos përmirësimit të cilësisë së shërbimeve si në aspekt të infrastrukturës ashtu dhe të shërbimeve, skenari propozon edhe përmirësimin e qasjes në qytezë por edhe brenda saj përmes rehabilitimit dhe zgjerimit të infrastrukturës së transportit motorrik por aty ku është e mundur edhe atij jo motorrik, masa që do të përmirësojnë jo vetëm qarkullimin e sigurinë në trafik por edhe do të ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit. Poashtu, planifikohet edhe zgjerimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës teknike si dhe përmirësimi i shërbimeve që gjithashtu do të kenë ndikim në mbrojtjen e mjedisit. Qyteza do të jetë edhe një e zhvillimit të industrisë dhe shërbimeve mbështetëse të saj, me qëllim të zvogëlit të ndikimit në mjedis inkurajon aplikimin e teknologjive të reja. Përpos, industrisë në qytezë propozohet edhe zhvillimi i shërbimeve tregtare dhe në masë më të vogël bujqësore. Meqenëse qyteza është e pasur me asete të trashëgimisë kulturore skenari

propozon edhe zhvillimin e turizmit gjithnjë duke pas parasysh mbrojtjen e tyre. Sic u përmend më lartë, skenari propozon edhe qendrat sekondare dhe qendrat e përzgjedhura turistike të cilat i bashkëngjiten hartës zhvillimore të komunës me qëllim të shfrytëzimit maksimal të natyrës, trashëgimisë dhe kapaciteteve komunale gjithnjë duke e balancuar atë me zhvillim bujqësor të kufizuar, zhvillim pyjor dhe mbrojtje të mjedisit. Ashtu si në qytezë edhe në nyjet sekondare do të përmirësohet infrastruktura dhe cilësia e shërbimeve sociale, infrastruktura e transportit për të siguruar lidhje më të mira me qytezën dhe lëvizshmëri të sigurtë dhe infrastruktura teknike.

Gjithashtu, rekomandohet për gjithë komunën krijimi i hapësirave dhe brezave të gjelbër por edhe përdorimi i burimeve të ripërtërishme që do të ndihmonin në zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Deri te ky propozim zhvillimor i dakorduar erdhi bazuar në potencialet reale të komunës, duke i marrë për bazë aspektet pozitive nga skenarët e mëparshëm dhe duke pasur si synim strukturimin e të gjitha potencialeve dhe ambicieve të banorëve të Komunës.



Harta 32. Skenari i përvetësuar

10 Prioritetet e zhvillimit Strategjik dhe Plani i veprimit

10.1 Prioritetet zhvillimore strategjike

Bazuar në nevojat e identifikuara me analizën e gjendjes ekzistuese të komunës është përcaktuar vizioni, qëllimet dhe objektivat e tij, të cilat do të realizohen sipas prioritetit që kanë për qytetarët dhe komunën. Prioritetet janë përcaktuar në bashkëpunim me ekipin komunal të planifikimit dhe në konsultim me palët e interesit, të cilat janë prezantuar në tabelën më poshtë.

Qëllimet	Prioritet strategjike (1-2 prioritet i lartë, 3 -4 prioritet mesatar, 5 Prioritet i ulët)
Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri Qëllimi 8 – Krijimi i një mjedisi të sigurt përmes përmirësimeve organizative, mjedisore dhe adresimit të ndryshimeve klimatike Prioriteti strategjik 1. Përmirësimi i mjedisit dhe parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë	1
Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike Qëllimi 9 – Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore/ biodiversitetit Prioriteti strategjik 2. Parandalimi i degradimit të trashëgimisë kulturore dhe resurseve natyrore	1
Ekonomia Qëllimi 7 - Nxitje e zhvillimit ekonomik bazuar në potenciale lokale Prioriteti strategjik 3. Mbështetja dhe përmirësimi i kushteve për zhvillimin e sektorëve të industrisë, tregtisë dhe bujqësisë Prioriteti strategjik 4. Zhvillimi i kapaciteteve dhe krijimi dhe sigurimi i zonave për zhvillim të turizmit	2
Infrastruktura e Transportit dhe Transporti Qëllimi 5 – Ofrimi i lëvizshmërisë optimale dhe të sigurtë për qytetarët dhe vizitorët Prioriteti strategjik 5. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës së transportit dhe i shërbimeve të transportit	3
Infrastruktura teknike dhe shërbimet Qëllimi 6 – Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve teknike baras për të gjithë qytetarët Prioriteti strategjik 6. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës teknike dhe i shërbimeve	3
Infrastruktura Publike dhe Sociale Qëllimi 4 – Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve sociale baras për të gjithë qytetarët Prioriteti strategjik 7. Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës dhe i shërbimeve sociale	4
Vendbanimet Qëllimi 1 – Zhvillimi i vendbanimeve sipas modelit kompakt Prioriteti strategjik 8. Zhvillimi kompakt i vendbanimeve dhe kontrolli i ndërtimeve	5
Banimi	5

Qëllimi 2 – Përmirësimi i kushteve të banimit Prioritetet strategjike 9. Krijim i mundësive për banimi të përballueshëm Prioriteti strategjik 10. Zbatimi i strategjisë së banimit	
Popullsia dhe gjithë përfshirja në vendimmarrje Qëllimi 3 – Qytetarët e informuar/ me njohuri të nevojshme dhe të përfshirë në vendim-marrje Prioriteti strategjik 10. Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse	5
Shfrytëzimi i planifikuar i tokës Qëllimi 1: Shfrytëzimi racional i tokës me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm Prioriteti strategjik 11. Sigurimi që zhvillimet të jenë në përputhje me hartën e shfrytëzimit të planifikuar të tokës dhe kushtet e përcaktuara me dokumentet e planifikimit hapësinor	6

Secili prioritet strategjik është zbërthyer në aktivitete të cilat do të realizohen brenda afateve të përcaktuara sipas prioritetit që kanë, realizimi i të cilave do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit për një zhvillim të qëndrueshëm të komunës sonë. Në përgjithësi, aktivitetet përfshijnë zhvillimin e kapaciteteve për treg të punës dhe sigurimin e vendeve të reja të punës përmes mbështetjes së hapjes së bizneseve, ndërtimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve sociale, publike, teknike dhe të transportit, dhe mbrojtjen e resurseve. Aktivitetet e planifikuara janë si në vijim:

10.1.4 Mjedis dhe sipërfaqet në rrezikshmëri

Prioriteti strategjik 1. Përmirësimi i mjedisit dhe parandalimi i rrezikut nga fatkeqësitë

Menaxhimi i mbeturinave

- Zbatimi i planit për menaxhimin të mbeturinave dhe hartimi i tij pas skadimit;
Zbatohet nga kompania rajonale dhe komuna e Hanit të Elezit
Planifikohet të zbatohet për 3 vite
Ka ndikim pozitiv në mjedis
Zbatohet nga financimi komunal
- Largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale dhe parandalimi i krijimit të deponive të reja;
Zbatohet nga kompania rajonale dhe komuna e Hanit të Elezit
Planifikohet të zbatohet për 1 vit
Ka ndikim pozitiv në mjedis
Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Ofrimi i shërbimeve për mbledhje të mbeturinave në fshatrat e pambuluara;
Zbatohet nga kompania rajonale dhe komuna e Hanit të Elezit
Planifikohet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme
Ka ndikim pozitiv në mjedis
Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Bashkëpunimi me komunat fqinje për menaxhim të përbashkët të mbeturinave në zonat ndërkufitare komunale;
Zbatohet nga kompania rajonale, komuna e Hanit të Elezit dhe komunat ndërkufitare
Planifikohet të zbatohet për 2 vite
Ka ndikim pozitiv në mjedis
Zbatohet nga financimi komunal
- Ndërtimi i deponisë për grumbullimin e mbetjeve inerte nga rrënimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;

- Zbatohet nga kompania rajonale dhe komuna e Hanit të Elezit
- Planifikohet të zbatohet për 2 vite
- Ka ndikim pozitiv në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Zvogëlimi i volumit të mbeturinave të deponuara përmes ndarjes në burim dhe përmes shfrytëzimit të deponisë transfer;
- Zbatohet nga kompania rajonale dhe komuna e Hanit të Elezit
- Planifikohet të zbatohet për 2 vite
- Ka ndikim pozitiv në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë

Mbrojtja e ujit

- Monitorimi i ndotjes së ujërave;
- Zbatohet nga kompania rajonale
- Planifikohet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme
- Ka ndikim pozitiv në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Hartimi i planeve për menaxhim të integruar të ujërave;
- Zbatohet nga kompania rajonale
- Planifikohet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme
- Ka ndikim pozitiv në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Rehabilitimi i sipërfaqeve të ndotura dhe parandalimi i ndotjes;
- Zbatohet nga kompania rajonale
- Planifikohet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme
- Ka ndikim pozit në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Shfrytëzimi i ujërave dhe sipërfaqeve bregore/ të afërta për zhvillime socio-ekonomike në përshtatshmëri me mjedisin dhe ujërat;
- Zbatohet nga kompania rajonale dhe komuna e Hanit të Elezit
- Planifikohet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme
- Ka ndikim pozit në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë

Mbrojtja e ajrit

- Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilesi të Ajrit me qëllim të reduktimit të ndotjes së ajrit;
- Zbatohet nga komuna e Hanit të Elezit dhe donatorë
- Planifikohet të zbatohet për 2 vite
- Ka ndikim pozitiv në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
- Monitorimi i ajrit dhe zhurmës;
- Zbatohet nga komuna e Hanit të Elezit dhe MMPHI
- Planifikohet të zbatohet në mënyrë të vazhdueshme
- Ka ndikim pozitiv në mjedis
- Zbatohet nga financimi komunal dhe donatorë
